



PRESIDENTI I AUSTRISË NDERON REKTORIN EDMOND HAJRIZI ME MEDALJEN E ARTË TË MERITAVE



*Intervistë e rektorit të UBT-së,
Prof. Dr. Edmond Hajrizi*

**UBT në vitin 2025: Arritjet,
sfida dhe perspektivat
për të ardhmen**



UBT rangohet në mesin e

**TOP
200**

institucioneve më të mira për krijimin e
kampuseve të gjelbra dhe të qëndrueshme,
sipas **UI GreenMetric World University Ranking**

www.ubt-uni.net



EFQM Global Award 2022



presented to
University for Business and
Technology

October 2022

Russell Longmuir
CEO, EFQM



25 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education | Research | Training | Consulting

2001/2025

IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Numrin e përgatiti: Media Grupi i UBT-së

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Albert Zuka

Intervistë e rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi

UBT në vitin 2025: Arritjet, sfida dhe perspektivat për të ardhmen

UBT vazhdon të jetë lider dhe një nga institucionet më inovative dhe të avancuara të arsimit të lartë në Kosovë dhe rajon. Me fokus në teknologji, kërkim shkencor, zhvillim të qëndrueshëm dhe lidhje të ngushta me industrinë, UBT është bërë një qendër e ekosistemit të dijes dhe inovacionit. Në këtë intervistë të fundvitit 2025, me Presidentin dhe Themeluesin, Rektorin, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, diskutohet zhvillimi i institucionit, roli i tij në edukimin dhe përgatitjen e studentëve për sfidat globale, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe iniciativat që e bëjnë UBT një model të suksesshëm në arsim dhe shoqëri.

1. Rektor Hajrizi, këtë fundvit ju u nderuat me Medaljen e Artë të Meritave nga Presidenti i Austrisë, një çmim i lartë shtetëror me peshë të madhe ndërkombëtare. Çfarë përfaqëson për ju personalisht kjo dekoratë dhe çfarë do të thotë për Kosovën?

Po, ishte një çmim jetësor, mund të themi, sepse bëhet fjalë për një nga çmimet që shteti austriak ka dhënë historikisht – që nga koha e monarkisë e deri më sot. Austria vlerëson personalitete që kanë kontribuar në ndërtimin, zhvillimin dhe promovimin e vlerave, inovacionit dhe kulturës austriake.

Në këtë pikë, jam shumë i lumtur që më është njohur angazhimi im tashmë 30-vjeçar në bashkëpunim me Austrinë, për Austrinë dhe për Kosovën. Është diçka që natyrisht të bën të ndihesh mirë kur një shtet me vlera të konsoliduara, siç është Austria, i konsideron angazhimet e tua si vlera të këtij niveli dhe të këtyre standardeve.

Për mua, kjo është edhe një kënaqësi e veçantë, duke pasur parasysh se vij nga Kosova, dhe një dëshmi se edhe ne shqiptarët mund të gjenerojmë vlera që vlerësohen nga shtete me një traditë të lashtë në konfirmimin e rezultateve dhe kontributeve shkencore e akademike, në fushën e inovacionit, teknologjisë, bashkëpunimit ndërshtetëror dhe ndërinstitucional, si dhe në aspektin e arritjeve personale.

Kështu që, mendoj se kjo përfaqëson një përmbledhje dhe përmbyllje të denjë të këtij angazhimi 30-vjeçar, duke mbetur gjithmonë me një vullnet dhe përgjegjësi të madhe për implementimin e këtyre vlerave edhe në UBT, natyrisht.

2. Gjatë vitit 2025, ju keni marrë edhe disa vlerësime të tjera madhore, si "Doctor Honoris Causa" në Tiranë, anëtarë-



simin në Akademinë Evropiane të Shkencave, si dhe mirënjohje ndërkombëtare për paqe dhe inovacion. Si reflektoni mbi këtë vit të jashtëzakonshëm të kontributeve dhe njohjeve ndërkombëtare?

Unë mendoj se tashmë kemi një përvojë dhe një kontribut, i cili, fatmirësisht, vlerësohet. Mbi këtë bazë, jam shumë i lumtur që në këtë përvjetor kemi arritur që institucione dhe organizata të ndryshme, me kriteret e ndryshme, të na vlerësojnë për punën tonë. Jam jashtëzakonisht i lumtur për këtë, sepse ka qenë një vit me shumë mirënjohje. Duke filluar nga përzgjedhja si lider botëror i udhëheqjes universitare, kjo është një ndjenjë shumë e mirë. Modeli që kam implementuar dhe zhvilluar gjatë këtyre viteve është vlerësuar si një nga udhëheqjet më të mira të universiteteve në botë.

Mendoj se kjo është një kënaqësi jo vetëm për ne, por edhe një dëshmi se praktikët e mira të lidhshimit nuk gjenden vetëm në universitetet me reputacion qindvjeçar, por edhe në struktura dhe institucione të reja, në vende në tranzicion. Ju e dini që nuk ka qenë e lehtë të ndërtoj një institucion nga zero, por gjithmonë kemi punuar me një strategji dhe model të qartë, inovativ, me praktika të mira, të lidhura me realitetin dhe me vizion. Në këtë mënyrë, kemi arritur të krijojmë një model që tashmë është shumë i njohur dhe i qasshëm në botë, i njohur për publikimet shkencore, çmimet e ndryshme dhe njohjen ndërkombëtare.

Organizata botërore që merret me vlerësimin e lidhshimit konfirmon këtë, dhe ne gjithmonë kemi pasur mision për Kosovën dhe për ne si shqiptarë. Kjo bën

që kënaqësia të jetë edhe më e madhe, sepse nuk është vetëm çmimi personal, por fakti që Kosova arrin të pozicionohet në këtë nivel.

Gjithashtu, kemi kontribuar shumë në vlera humane, promovimin e paqes, bashkëpunimin ndër-etnik, ndër-kulturor dhe ndërkombëtar. Kjo është një vlerësim i rëndësishëm për kontributin tonë në krijimin e një mendimi paqësor, për fëmijët dhe të rinjtë, dhe për bashkëpunimet me organizatat ndërkombëtare të paqes, siç janë ato të OKB-së. Si shqiptarë, kemi parime themelore, si familja, respekti ndaj tjetrit dhe ndihma kur ka nevojë, dhe kjo konfirmon kulturën dhe atributet tona të natyrës paqësore dhe proaktive.

Përvoja jonë përfshin edhe faza të vështira kur nuk kemi pasur liri, kur kemi përjetuar pushtim dhe shumë sfida. Këto përvoja kanë krijuar reziliencë dhe kanë mundësuar që të ndihmojmë të tjerët të kuptojnë rëndësinë e paqes dhe sigurisë.

Çmimi ishte një konfirmim i shkëlqyer, dhe pranimi im në dy akademi evropiane – Akademinë Evropiane të Shkencave dhe Akademinë Evropiane të Shkencave dhe Arteve – është një rrugëtim që kërkon konfirmim të punës shkencore dhe akademike me vite, bazuar në kriteret e caktuara dhe vlerësim nga komuniteti ndërkombëtar. Jam shumë falënderues që këto institucione prestigjioze kanë njohur kontributin tim, duke më mundësuar të jap edhe vetë kontributin tim në këto organizata. Për mua, kjo përfaqëson kulminacionin dhe konfirmimin e angazhimit tim akademik.

Gjatë viteve kemi fituar çmime për lidership, shkencë, inovacion dhe përgjegjësi

sociale, një diversitet i bukur që pasqyrohet dhe konsolidohet në një vit. Marrja e Medaljes së Artë nga Austria është një mesazh i rëndësishëm për të rinjtë dhe për të gjithë ata që punojnë me konsistencë dhe angazhim. Vlerat, kontributi dhe parimet e mira gjithmonë do të njihen. Njerëzimi e vlerëson angazhimin e sigurtë, edhe pse ndonjëherë mund të hasë burokraci ose pengesa. Por, në përgjithësi, njerëzit vlerësojnë ata që punojnë me sinqeritet dhe përkushtim – që ndërtojnë sisteme akademike dhe kontribuojnë në mirëqenien, zhvillimin e të rinjve dhe zhvillimin nacional përmes edukimit, inovacionit, kërkimit shkencor dhe ndërmarrësisë.

3. UBT u rendit këtë vit me çmime globale si Engaged University of the Year në Triple E Awards. Çfarë tregon ky për pozicionin e UBT-së në hartën botërore të arsimit të lartë?

Edhe UBT tashmë vitin e ardhshëm do të festojë 25-vjetorin, një çerek shekulli në ndërtimin e një institucioni, i cili me rezultatet e tij 25-vjeçare po demonstron qasje dhe koncepte unike të zhvillimit, si dhe impakte të veçanta në shoqëri, akademi dhe zhvillim të qëndrueshëm. Natyrisht, këto rezultate po pasqyrohen edhe në rangime ndërkombëtare dhe, bazuar në këto të dhëna, kemi filluar të marrim rangime dhe çmime në Evropë dhe në botë.

Edhe sivjet, UBT është renditur shumë mirë në fusha të ndryshme: në inovacion, në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në impaktin social, në aspektin shkencor – për shembull në fushën e inxhinierisë UBT është institucioni më i lartë – në teknologji, në inteligjencë artificiale, dhe gjithashtu ka marrë një vlerësim të veçantë si universiteti më i mirë në botë për angazhimin aktiv të universitetit në aktivitete dhe në shoqëri në përgjithësi.

Kjo do të thotë se, përveç angazhimit akademik dhe shkencor si elemente bazë funksionale, universiteti ka shkuar edhe më tej për të ndihmuar shoqërinë në zhvillimin e saj – jo vetëm në edukim, shkencë dhe trajnime, por edhe në krijimin e vendeve të reja të punës, zhvillimin ekonomik të Kosovës, rritjen e eksporteve, promovimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, si dhe ndërtimin e kapaciteteve infrastrukturore dhe humane të shtetit të Kosovës. Këto janë disa nga mekanizmat që e kanë bërë UBT-në shumë unik në relacion me konkurrencën globale, duke u zgjedhur si universiteti më i mirë në botë.

Duke marrë parasysh se kemi një histori relativisht të shkurtër, vetëm 25 vjet, UBT ka arritur vepra shumë të mëdha dhe të veçanta, të cilat komisioni i përbërë nga rreth 50 anëtarë i ka vlerësuar duke na dhënë këtë pozicion si universiteti më i mirë në botë sivjet. Kjo është një kënaqësi

e madhe, dhe mendoj se Kosova ka hyrë përmes UBT-së në shumë mekanizma dhe pika të rëndësishme botërore, duke u bërë një referencë e veçantë.

Natyrisht, gjëra të tilla nuk janë të lehta për t'u arritur. Konkurrenca ka qenë me universitetet më të njohura në botë, si ato në Kanada apo vende të tjera, të cilat kanë buxhete të konsiderueshme dhe mbështetje të fortë nga shteti. Ndërsa ne, me një financim të vetë-ndërmarrë dhe strukturë organike, kemi arritur të dalim jashtë kërkesave klasike të një universiteti, duke u fokusuar jo vetëm në edukim dhe shkencë, por edhe në fusha të tjera që nuk janë pjesë e definicioneve klasike, por që kanë qenë pjesë e misionit tonë.

UBT ka synuar të ndërtojë një institucion që ndihmon një vend që ka dalë nga lufta, një vend që ka nevojë të zhvillohet dhe të transformohet me shpejtësi, në mënyrë inovative, duke u lidhur me praktikën dhe standardet më të mira botërore. Misioni i UBT-së ka qenë shumë i veçantë, dhe kjo është arsyeja që këto çmime vazhdimisht vijnë dhe organizatat botërore po na vlerësojnë.

Si rektor dhe themelues i UBT-së, jam shumë i lumtur dhe krenar. Me gjithë stafin po punojmë shumë për të arritur dhe ruajtur një pozicion të tillë, i konfirmuar gjithashtu edhe nga organizata me renome botërore. Kjo për ne është një validim i angazhimit, dëshirës dhe pritshmërisë tonë, duke treguar se puna dhe kontributi i sinqertë gjithmonë vlerësohen.

4. Në vitin 2025 keni pasur një numër të madh vizitash dhe bashkëpunimesh ndërkombëtare në vende si Italia, Spanja, Portugalia, Gjermania, ShBA. Cilat prej këtyre bashkëpunimeve do t'i veçonit si më domethënëset për UBT-në?

Është e vështirë të veçosh një aspekt të vetëm, sepse të gjitha kanë unicitetin dhe veçantinë e tyre, si dhe vlerat që lidhen me zhvillimin tonë të përgjithshëm dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Duhet marrë parasysh se fryma e ndërtimit tonë ka qenë gjithmonë në partneritet dhe bashkëkrijim të vlerave me universitete partnere, që tashmë arrijnë numrin mbi 500. Këto institucione janë shumë aktive, po ashtu edhe ne, në mirëpritjen e organizatave dhe universiteteve që vijnë për të na vizituar. Ju e dini që kemi dhjetëra e qindra vizita, por edhe ne kemi ftesa të shumta për të qenë prezent, sidomos vitet e fundit, ku rreth 100 vende dhe institucione na kanë ftuar të prezantojmë UBT-në dhe modelin e saj, qytetin mësimor të UBT-së dhe modelet e reja të teknologjisë të avancuar në edukim. Kemi pasur kënaqësinë të prezantojmë dhe njëkohësisht të krijojmë bashkëpunime në fusha të ndryshme me universitete, kompani prestigjioze, organizata

shtetërore dhe organizata joqeveritare. Me Italinë kemi ndërtuar një bazë shumë të fortë bashkëpunimi; vitet e fundit kemi vendosur gjuhën italiane si gjuhë zyrtare studimore në kuadër të UBT-së – një iniciativë unike për herë të parë në Kosovë. Po ashtu, kemi krijuar qendrën e parë të certifikimit të gjuhës italiane dhe kemi hapur Italian Hub, për të mbështetur kompanitë dhe institucionet italiane që dëshirojnë të investojnë në Kosovë, duke u ofruar infrastrukturën dhe kompetencat tona.

Në këtë bazë kemi ndërtuar shumë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e edukimit, për diplomë të dyfishta, por edhe në aspektet e bashkëpunimit industrial dhe teknologjive të avancuara, qoftë për dronë, siguri kibernetike, ushqim, turizëm dhe fusha të tjera që karakterizojnë Italinë. Me Portugalinë kemi krijuar gjithashtu një lidhje shumë të fortë, duke vizituar shumë institucione dhe universitete prestigjioze, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi, dhe duke kontribuar në shkëmbime studentësh dhe stafesh, ndërtimin e forumeve ekonomike dhe shkencore, si dhe në anëtarësim të ndryshme globale. Lidhja me Portugalinë përforcohet edhe nga ngjashmëria kulturore dhe funksionale, përfshirë teknologjinë dhe ushqimin, duke krijuar mundësi të shkëmbimit reciprok.

UBT luan një rol të ngjashëm me atë të një ambasadori, duke përfaqësuar Kosovën dhe praktikën e saj të mira. Në Gjermani, Austri dhe shumë vende të tjera, kemi pasur vizita të veçanta. Në Bullgari kemi zhvilluar projekte shumëdimensionale për ngritjen e kapaciteteve kërkimore, bashkëpunuar me Universitetin e Sofjes dhe partnerë të tjerë për publikime shkencore dhe organizimin e konferencave dhe shkollave verore.

Në Shqipëri, Angli dhe Britaninë e Madhe kemi bashkëpunuar me universitete prestigjioze, si Universiteti i Cambridge-it, duke krijuar qasje dhe formate të reja, si cooperation labs, të njohura për inovacionin në nivel botëror. Nga ana tjetër, kemi arritur akreditime dhe formate të reja në bashkëpunim me institucione britanike.

Po ashtu, kemi bashkëpunime me vende të tjera, përfshirë Azinë, Amerikën Latine (p.sh. Kolumbi dhe Panama) dhe Afrikën. Këtë vit, UBT ka pasur një shtrirje globale në pothuajse të gjitha kontinentet, duke vizituar institucione dhe duke pritur delegacione ndërkombëtare. Një vizitë e veçantë ishte edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Sam Houston State University në Teksas, ku përveç programeve akademike dhe shkëmbimit, kemi krijuar edhe ide inovative për një lloj US Texas American Study në UBT, për të ndërtuar një ndërlidhje të vazhdueshme dhe të

shkëmbimit të përvojave. Kjo do të shërbejë gjithashtu si qendër komunikimi për institucionet amerikane në pjesën akademike dhe shkencore, edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Këto shkëmbime kanë qenë jashtëzakonisht të veçanta dhe kanë ndikuar në ngritjen e cilësisë së studimeve tona, konfirmimin e cilësisë së programeve, si dhe në zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve dhe stafit tonë. Dua t'i falënderoj të gjithë për mikpritjen, ftësën, prezantimin dhe bashkëpunimin. Është një ndjenjë shumë e mirë të shohësh një angazhim kaq të madh dhe rezultate konkrete. Në javën tjetër do të kemi vizita të veçanta në Itali, në Universitetin e Torinos dhe në Gjenevë, ku do të marrim pjesë në një konferencë të Akademisë Evropiane të Shkencës.

Kështu, po përmbillet një cikël i madh bashkëpunimesh ndërkombëtare, që është me të vërtetë unik dhe shumë dinamik, duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së studimeve, zhvillimin e stafit dhe studentëve, si dhe në aspektin shkencor dhe profesional.

5. Cilat janë marrëveshjet ose projektet më të rëndësishme strategjike që UBT ka nënshkruar këtë vit me institucione ndërkombëtare?

Unë mendoj se kemi pasur dhjetra partneritete me universitete të ndryshme në botë, me të cilat kemi lidhur marrëveshje. Përveç marrëveshjeve klasike të bashkëpunimit, këtë vit kemi qenë shumë më specifike, duke përfshirë diploma të përbashkëta, shkëmbimin e stafit dhe krijimin e qendrave të përbashkëta. Për shembull, me Turqinë dhe vende të tjera kemi krijuar edhe zona teknologjike të përbashkëta, zona virtuale teknologjike, si dhe hubs, domethënë qendra të bashkëpunimit. Po ashtu, kemi lidhur marrëveshje me industri të ndryshme për zhvillimin e produkteve të reja të përbashkëta.

Me Zvicrën, për shembull, kemi lidhur një marrëveshje shumë të rëndësishme bashkëpunimi me kompani globale, si dhe me kompani nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Izraeli, Turqia, Evropa, Austria, dhe vende të tjera. Thjesht, kemi shpërndarë shumë marrëveshje të reja, ku futemi me iniciativa inovative. Nuk po hyj në detaje specifike sepse merr kohë, por sidoqoftë, ato kanë qenë strategjike dhe kanë ndihmuar në krijimin e një "qyteti" me diversitet shumë të madh, siç është UBT.

6. UBT shënoi një rritje rekord të regjistrimeve në studime, në të gjitha nivelet dhe sidomos në programe të reja. Ku e bazoni këtë rritje të madhe dhe pse mendoni se gjithnjë e më shumë të rinj po e zgjedhin UBT-në?

Unë mendoj që, fatmirësisht, në të gjitha këto formate ekziston një ndjenjë shumë e mirë dhe pozitive, gjë që reflektohet edhe në indikatorët e studentëve, ku kemi rritje të vazhdueshme çdo vit. Kemi filluar me 20 studentë, ndërsa sot kemi mijëra studentë që vijnë dhe regjistrohen, dhe çdo vit është shënuar rritje. Kënaqësia është shumë e madhe që edhe këtë vit kemi një rritje të theksuar, duke u mbuluar plotësisht numri i vendeve që kemi pasur në dispozicion sipas akreditimit, përkundër faktit që sivjet kemi pasur kërkesa edhe më të larta. Aktualisht po punojmë që këta numra dhe programet të rriten edhe më tej.

Unë mendoj që oferta e UBT-së është një ofertë unike dhe e veçantë, për shkak se ka një diversitet shumë të madh të programeve inovative. Çdo program në UBT është ndër programet më të reja dhe më të përditësuara në nivel botëror. Kjo na konfirmon edhe fakti që ne kemi diploma që njihen në Amerikë, kemi bashkëpunime me universitete në Evropë dhe më gjerë, si dhe akreditime të ndryshme ndërkombëtare. Kjo bën që realisht studenti dhe studimet e përfunduara në UBT të jenë të bazuara në atë që quhet state of the art.

Në këtë rast, nuk ka arsye të mendohet se ka mbetur ndonjë mangësi në përmbajtje, në tematika të reja apo në emërtimet moderne të programeve që ofron UBT. Me mbi 100 specializime të ndryshme, të gjitha shumë të afërta me tregun e punës dhe me kompetencat e së ardhmes, mendoj që kjo ofertë është shumë atraktive dhe e veçantë krahasuar me institucionet e tjera, gjë që reflektohet edhe në interesimin e lartë të studentëve.

Një pjesë tjetër shumë e rëndësishme është infrastruktura moderne. UBT ka arritur t'u ofrojë studentëve një qytet të tërë universitar, duke ndërtuar qytetin e vet – Qytetin e Mençur të UBT-së – i cili përveç edukimit dhe jetës për të gjitha gjeneratat, përmban mbi 200 laboratorë funksionalë, unike dhe të kompletuar në një standard që rrallë gjendet në rajon. Përveç kësaj, janë ndërtuar mbi 80 kompani dhe funksione reale të kompanive, ku studentët kanë mundësinë të mësojnë dhe të përjetojnë aspektin industrial para se të hyjnë në tregun e punës, gjë që i bën ata shumë më të përgatitur dhe më të shpejtë në integrimin në kompetencat që kërkon tregu i punës.

Edhe nga aspekti statistikor, kënaqësia e industrisë me të diplomuarit e UBT-së është shumë e lartë. Industria jep vazhdimisht mesazhe pozitive për cilësinë e tyre, dhe kjo ndikon drejtpërdrejt edhe tek familjet dhe të rinjtë, të cilët ndërlidhen me këtë komunikim dhe shprehin interes për bashkëpunim dhe studim në UBT.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm është se ne kemi dashur ta mbajmë koston

sa më të ulët për studentët tanë, sepse kemi ndërtuar një universitet për ta, të përballueshëm me një kosto minimale. Kjo kosto është e pakrahasueshme me cilësinë që ofrojmë në nivel botëror dhe shpeshherë është shumë herë më e ulët, madje e përafërt ose nganjëherë edhe e krahasueshme me institucionet publike të vendit. Kur ofrohet njëkohësisht edhe cilësia edhe përballueshmëria financiare, krijohet një mundësi reale për talentët dhe të rinjtë që të marrin atë që e meritojnë: një shkollim cilësor në vendin e tyre, pa pasur nevojë të largohen nga familja dhe pa shpenzime enorme.

Fatmirësisht, sot të gjitha ato që të rinjtë i ëndërrojnë mund t'i gjejnë në UBT, dhe pikërisht mënyra se si UBT renditet në pozitat më të larta ndërkombëtare dëshmon se kjo është ajo që konsiderohet state of the art në arsimin e lartë.

Përveç kësaj, një rol kyç ka edhe stafi. Ne kemi një staf shumë të dedikuar, të edukuar në nivelet më të larta akademike, në universitetet dhe qendrat më të mira botërore. UBT ka raportin më të lartë dhe më cilësor të stafit të rregullt në raport me numrin e studentëve në Kosovë, duke u afruar shumë me modelet e universiteteve më të mira në botë. Kemi ndërtuar një ekip me mbi 400 doktorë të shkencave të rregullt, si dhe qindra specialistë të tjerë: magjistra, asistentë të rinj, doktorë të mjekësisë nga klinika të ndryshme, inxhinierë dhe profesionistë të fushave të ndryshme.

Njëkohësisht, kemi ftuar edhe ekspertë nga industria, të cilët sjellin përvojën e tyre praktike, si dhe profesorë dhe ekspertë ndërkombëtarë, duke garantuar një ndërkombëtarizim të vërtetë të kompetencave akademike. Studentët i kanë këto kompetenca pranë vetes, në vendin e tyre, me një përkushtim të veçantë, sikur të ishin fëmijët tanë, për t'i ndihmuar të zhvillohen dhe të punësohen. Një pjesë e madhe e tyre punësohen edhe brenda ekosistemit të UBT-së, por edhe në Kosovë dhe më gjerë.

Të gjitha këto bëjnë që UBT të ketë një interesim gjithnjë e më të madh nga studentët vendorë, por edhe nga rajoni dhe më gjerë. Ka një rritje të ndjeshme të studentëve që vijnë nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, por edhe nga Turqia dhe Italia, ku numri i tyre ka filluar të rritet ndjeshëm, pikërisht për shkak të cilësisë, ndërkombëtarizimit dhe kushteve të mira të studimit.

Sidomos këtë vit kemi pasur një rritje të konsiderueshme, madje të dyfishuar, të interesimit për studime në nivelin master. Të rinjtë po e kuptojnë gjithnjë e më shumë se kompetencat e nivelit bachelor nuk janë gjithmonë të mjaftueshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe tranzicionet e mëdha globale. Ata kërkojnë ekspertizë

dhe dije më të avancuar, që fillon pikërisht në nivelin master dhe doktoratë. Kjo është edhe një shenjë shumë pozitive dhe një mesazh i mirë për stabilitetin e Kosovës, duke pasur parasysh interesimin e të rinjve për zhvillim të qëndrueshëm dhe avancim të vazhdueshëm të kompetencave.

7. Në aspektin e komunikimit dhe marketingut, UBT në mediat sociale arriti më shumë se 40 milionë shikime në total këtë vit, një shifër rekord. Si e shihni këtë performancë dhe sa përkthehet në ndikim real për studentët dhe institucionin?

Vetë kjo shifër tregon se ekziston një shpërndarje enorme e aktiviteteve dhe e punës. Mendoj se mund të flisnim me ditë të tëra për angazhimet e UBT-së dhe për rezultatet e arritura. Vetë grupi i mediave bën një punë të jashtëzakonshme, po ashtu edhe qendrat e informimit dhe orientimit, si dhe grupi i marrëdhënieve me publikun, të cilët gjenerojnë dhjetëra informacione për televizion, radio dhe platformat e UBT-së. Fatmirësisht, këto janë lajme pozitive dhe interesante, të cilat rrisin kureshtjen e shikuesve.

Falënderoj të gjithë ata që janë angazhuar dhe vazhdojnë të angazhohen, duke bërë një punë të jashtëzakonshme dhe duke arritur që UBT të njihet dhe të lidhet me publikun, jo vetëm në nivel vendor, por edhe ndërkombëtar. Kjo konfirmon se bëhet fjalë për një punë me vlerë dhe se ekziston interes për ta përcjellë këtë punë.

Në këtë mënyrë, ka njerëz që na ndjekin dhe na tregojnë se na përcjellin në rrjetet sociale, duke e konsideruar këtë një përgëzim për ekzistencën e institucioneve të tilla, të cilat vazhdimisht gjenerojnë suksese. E gjithë kjo punë realizohet në bashkëpunim me gjithë ekosistemin e UBT-së, i cili reflektohet përmes gjithë stafit në gjenerimin e sukseseve për studentët, dhe më pas, përmes angazhimit të grupit të mediave dhe promovimit, këto suksese kanalizohen në një rrugëtim sa më të qartë dhe komunikueshëm.

Kështu, qytetarët arrijnë të kenë informacion dhe një perceptim pozitiv, i cili shpresoj se mund t'i ndihmojë në orientimin e tyre. Kosova ka shumë nevojë për lajme pozitive, dhe UBT është gjeneruesi më i madh i lajmeve dhe rezultateve pozitive në vend. Nuk ka krahasueshmëri në mënyrën se sa punohet për sukseset akademike, si dhe për arritjet ku përfaqësohet flamuri i Kosovës në nivel botëror.

Në çdo garë, pozicion dhe proces ndërkombëtarizimi, UBT është lider sa i përket angazhimit dhe përgjegjësisë sociale. Unë mendoj se publikut i ofrojmë informacione dhe dije të vlefshme, të cilat, bazuar në statistika shumë të mira, tregojnë një trend të qartë rritjeje nga viti në vit.

“ Jemi duke punuar që qendrat tona botërore të zhvillohen edhe më tej, në mënyrë që të krijojmë satelite më të mëdha të prezencës së UBT-së në nivel global. Tashmë, me prezencën tonë në Evropë, besojmë se do ta kemi edhe në Amerikë, Azi dhe Afrikë. Ky model i ri, tashmë i stabilizuar dhe konfirmuar, ka shumë kërkesa për të u bartur edhe në zona të tjera, dhe ne do të jemi aktivë në globalizimin dhe ndërtimin e formateve të tilla ”

8. UBT është bërë model i inovacionit, sipërmarrjes dhe impaktit shoqëror jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Cilat iniciativa të vitit 2025 do të theksonit si më transformative?

Ne jemi në një strategji për periudhën 2027–2030, në kuadër të së cilës kemi vendosur modelin UBT 5S, një sistem që synon të konfirmojë arsyen dhe rëndësinë e ekzistencës së një ekosistemi inovativ dhe të vetëqëndrueshëm, si në aspektin e ndërmarrësisë, ashtu edhe të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky ekosistem përfshin të gjitha teknologjitë moderne që rrisin cilësinë e jetës së njeriut, produktivitetin, rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, sigurinë dhe shumë komponentë të tjerë pozitivë.

Ky model është duke u kompletuar dhe gjatë vitit 2025 kemi pasur shumë arritje. Vetë qyteti që kemi ndërtuar në zonën e kampusit ka dhënë rezultate të shumta. Gjatë këtij viti kemi hapur fabrika të reja, përfshirë fabrikën për përpunimin e ujit të pijshëm dhe të distiluar, fabrikën e materialeve pastruese, si dhe një farmaci. Po ashtu, kemi vazhduar me investime në ndërtimin e kapaciteteve të reja klinike dhe spitalore, si dhe kemi hapur Institutin e Mjekësisë Sportive, një nevojë e rëndësishme për Kosovën.

Kemi vazhduar gjithashtu me hapjen e qendrave të ndryshme të shkencave humane dhe sociale, si dhe instituteve të ndryshme kërkimore. Është rritur numri i kapaciteteve të teknologjive moderne dhe të avancuara. Po ashtu, këtë vit kemi përmbyllur të gjithë ekosistemin dhe platformën e lidhur me Inteligjencën Artificiale, me të cilën kemi arritur të pozicionohemi si institucioni më i kompletuar për sa i përket ndërlidhjes dhe përdorimit të Inteligjencës Artificiale në të gjitha funksionet e ekosistemit tonë. Për këtë arsye, jemi vlerësuar edhe në aspektin ndërkombëtar.

Gjatë kësaj periudhe kemi hapur programe të reja studimi, kemi ndërtuar infrastrukturë dhe qendra të reja inovacioni. Kemi aktivizuar UBT-në në Londër, Vjenë dhe Shqipëri, duke shënuar një rritje të strukturuar të UBT-së gjatë këtij viti. Përveç rrisive të reja, kemi pasur edhe rritje të stafit akademik dhe administrativ.

Edhe këtë vit kemi zhvilluar aktivitete të shumta në shërbim të komunitetit. Kemi ndihmuar komunat në hartimin e planeve zhvillimore urbane dhe të politikave publike. Po ashtu, kemi kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të komunitetit për integrim dhe zhvillim. Njëkohësisht, kemi mbështetur kompanitë e Kosovës që të shfrytëzojnë ekosistemin e UBT-së për të rritur efikasitetin e tyre dhe për të krijuar mundësi zhvillimi më të shpejtë.

9. Një nga lajmet më të rëndësishme të këtij viti ishte hapja e Shkollës së Futbollit të S.L. Benfica në Prishtinë, në partneritet me UBT-në. Si erdhi ky partneritet dhe çfarë do të thotë për të rinjtë në Kosovë?

UBT ka një rol të rëndësishëm për Kosovën dhe luan një funksion të veçantë si ambasador për promovimin e saj, përmes potencialit që zotëron. Përmes kompetencave të saj, ne jemi një institucion atraktiv, i cili tërheq institucione dhe kompani që vijnë dhe investojnë në Kosovë. Ju e dini se deri më tani kemi arritur të kemi mbi 100 kompani që, falë UBT-së, kanë ardhur dhe janë pozicionuar në Kosovë.

Një prej tyre është edhe Akademia e Futbollit e Benfica, e njohur si akademia më e mirë dhe më e zhvilluar në botë, me një traditë të jashtëzakonshme. Ne u kemi ofruar atyre bashkëpunim dhe një vlerë që ndërlidhet drejtpërdrejt me misionin, vizionin dhe strategjinë e tyre. Në nivel rajonal, ata e kanë parë UBT-në si institucionin me të cilin mund të bashkëpunojnë pa i humbur vlerat e tyre, përkundrazi, duke i implementuar ato sa më mirë dhe sa më shpejt.

Vlerat e akademisë nuk lidhen vetëm me futbollin në kuptimin klasik – fushën dhe individin – por përfshijnë edhe teknologjinë, shëndetin, mjekësinë, analizat e ndryshme, ushqyerjen, menaxhimin dhe lidhshimin. Të gjitha këto platforma, UBT ua ofron partnerëve për të krijuar një rrugë të lehtë, të drejtë dhe të ndërtuar mbi standarde të larta.

Jam shumë i lumtur që, si UBT, po sjellim këtë akademi në Kosovë, duke bërë që Kosova të mbetet qendër e zhvillimit të talenteve mbi praktikën më të mira në botë. Duke marrë parasysh faktin se Benfica ka zgjedhur të vijë në Kosovë dhe jo në një vend tjetër, kjo përbën një konfirmim të qartë se është bërë një punë e mirë dhe pozitive. Në vitin 2026 do të startojmë zyrtarisht me akademinë.

Ardhja e Benfices është një lajm shumë i mirë për Kosovën, sepse është rezultat i një pune dhe angazhimi shumëvjeçar për të konfirmuar dhe validuar këtë bashkëpunim. Edhe ata kanë qenë proaktivë në afrimin me ne, duke ndërtuar së bashku një balancë të shëndoshë dhe të qëndrueshme të bashkëpunimit.

10. UBT këtë vit u bë institucioni i parë në rajon që integroi në mënyrë të plotë inteligjencën artificiale në sistemin arsimor, qoftë në mësimdhënie, mësimnxënie, kërkim shkencor apo shërbime studentore. Si e vlerësoni këtë hap transformues dhe çfarë ndikimi konkret ka pasur në cilësinë e studimeve dhe përgatitjen e studentëve për tregun e së ardhmes?

Mendoj se ju e dini që një prej fjalëve më të përdorura në vitet e fundit, sidomos pas zhvillimit të modeleve gjenerative të Inteligjencës Artificiale (AI), është pikërisht AI-ja. Kjo është një temë që nuk mund dhe nuk duhet të neglizhohet. Po jetojmë në një periudhë ku AI ka filluar të zbatohet dhe të ketë një ndikim gjithnjë e më të prekshëm në jetën e njeriut. Fatmirësisht, për UBT-në kjo ka ndodhur në kohën e duhur, sepse UBT gjithmonë ka punuar vazhdimisht në ndërtimin e kapaciteteve të veta, duke zhvilluar struktura që e ndërlikojnë, e zhvillojnë dhe e zbatojnë Inteligjencën Artificiale në të gjitha funksionet e saj.

Funksionet tona përfshijnë edukimin, trajnimet e stafit dhe të qytetarëve, krijimin e kompetencave të reja në ndërmarrësi, zhvillimin softuerik dhe aplikacionet e reja, si dhe fushën e sigurisë kibernetike. Ne kemi krijuar UBT AI Factory, një terminologji e njohur në teknologji, e cila përfaqëson një zonë dhe qendër prodhuese të aplikacioneve të AI-së në fusha të ndryshme.

Në këtë bazë, kemi arritur të zhvillojmë aplikacione të ndryshme në fushën e gjuhës, përfshirë përkthimin automatik nga gjuha shqipe në anglisht, testime shëndetësore, matjen e parametrave shëndetësorë përmes zërit dhe kollitjes, analiza të qelizave njerëzore dhe konfirmimin e gjendjes së tyre aktuale për raportim dhe ndërhyrje të saktë, si dhe parandalimin e zjarreve. Po ashtu, kemi zhvilluar shumë funksione të digjitalizimit dhe zgjidhje të tjera që përbëjnë një kontribut të drejtpërdrejtë të UBT-së në risitë e përdorimit të AI-së në fusha të ndryshme të jetës.

Përveç kësaj, kemi krijuar edhe platformën tonë dhe, në bashkëpunim me EON, kemi zhvilluar një platformë të bazuar në teknologjinë cloud, e cila mundëson qasje të vazhdueshme të studentëve dhe profesorëve për trajnim, mbështetje, edukim dhe vlerësim, pavarësisht se ku ndodhen. Kjo platformë është diçka unike në botë dhe, përmes saj, kemi adresuar edhe dilemat rreth mënyrës së përdorimit të AI-

së, nivelit të shfrytëzimit dhe ndikimit të saj. Kemi konstatuar se AI është një vlerë e shtuar për njerëzimin, pasi rrit produktivitetin dhe kreativitetin dhe ndihmon në shumë aspekte të jetës, por përdorimi i saj duhet të jetë gjithmonë etik dhe profesional.

UBT ka ndërtuar një pozicion shumë të mirë në këtë drejtim dhe kjo nuk është rastësi. Ne kemi marrë edhe çmime të larta ndërkombëtare, duke u renditur në vendin e 26-të në botë për kategorinë “Generative AI Application” dhe në vendin e 5-të për kategorinë “Support for Global Resilience”. Po ashtu, kemi marrë pjesë në dhjetëra konferenca ndërkombëtare, ku jemi ftuar të flasim për ndikimin, rolin dhe mënyrën e implementimit të Inteligjencës Artificiale, bazuar në përvojën konkrete të UBT-së në fusha të ndryshme.

11. Gjatë vitit 2025, UBT ka marrë role të rëndësishme edhe në diplomaci akademike dhe projekte ndërkombëtare. Si e shihni rolin e UBT-së në avancimin e imazhit të Kosovës në arenën globale?

Unë mendoj se UBT, që nga fillimi, ka qenë shumë e angazhuar. Ne kemi qenë shumë të angazhuar dhe unë, personalisht, shumë i përkushtuar. Mendoj se rreth 50% e kohës i takon promovimit të Kosovës përmes vlerave akademike, rezultateve shkencore dhe inovacioneve që zhvillojmë, me qëllim që të sjellim Kosovën në nivele të ndryshme dhe në organizata, qendra, çmime të ndryshme, dhe për ta konfirmuar se Kosova është një vend i zhvilluar, inovativ, me talent, demokratik dhe të interesuar të jetë pjesë e frymës demokratike dhe të vlerave euro-atlantike.

Besoj se me kohë, dije dhe financa do të bëjmë maksimumin që kjo punë të jetë prioriteti ynë, sepse për ne kjo është prioritet. Ju jeni dëshmitarë të veprave tona që i zhvillojmë në këtë drejtim. Ne kemi dhjetra anëtarësime të Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe edhe sivjet kemi bërë anëtarësime të reja, si për Kosovën, jo vetëm si UBT, por edhe përfaqësim në nivel profesional dhe të Akademisë së Kosovës.

Pjesëmarrja jonë në gara robotike, në gara të ndryshme, prezenca, çmimet tona, gjithë organizimi dhe financimi, si dhe marrja e përgjegjësisë, tregojnë se UBT ka një fokus të madh. Ftesat nga organizatat botërore për të organizuar aktivitetet e tyre janë gjithashtu dëshmi e këtij fokusi. Në tetor, për shembull, organizata botërore e mjekësisë sportive erdhi për herë të parë në Kosovë dhe për herë të parë u organizua një konferencë e rangut botëror. Po ashtu, International Federation for Control and Automation, një organizatë me nivel botëror, është sjellë falë

përpjekjeve tona, si dhe shumë mekanizma të tjerë, të cilët gjatë vitit 2025 kanë qenë relevantë dhe të vendosur nga UBT.

Të gjitha këto pozita dhe vizita, të cilat i përmenda më lart, kanë qenë po ashtu në funksion të promovimit të Kosovës dhe të ndërlidhjes së saj me botën. Edhe anëtarësimi ynë në organizatën botërore të institucioneve të ndërmarrësisë ka qenë një risi sivjet, ndërsa anëtarësimet e mia në Akademinë e Shkencave dhe në shumë organizata të tjera i dedikohen gjithashtu promovimit të Kosovës dhe funksionit të saj ndërkombëtar.

12. Si ka evoluar bashkëpunimi i UBT-së me sektorin privat dhe industrinë gjatë vitit 2025, dhe si ka ndikuar kjo në përgatitjen praktike të studentëve?

Po, siç thashë, ne kemi punuar shumë edhe në këtë pikë, sepse bashkëpunimi ynë me industrinë është jetësor, pa të cilin nuk mund të funksionojmë. Për ne, ndërmarrësia, industria dhe sektorë të ndryshëm, por edhe Qeveria, janë shumë të rëndësishme. Dëshirojmë që ky bashkëpunim të jetë sa më i madh, sa më i afërt dhe me komunikime të vazhdueshme. Ne kemi pasur bashkëpunime të tilla me oda të ndryshme dhe përfaqësues të bizneseve, por sivjet kemi bërë një hap më të madh: kemi krijuar ekosistemin tonë industrial në UBT.

Ky ekosistem i dedikohet një lidhjeje direkte me kompanitë, duke zhvilluar bashkëpunime të përbashkëta, trajnime të përbashkëta, programe të përbashkëta dhe panairë të përbashkëta. Po ashtu, kompanitë kanë kontribuar edhe në këshillat mbikëqyrës dhe këshillat këshilldhënëse industriale të çdo fakulteti apo programi studimi në UBT. Tani kemi me qindra dhe mijëra kompani me të cilat kemi një bashkëpunim të mirëfilltë, si përmes marrëveshjeve formale, ashtu edhe përmes një ndërlidhjeje të veçantë.

Gjithashtu, ato kanë ndihmuar edhe në sponsorizime të ndryshme të eventeve tona, për të cilat dua t'i falënderoj në mënyrë të veçantë dhe t'i ftoj të gjithë që të përfitojnë nga ky ekosistem. Ne u kemi

“**Kemi një strategji deri në vitin 2030 dhe gjithashtu një strategji që shikon deri në vitin 2035. Bazuar në këto strategji, me qëllime shumë të qarta dhe objektiva të mirëfillta për çdo dyvjeçar, besojmë se do të arrijmë një formësim të qëndrueshëm.**”

ofruar mundësi për të përdorur kuadrot tona, stafin e ri dhe të përgatitur, si dhe laboratorët dhe qendrat tona testuese për të testuar prototipet dhe zhvillimet e tyre. Realisht, UBT është një qendër testuese për zhvillime inovative, dhe i ftoj të gjithë ata që ende nuk e kanë përdorur këtë mundësi që dyert tona janë të hapura, për t'u arritur sa më shpejt rezultatet konkrete të zhvillimit të produkteve apo koncepteve që ata dëshirojnë.

Pra, ky ekosistem industri – UBT është tanimë një realitet që po natyralizohet përmes mënyrës se si komunikojmë me partnerët tanë. Besoj se sivjet ka pasur një rritje të madhe të këtij bashkëpunimi dhe uroj që në vitin e ardhshëm të konkretizojmë edhe projekte shumë më të mëdha.

13. Duke qenë se viti 2026 shënon 25-vjetorin e themelimit të UBT-së, çfarë simbolizon ky jubile për ju personalisht dhe për institucionin? A keni planifikuar aktivitete ose projekte të rëndësishme?

Ne, natyrisht, 25-vjetorin nuk mund ta lëmë pa reflektuar, pa u ndalur pak. Është një kënaqësi, një lumturi, një moment që na detyron të vlerësojmë punën 25-vjeçare që është bërë, dhe kemi mjaftueshëm për të treguar. Nga fundi i këtij muaji dhe fillimi i vitit të ri, e deri në fund të vitit, do ta shënojmë vitin e 25-të, një çerek shekulli të angazhimit të UBT-së.

Puna që ka filluar në vitin 2001 ka krijuar një rrugëtim që tani po kurorëzohet me një çerek shekulli rritjeje të vazhdueshme, një rritje organike që në shumë raste është unike në nivel botëror. Është e nevojshme që të kthehemi pak pas dhe të themi se çfarë kemi bërë, si është zhvilluar dhe ndërtonuar UBT-ja, duke ndërtuar veten, duke ndihmuar ndërtimin e shtetit, kapaciteteve shtetërore, duke anëtarësuar Kosovën, duke ndërtuar kuadro të reja, si dhe duke krijuar të vetat. Ky ka qenë një rrugëtim natyror që ka sjellë shumë përgjegjësi, dhe fatmirësisht ka ndodhur me sukses.

Kemi vendosur që 25-vjetorin ta shënojmë jo vetëm me një aktivitet, por me një seri aktivitete gjatë vitit 2026. Do

të ketë konferenca të ndryshme dedikuar 25-vjetorit, aktivitete kulturore, një ceremoni madhështore ku ftojmë partnerët tanë nga e gjithë bota, publikime të ndryshme të librit të 25-vjetorit, dhe aktivitete artistike dhe kulturore që prezentojnë këtë përvjetor. Edhe brendimi ynë do të jetë i veçantë, për të konkretizuar diçka shumë të lumtur, të bukur dhe me vërtetë kënaqësi.

Ky 25-vjetor është një ndjenjë e plotësuar, duke marrë parasysh thënien e Kennedy-t: “Mos prit çfarë bën shteti për ty, por çfarë ti mund të bësh për shtetin.” Këtu kemi mjaft konfirmime: kur i shohim të rinjtë tanë që janë bërë profesorë dhe vazhdojnë të kontribuojnë, kur i shohim në kompanitë që kanë ndërtuar, në qendrat botërore dhe në politikë. Po ashtu, shohim një rritje të vazhdueshme të kompanive të Kosovës, të cilat me studentët dhe stafin tonë gënjerojnë eksporte të ndryshme dhe krijojnë prezencë të vazhdueshme.

UBT-ja dhe Kosova janë tashmë qendra inovative e arsimit, me kërkesa gjithnjë e më të mëdha për shkëmbime, bashkëpunime dhe ardhjen e studentëve për studime. Këto do të reflektohen në formate të ndryshme: muze të shtuar me vlerat e 25-vjetorit, galeri të pasuruara, teatro me shfaqje të veçanta për këtë përvjetor, koncerte të shumta dhe publikime që dokumentojnë dhe kultivojnë të dhënat dhe informacionet e këtyre viteve.

Natyrisht, do të bëjmë një falënderim dhe reflektim të gjithë atyre që kanë kontribuar: familjeve, partnerëve, stafit, studentëve, prindërve të studentëve, industrisë, shtetit të Kosovës dhe shteteve të tjera që kanë qenë pjesë aktive, si dhe parlamentarëve dhe shumë kontribuesve të tjerë. Ata kanë marrë pjesë me kënaqësi dhe janë bashkuar me misionin dhe vizionin tonë.

Kjo nuk është një mbyllje, por një reflektim dhe vazhdimësi, sepse një institucion i tillë duhet të qëndrojë për qindra e mijëra vjet, si universitetet e tjera që ekzistojnë dhe janë aktive për shekuj me radhë. UBT

do të punojë që të mbetet gjallë dhe aktive përgjithmonë.

14. Me gjithë këto arritje të vitit 2025, cilat janë pritshmëritë, vizionet dhe objektivat strategjike të UBT-së për vitin 2026, sidomos në prag të 25-vjetorit?

Ne jemi duke elaboruar dhe pozicionuar UBT-në në nivel global. Kemi arritur të pozicionohemi mjaft mirë dhe të përmbyllim konceptin e qytetit të mençur, i cili është një proces i vazhdueshëm. Transformimet digjitale, teknologjitë e gjelbra dhe të tjera na japin hapësirë të madhe për zhvillim në pesë vitet e ardhshme.

Njëkohësisht, jemi duke punuar që qendrat tona botërore të zhvillohen edhe më tej, në mënyrë që të krijojmë satelite më të mëdha të prezencës së UBT-së në nivel global. Tashmë, me prezencën tonë në Evropë, besojmë se do ta kemi edhe në Amerikë, Azi dhe Afrikë. Ky model i ri, tashmë i stabilizuar dhe konfirmuar, ka shumë kërkesa për të u bartur edhe në zona të tjera, dhe ne do të jemi aktivë në globalizimin dhe ndërtimin e formateve të tilla.

Do të rrisim edhe më shumë pjesën shkencore dhe produktivitetin akademik, në mënyrë që të pozicionohemi më mirë, si dhe do të krijojmë qendra të përbashkëta hulumtimi dhe inovacioni. Në këtë mënyrë, besojmë se rritja do të vazhdojë po aq dinamike sa deri më tash.

Kemi një strategji deri në vitin 2030 dhe gjithashtu një strategji që shikon deri në vitin 2035. Bazuar në këto strategji, me qëllime shumë të qarta dhe objektiva të mirëfillta për çdo dyvjeçar, besojmë se do të arrijmë një formësim të qëndrueshëm. Edhe me rastin e 25-vjetorit, mund të bëjmë një shpallje apo reflektim më specifik për dhjetëvjeçarin e ardhshëm. Vija dhe vizioni janë të qarta: të vazhdojmë me rritje organike, të kemi një qasje të vazhdueshme ndaj ndërmarrësisë dhe përgjegjësisë shoqërore, dhe mbi të gjitha, të konfirmojmë edhe më tej rolin e inovacionit, teknologjisë dhe edukimit.

Edona Sulejmani, Jehonë Kapllani, Driton Hyseni

Mesazhi për fundvit nga Rektori Hajrizi

Në fund të vitit, një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që kanë kontribuar dhe bashkëpunuar me ne: studentët tanë dhe familjet e tyre, stafin tonë të ndëruar, partnerët, universitetet, komunitetin tonë, bizneset, qeveritë lokale dhe qendrore, si dhe universitetet botërore. Të gjithëve, një falënderim i veçantë për bashkëpunimin e deritanishëm.

Nga ana tjetër, urojmë festat e fundvitit dhe Vitin e Ri, duke ju dëshiruar të gjitha të mirat që çdo individ dhe partner i dëshiron në misionin dhe vizionin e tij. Dëshirojmë që ato dëshira të plotësohen, duke qenë sa më të lumtur, të suksesshëm, të shëndetshëm, humanë, me qetësi shpirtërore, të lidhur me paqen personale, familjen dhe shoqërinë, pa ndjerë pasiguri, por me energji pozitive për një të ardhme të ndritshme.

Ne besojmë dhe urojmë që vitin e ardhshëm ta shohim të gjithë më pozitiv, dhe që e ardhmja të jetë sa më e mirë. Deri më tani, njerëzimi ka pasur zhvillim të vazhdueshëm dhe një jetë më të mirë, dhe unë jam fuqishëm i bindur se edhe e ardhmja do të jetë e tillë.

Ju dëshiroj të gjithëve një rrugëtim sa më të mbarë në vitin e ardhshëm dhe në vitet që vijjnë.

Faleminderit të gjithëve!

Në një ceremoni organizuar në Kampin Inovativ të UBT-së Presidenti i Austrisë nderon Rektorin Edmond Hajrizi me Medaljen e Artë të Meritave

Presidenti i Austrisë, Alexander Van der Bellen e ka dekoruar Presidentin dhe Rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi me Medaljen e Artë të Meritave, një çmim që u jepet personaliteteve të larta botërore.

Dekorata e lartë iu dorëzua Rektorit Hajrizi, në një ceremoni solemne organizuar sot në Parkun Inovativ të UBT-së, nga Ambasadori i Austrisë në Kosovë, z. Georg Schnetzer.

Kjo dekoratë është ndarë me dekret shtetëror nga Presidenti i Austrisë, Van der Bellen, më 23 prill 2025. Ajo nderon kontributin e jashtëzakonshëm të Rektorit Hajrizit në zhvillimin dhe avancimin e sistemit arsimor në Kosovë, si dhe në forcimin e marrëdhënieve akademike, shkencore dhe kulturore ndërmjet Austrisë dhe Kosovës.

Në fjalën e tij, ambasadori Schnetzer vlerësoi ndikimin afatgjatë që Rektorit Hajrizi ka pasur në fushën e arsimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

“Është një nder i veçantë për mua që sot, në emër të Republikës së Austrisë, t’ia dorëzoj këtë medalje të rëndësishme Profesor Edmond Hajrizit. Ky çmim, i ndarë nga Presidenti Federal Alexander Van der Bellen, përfaqëson mirënjohjen e Austrisë për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit në Kosovë dhe për forcimin e lidhjeve të qëndrueshme ndërmjet dy vendeve tona në fushën e shkencës, kërkimit dhe shkëmbimeve akademike”, deklaroi ambasadori Schnetzer.

Ai shtoi se UBT është shndërruar në një urë të fortë akademike mes Austrisë dhe Kosovës, duke nxitur partneritete të qëndrueshme dhe bashkëpunime të frytshme në shumë fusha.

Në fjalën e tij falënderuese, Prof. Dr. Edmond Hajrizi e cilësoi këtë medalje si një nder të jashtëzakonshëm dhe me domethënie të veçantë personale.

“Kjo medalje ka një kuptim jashtëzakonisht të veçantë për mua, sepse më jepet nga shteti i Austrisë, një vend që për më shumë se 30 vjet e kam quajtur shtëpinë time të dytë. Në një kohë kur Kosova po kalonte periudha të vështira, Austria ishte vendi që hapi dyert për ne, duke na dhënë mundësinë të ëndërojmë, të zhvillohemi dhe të kontribuojmë për të ardhmen”, theksoi Rektorit Hajrizi.



Ai shtoi se modeli austriak i arsimit ka qenë një nga frymëzimet kryesore në ndërtimin e filozofisë akademike të UBT-së:

“Austria është një lider global në inovacion, arsim dhe zhvillim. Ajo ka krijuar një ekosistem të jashtëzakonshëm që lidh ngushtë akademinë me industrinë, duke u ofruar studentëve mundësinë të aplikojnë dijen në praktikë. Kjo qasje është bërë pjesë thelbësore e punës sime dhe e modelit që kemi ndërtuar në UBT”, tha Rektorit Hajrizi.

Hajrizi, i nderuar për këtë çmim jetësor, falënderoi të gjithë bashkëpunëtorët e shumtë, ndërkombëtarë e vendorë, që ndihmuan në rrugëtimin dhe të arriturat e tij jetësore.

Ai theksoi mbështetjen e familjen së tij, si një nga elementet më të rëndësishme të suksesit dhe të arritjeve së tij, veçanërisht bashkëshorten e tij, Fisnetë Hajrizi, e cila ishte bashkrijuese, përkrahëse e vazhdueshme e vizionit dhe ideve të tij, nga fillimi deri në realizimin final.

Përveç rolit të tij akademik, Prof. Hajrizi është ndërmarrës vizionar që ka themeluar më shumë se 30 kompani dhe laboratorë inovacioni, si dhe Parkun e parë të Shkencës, Inovacionit dhe Teknologjisë në Kosovë. Ai është anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, fitues i disa çmimeve ndërkombëtare dhe pjesëmarrës aktiv në iniciativa që promovojnë arsimin, kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

UBT, i themeluar në vitin 2001 nga Prof. Hajrizi, ku mandej nisi me vetëm 29 studentë dhe sot numëron mbi 10000 studentë në disa kampuse. Institucioni

është ndërtuar mbi modelet dhe standardet akademike austriake, me një qasje ndërdisiplinore dhe të orientuar drejt praktikës. Në vitet e para të funksionimit, UBT ka përfutur ndjeshëm nga ekspertiza e profesorëve dhe hulumtuesve të Universitetit Teknik të Vjenës (TU Wien) dhe institucioneve të tjera akademike austriake.

Sot, institucioni vazhdon bashkëpunime të shumta me universitete, institute kërkimore dhe qendra ekselence në Austri, ndërsa programi EUROTRIP i UBT-së u mundëson studentëve vizita studimore dhe eksperiencia praktike në institucione austriake.

Përveç dimensionit akademik, UBT ka kontribuar ndjeshëm edhe në forcimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Austrisë dhe Kosovës, përmes bashkëpunimeve me Dhomën Ekonomike Federale të Austrisë (WKÖ), organizatën austriake për zhvillim ekonomik WIFI, si dhe institucione të tjera partnere. Universiteti organizon rregullisht aktivitetin tradicional “Ditët e Austrisë”, që ka shërbyer si platformë për shkëmbim idesh, përvoja dhe mundësi bashkëpunimi.

Gjithashtu, UBT ka qenë një nga promotorët kryesorë të futjes së modelit austriak të arsimit profesional dual në Kosovë, duke kontribuar në reformimin e sistemit arsimor në vend. Ceremonia e dorëzimit të medaljes u mbyll me një pritje solemne, ku morën pjesë përfaqësues institucionesh, profesorë, studentë, bashkëpunëtorë ndërkombëtarë dhe miq të institucionit.

Sipas The Impact Rankings 2025

UBT renditet i pari në Kosovë dhe ndër universitetet më të mira në rajon

UBT ka dëshmuar edhe një herë përkushtimin e tij ndaj cilësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke u renditur në mesin e universiteteve më të mira në rajon sipas THE Impact Rankings 2025 – klasifikimi global që mat performancën e universiteteve në përmbushjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të Kombeve të Bashkuara.

UBT qëndron larg përpara të gjitha universiteteve të tjera në Kosovë, duke dëshmuar përkushtimin e tij të vazhdueshëm për ndikim real në shoqëri, ekonomi dhe mjedis. Në këtë edicion të rankimit, UBT ka shënuar progres të theksuar krahasuar me vitet e kaluara, veçanërisht në disa fusha kyçe të qëndrueshmërisë globale si: SDG 5 – Barazi gjinore: Me politika aktive për gjithëpërfshirje, barazi dhe fuqizimin e grave në edukim dhe menaxhim, SDG 9 – Industri, Inovacion dhe Infrastruktura: Përmes zhvillimit të ekosistemeve të inovacionit dhe teknologjisë, si

dhe infrastrukturës së avancuar kërkimore, SDG 11 – Qytete dhe komunitete të qëndrueshme: Me projekte të shumta në planifikimin dhe ndërtimin e kampuseve të mençura, reziliente dhe miqësore me mjedisin

SDG 12 – Konsum dhe prodhim i qëndrueshëm: Me integrimin e parimeve të ekonomisë qarkore në edukim dhe praktika institucionale.

Ky sukses është dëshmi e vizionit të UBT-së si institucion lider në arsimin e lartë, inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm, i cili jo vetëm që konkurren denjësisht në nivel ndërkombëtar, por edhe kontribuon ndjeshëm në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për komunitetet lokale dhe më gjerë.

Times Higher Education (THE) Impact Rankings vlerëson dhe rangon universitetet në mbarë botën bazuar në kontributet e tyre në raport me promovimin dhe implementimin e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të



UBT RENDITET **#1** NË KOSOVË DHE NDER UNIVERSITETET MË TË MIRA NË RAJON NGA THE IMPACT RANKINGS 2025

Kombeve të Bashkuara. Ky rangim global përqendrohet në ndikimin shoqëror dhe mjedisor të një universiteti përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, angazhimit me komunitetin dhe politikave të brendshme – përtej aktivitetit klasik akademik dhe shkencor.

Institucionet ndër të tjera vlerësohen edhe për SDG 17 (Partneritet për Qëllimet), SDG 4 (Arsimi Cilësor), SDG 5 (Barazia Gjinore) dhe SDG 13 (Veprimi për Klimën). SDG-të tjera përfshijnë shëndetin, inovacionin dhe qytetet e qëndrueshme. Këto renditje promovojnë transparencën dhe inkurajojnë universitetet të harmonizojnë punën e tyre me sfidat globale, duke theksuar rolin e tyre në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Sipas National H-index Ranking për tremujorin e dytë të vitit 2025

UBT, prapë i pari dhe më i miri për kërkime shkencore

UBT është ranguar si institucioni i parë dhe më i mirë i arsimit të lartë privat në Kosovë për kërkime shkencore, sipas Renditjes Kombëtare të H-indeksit (National H-index Ranking) për tremujorin e dytë të vitit 2025.

Përmes një strategjie të qartë institucionale dhe përkrahjes së fuqishme të stafit akademik e studentëve, UBT ka arritur të krijojë një ekosistem shkencor ku kërkimi dhe aplikimi i njohurive ndërthuren për të gjeneruar zgjidhje të reja dhe të qëndrueshme.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se kjo renditje tregon përkushtimin e UBT-së në promovimin e shkencës dhe kërkimit shkencor në vend dhe përtej tij. “Kjo renditje në H-index është rezultat i punës së palodhshme të akademikëve tanë dhe përkushtimit për të qenë gjithnjë në hap me zhvillimet globale në fushën e kërkimit shkencor. Ne do të vazhdojmë të investojmë në projekte kërkimore, partneritete ndërkombëtare dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve tona akademike”, theksoi Rektori Hajrizi.

UBT është një prej institucioneve më aktive në publikime shkencore me ndikim ndërkombëtar, në fusha si teknologjia, inxhinieria, shkencat mjekësore, arkitektura, menaxhimi,

edukimi dhe shumë të tjera. Përmes pjesëmarrjes në projekte të mëdha evropiane dhe angazhimit të ekspertëve të njohur ndërkombëtarë, UBT po kontribuon në ngritjen e standardeve kërkimore në Kosovë.



UBT, **#1** për kërkime shkencore sipas National H-index Ranking për tremujorin e dytë të vitit 2025



edukimi dhe shumë të tjera. Përmes pjesëmarrjes në projekte të mëdha evropiane dhe angazhimit të ekspertëve të njohur ndërkombëtarë, UBT po kontribuon në ngritjen e standardeve kërkimore në Kosovë.

Për të tretin vit radhazi

UBT finalist në Triple E Awards – këtë herë edhe në kategorinë globale

UBT ka shënuar një tjetër arritje të rëndësishme ndërkombëtare, duke u përzgjedhur për të tretin vit radhazi si finalist në ceremoninë prestigjioze Triple E Awards, e cila vlerëson universitetet më të angazhuara në dobi të komunitetit dhe me impakt real në shoqëri.

Në këtë kategori globale të çmimeve vlerësohen universitetet nga e gjithë bota në raport me realizimin e Misionin të Tretë të Universiteteve, i cili ka të bëjë

me angazhimin ndaj komunitetit dhe përtej rolit klasik të universitetit në humlumtim, shkencë dhe edukim.

Iniciativat e shumta të UBT-së, si shërbimet shëndetësore më të lira dhe falas, shërbimet e këshillimit psikologjik, programet gjithëpërfshirëse të bursave, përkrahja profesionale ndaj institucioneve publike, platformat si Pro-Academia, si dhe partneritetet me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare për monitorimin e SDG-ve, janë ndër komponentet që kanë bërë që këtë vit UBT të hyjë në listën e ngushtë të finalistëve në Triple E Award Global Engaged University.

Kjo arritje e rëndësishme, jo vetëm për UBT-në, dëshmon edhe një herë rolin e tij si një universitet inovativ, i përfshirë në të gjitha proceset e rëndësishme shoqërore, si dhe promotor i ndërmarrësisë dhe punësimit.

UBT vazhdon të vendosë standarde globale – përkrah universiteteve më prestigjioze në botë në rangimin e fundit global nga WURI

Një sukses që tejkalon kufijtë kombëtarë dhe vendos Kosovën në hartën globale të arsimit të lartë është rangimi i radhës i UBT-së, i cili ka arritur të renditet ndër universitetet më të mira dhe më inovative në botë, sipas rangimit prestigjioz të World University Rankings for Innovation (WURI 2025), duke u radhitur përkrah universiteteve prestigjioze si Harvard, MIT, Stanford, Oxford, e të tjera.

Në raportin zyrtar të publikuar nga WURI, UBT ka arritur pozicionime të larta në disa kategori kyçe, duke u radhitur në mesin e institucioneve lidere të arsimit të lartë në nivel global:

Vendi i 10-të në kategorinë ESG Trend (B3) – për përkushtimin në mjedis, shoqëri dhe menaxhim të qëndrueshëm;

Vendi i 14-të në kategorinë Funding for Sustainability (B5) – për sigurimin e burimeve për projekte që ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm;

Vendi i 5-të në kategorinë University Brand and Reputation (B8) – për ndërtimin e një identiteti të fuqishëm institucional dhe reputacioni ndërkombëtar në rritje; Dhe, vendi i 208-të në renditjen e përgjithshme ndër Global Top 400 Innovative Universities.



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, vlerësoi këto arritje si një tregues i qartë i progresit të vazhdueshëm të institucionit.

“UBT po dëshmon se është një forcë lëvizëse e arsimit të lartë në botë. Rangimet e WURI janë pasqyrim i realitetit që po ndërtojmë çdo ditë: një universitet që promovon dijen, inovacionin, dhe përkushtimin ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe ndërkombëtarizimit”.

Ky sukses i radhës konfirmon rolin e UBT-së si një lider në fushën e inovacionit, teknologjisë dhe ndërkombëtarizimit, duke e vendosur Kosovën fuqishëm në hartën globale të arsimit cilësor dhe transformues.

Për më tepër, renditja e UBT-së në mesin e universiteteve më të mira dhe më inovative në botë sipas WURI 2025 përfaqëson një arritje të jashtëzakonshme jo vetëm për institucionin, por për gjithë sistemin e arsimit të lartë në

Kosovë. Pozicionimi në vendin e 10-të për ESG Trend dëshmon angazhimin e UBT-së për zhvillim të qëndrueshëm dhe përgjegjësi ndaj mjedisit dhe shoqërisë, ndërsa vendi i 14-të në Funding for Sustainability tregon kapacitetin për të siguruar burime për projekte me ndikim afatgjatë. Veçanërisht i rëndësishëm është renditja në vendin e 5-të në University Brand and Reputation, që e vendos UBT-në si një nga institucionet me reputacion më të madh global, duke rritur besueshmërinë dhe vlerën e diplomës për studentët, si dhe mundësitë për bashkëpunime ndërkombëtare për stafin akademik.

Ky sukses engre më tej profilin e Kosovës në skenën ndërkombëtare të arsimit, duke e bërë më tërheqëse për studentë, profesorë dhe partnerë strategjikë nga e gjithë bota dhe duke dëshmuar se institucionet kosovare mund të konkurrojnë denjësisht në nivel global.

Lider në arsimin e lartë privat në Kosovë UBT sërish i pari në rangimin e Webometrics



#1 RANKED

institucion i arsimit të lartë privat në rajon sipas renditjes së **Webometrics**

Në edicionin e korrikut të rangimit ndërkombëtar Webometrics, UBT ka konfirmuar edhe një herë pozitën e tij si institucioni më i mirë privat i arsimit të lartë në Kosovë, duke dëshmuar vazhdimësinë e përkushtimit ndaj cilësisë akademike dhe kërkimit shkencor.

Ky sukses i radhës nuk është vetëm një tregues i pozicionimit të lartë në nivel ndërkombëtar, por edhe një dëshmi konkrete e progresit të vazhdueshëm të institucionit në fushat kyçe të arsimit modern dhe inovacionit.

Rritja e vazhdueshme e numrit të citimeve në publikimet shkencore të stafit të UBT-së është një tregues i qartë i qasjes së

qëndrueshme dhe serioze ndaj shkencës, si dhe impaktit të saj shoqëror. Kjo rritje pasqyron jo vetëm përkushtimin individual të stafit akademik, por edhe mbështetjen institucionale, përfshirë infrastrukturën moderne për hulumtim dhe politikat e brendshme që inkurajojnë botimet cilësore.

Rangimi Webometrics, i cili publikohet çdo gjashtë muaj nga Cybermetrics Lab – pjesë e Këshillit Kombëtar të Kërkimeve Shkencore të Spanjës – analizon mijëra universitete dhe institucione të arsimit të lartë në të gjithë botën. Vlerësimi bazohet në disa indikatorë, si transparenca akademike, përmbajtja online dhe ndikimi i punimeve shkencore.

Përveç suksesit në këtë rangim, UBT ndër vite është vlerësuar lartë edhe në fusha të tilla si teknologjia, inovacioni, inteligjenca artificiale gjenerative, ndërmarrësia dhe cilësia e arsimit. Vlerësimet e vazhdueshme nga organizata ndërkombëtare e pozicionojnë UBT-në si një institucion udhëheqës që kontribuon në zhvillimin akademik dhe shoqëror të Kosovës, duke e përfaqësuar atë me dinjitet në skenën globale.

Elita nga Kosova fiton çmimin për mentoren më të mirë në garën botërore të robotikës në Panama



Mentorja e ekipit FIRST Kosova, Elita Hajrizi, është vlerësuar me çmimin prestigjioz “Outstanding Mentor Award” në garën botërore të robotikës FIRST Global Challenge, duke u shpallur njëra ndër mentorët më të mira në botë.

Ky çmim i dedikohet mentorëve që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për ekipin e tyre, duke kaluar përtej çdo pritsshmërie në përkushtim, udhëheqje dhe frymëzim.

Ky vlerësim përbën një mirënjohje ndërkombëtare për punën e palodhshme dhe pasionin e Elita Hajrizit në zhvillimin e brezit të ri të inovatorëve kosovarë.

Rektori Hajrizi, nderohet me mirënjohje në Samitin Ndërkombëtar të të Rinjve për Paqe në Ballkan 2025

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u nderua në Balkan International Youth Summit for Peace 2025, ngjarje që mbledhi mbi 120 të rinj nga më shumë se 40 shtete të botës, së bashku me personalitete akademike, politike dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Samiti, i organizuar nga Youth and Students for Peace Balkan (YSP Balkan) në bashkëpunim me komunat e Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut dhe Leposaviqit, zhvilloi tre ditë dialogu, inovacioni dhe aktivitetet kulturore.

Në mirënjohje, thuhet: “Në njohje të kontributit tuaj të shquar për fuqizimin e të rinjve si qytetarë aktivë dhe për

mbështetjen e iniciativave që përputhen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Përmes përkushtimit tuaj ndaj dialogut, edukimit dhe bashkëpunimit, ju keni avancuar vlerat e paqes, drejtësisë dhe përfshirjes, duke frymëzuar të rinjtë të marrin përgjegjësi në formësimin e komuniteteve të tyre dhe të ardhmes sonë të përbashkët”.

Prof. Dr. Hajrizi u vlerësua për mbështetjen e vazhdueshme që UBT dhe UBT International Smart Schools i kanë dhënë nismave për paqe, përfshirjes së të rinjve dhe ndërtimit të urave ndërkombëtare të bashkëpunimit.



UBT dhe Rektori Hajrizi vlerësohen me çmimet më të larta globale si rol model për inovacion, sipërmarrësi dhe impakt shoqëror nga Triple E Awards



UBT dhe Rektori, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në edicionin e fundit të Global Triple E Awards, u vlerësuan nga një juri ndërkombëtare me çmimet më të larta globale, si rol model për lidhshmërinë në

transformimet inovative dhe ndikimin e jashtëzakonshëm në shoqëri përmes edukimit, sipërmarrjes, inovacionit, përgjegjësisë sociale dhe adresimit të sfidave globale.

UBT u vlerësua si “Engaged University of the Year”, duke u renditur më i miri në nivel global dhe duke lënë pas universitete prestigjioze nga Suedia, Kanadaja, Australia dhe Arabia Saudite.

Me moton kryesore “Knowledge in Action: Shaping Tomorrow through Science, Equity, and Shared Progress”, UBT vendoset në qendër të hartës botërore të arsimit të lartë, si një institucion që jo vetëm krijon ndikim në nivel shoqëror, por edhe kontribuon në ndërtimin e shtetit dhe në përballimin e sfidave

globale.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u konfirmua lideri i dytë më i mirë global në arsimin e lartë, duke u nderuar me çmimin prestigjioz “University Leader of the Year Award – Runner up”. Kontributi i tij në “Reimagining Education, Building the Future: Prof. Hajrizi and the UBT Ecosystem”, u vlerësua për lidhshmërinë vizionare dhe ndikimin e tij transformues në arsim dhe shoqëri. Ky sukses i ri vjen pas një vlerësimi të vitit të kaluar, kur Rektori Hajrizi u rendit i pari në kategorinë “Entrepreneurship Educator of the Year”, ndërsa UBT u rendit në vendin e dytë për “Young Entrepreneurial University of the Year”.

UBT rangohet institucioni i parë në Kosovë për shkencë nga SCImago

UBT ka shënuar një tjetër sukses të madh në arenën ndërkombëtare, duke u ranguar si institucioni i parë në Kosovë për kërkim shkencor në rangimin prestigjioz SCImago. Përveçse lider në Kosovë, UBT ka tejkaluar disa nga universitetet edhe në rajon, duke u konfirmuar si një nga institucionet më të fuqishme akademike dhe shkencore në mbarë trojet shqiptare. Ky vlerësim e pozicionon UBT-në si institucionin më të mirë në vendet shqipfolëse, duke dëshmuar përkushtimin e tij në kërkimin shkencor, inovacion dhe avancimin e arsimit të lartë. Në këtë rangim, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është renditur i dyti në Kosovë, ndërsa institucionet e tjera nuk janë ranguar ende. Rektori i UBT-së,

Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka theksuar se ky sukses është rezultat i vizionit të qartë dhe punës së palodhur për të krijuar një ekosistem akademik të integruar.

“UBT ka arritur të ndërtojë një platformë të veçantë që ndërthur teknologjinë, shkencën dhe inovacionin, duke krijuar mundësi reale për kërkuesit dhe studentët. Rangimi në SCImago është një tjetër dëshmi e cilësisë dhe lidhshmëritë të UBT-së në arsimin dhe shkencën në rajon”, u shpreh Rektori Hajrizi.

SCImago është një platformë ndërkombëtare, e cila analizon dhe renditë e institucionet shkencore bazuar në produktivitetin dhe impaktin e tyre shkencor. Rangimi bëhet duke kombinuar performancën kërkimore, inovacionin



dhe ndikimin shoqëror. UBT vazhdon të konfirmojë statusin e tij si institucion lider në arsimin e lartë, duke u renditur në klasifikime prestigjioze si WURI, GreenMetric, Webometrics, EFQM, si dhe duke u vlerësuar me çmime të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë “European Young Entrepreneurial University of the Year”.

UBT shënon arritje historike: Renditet përsëri ndër institucionet më të mira në botë dhe i pari në rajon, sipas GreenMetric



UBT është renditur ndër institucionet më të mira në botë nga UI GreenMetric World University Ranking, një ndër vlerësimet globale më prestigjioze për

qëndrueshmërinë universitare dhe kampuset e gjelbra. UBT është institucioni i parë në rajon që pozicionohet me sukses në këtë renditje të rëndësishme ndërkombëtare.

Nga mbi 1,800 institucione pjesëmarrëse nga e gjithë bota, UBT është renditur në 50% e institucioneve më të mira, duke konfirmuar angazhimin e tij për krijimin e kampuseve të gjelbra, të qëndrueshme dhe inovative.

Në veçanti, në kategorinë e kampuseve inovative, në mesin e mbi 500 institucione të përfshira globalisht, UBT u rendit në vendin e 169, duke treguar përkushtimin e vazhdueshëm të institucionit ndaj standardeve ndërkombëtare dhe inovacionit në mjedis.

UI GreenMetric përdor një metodologji që vlerëson 39 indikatorë në gjashtë fusha kyçe: mjedisin dhe infrastrukturën, energjinë dhe ndryshimet klimatike,

menaxhimin e mbetjeve, ujin, transportin, si dhe edukimin dhe kërkimin.

Rezultatet e këtij viti e pozicionojnë UBT-në si një nga institucionet më të përparuara në rajon për qëndrueshmërinë e kampusit dhe politikat inovative të menaxhimit. Kjo arritje e vendos UBT-në në një pozitë të veçantë në hartën akademike ndërkombëtare dhe përfaqëson një sukses të jashtëzakonshëm për institucionin dhe arsimin e lartë në Kosovë.

Ajo dëshmon se institucionet në Kosovë mund të konkurrojnë me sukses në skenën globale, duke tejkaluar standardet ndërkombëtare në qëndrueshmëri, inovacion dhe zhvillim të përgjegjshëm. UBT ka qenë pjesë e kësaj renditjeje prestigjioze edhe në vitet 2023 dhe 2024, duke treguar një angazhim të vazhdueshëm për qëndrueshmërinë mjedisore dhe ndryshimet klimatike.

Në garën botërore të robotikës FIRST Global Challenge në Panama

Ekipi përfaqësues i Kosovës merr dy çmime

Nga Panamaja, ekipi përfaqësues i Kosovës në garën botërore të robotikës FIRST Global Challenge u vlerësua për videon më të mirë prezantuese dhe për dokumentimin më të mirë të garës në rrjetet sociale në mesin e 190 shteteve pjesëmarrëse. Ky sukses tregon angazhimin dhe kreativitetin e të rinjve kosovarë, të cilët përfaqësuan vendin me krenari në një nga garat më prestigjioze ndërkombëtare të robotikës.

Tema e garës së sivjetme kishte në fokus ruajtjen e ekuilibrit të biodiversitetit dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike, duke inkurajuar të rinjtë nga e gjithë bota të zhvillojnë zgjidhje teknologjike për mbrojtjen e mjedisit.



Në kuadër të projekteve të financuara nga Regional Challenge Fund UBT fiton çmimin e parë në Ballkanin Perëndimor për projektin më të mirë

UBT është shpallur fitues i çmimit të parë në Ballkanin Perëndimor nga Regional Challenge Fund (RCF) në kuadër të iniciativës "Update & Shine – Net4VET Challenge", për projektin më të mirë inovativ "Developing Software Developer Skills by Integrating Artificial Intelligence".

Projekti i UBT-së u dallua për qasjen vizionare në zhvillimin e aftësive të programuesve të rinj, përmes integritimit të inteligjencës artificiale në procesin e të

mësuarit dhe trajnimit praktik.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimit morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe Drejtori i Departamentit për Edukim dhe Zhvillim Profesional, Prof. Dr. Besnik Skenderi.

UBT konfirmon lidhshirësinë në rajon në fushën e teknologjisë, inteligjencës artificiale dhe edukimit profesional, duke dëshmuar se është një model i ekselencës dhe inovacionit ndërkombëtar.



Zgjerohet edhe më tutje rrjeti global i UBT-së UBT hap degën e vet në Londër

Në një ceremoni të veçantë, ku morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Ambasadori i Kosovës në Britaninë e Madhe, Ilir Kapiti, zëvendësambasadori, Vlorat Gashi, përfaqësues nga diaspora, miq, familjarë, partnerë dhe akademikë të shquar, UBT ka filluar zyrtarisht punën në qendrën e tij inovative, Global UBT London.

Rektori Hajrizi theksoi se hapja e UBT-së në Londër, pranë Institucioneve Financiare dhe Globale në Canary Wharf, tregon përkushtimin e UBT-së për t'u aktivizuar në nivel global, sepse vlerat, produktet dhe shërbimet që UBT tashmë i ka zhvilluar nuk kanë vetëm qasje për Kosovën, por janë edhe vlera të shtuara për tregun global.

Përmes Londrës, si një qendër globale e botërore, ndihmohen edhe Kosova edhe Ballkani Perëndimor, në lidhjen me bizneset, realizimin e projekteve, rritjen e vendeve të reja të punës, duke rritur kështu edhe zhvillimin, shtoi ai.

“Vlerat, produktet dhe shërbimet që UBT ka zhvilluar ndër vite nuk kufizohen



vetëm në Kosovë, por përbëjnë vlera të shtuara për tregun global. Përmes Londrës, si një nga qendrat kryesore botërore, synojmë të forcojmë lidhjet me bizneset, të realizojmë projekte të reja dhe të gjenë vendet e reja pune, duke ndikuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor”, u shpreh Rektori Hajrizi. Ambasadori Kapiti vlerësoi hapjen e kësaj qendre si një hap të rëndësishëm për forcimin e marrëdhënieve akademike dhe profesionale midis Kosovës

dhe Britanisë së Madhe dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetje. Modeli i UBT-së, si një ekosistem inovativ për zhvillimin e kompetencave dhe projekteve të reja, përmes një qasjeje të re dhe revolucionare në arsim, shkencë, teknologji dhe biznes është i kërkuar nga shtete të ndryshme.

Një tregues i qartë i kësaj është hapja e qendrave të UBT tanimë edhe në vende tjera të Botes si dhe bashkëpunimi global që UBT tani ka më shumicën e vendeve të zhvilluara dhe me perspektivë në botë.

Rektori i UBT-së prezantoi modelin “UBT Smart City” në Universitetin e Cambridge



Në Universitetin e Cambridge, një nga institucionet më prestigjioze në botë, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka mbajtur një ligjëratë mbi modelin inovativ “UBT Smart City”, një ekosistem i zgjuar dhe i qëndrueshëm, i cili tashmë është prezantuar në mbi 100 institucione në mbarë botën.

Me pjesëmarrjen e një audience të gjerë akademikësh, studiuesish dhe studentësh, Rektori Hajrizi ndau vizionin e tij mbi zhvillimin e qyteteve të mençura, duke theksuar rolin e teknologjisë, inteligjencës artificiale dhe ndërmarrësisë në krijimin e zgjidhjeve inovative për sfidat urbane.

Ai prezantoi gjithashtu konceptin “UBT 5S” (Small Scale Smart Sustain System), një ekosistem sipërmarrës që tashmë po zbatohet me sukses në UBT dhe që ndikon në zhvillimin ekonomik, cilësinë e jetës dhe edukimin e qëndrueshëm.

Mbi bazën e teknologjisë së lartë digjitale – rrjeti 5G, inteligjenca artificiale dhe realiteti virtual – UBT ka ndërtuar konceptin “UBT Smart City”, apo “15 minuta ecje deri në qytetin e mençur”. Ky model, i cili përfshin laboratore, dhoma studimi, biblioteka, qendra teknologjike dhe elemente të tjerë, është një qytet me të gjitha funksionet e jetës për studentët dhe qytetarët, në

një hapësirë që ndodhet brenda 15 minutash.

Në kuadër të qëndrimit të tij në Cambridge, Rektori Hajrizi zhvilloi gjithashtu takime të rëndësishme me departamente të ndryshme për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit të mëtutjeshëm.

UBT, bashkë me Qendrën për Rezilencë dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, ka zhvilluar Programin për krijimin e laboratorëve për simulime të politikave punuese dhe kombëtare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Programet dhe studimet që janë zhvilluar përfshijnë tema si ushqyerja e fëmijëve, energjia, sigurimi shëndetësor, ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e performancës së institucioneve publike, etj. Ky angazhim është një hap tjetër në përpjekjet për të ofruar zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme për problemet globale.

Vizita në Cambridge dhe ligjëratat e Rektorit Hajrizi theksojnë rëndësinë e lidhjeve ndërkombëtare dhe përpjekjet për të avancuar edukimin dhe inovacionin në nivel global, duke kontribuar në forcimin e partneriteteve të reja dhe mbështetjen e kërkimit dhe iniciativat që ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave të përbashkëta globale.

UBT pjesë e panairit më të madh botëror të teknologjisë në Bett

UBT vazhdon të shënojë suksese në arenën ndërkombëtare, duke marrë pjesë në panairin më të madh botëror të teknologjisë në arsim, Bett, i cili u mbajt në Londër, Britani e Madhe.

Me një ftesë të veçantë, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, së bashku me kolegët Hasan Metin dhe Elita Hajrizin, përfaqësuan UBT-në në këtë ngjarje e cila mbledh profesionistë, institucione arsimore dhe kompani nga e gjithë bota. Gjatë këtij panairi, ekipi i UBT-së zhvilloi takime me përfaqësues të disa prej kom-

panive më të mëdha globale, përfshirë Microsoft, Meta, Google dhe shumë të tjera, ku UBT prezantoi teknologjitë e veta më të sofistikuar, si dhe u eksploruan mundësitë për bashkëpunime strategjike. UBT vitin e ardhshëm do të marrë prezantime produktet e veta të teknologjisë në arsim, sikurse 3.0, 4.0, AI, Smart City, si dhe mbi 40 produkte të tjera në këtë panair prestigjioz, duke u veçuar si një nga institucionet e pakta nga rajoni që do të përfaqësojë potencialin dhe arritjet e Ballkanit në skenën globale.



Rektori i UBT-së përcjell punimet e Forumit Ekonomik Botëror Davos 2025



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, si anëtar digjital dhe pjesëmarrës në Forumin Botëror të Davos-it përmes Open Forum po përcjell me pjesëmarrje aktive punimet e Forumit Ekonomik

Botëror Davos 2025, i cili po mbahet këtë javë në Zvicër.

UBT vazhdon të jetë një kontribuues i fuqishëm në ndërlidhjen mes arsim-it, inovacionit dhe zhvillimit ekonomik, duke sjellë përvoja dhe vizione që mbështesin avancimin e Kosovës në arenën globale.

Temat e Forumit në këtë vit janë më me interes strategjik edhe për UBT-në edhe për Kosovën. Forumi i sivjetmë, që bashkon liderë globalë nga politika, biznesi dhe shoqëria civile, ka si temë kryesore "Bashkëpunimi për Epokën Inteligjente", duke adresuar sfidat dhe mundësitë që sjellin teknologjitë e avancuara dhe inteligjenca artificiale.

Bashkëpunimi global, interdisciplinarteti dhe inovacioni janë përgjigje

për sfidat e sotme dhe të ardhmes së njerëzimit, e të planetit tonë në përgjithësi.

"UBT me ekosistemin inovativ të mençur dhe me fokus në reziliencë dhe zhvillim të qëndrueshëm po ofron një platformë konvergjente për edukim, shkencë, inteligjencë artificiale, teknologji e biznes, me të cilat mund të gjenerohen kushte reale për shkathësitë e së ardhmes, vende të reja të punës, potencial për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm", potencoi Rektori Hajrizi.

Për këtë arsye, UBT vitet e fundit është vlerësuar për kontributin dhe ndikimin në edukim, cilësi, ndërmarrësi, teknologji, inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm e punë pionire.

Rektori Hajrizi po merr pjesë në ceremoninë e 70-vjetorit të Universitetit të Salentos në Lecce të Italisë

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me ftesë të Rektorit të Universitetit të Salentos, Prof. Fabio Pollice, po merr pjesë në ceremoninë e 70-vjetorit të themelimit të këtij institucioni të shquar në Lecce të Italisë. Kjo ngjarje e rëndësishme ka mbledhur personalitete të njohura nga bota akademike, politike dhe shoqërore, duke e kthyer atë në një moment të veçantë për arsimin dhe kërkimin shkencor.

UBT dhe Universiteti i Salentos tashmë kanë vendosur bashkëpunime akademike në fusha të ndryshme, duke përfshirë vizitat studimore, projekte zhvillimore akademike dhe shkëmbime të studentëve dhe stafit, që kontribuojnë në avancimin e arsimit dhe inovacionit në të dy institucionet.

Në këtë ceremoni, ku po merr pjesë edhe Presidenti i Italisë, Sergio Mattarella, Rektori Hajrizi po përfaqëson UBT-në si institucion lider në arsimin e lartë në



Kosovë. Ai po zhvillon takime me përfaqësues të universiteteve prestigjioze evropiane dhe personalitete të njohura nga fusha të ndryshme, me qëllim forcimin e lidhjeve dhe zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Ceremonia shënon një moment të veçantë për universitetin pritës, duke vlerësuar historinë dhe kontributin e tij në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, ndërsa Rektori Hajrizi ka shprehur vlerësimin e tij për rolin e rëndësishëm që Universiteti i Salentos ka luajtur në zhvillimin e dijes dhe shkencës ndër vite.

Rektori Hajrizi mori pjesë në ceremoninë përkujtimore të 19-vjetorit të vdekjes së Presidentit Dr. Ibrahim Rugova

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë në ceremoninë përkujtimore me rastin e 19-vjetorit të vdekjes së Presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova. Ceremonia, e organizuar nga Presidenca e Republikës së Kosovës, mbledhi personalitete të rëndësishme nga fusha e politikës, akademisë, kulturës dhe shoqërisë civile për të nderuar trashëgiminë e paharruar të Presidentit Rugova. Rektori Hajrizi vlerësoi rolin vendimtar të Presidentit Rugova në konsolidimin e identitetit kombëtar dhe në rrugëtimin e Kosovës drejt pavarësisë dhe demokracisë. Ai theksoi se vizioni dhe filozofia paqësore e Rugovës mbeten një burim frymëzimi për brezat e rinj, duke u bërë shembull i një lidërshepi që ndërtoi ura mirëkuptimi dhe qëndroi gjithmonë besnik ndaj aspiratave të popullit.

Rektori Hajrizi: Shkenca dhe inovacioni, prioritet i UBT-së për zhvillimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare



UBT ka shënuar një progres të jashtëzakonshëm duke u renditur në mesin e 100 universiteteve më të mira në botë dhe duke u veçuar në fusha specifike si inteligjenca artificiale dhe ndërmarrësia në nivel evropian. Ky institucion është pozicionuar si universiteti i dytë në Evropë për qasje në ndërmarrësi dhe i 26-ti në botë për inteligjencën artificiale, duke përforcuar rolin e tij si një qendër arsimore dhe shkencore kryesore në Kosovë dhe më gjerë.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka theksuar se puna shkencore është prioritet kryesor i institucionit. Gjatë vitit akademik 2024/2025, mbi 3 mijë studentë u regjistruan në UBT, me 75% të tyre të përqendruar në fushat

STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe menaxhim) dhe 25% në fusha të tjera. Sipas Hajrizit, UBT ka përfutuar ndjeshëm nga projektet evropiane dhe ndërkombëtare, duke rritur numrin e diplomave të dyfishta dhe projekteve hulumtuese shkencore në bashkëpunim me institucione prestigjioze nga SHBA dhe Evropa.

“Kemi pasur ngritje të ndjeshme në rankimet ndërkombëtare, si për ndërmarrësinë, ashtu edhe për inovacionin dhe inteligjencën artificiale. Gjithashtu, kemi krijuar mbi një mijë vende pune, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të vendit”, theksoi ai.

UBT ka punuar për ta futur Kosovën në hartën ndërkombëtare të kërkimit shkencor, përmes digjitalizimit dhe zhvillimit të aplikacioneve teknologjike që ndihmojnë sektorë si arsimit publik dhe shëndetësia.

“Kemi krijuar mundësi për trajtime mjekësore falas dhe kemi ndihmuar shkollat publike dhe institucionet me zgjidhje inovative”, shtoi Rektori Hajrizi, duke nënvizuar se arsimiti i lartë në Kosovë ka ende nevojë për avancim, sidomos në pjesën e rankimeve shkencore.

Gjatë vitit 2024, UBT ka aplikuar për disa

programe të reja studimore, duke përfshirë doktoratat në fushën e mjekësisë ndërkombëtare dhe zgjerimin e akreditimeve globale. Institucioni është gjithashtu i angazhuar në zhvillimin e komponentëve të qytetit të mençur 2025, një nismë që synon të vendosë Kosovën në qendër të teknologjisë dhe inovacionit.

UBT ka zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve me universitete dhe institucione ndërkombëtare si ato në Vjenë, Itali, Gjermani, Varshavë, Spanjë, Britani, dhe SHBA, duke forcuar programet e diplomave të dyfishta dhe duke ndarë njohuri të avancuara në teknologji dhe shkencë. Synimet për të ardhmen duke reflektuar mbi këto arritje, UBT synon ta rrisë më tej ndikimin e tij në skenën globale përmes avancimit të punës shkencore dhe integritit të Kosovës në rrjetet ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit.

“Prioriteti ynë për vitin 2025 do të jetë zhvillimi i punës shkencore, që Kosova të duket më mirë në statistikën globale dhe të përfaqësohet në nivele të larta”, përfundoi Rektori Hajrizi. Me këto arritje dhe përkushtim, UBT po pozicionohet si lider në arsimin e lartë dhe një shtyllë e rëndësishme në zhvillimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Rektori Hajrizi prezanton ekosistemin inovativ UBT Smart City në EU Winter School

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ishte pjesë e EU Winter School, një program i organizuar nga EYCA Kosova, i cili synon të mbledhë ekspertë dhe profesionistë të rinj për të diskutuar mbi inovacionin, tërheqjen e investimeve dhe rritjen ekonomike.

Në ditën e parë të programit, e cila u fokusua në baza teorike mbi tërheqjen e investimeve, Rektori Hajrizi prezantoi temën: “UBT Smart City –a Place based Small-scale smart sustain en-

trepreneurial innovation ecosystem”. Në prezantimin e tij, Prof. Dr. Hajrizi ndau përvojën e UBT-së në ndërtimin e një ekosistemi të zgjuar inovativ, që promovon zhvillimin e sipërmarrjes së qëndrueshme, integritimin e teknologjisë në jetën urbane dhe krijimin e një mjedisi ku studentët dhe profesionistët mund të eksperimentojnë me zgjidhje të avancuara për qytetet e së ardhmes. Një element kyç i këtij ekosistemi është krijimi i një mjedisi interaktiv, ku stu-



dentët, profesionistët dhe sipërmarrësit kanë hapësirën dhe mjetet e duhura për të zhvilluar inovacione teknologjike, duke eksperimentuar dhe testuar në kushte reale ide që mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës urbane.

UBT arrin numrin më të lartë të të punësuarve në sektorin privat të arsimit të lartë

Politika e punës dhe funksionimit të UBT-së, që nga themelimi e deri sot, në përvjetorin e saj të 24-të, ka pasur si qëllim kryesor përgatitjen e gjeneratave të reja për tregun e punës dhe angazhimin e tyre në sektorin privat të arsimit të lartë. Një tjetër prioritet i rëndësishëm ka qenë shndërrimi i UBT-së në një vatrë punësimit për individë të tjerë.

UBT vazhdon të mbetet lider në arsimin e lartë jopublik, duke luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë dhe në uljen e papunësisë në vend.

Nga fillimet e tij, kur funksiononte me një numër të vogël akademikësh, kryesisht nga rrafshi ndërkombëtar, sot UBT

ka mbledhur qindra profesionistë dhe akademikë nga të gjitha trojet shqiptare. Këta individë janë shkolluar në universitetet më të njohura dhe prestigjioze të botës dhe tashmë ndajnë përvojën dhe ekspertizën e tyre me studentët e UBT-së. Përveç kontributit në uljen e papunësisë, UBT ka vënë theks të veçantë edhe në fuqizimin e grave në shkencë dhe menaxhimin, duke promovuar barazinë gjinore në punësim dhe zhvillim profesional. Stafit akademik i UBT-së përbëhet nga ekspertë me kompetenca të larta profesionale dhe diploma nga institucione të njohura ndërkombëtare, çka përbën një vlerë të shtuar jo vetëm

për institucionin, por edhe për Kosovën. “UBT kryesisht përbëhet nga një staf akademik, ku shumica janë doktorë shkencash ose në proces të përfundimit të doktoraturës. Politika jonë është të mbështesim intelektualët e rinj që kanë studiuar jashtë dhe tani kanë mundësi të angazhohen në UBT. Ky trend i rritjes së stafit është një arritje e jashtëzakonshme për ne”, theksoi Rektori Hajrizi. UBT është institucioni udhëheqës në lidhje me numrin e stafit të punësuar në arsimin privat të lartë. Ky trend rritjeje vazhdon çdo vit, duke pasqyruar përkushtimin e institucionit ndaj cilësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në 17-vjetorin e Pavarësisë, UBT mbështet rreth 200 studentë me bursa studimi

Në përvjetorin e 17-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, UBT ka shpërblyer 166 studentë ekselentë të të gjitha fakulteteve me bursa studimi, duke vlerësuar përkushtimin dhe rezultatet e tyre të shkëlqyera akademike. Këta studentë, të cilët kanë arritur një notë mesatare mbi 9.0, tashmë kanë siguruar një mbështetje të rëndësishme që do t'u lehtësojë rrugëtimin e tyre arsimor.

Gjatë ceremonisë së ndarjes së bursave, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e këtij shpërblimi si pjesë e angazhimit të institucionit për zhvillimin e talenteve dhe mbështetjen e studentëve më të dalluar. "Ky vendim është një shenjë e rëndësishme e përkushtimit tonë për të mbështetur studentët që janë të dalluar dhe që me punën e tyre kontribuojnë për të ardhmen e Kosovës. Në UBT, ne nuk ofrojmë vetëm edukim, por krijojmë mundësi për sukses duke i pajisur studentët me teknologjitë dhe resurset më të avancuara," tha ai.

Përveç bursave të ndara për këta 166 studentë, UBT vazhdon të jetë një nga institucionet më të përkushtuara në mbështetjen e arsimit, duke ndarë çdo vit bursa në vlerë totale prej 1 milion e 500 mijë euro. Këto bursa u ofrojnë mundësi studimi qindra të rinjve nga Kosova dhe rajoni, duke u mundësuar të ndjekin studime të avancuara dhe të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë.

Në këtë ceremoni, Rektori Hajrizi gjithashtu shpalli nënshkrimin e thirrjeve akademike për profesorët e UBT-së, të cilët me përkushtimin e tyre edukojnë gjenerata të tëra profesionistësh në mbi 50 fusha studimi. Ky angazhim i vazhdueshëm synon të rrisë cilësinë e arsimit dhe të krijojë mundësi të reja për punësim në nivel global.

UBT shënoi 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, nderon me çmimin më të lartë institucional ish-presidentin Fatmir Sejdiu dhe filantropin italian Salvatore Tafuro. Në një ceremoni solemne, UBT shënoi 17-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, një ditë me rëndësi të veçantë për kombin shqiptar dhe historinë e vendit. Me këtë rast, Këshilli Akademik i UBT-së ndau çmimin më të lartë institucional Honorary Degree "Excellence in Leadership": për dy personalitete me kontribut të jashtëzakonshëm në paqe, siguri dhe zhvillim: ish-presidentin e Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, dhe Presidentin dhe Themeluesin e R.I. Group dhe "Hospitals Without Borders", Salvatore Tafuro.

Në këtë ngjarje të rëndësishme morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkom-



bëtare, profesorë, studentë dhe të ftuar të shumtë.

Rektori Hajrizi, theksoi rëndësinë e vlerësimit të personaliteteve që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për të ardhmen e Kosovës.

"Në këtë ditë të shënuar, UBT ka nderin të vlerësojë dy personalitete të cilët kanë dhënë një kontribut të veçantë në paqe, siguri dhe zhvillim: ish-presidentin e Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, dhe Salvatore Tafuro, President dhe Themelues i R.I. Group dhe "Hospitals Without Borders". Presidenti Sejdiu ka luajtur një rol kyç në konsolidimin e shtetit të Kosovës, duke udhëhequr me vizion në momentet më të rëndësishme të historisë sonë dhe duke forcuar pozitën ndërkombëtare të vendit. Salvatore Tafuro, nga ana tjetër, ka treguar një përkushtim të jashtëzakonshëm në ndihmën humanitare ndaj shqiptarëve gjatë krizave më të vështira, duke krijuar kushte ekzistenciale për refugjatët shqiptarë të larguar nga Kosova drejt Shqipërisë në vitin 1999. Ai ka ndihmuar popullin tonë në periudha kritike dhe ka themeluar Hospitals Without Borders, një iniciativë që synon të ofrojë ndihmë shëndetësore dhe humanitare në zonat e krizës. Ky çmim është një shenjë mirënjohjeje për kontributin e tyre të madh ndaj Kosovës dhe njerëzimit", tha Rektori Hajrizi.

Në vijim, Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e arsimit dhe formimit të brezave të rinj, si një garanci për të ardhmen e vendit. "Ne të gjithë kemi një përgjegjësi të madhe për të edukuar një brez të ri profesionistësh të ardhshëm, njerëz të pasur shpirtërisht dhe qytetarë të denjë të Kosovës. Vetëm përmes diturisë, inovacionit dhe përkushtimit do të arrijmë ta bëjmë Kosovën një vend më të mirë dhe një atdhe të dashur për të gjithë", u shpreh ai.

Në fjalën e tij, ish-presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, u shpreh thellësisht i nderuar nga ky vlerësim dhe reflektuar mbi rrugëtimin e shtetit të Kosovës: "Ndiheh i prekur, pozitivisht, dhe i nderuar nga ky çmim, veçanërisht në këtë përvjetor të Pavarësisë së Kosovës. Sot, ne kujtojmë të kaluarën tonë të vështirë dhe shikojmë drejt të ar-



dhmes me vizion dhe shpresë. Historia jonë ndahet në dy epoka të rëndësishme: periudha para pavarësisë, e mbushur me sakrificë dhe përpjekje për të siguruar lirinë tonë, dhe periudha pas shpalljes së pavarësisë, e cila ka hapur horizonte të reja për zhvillimin dhe përparimin tonë. Nuk mund të mos përmend presidentin historik Ibrahim Rugova dhe komandantin legjendar Adem Jashari, të cilët përbëjnë një binom të pashkëputshëm në historinë tonë. Rugova, me diplomacinë dhe vizionin e tij, e çoi të vërtetën e Kosovës në çdo cep të botës, ndërsa Adem Jashari, me sakrificën e tij sublime, mbrojti pragun e shtëpisë dhe nderin e kombit", u shpreh Dr. Sejdiu.

Salvatore Tafuro, personalitet i shquar i fushës së filantropisë dhe ndihmës humanitare, shprehu mirënjohjen e tij për këtë vlerësim dhe përcolli një mesazh të fuqishëm për të rinjtë kosovarë.

"Është një nder i veçantë për mua të jem vlerësuar nga UBT, një institucion që mishëron dijen dhe përparimin e Kosovës. Gjatë viteve të vështira të luftës dhe pas saj, Kosova tregoi se është një popull i vogël, por me një zemër të madhe, me një dëshirë të madhe për t'u bërë një shtet i zhvilluar dhe i fuqishëm. Dua t'u përcjell një mesazh të veçantë të rinjve dhe akademikëve të UBT-së: sukseset më të mëdha në jetë arrihen kur përdorim trurin, duart dhe zemrën. Vetëm duke kombinuar dijen, punën dhe humanizmin, mund të krijojmë një të ardhme më të mirë për veten dhe për shoqërinë tonë", potencoi Tafuro.

Në fjalën e tij, Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, e vlerësoi këtë nisim të UBT-së si një akt të rëndësishëm për nderimin e personaliteteve që kanë dhënë kontribut të çmuar në fusha të ndryshme. Përmes kësaj ceremonie, UBT edhe një herë dëshmoi përkushtimin e saj ndaj vlerave të lirisë, dijes dhe humanizmit, duke nderuar figura që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë dhe zhvillimin e Kosovës. UBT do të vazhdojë misionin e tij për të formuar liderë të rinj dhe për të ndërtuar ura bashkëpunimi, duke mbetur një nga institucionet më të rëndësishme akademike dhe zhvillimore në Kosovë dhe më gjerë.

UBT në bashkëpunim me partnerët italianë organizon kursin për fonde dhe projekte Evropiane në Parlamentin Evropian

UBT, në bashkëpunim me partnerët italianë, ka organizuar kursin e parë për fonde dhe projekte evropiane, i cili u zhvillua në ambientin e Parlamentit Evropian. Ky kurs synon të forcojë njohuritë dhe aftësitë e pjesëmarrësve në menaxhimin dhe aplikimin e projekteve financuese evropiane.

Kursi u organizua në bashkëpunim me ITA-ICE, Flavio Boccia & Partners, AB-Corporation, Nexumstp, Eurocogit, IC&Partners, Zyrën Ligjore Boccia & Partners, Urdhrin Kombëtar të Kontabilistëve të Certifikuar të Italisë dhe UBT, duke u mbështetur edhe nga institucione të tjera ndërkombëtare.

Ky kurs mori mbështetje të fuqishme nga eurodeputeti Alberico Gambino dhe ishte një mundësi e jashtëzakonshme për zhvillimin e aftësive të specialistëve të rinj në fushën e europrojekteve, me një fokus të veçantë për Italinë, Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor.

Gjatë këtij eventi, rektori Hajrizi, në fjalimin e tij, theksoi potencialin, angazhimin dhe gatishmërinë e ekosistemit të UBT-së për të kontribuar në zhvillimin e projekteve të ndryshme në nivel evropian.

Në fjalimin e tij, Hajrizi shprehu përkushtimin e UBT-së për të ndihmuar në avancimin e projekteve që mbështesin



zhvillimin e politikave dhe iniciativave evropiane, duke siguruar që edukimi, kërkimi shkencor, inovacioni dhe industria të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e rajonit dhe më gjerë. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë dhe potencialin e bashkëpunimit midis institucioneve evropiane, italiane, të Kosovës dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të trajnohen dhe të mësojnë më shumë për mundësitë që ofron Bashkimi Evropian për projektet ndërkombëtare dhe të shohin eksperiencën dhe këndvështrime

nga ekspertët që prezantuan në këtë kurs. Një vlerë e shtuar ishte edhe vetë prezenca gjatë këtyre ditëve në Parlamentin Evropian, duke e përjetuar drejtpërdrejt ambientin e punës në Parlamentin Evropian.

Para disa kohësh, UBT së bashku me disa nga partnerët e këtij bashkëpunimi ka themeluar UBT Italian Innovation Hub në UBT Smart City, një hap i rëndësishëm për zhvillimin dhe avancimin e projekteve inovative ndërkombëtare. Duke parë interesimin e madh për tematika të tilla, UBT dhe partnerët kanë vendosur që kurse të tilla të ofrohen edhe në Kosovë dhe në rajon.

Rektori Hajrizi vizitoi Panairin Ndërkombëtar të Farmacisë dhe Kozmetikës “Cosmofarma Exhibition” në Bolonja



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka vizituar panairin ndërkombëtar “Cosmofarma Exhibition” që u mbajt në Bolonja të Italisë – një nga ngjarjet më

të rëndësishme në Evropë në fushën e farmacisë, kozmetikës dhe mirëqenies. Ky panair shërben si platformë për prezantimin e risive dhe praktikave më të avancuara në kujdesin farmaceutik dhe estetik, me fokus në shëndetin holistik të qytetarëve.

Pjesëmarrja e UBT-së në këtë aktivitet prestigjioz është dëshmi i angazhimit të saj për të qëndruar në hap me zhvillimet globale dhe për të promovuar standartet më të larta akademike e shkencore, sidomos në Fakultetin e Farmacisë, por edhe në njësitë tjera brenda ekosistemit inovativ të UBT-së.

Gjatë vizitës, Rektori Hajrizi zhvilloi takime me përfaqësues të kompanive farmaceutike dhe kozmetike, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në fushat e teknologjisë farmaceutike, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të produkteve të reja.

UBT tashmë ka ndërtuar eksperiencë të konsiderueshme në sektorin e farmacisë dhe shëndetësisë, jo vetëm në arsimim, por edhe përmes prodhimeve të veta, me synimin për të zgjeruar më tej bashkëpunimet ndërkombëtare në këtë fushë me ndikim të madh shoqëror.

Rektori Hajrizi takohet me Alessandro Alberanin, ish-presidentin e Interportos dhe Acer-it

Në vijim të qëndrimit të tij në Bolonjë, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, është takuar me ish-presidentin e Interportos dhe Acer-it, Dr. Alessandro Alberani – një nga portet më strategjike për tregtinë dhe transportin në rajon. Gjatë këtij takimi u diskutuan mënyrat

e bashkëpunimit në fushat e logjistikës, inxhinierisë së infrastrukturës, menaxhimit të transportit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe industrial – fusha këto të cilat janë të përfaqësuara në UBT përmes departamenteve si: Inxhinieria e Ndërtimit, Infrastruktura,

Planifikimi Hapësinor, dhe të tjera.

UBT synon që përmes këtyre lidhjeve të forcojë komponentën praktike të studimeve, duke sjellë përvojat e Portit të Bolonjës si model për zhvillimin e logjistikës së avancuar dhe portit të thatë të Kosovës.

Diskutim i hapur në UBT me Christopher Hyland: Miqësia Kosovë-ShBA, e ndërtuar mbi vlera të përbashkëta



Në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan, u mbajt diskutimi i hapur mbi temën “Kosovo’s Constitution: A Model of Democracy and Inclusivity”, me pjesëmarrjen e Christopher Hyland, një prej mbështetësve të fuqishëm të çështjes shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kjo ngjarje, e organizuar nga UBT HYLAND Center of Global Studies, mbledhi studentë, akademikë dhe të ftuar të rëndësishëm, të cilët patën mundësinë të dëgjojnë dhe të diskutojnë mbi rëndësinë e Kushtetutës së Kosovës në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe gjithëpërfshirëse.

Gjatë fjalës së tij, Christopher Hyland ndau përvojën dhe përkushtimin e tij në mbështetjen e aspiratave të shqiptarëve për liri, pavarësi dhe dinjitet kombëtar. Ai vuri në dukje rolin e tij në forcimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe rëndësinë e ndërhyrjes së NATO-s për lirinë e Kosovës.

“Që nga fundi i viteve 1980 dhe fillimi i viteve 1990, kërkova mbështetje nga komunitetet shqiptare dhe kosovare në Amerikë, të cilat sapo kishin filluar të çliroheshin nga aparati shtypës i diktaturës komuniste. Gjatë fushatës dhe

tranzicionit presidencial të Bill Clinton, si dhe më pas, punova me përkushtim për ta vendosur Kosovën dhe komunitetin shqiptaro-amerikan në qendër të politikës së administratës së re”, u shpreh Hyland.

Ai gjithashtu ndau kujtimet për takimet me figura kyçe të Kosovës, duke përfshirë Presidentin Ibrahim Rugova dhe aktivistin Jim Xhema, të cilët luajtën një rol kyç në ndërtimin e shtetit të Kosovës. “Kam pasur nderin të bashkëpunoj me figura të mëdha si Presidenti Ibrahim Rugova dhe Jim Xhema, të cilët ishin thelbësorë në ndërtimin e një rruge të sigurt drejt shtetësisë së Kosovës. Rugova me vizionin dhe diplomacinë e tij dhe Xhema me përkushtimin e tij të palodhur në SHBA, luajtën një rol të pazëvendësueshëm në këtë proces historik”. Në hapjen e kësaj ngjarje, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e diskutimeve të tilla në edukimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për demokracinë dhe të drejtat kushtetuese. “UBT është një qendër e rëndësishme e inovacionit, dijes dhe zhvillimit akademik, duke kontribuar në formimin e liderëve të ardhshëm që do të ndikojnë në qeverisjen, ligjin dhe demokracinë në Kosovë dhe më gjerë. Ne jemi të nderuar që kemi mundësinë

të presim një figurë kaq të shquar si Christopher Hyland, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në avancimin e proceseve demokratike dhe forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës,” tha Rektori Hajrizi.

Gjatë diskutimit, Christopher Hyland analizoi thellësisht rolin e Kushtetutës së Kosovës si një model demokracie dhe gjithëpërfshirjeje, duke vlerësuar rëndësinë e saj në forcimin e institucioneve shtetërore dhe të drejtave të qytetarëve. Ai gjithashtu dha një perspektivë të gjerë mbi konstitucionalizmin si bazë e ndërtimit të demokracive të qëndrueshme në nivel global.

“Jam krenar për lidhjen e fortë që është krijuar mes Kosovës dhe SHBA-së. Kjo nuk është një miqësi e rastësishme, por një marrëdhënie e ndërtuar mbi vlerat e përbashkëta të lirisë dhe demokracisë. Kur NATO ndërhyri për të ndaluar gjenocidin ndaj shqiptarëve të Kosovës, ishte një moment historik që erdhi si rezultat i një angazhimi të madh diplomatik dhe një miqësie të sinqertë mes dy popujve”. Hyland gjithashtu ngriti shtetësimin për kërcënimet ndaj Kushtetutës së Kosovës, duke theksuar se: “Mbrojtja e Kushtetutës së Kosovës është thelbësore, sidomos ndaj përpjekjeve për të krijuar një asociacion të komunave serbe brenda Kosovës, një entitet që do të ishte de facto i lidhur me Serbinë. Kjo është një çështje që duhet të adresohet me kujdes të madh”.

Në përmblyllje të diskutimit, Christopher Hyland shprehu vlerësimin e tij për UBT-në dhe për përpjekjet e saj për të ndërtuar një akademi që kontribuon në zhvillimin e Kosovës.

“Kur jam në UBT, ndiej se jam në shtëpi. Ky është një institucion i jashtëzakonshëm që ka një ndikim të madh në të gjitha fushat e shoqërisë. Jam i nderuar të jem këtu sot dhe të ndaj këtë bisedë të rëndësishme me ju”, u shpreh Hyland.

Rektori Hajrizi viziton fabrikën “Pensi” në Bolonja – shembull suksesi i diasporës shqiptare në Itali

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, gjatë një vizite zyrtare në Itali, ka vizituar fabrikën industriale “Pensi” në qytetin e Bolonjës – një ndërmarrje moderne që është ndërtuar dhe drejtohet me profesionalizëm nga sipërmarrësit shqiptarë me origjinë nga Shkodra, Genc dhe Ervin Podgorica.

Gjatë vizitës, Rektori Hajrizi u njoh nga afër me teknologjitë më të avancuara që

përdoren në fabrikë, organizimin modern të punës si dhe me gamën e gjerë të produkteve që zhvillohen në këtë qendër të prodhimit industrial.

Ai i përgëzoi vëllezërit Podgorica për suksesin e arritur dhe për kontributin e tyre si model frymëzues i diasporës shqiptare në botë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit mes bizneseve shqiptare në diasporë dhe insti-

tucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Rektori Hajrizi shprehu gjithashtu gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, sidomos në drejtim të shkëmbimit të përvojave dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta në fushat e industrisë, mekanikës, robotikës dhe inovacionit teknologjik – fusha në të cilat UBT po përgatit kuadro të rinj dhe të specializuar prej vitesh.

Rektori i UBT-së në ceremoninë festive të inaugurimit si anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Evropës në Salzburg në Austri



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë në ceremoninë festive për inaugurimin e anëtarëve të rinj të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Evropës. Kjo ngjarje prestigjioze u organizua në Amfiteatrin kryesor të Universitetit të Salzburgut dhe mbledhi personalitete të shquara nga e gjithë bota.

Me këtë rast, Rektorit Hajrizi dhe anëtarëve të tjerë të pranuar gjatë këtij viti iu nda Certifikata e Anëtarësimit.

Rektori Hajrizi theksoi se pranimi në Akademi është një mundësi për të kontribuar më tej në fushat e interesit, duke adresuar probleme globale dhe sfida të reja.

“Jam i nderuar dhe i lumtur që jam pranuar në një komunitet kaq të rëndësishëm në Evropë dhe do të ofroj kontributin tim edhe më gjerë, veçanërisht në trajtimin e problematikave të reja

globale që lidhen me fushat e mia të interesit, si inteligjenca artificiale, zhvillimi i qëndrueshëm, inovacioni, qytetet e mençura dhe të vetëqëndrueshme, edukimi, teknologjia dhe shumë të tjera”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Pranimi në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Evropës është një tjetër arritje e rëndësishme e Rektorit Hajrizi dhe UBT-së, duke theksuar angazhimin për zhvillimin e shkencës, inovacionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në nivel akademik.

Rektori Hajrizi u takua me shumë personalitete të njohura të shkencës nga e gjithë bota, duke përfshirë edhe Presidentin e Akademisë, z. Klaus Mainzer, me të cilët diskutoi mundësitë e bashkëpunimit. Për hir të anëtarëve të rinj, Akademia Evropiane organizoi një mbrëmje gala festive të shtunën.

Rektori Hajrizi vizitoi Panairin Ndër-

kombëtar të Farmacisë dhe Kozmetikës “Cosmofarma Exhibition” në Bolonja. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka vizituar panairin ndërkombëtar “Cosmofarma Exhibition” që u mbajt në Bolonja të Italisë – një nga ngjarjet më të rëndësishme në Evropë në fushën e farmacisë, kozmetikës dhe mirëqenies.

Ky panair shërben si platformë për prezantimin e risive dhe praktikave më të avancuara në kujdesin farmaceutik dhe estetik, me fokus në shëndetin holistik të qytetarëve.

Pjesëmarrja e UBT-së në këtë aktivitet prestigjioz është dëshmi e angazhimit të saj për të qëndruar në hap me zhvillimet globale dhe për të promovuar standardet më të larta akademike e shkencore, sidomos në Fakultetin e Farmacisë, por edhe në njësitë tjera brenda ekosistemit inovativ të UBT-së. Gjatë vizitës, Rektori Hajrizi zhvilloi takime me përfaqësues të kompanive farmaceutike dhe kozmetike, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në fushat e teknologjisë farmaceutike, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të produkteve të reja.

UBT tashmë ka ndërtuar eksperiencë të konsiderueshme në sektorin e farmacisë dhe shëndetësisë, jo vetëm në arsimim, por edhe përmes prodhimeve të veta, me synimin për të zgjeruar më tej bashkëpunimet ndërkombëtare në këtë fushë me ndikim të madh shoqëror.

Rektori Hajrizi mori pjesë në Konferencën Vjetore të EU4DUAL në Spanjë

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë në Konferencën Vjetore të Aleancës më të madhe të Universiteteve Evropiane për Edukimin Dual – EU4DUAL, e cila u mbajt në San Sebastian në Spanjë. Kjo ngjarje mbledhi përfaqësues nga universitetet më prestigjioze të Evropës, institucione kërkimore dhe industria për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në arsimin dual dhe ndikimin e tij në tregun e punës dhe inovacionin global.

Gjatë konferencës, Rektori Hajrizi ishte pjesë e debatit dhe diskutimeve kyçe mbi ekonominë e gjelbër (green economy), të ardhmen e punës (future work), shëndetin (health), prodhimtarinë e qëndrueshme dhe inteligjencën artificiale (AI).

Ai zhvilloi takime të rëndësishme për përfaqësues të tjerë dhe ndau përvojën dhe qasjen e UBT-së në këto fusha,



duke theksuar rëndësinë e edukimit të bazuar në praktikë, inovacionit teknologjik dhe bashkëpunimit ndërmjet

akademisë dhe industrisë.

UBT është ranguar dhe ka marrë çmime botërore për fushat përkatëse, sikurse për Generativ AI është renditur në vendin e 26 nga WURI, e po ashtu në top universitetet më të mira për mjedisin dhe qëndrueshmërinë klimatike nga Green Metric, si dhe për inovacion, cilësi, teknologji e të tjera. Këto arritje Rektori Hajrizi i ka theksuar edhe gjatë diskutimeve në Konferencën Vjetore të EU4DUAL në Spanjë, duke ndarë përvojën dhe qasjen e UBT-së për integrimin e inovacionit dhe teknologjive të avancuara në arsimin dhe kërkimin shkencor.

UBT është institucioni udhëheqës në Kosovë dhe rajon, që integron edukimin dual dhe qasjet moderne të mësimdhënies, me qëllim krijimin e një gjenerate të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e së ardhmes.

Sektori publik dhe privat bashkë në UBT për politika të qëndrueshme energjetike



Në ambientet e UBT-së, në bashkëorganizim me CIGRE Kosova, u mbajt konferenca me temën “Tranzicioni i Energjisë: Implementimi i Politikave dhe Strategjisë së Energjisë, Digjitalizimi”. Kjo konferencë mbledhi përfaqësues të institucioneve të rëndësishme të sektorit energjetik, akademikë, studentë dhe ekspertë të fushës, për të diskutuar rreth zhvillimeve aktuale dhe sfidave në procesin e tranzicionit energjetik në Kosovë. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në fjalën e tij hyrëse theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional, digjitalizimit dhe inovacionit si elemente kyçe për përballimin e sfidave të tranzicionit energjetik.

“UBT është një institucion që është përgatitur me kohë që përmes platformës akademike dhe shkencore, të përgatisë kuadro të rinj profesionalë dhe të kontribuojë në ndërtimin e një ekonomie të gjelbër dhe të qëndrueshme në vendin tonë”.

Ndërsa Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, theksoi përkushtimin e Qeverisë për zhvillimin e sektorit të energjisë përmes miratimit të Strategjisë së Energjisë, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së gjerë në këtë proces.

“Për hartimin e Strategjisë së Energ-

jisë kemi pasur konsultime publike në shtatë komuna të Kosovës, ku edhe vetë kam marrë pjesë. Megjithatë, kemi parë që interesimi më i madh i qytetarëve shfaqet kur flitet për tarifën, e jo kur diskutojmë për dokumentet strategjike që janë themelore për zhvillimin afatgjatë”, tha Ministria Rizvanolli.

Më tej, ajo shtoi se “energjetika është një fushë dinamike që po ndryshon shumë shpejt për shkak të zhvillimeve teknologjike dhe ndikimeve ndërkombëtare, prandaj zhvillimi i kapaciteteve njerëzore është thelbësor”.

Ajo potencoi se deri tani janë bërë dy ose tre investime të mëdha sipas strategjisë energjetike, dhe theksoi se synimi është që “deri në vitin 2030 Kosova të jetë pjesë e tregut evropian të energjisë elektrike”. Kryetarja e Komitetit Nacional të CIGRE Kosova, Pranvera Dobruna – Kryeziu, foli për rolin ndërkombëtar të kësaj organizate si burim ekspertize në fushën e energjisë.

“CIGRE në vitin 2022 ka miratuar një strategji që parasheh përdorimin e ekspertizës së anëtarëve të saj për të mbështetur vendimmarrjen në politikëbërje publike”.

Ajo rikujtoi se në simpoziumin e parë të mbajtur në vitin 2022, “menjëherë pas përfundimit kemi dërguar rekoman-

dimet tona në institucionet përkatëse, përfshirë edhe ministrinë, në një kohë kur strategjia ende nuk ishte miratuar”. Konferenca u karakterizua nga pjesëmarrja e studentëve të programit të energjisë, si dhe nga profesorë universitarë, dekanë dhe përfaqësues të institucioneve publike dhe private që janë të përfshira në implementimin e politikave energjetike në Kosovë.

Gjatë konferencës u mbajtën prezantime të shumta, përfshirë: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e cila prezantoi sfidat e dekarbonizimit sipas strategjisë së re energjetike,

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë (KOSTT) që diskutoi rreth vështirësive në zbatimin e masave në rrjetin transmetues dhe balancimin e sistemit, Kompania për Distribucion të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) që solli në fokus sfidat e rrjetit të shpërndarjes,

Kompania AIR Energy (GURIS) e cila ndau përvojën nga operimi i Parkut me Erë në Kitkë, në juglindje të Kosovës, dhe UBT që paraqiti ndikimin e integritetit të burimeve të ripërtëritshme në aspektin ekonomik dhe teknologjik të sektorit energjetik.

Konferenca u përmbyll me një sesion diskutimesh të hapura mes ekspertëve, studentëve dhe përfaqësuesve institucionale, ku u theksua domosdoshmëria për përsheptimin e reformave, krijimin e kushteve të favorshme për investime dhe mbështetjen e brezit të ri si faktor kyç për të ardhmen energjetike të Kosovës.

Rektori Hajrizi pjesëmarrës në takim vjetor të Aleancës më të madhe të Universiteteve Evropiane për Edukimin Dual EU4DUAL në Francë

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë si anëtar i Bordit Këshillëdhënës Industrial në takim vjetor të Aleancës më të madhe të Universiteteve Evropiane për Edukimin Dual EU4DUAL, i cili u mbajt në Institutin e Teknologjisë ESTIA në Francë. Ky takim ka të bëjë me avancimin dhe përmirësimin e arsimit dual në Evropë dhe mbledh përfaqësues të institucioneve edukative, industrisë dhe sektorëve të inovacionit.

Gjatë këtij takimi, Rektori Hajrizi prezantoi UBT-në dhe modelin e tij të edukimit dual, duke theksuar veçoritë dhe sukseset e ekosistemit të UBT-së. Ai diskutoi mbi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë mes universiteteve dhe

industrisë, si dhe ndikimin e UBT-së në përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe nevojat e tij të zhvilluara. Prezantimi i tij shpjegoi gjithashtu strategjitë dhe praktikatat që UBT implementon për të krijuar mundësi të mëdha për studentët, duke i përgatitur ata për një karrierë të suksesshme në sektorët kyç të industrisë dhe teknologjisë.

Takimet e partnerëve të aleancës EU4Dual, që kanë vazhduar për disa ditë, kanë mbledhur ekspertë dhe përfaqësues të lartë nga fusha e arsimit, industrisë dhe inovacionit.

Rektori Hajrizi ka zhvilluar një sërë takimesh dhe vizitash me përfaqësues të universiteteve të ndryshme pjesëmarrëse, duke promovuar modelin



e UBT-së dhe duke diskutuar mundësi bashkëpunimi për të avancuar arsimin dual dhe për të ndihmuar zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të studentëve. Kjo ngjarje u ofroi pjesëmarrësve mundësi për të diskutuar sfidat dhe mundësitë që paraqiten në edukimin dual, veçanërisht në kontekstin e ndryshimeve të shpejta në tregun global të punës.

UBT përfaqësohet në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “Drejtësia, Siguria dhe të Drejtat e Njeriut”



Fakulteti Juridik në UBT ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore “Justice, Security and Human Rights” (ICJSHR-LFUL 2025), të mbajtur në ambientet e Universitetit Luarasi në Tiranë.

Konferenca, e cila u zhvillua në kuadër të Ditës së Evropës, mbledhi së bashku personalitete të njohura akade-

mike, përfaqësues institucionalë dhe ekspertë të fushave të drejtësisë, sigurisë dhe të drejtave të njeriut, nga Shqipëria, Kosova dhe rajoni.

UBT ishte pjesë e kësaj ngjarjeje të rëndësishme si partnere akademike dhe u përfaqësua nga Dr. Egzone Osmanaj, Zëvendësdokane e Fakultetit

Juridik, e cila mbajti një fjalë përshëndetëse në sesionin plenar, si dhe prezantoi dy punime shkencore në sesionet tematike të konferencës.

Konferenca u shënua nga një frymë bashkëpunimi ndërinstitucional dhe akademik, duke ofruar një platformë të vlefshme për shkëmbimin e ideve, përvojave dhe praktikave të mira në fushën e drejtësisë dhe të sigurisë.

UBT, përmes përfaqësuesve të tij dhe bashkëpunimit të ngushtë me institucione të tjera akademike në Shqipëri, po dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm në avancimin e dijes juridike, promovimin e të drejtave të njeriut dhe ngritjen e standardeve të arsimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Studentët e Inxhinierisë së Agrikulturës dhe Mjedisit në UBT realizojnë vizitë praktike në industrinë e bletarisë

Studentët e programit Inxhinieria e Agrikulturës dhe Mjedisit në UBT, si në nivelin Bachelor ashtu edhe Master, zhvilluan një vizitë praktike studimore në dy nga ndërmarrjet më të njohura të sektorit të bletarisë në vend, “API ROI” dhe “APIMODERNA”.

Gjatë kësaj vizite, studentët patën mundësinë të njoftohen nga afër me proceset e prodhimit, përpunimin dhe kontrollin e cilësisë në këto industri, duke parë në praktikë se si funksionojnë standardet profesionale në sektorin e prodhimit të mjaltit dhe produkteve të tjera bletare.

Vizita u zhvillua në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme të UBT-së për të kombinuar teorinë me praktikën, duke



i ofruar studentëve një përvojë të drejtpërdrejtë në terren, që ndihmon në zgjerimin e njohurive akademike dhe zhvillimin e aftësive praktike profesionale. Ky aktivitet dëshmon edhe njëherë qasjen moderne të UBT-së në arsim,

përmes lidhjes së ngushtë me industrinë dhe krijimit të mundësive konkrete për përgatitje të avancuar profesionale, duke përgatitur studentë të aftë për tregun e punës dhe sfidat reale të sektorëve të agrikulturës dhe mjedisit.

UBT mbështet industrinë ushqimore përmes trajnimeve praktike dhe bashkëpunimeve strategjike

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Fakultetit të Shkencave të Ushqimit në UBT dhe industrisë ushqimore në Kosovë, janë realizuar me sukses dy trajnime profesionale për stafin e kompanisë “Sach Pizza Corporation”, e cila operon në 18 lokacione në Kosovë dhe është zgjeruar edhe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

Trajnimi i parë, i udhëhequr nga Prof. Asoc. Dr. Mergim Mestani, u fokusua në temën: “Faktorët që ndikojnë në Sigurinë Ushqimore: Higjiena/Sanitarja, Siguria në Punë dhe Kujdesi ndaj Mjedisit”.

Ky trajnim trajtoi çështje kyçe si: Higjiena personale dhe ambientale në

industrinë ushqimore; Parandalimi i kontaminimeve mikrobiologjike, kimike dhe fizike; Identifikimi i rreziqeve në vendin e punës dhe masat parandaluese; Menaxhimi i mbetjeve ushqimore dhe ndikimi në mjedis; Edukimi i vazhdueshëm i punonjësve për mbajtjen e standardeve të sigurisë.

Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime praktike dhe morën materiale vizuale dhe video edukative që ndihmuan në thellimin e njohurive të fituara. Trajnimi i dytë, i udhëhequr nga Prof. Asoc. Dr. Medin Zeqiri, u përqendrua në temat: “Pritja dhe Komunikimi me Klientët në Pikat e Shitjes” dhe “Prezantimi Vizual i Ushqimeve për Konsumatorët”

Ky trajnim synoi rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientit përmes zhvillimit të aftësive të komunikimit dhe prezantimit profesional, si dhe përmirësimin e përvojës së konsumatorit në pikat e shitjes.

Ky bashkëpunim konkret ndërmjet UBT-së dhe kompanisë Sach Pizza reflekton angazhimin e institucionit për të ofruar arsim praktik, të lidhur ngushtë me tregun e punës. Studentët e Fakultetit të Shkencave të Ushqimit në UBT përfitojnë nga vizitat studimore dhe praktikat profesionale në këtë kompani, ndërsa disa prej tyre tashmë janë të punësuar në sektorin ushqimor.

Etika mediatike në fokus të debatit në UBT, me pjesëmarrje të personaliteteve të njohura nga fusha e gazetarisë dhe komunikimit

Në kuadër të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, në UBT është mbajtur një forum i nivelit të lartë, i cili mbledhi së bashku personalitete të njohura të gazetarisë, komunikimit dhe rregullatorëve mediatikë, për të trajtuar temën shumë të ndjeshme dhe aktuale të etikës në media.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin: Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive në Shqipëri, Armela Krasniqi, Kryetari i Komisionit të Pavarur për Media, Besnik Berisha, Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Prof. Dr. Ferid Selimi, Kryeredaktorja e KTV-së dhe Kryetare e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, Brikenda Rexhepi, gazetari dhe autori i disa botimeve në fushën e etikës mediatike, Prof. Musa Sabedini, drejtuesit dhe redaktorë të mediave vendore si Muhamet Hajrullahu, Ilir Zylfiu, Shkodran Gajraku, si dhe profesorë e studentë të fushës së komunikimit.

Në fjalën hapëse, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e thellimit të diskutimit për etikën profesionale në gazetari, duke vënë në dukje se kjo çështje nuk është vetëm akademike, por përbën një dimension thelbësor për funksionimin e shoqërisë demokratike:

“Pjesa e etikës është një tematikë që nuk duhet anashkaluar. Janë çështje me interes për t’u diskutuar për të gjithë, dhe uroj që ky forum të shërbejë për konkluzione konkrete që të japim një mesazh të qartë nga ky takim”.

Ai shtoi se në bashkëpunim me ekspertë të fushës janë realizuar disa hulumtime për të analizuar nivelin e etikës në media dhe ndikimin që ajo ka në rritjen e besueshmërisë tek publiku. Duke vlerësuar punën e gazetarëve, Hajrizi ngriti edhe çështjen e stabilitetit financiar, duke thënë se gazetarët nuk paguhen sa duhet dhe kjo ndikon në cilësinë e punës së tyre. “Gazetaria është profesion fisnik. Por, për ta mbështetur atë, duhet t’u krijojmë kushte të qëndrueshme financiare gazetarëve, që të mos bien pre e ndikimeve negative”.

Në këtë diskutim, Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Prof. Dr. Ferid Selimi, tha se etika është një nga shtyllat bazë të formimit profesional të studentëve të komunikimit, dhe UBT është e përkushtuar që përmes kurrikulave moderne dhe trajnimve të përgatit gazetarë të përgjegjshëm.

Rektori Hajrizi vlerësoi kontributin e profesorëve të UBT-së të cilët publiko-



jnë herë pas here libra të rëndësishëm për etikën dhe komunikimin, duke përmendur veçanërisht kontributin e gazetarit dhe profesorit Musa Sabedini, i cili ka mbi 33 vite përvojë dhe ka botuar tri libra, ndërsa së shpejti pritet të publikojë edhe një tjetër që prek temat delikate të etikës mediatike në Kosovë.

Ndërkohë, Armela Krasniqi, Kryetare e AMA-s në Shqipëri, theksoi se edhe pse janë vendosur gjopa ndaj televizioneve, problemi kryesor mbetet edukimi i individëve, sidomos në raport me platformat si TikTok. Ajo tha se janë vërejtur disa shkelje serioze të ligjit dhe mungesë transparence në pronësinë e mediave online. “Nuk është e lehtë të konkurrosh në një mjedis të tillë mediatik. Ka media që nuk dihet kush janë pronarët e tyre, dhe kjo e bën të vështirë rregullimin. Por, shtypi duhet të jetë i lirë, sepse vetëm një shtyp i lirë krijon qytetarë të shëndetshëm”, tha mes tjerash Krasniqi. Besnik Berisha, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media, theksoi se liria e shprehjes ka kuptim vetëm kur menaxhohet me vetëkontroll dhe jo me masa ndëshkuese. “Sfidat për gazetarët rriten kur raportojnë për interesa të mëdha financiare. Media duhet të jetë profesionale dhe objektive, jo shërbëtoare e grupeve të interesit. Misioni ynë është të nxisim diversitetin, jo të mbyllim mediat”, u shpreh Berisha.

Prof. Musa Sabedini, gjatë fjalës së tij, tha se mungesa e literaturës ka qenë nxitje për të përfshirë temat e etikës në tekstet që ai ka shkruar, duke u përpjekur të trajtojë ato tema për të cilat të tjerët nuk kanë guxuar të flasin.

“Gazetaria online ka mungesë dokumentimi, mungesë transparence për përmbytjen dhe kufijtë e saj. Ka gazetarë të mirë, por mungojnë ata që kanë guximin të dalin në terren. Gazetari duhet të jetë në gjendje të përballet me institucionet, me pushtetin, pa frikë. Etika nuk është një ditë në vit, por duhet të jetë pjesë e përditshmërisë sonë”, potoi Sabedini.

Brikenda Rexhepi, Kryeredaktore në KTV dhe Kryetare e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, theksoi se përkundër përpjekjeve për vetërregullim, ka raste kur gazetarët qëllimisht e shkelin etikën për klikime dhe përfitime financiare.

“Media duhet të ketë pronësi të qartë, transparencë financiare dhe profesionalizëm. Një gazetar i mirë duhet të formohet në terren, të dijë të shmangë shkeljen e etikës dhe të ruajë balancën mes lirisë dhe përgjegjësisë. Liria nuk është kur publikohen foto të fëmijëve në kushte të papërshtatshme apo kur promovohen përmbajtje që nxisin vetëvrasje. Kjo është e papranueshme”, vlerësoi Rexhepi.

Kryeredaktori i Telegrafi, Muhamet Hajrullahu, me rreth 25 vite përvojë në media, u shpreh i shqetësuar për renditjen e Kosovës në vendin e 99-të për lirinë e medias. Ai theksoi nevojën për t’u përshtatur me format inovativë të gazetarisë dhe rritjen e profesionalizmit. Safet Zejnullahu theksoi se roli i gazetarit është i pazëvendësueshëm edhe në kohën e inteligjencës artificiale.

“Gazetari duhet të jetë në vendin e ngjarjes, të dijë të bëjë gjithçka – të raportojë, të fotografojë, të analizojë. Redaksitë nuk kanë më luksin të kenë staf të ndarë për gjithçka, por kjo nuk duhet të cenojë cilësinë”.

Prof. Afërdita Maliqi, gazetare dhe ligjëruese që nga viti 1999, tha se pavarësisht moshës, është e rëndësishme të përqafohen risitë, por pa lënë pas profesionalizmin dhe etikën. Ndërsa, gazetari Shkodran Gajraku, që ka nisur punën në media që nga viti 2008, ndau përvojën e tij, duke theksuar lirinë që ka pasur në raportim, por edhe sfidat, përfshirë kërcënimet e drejtpërdrejta.

Në këtë forum u dha një mesazh i qartë: Etika në gazetari nuk është luks, por domosdoshmëri. Liria e shprehjes dhe përgjegjësia duhet të ecin krahas krahas, për një media më të lirë, më të drejtë dhe më profesionale.

Profesori i Akademisë Ajrore të ShBA mban ligjëratë për studentët e Studimeve të Sigurisë në UBT

Në kuadër të ciklit të ligjëratave të lëndës “Strategjia Kombëtare e Sigurisë”, studentët e vitit të parë të programit të Studimeve të Sigurisë patën mundësinë të ndjekin një ligjëratë tematike të mbajtur nga një figurë e shquar ndërkombëtare në fushën e sigurisë – Profesori amerikan Col. Chad Austin.

Ligjëratata u organizua nga Prodekani i Fakultetit të Studimeve të Sigurisë, Prof. Arian Kadriu dhe Prof. Shaip Osmani, dhe u zhvillua në një atmosferë dinamike dhe interaktive, ku të pranishmit patën mundësinë të përfshiheshin në diskutime të hapura mbi çështje aktuale të sigurisë globale.

Prof. Col. Chad Austin, i cili aktualisht ligjëron në United States Air Force Academy në Colorado Springs, ShBA, si dhe në European University Viadrina Frankfurt (Oder) në Brandenburg, Gjermani, solli një pasqyrë të thelluar mbi temat kyçe si: lidhshimi në kontekste të tensionuara, kornizat ligjore



të sigurisë, dhe proceset e negociatave gjatë konflikteve.

Gjatë prezantimit, Prof. Austin ndau përvoja konkrete nga puna e tij me misionet ushtarake ndërkombëtare, duke ndriçuar rëndësinë e përgatitjes akademike të studentëve të sigurisë për të kuptuar dhe menaxhuar situata të ndërlikuara në mjedise reale të konfliktit dhe diplomacisë ndërkombëtare. Ky aktivitet është pjesë e vazhdimë-

sisë së bashkëpunimit të Fakultetit të Studimeve të Sigurisë me Ushtrinë Amerikane dhe me ekspertë ndërkombëtarë të fushës së sigurisë, përmes ligjëratave tematike, tryezave të rumbullakëta dhe konferencave shkencore. Kjo qasje e hapur dhe ndërkombëtare kontribuon ndjeshëm në zgjerimin e horizontit akademik të studentëve dhe në përgatitjen e tyre për sfidat e reja të sigurisë globale.

Inteligjenca Artificiale në fokus: UBT sjell ekspertizën në Qendrën DIG-4K



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Harizi, së bashku me Prof. Vehbi Sofiun, Drejtor i Kampusit të UBT-së në Prizren, dhe Prof. Besnik Skenderin, Drejtor i Departamentit për Edukim dhe Zhvillim Profesional në UBT, morën pjesë në ceremoninë zyrtare të lansimit të Qendrës për Ekselencë në Inovacion Digjital “Digital Innovation Gateway for Kosovo – DIG-4K”.

Kjo qendër, e para e këtij lloji në Kosovë, u lansua në kuadër të programit Evropa Digjital, të cilin Kosova e nënshkroi me Bashkimin Evropian në vitin 2023. DIG-4K tashmë është bërë pjesë e Rrjetit të Qendrave Evropiane të Inovacionit Digjital (EDIH) dhe synon të nxisë zhvillimin digjital në sektorë kyç të ekonomisë dhe shoqërisë.

DIG-4K do të ofrojë mbështetje të specializuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), si dhe për organiza-

tat publike, përmes qasjes në teknologji të avancuara si cloud computing, siguri kibernetike, inteligjencë artificiale, dhe mjete të tjera digjitale të nivelit të lartë. Ajo gjithashtu do të mbulojë fusha strategjike si e-commerce, fintech, shëndetësia, arsimi, dhe bujqësia.

UBT, si partner në këtë qendër të rëndësishme, do të japë kontribut të drejtpërdrejtë përmes ekspertizës së saj në inteligjencën artificiale, duke ofruar trajnime të avancuara, mentorim profesional dhe ndihmë në zhvillimin e zgjidhjeve digjitale për bizneset dhe institucionet publike që aplikojnë për mbështetje në kuadër të DIG-4K.

Kjo pjesëmarrje e UBT-së konfirmon edhe njëherë rolin e saj udhëheqës në avancimin teknologjik dhe edukimin e gjeneratave të reja me njohuritë më të fundit në fushat më kërkuese të kohës.

Stafi i UBT-së prezanton një model të ri për monitorimin bujqësor përmes dronëve dhe AI në FH Salzburg të Austrisë

Në kuadër të konferencës prestigjioze Austrian Robotics Workshop, zhvilluar në FH Salzburg të Austrisë, stafi i UBT-së: Ylli Rexhaj dhe Roni Kasemi prezantuan punimin e tyre inovativ me titull “DOPS – Drone Optimized Performance Score for Evaluating Real-Time Tomato Ripeness Detection”. Ky punim sjell një qasje të re dhe të avancuar për monitorimin e pjekurisë së domates përmes përdorimit të dronëve të pajisur me sensore të avancuar dhe algoritme inteligjence artificiale. Konferenca, që mbledh ekspertë dhe profesionistë nga fusha të ndryshme të robotikës, automatizimit dhe inteligjencës artificiale, ofron mundësinë që punimet më të fundit shkencore të ndahen dhe diskutojnë me një audiencë ndërkombëtare.

Punimi i Rexhajt dhe Kasemit është një hap përpara në përdorimin e teknologjisë për përmirësimin e efikasitetit të bujqësisë dhe ofron një zgjidhje praktike për monitorimin në kohë reale të pjekurisë së domates, duke ndihmuar fermerët të përmirësojnë cilësinë dhe rendimentin e prodhimeve të tyre.

UBT priti delegacionin e lartë nga Emiratet e Bashkuara Arabe – diskutohet për zhvillim arsimor dhe teknologjik

Në ambientet e UBT-së u zhvillua një takim i nivelit të lartë mes Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe një delegacioni të lartë nga Zyra për Çështje të Zhvillimit të Presidencës së Emirateve të Bashkuara Arabe. Delegacioni përbëhej nga ekspertë dhe këshilltarë të afërt të Presidentit të Emirateve të Bashkuara Arabe: Rabih Abouchakra, Bogdan Kolarov, Mohamed Al-Shamsi dhe Andrew Archer. Qëllimi i këtij takimi ishte vendosja e bashkëpunimeve strategjike ndërmjet Emirateve të Bashkuara Arabe dhe UBT-së, si një nga institucionet më kredibile dhe inovative në rajon. Në fokus të diskutimeve ishin fushat me interes të ndërsjellë, përfshirë arsimin e lartë, shëndetësinë, ndikimin e Intelligjencës Artificiale, si dhe sektorë



të tjerë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, teknologjik dhe social. Delegacioni nga Emiratet u impresionua nga niveli i zhvillimit të UBT-së, infrastruktura moderne, qasja ndërdisiplinare, bashkëpunimet ndërkombëtare si dhe rezultatet konkrete që ky institucion ka arritur në përgatitjen e kuadrove profesionale në Kosovë dhe më gjerë. Si rezultat i këtij takimi, përfaqësuesit nga Zyra për Çështje

të Zhvillimit të Presidencës së Emirateve të Bashkuara Arabe shprehën gatishmërinë për të avancuar bashkëpunimin konkret me UBT-në dhe ftuan zyrtarisht Presidentin dhe Rektorin e UBT-së për një vizitë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku pritet të konkretizohen projektet dhe iniciativat e përbashkëta në të ardhmen e afërt.

Shkenca, teknologjia dhe arsimiti i lartë në qendër të vizitës zyrtare të Rektorit Hajrizi në Itali

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Itali, me qëllim thellimin e bashkëpunimeve strategjike dhe zgjerimin e rrjeteve ndërkombëtare në fusha kyçe si teknologjia, arsimiti dhe inovacioni.


Kjo vizitë përfshiu takime të rëndësishme me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe rajonale, drejtues të kompanive të njohura, si dhe liderë të shkollave të menaxhmentit dhe teknologjisë.

Gjatë vizitës, Rektori Hajrizi ka prezantuar përvojën dhe sukseset e UBT-së në zhvillimin e arsimit të lartë, digjitalizimin, kërkimin shkencor dhe sipërmarrjen, duke e vendosur institucionin partner të besueshëm për projekte të përbashkëta evropiane dhe globale.

Pjesë e rëndësishme e agjendës është edhe diskutimi për shkëmbime akademike, projekte të përbashkëta kërkimore, si dhe integrimi i studentëve dhe stafit në rrjete të reja të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjatë kësaj vizite, Rektori Hajrizi u takua dhe zhvilloi një drekë pune me zëvendëspresidenten për Mobilitet dhe Infrastrukturë në rajonin Emilia-Romagna, Irene Priolo.

Studentët e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë vazhdojnë ligjëratat e përbashkëta me Universitetin e IOWA-s



Studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT kanë vazhduar me ligjëratat e përbashkëta me studentët nga Universiteti i IOWA-s në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kuadër të lëndës “Mjedisi Biznesor Ndërkombëtar”.

Ligjëratat janë udhëhequr nga Prof. Erin Johnson dhe Prof. Enver Krasniqi dhe janë zhvilluar në formë online,

duke ofruar një përvojë ndërkulturore dhe akademike të veçantë për të gjithë pjesëmarrësit.

Kjo është gjenerata e shtatë me radhë që merr pjesë në këtë bashkëpunim, ku studentët kanë pasur qasje në platformën akademike të Universitetit të IOWA-s, përmes së cilës kanë punuar në detyra, diskutime dhe aktivitete të tjera relevante që kontribuojnë në certifikimin e tyre nga ky program.

Gjatë ligjëratave, studentët nga të dy universitetet kanë bashkëpunuar në grupe, duke treguar angazhim dhe performancë të jashtëzakonshme në prezantimet e tyre. Temat e trajtuara filluan me prezantime ndërkulturore për jetën studentore në IOWA dhe në UBT, duke krijuar një ambient bashkëpunues dhe të hapur për shkëmbim përvojash.

Në përfundim të ciklit të ligjëratave, secili grup përgatiti dhe prezantoi një infografik për një produkt ose shërbim që aktualisht mungon në njërin nga vendet, por që do të kishte potencial suksesi në tregun tjetër. Prezantimet e dhjetë grupeve u vlerësuan si shumë të suksesshme dhe përmbushën të gjitha objektivat e sesioneve të përbashkëta, duke reflektuar një nivel të lartë të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të aftësive të fituara nga studentët.

UBT përkrah Edicionin e 15-të të Chopin Piano Fest Prishtina

UBT, si institucion i përkushtuar për avancimin e kulturës dhe artit në vend, ka kënaqësinë të jetë pjesë mbështetëse e Chopin Piano Fest Prishtina, një festival që është tashmë një traditë e konsoliduar kulturore për Kosovën.

Në kuadër të kësaj, do të mbahet një koncert që sjell në skenën kosovare dy nga emrat më të njohur të muzikës klasike në Evropë dhe më gjerë: violinistin e famshëm austriak Benjamin Schmid dhe pianistin virtuoz Marcus Schirmer.

Benjamin Schmid, që nga debutimi i tij si partner solo i legjendarit Sir Yehudi Menuhin në Festivalin e Salzburgut në vitin 1986, ka zhvilluar një karrierë të jashtëzakonshme ndërkombëtare me mbi 3000 performanca live. Ai është fitues i Konkursit Carl Flesch në Londër dhe një nga figurat qendrore të violinës moderne, duke interpretuar me violinën legjendare "ex-Viotti 1718" Strad-

ivarius.

Marcus Schirmer, i njohur për stilin e tij të fuqishëm dhe emocional, është lavdëruar për mënyrën e veçantë me të cilën ndërton histori përmes pianos. Me një karrierë të pasur koncertesh dhe mësimdhënieje, ai është një prej figurave kyçe të jetës muzikore në Austri dhe më gjerë.

Koncerti është pjesë e edicionit të 15-të të Chopin Fest, një festival që reflekton hapjen kulturore të vendit tonë, pasionin për muzikën dhe përkushtimin për cilësi. Këtë vit, në festival janë bashkuar artistë nga vende të ndryshme të botës, sikurse: Polonia, Franca, Hungaria, Ukraina, Austria, Italia, Mbretëria e Bashkuar, Lituania, Kuba dhe Suedia.

Koncerti do të mbahet të mërkurën, më 14 maj, në ora 20:00, në Amfiteatrin e Ri të Bibliotekës Qendrore Universitare të Prishtinës dhe realizohet në bash-



këpunim edhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ambasadën Austriake në Prishtinë dhe Meditech.

UBT fton të gjithë artdashësit që të bëhen pjesë e këtij koncerti dhe të përjetojnë nga afër mjeshtërinë muzikore të dy artistëve të mëdhenj.

Studentët e UBT-së diskutojnë për reformën në drejtësi dhe krimin e organizuar me Ambasadorin e Finlandës

UBT, vazhdon të jetë një platformë ku dijet ndërkombëtare ndërthuren me aftësitë e studentëve për t'u përballur me sfidat e kohës. Në kuadër të serisë së ligjëratave bashkëpunuese ndërmjet UBT-së dhe Ambasadës së Finlandës në Kosovë, kampusin e UBT-së e vizitoi Ambasadori finlandez, Matti Nissinen, i cili u prit me interes të madh nga studentët dhe stafi akademik i Departamentit të Shkencave Politike dhe Studimeve të Sigurisë.

Këtë herë, aktiviteti u përqendrua në prezantimet e përgatitura nga vetë studentët, të cilët trajtuan dy tema kyçe për të ardhmen e vendit dhe integrimin evropian: reformën në sistemin gjyqë-



sor në Kosovë dhe luftën e Bashkimit Evropian kundër krimit të organizuar. Prezantimet ishin të thelluara, me analiza të bazuara në hulumtim shkencor dhe praktikë krahasimore, duke ngjallur diskutime të frytshme mbi sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e sistemit gjyqësor në Kosovë. Gjithash-tu, u theksuan mekanizmat përmes të cilëve BE-ja dhe Kosova mund të bashkëpunojnë më ngushtë në luftimin e krimit të organizuar në rajon.

Studentët e UBT-së demonstruan nivel të lartë të përgatitjes, të mendimit kritik dhe të angazhimit qytetar, duke ngjitur pyetje të rëndësishme dhe duke

ofruar ide kreative për zgjidhje konkrete. Ambasadori Nissinen vlerësoi lart pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe vizionin e tyre për çështjet që ndikojnë drejtpërdrejt në sundimin e ligjit dhe sigurinë në Kosovë dhe më gjerë.

Aktiviteti dëshmon edhe një herë rolin aktiv që UBT ka në formimin e liderëve të së ardhmes në fushat e politikës, sigurisë dhe diplomacisë, duke u krijuar studentëve mundësi të drejtpërdrejta për të bashkëbiseduar me përfaqësues diplomatikë dhe për të marrë pjesë në diskutime me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare.

Rektori Hajrizi në Itali: Viziton Bologna Business School, drejt bashkëpunimeve akademike dhe shkencore

Gjatë vizitës së tij zyrtare në Itali, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, zhvilloi një takim me Prof. Emanuele Bajo, Drejtor i Bologna Business School (BBS) – shkollë e njohur për studimet e avancuara në fushën e menaxhmentit, ekonomisë dhe inovacionit në ndërmarrësi. Në këtë takim u prezantuan programet e avancuara të UBT-së, të

cilat ndërthurin teorinë me praktikën, duke fuqizuar kapacitetet menaxheriale dhe sipërmarrëse të studentëve në një kontekst global. Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë që UBT i jep inovacionit, ndërkombëtarizimit dhe ndërlidhjes me industrinë, si elemente kyçe për përgatitjen e kuadrove të ardhshme udhëheqëse.

U diskutua gjerësisht për mundësitë e bashkëpunimit në krijimin e programeve të përbashkëta, duke synuar rritjen e shkëmbimit të njohurive, përvojave akademike dhe shkencore, si dhe për zhvillimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe të financuara nga programet evropiane.

UBT nderon Tony Clement me çmimin më të lartë institucional Honorary Degree – Excellence in Leadership

Në një ceremoni solemne të mbajtur në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së, në Lipjan, UBT ndau çmimin më të lartë institucional Honorary Degree – Excellence in Leadership për liderin dhe politikanin e njohur kanadez, Tony Clement.

Ky çmim i veçantë vjen si njohje për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në fushën e udhëheqjes, inovacionit politik dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në ceremoni ishte i pranishëm edhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili tha se ky çmim përfaqëson një nderim të veçantë për një personalitet me një përvojë të thellë në leadership dhe, njëkohësisht, për një mik të çmuar të Kosovës. “Përmes këtij çmimi ne po nderojmë jo vetëm një personalitet me përvojë të pasur në leadership, por edhe një mik të Kosovës, i cili ka mbështetur vazhdimisht avancimin e vlerave demokratike dhe zhvillimin ndërkombëtar”, tha Rektori Hajrizi.

Në vijim të ceremonisë, Rektori Hajrizi theksoi se figura e Clement është shembulli më i qartë i një udhëheqësi që përmes vizionit, rrisë dhe përkushtimit ndaj së mirës së përbashkët ka krijuar ndikim të qëndrueshëm.

“Clement është shembulli më i mirë se si leadershipi vizionar, inovacioni dhe përkushtimi ndaj të mirës publike mund të krijojnë ndikim afatgjatë. Me këtë çmim, ne duam të inspirojmë brezat e rinj që të ndjekin rrugën e lider-



shipit të përgjegjshëm dhe bashkëpunimit global”. Clement, gjatë fjalës së tij, theksoi se ndjehej veçanërisht i nderuar për çmimin nga një institucion që përfaqëson përparimin, edukimin cilësor dhe të ardhmen. Ai vlerësoi Kosovën dhe UBT-në si shembuj të përkushtimit të sinqertë ndaj zhvillimit dhe integritetit ndërkombëtar, duke shprehur bindjen se këto vlera janë themeli i një bote më të bashkuar dhe të drejtë. “Është një privilegj i madh të pranoj këtë nderim nga një institucion që përfaqëson të ardhmen, përparimin dhe edukimin cilësor. Kosova dhe UBT janë shembuj të fuqishëm të përkushtimit ndaj zhvillimit dhe integritetit global”, tha Clement.

Në përmblyllje të fjalës së tij, Clement u shpreh se ky ishte nderimi i tij i parë i këtij lloji, të cilin e konsideronte si një

pikënisje të një marrëdhënieje të re dhe të veçantë me UBT-në.

“Ky është nderimi im i parë i këtij lloji dhe e konsideroj si një lidhje të veçantë që sapo është krijuar mes meje dhe UBT-së. Do të jem krenar të jem pjesë e komunitetit tuaj dhe do të përpiqem të kontribuoj përtej këtij momenti simbolik”.

Tony Clement ka mbajtur disa nga pozitat më të larta në qeverinë e Kanadasë, përfshirë ministrin e Shëndetësisë dhe ministrin e Industrisë, dhe ka qenë një zë i fuqishëm në mbështetje të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe reformave të thella politike dhe ekonomike. Me këtë çmim, UBT vazhdon traditën e tij për të nderuar personalitete të shquara që kanë lënë gjurmë në udhëheqje, arsim dhe shoqëri.

UBT u dallua me përfaqësim të suksesshëm dhe kontribut shkencor në Kongresin e 9-të Ndërkombëtar të Infermierisë Forenzike në Turqi



Në Universitetin e Kırıkkale-s në Turqi u mbajt Kongresi i 9-të Ndërkombëtar i Infermierisë Forenzike, i cili mbledhi studiues, akademikë dhe profesionistë nga vende të ndryshme për të diskutuar zhvillimet më të fundit në fushën e

infermierisë dhe shkencave forenzike. Ky kongres u organizua në bashkëpunim me Universitetin Katip Çelebi të Izmirit, Universitetin Bozok të Yozgatit, dhe Shoqatën e Shkencëtarëve Forenzikë të Turqisë, ndërkohë që UBT mori pjesë si universitet partner, duke u dalluar me prezencën dhe kontributin e tij shkencor.

UBT u përfaqësua nga Prof. Dr. Cengiz Çesko, i cili mbajti një prezantim shkencor në fushën e tij të ekspertizës. Prezantimi u prit me interes dhe vlerësim të lartë nga pjesëmarrësit, duke reflektuar profesionalizmin dhe përvojën akademike të UBT-së në fushat e shkencave forenzike dhe atyre shëndetësore.

Ndër figurat e rëndësishme të pranishme në këtë kongres ishin edhe Prorektori i Universitetit të Kırıkkale-s, Prof. Dr. Mehmet Başalan, dhe Rektori

i Universitetit Bozok të Yozgatit, Prof. Dr. Evren Yaşar. Në emër të UBT-së, Prof. Dr. Cengiz Çesko u dorëzoi atyre dhurata simbolike – një gjest që u vlerësua si shprehje e respektit institucional dhe thellimit të bashkëpunimit akademik ndërkombëtar.

Pjesëmarrje aktive në organizimin dhe zhvillimin e kongresit pati edhe Prof. Dr. Hamit Hanci, Kryetar i Shoqatës së Shkencëtarëve Forenzikë, i cili kontribuoi ndjeshëm në pasurimin e sesioneve shkencore dhe tërë programit kongresual.

Gjuha zyrtare e kongresit ishte turqishtja dhe anglishtja, ndërsa ngjarja ofroi një platformë të vlefshme për shkëmbim të njohurive dhe përvoja ndërkombëtare në fushën e infermierisë forenzike, duke nxitur lidhje të reja akademike dhe profesionale në këtë fushë me rëndësi të veçantë.

Rektori Hajrizi merr pjesë në Javën Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Akademik në TU-Sofia të Bullgarisë



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, po merr pjesë në Javën Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Akademik, e cila po mbahet në Universitetin Teknik të Sofjes (TU-Sofia).

Në këtë aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar, Rektori Hajrizi shoqërohet nga një delegacion prej pesë anëtarësh nga UBT, përfshirë profesorë dhe studi-

ues të fushave të ndryshme, të cilët kanë mbajtur prezantime dhe kanë shkëmbyer përvoja me përfaqësues të universiteteve nga Evropa, Amerika Latine dhe rajoni i Ballkanit.

Rektori Hajrizi ka zhvilluar takime me Rektorin e TU-Sofia, Prof. Dr. Georgi Venkov, Zëvendësrektoren Prof. Dr. Lidia Galabova, si dhe me drejtoreshën

e programit Erasmus+ në Bullgari dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve akademike partnere. Rektori Hajrizi mbajti një prezantim mbi vizionin dhe qasjen e UBT-së si një institut lider në arsim, i cili ndërthur arsimin, kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik në mënyrë të integruar. Ndërsa, Prof. Dr. Zhilbert Tafa, zhvilloi një prezantim rreth temës "Insights and Research in IoT" dhe Prof. Dr. Besnik Qehaja prezantoi hulumtime të reja në fushën e menaxhimit dhe inovacionit.

Delegacioni i UBT-së u bë pjesë aktive e paneleve dhe ligjëratave të shumta, ku trajtuan tema aktuale si: inteligjenca artificiale, algoritmet për edukim të personalizuar, digjitalizimi i arsimit, IoT dhe zhvillimet në rrjetet e avancuara 6G.

Studentë të Shkencave Politike nga ShBA vizituan UBT-në



Në kuadër të bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe shkëmbimeve akademike, një grup studentësh të Shkencave Politike nga Clemson University, ShBA, të shoqëruar nga profesori i njohur amerikan Jeffrey Peake, realizuan një vizitë studimore në UBT, ku u pritën nga studentët dhe stafi i programit Studime të Sigurisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte të nxitë njohjen e realitetit politik, historik dhe të

sigurisë në Kosovë, përmes interaksionit të drejtpërdrejtë ndërmjet studentëve amerikanë dhe atyre kosovarë. Diskutimet e zhvilluara në formë dialogu të hapur, shkëmbyen njohuri mbi sfidat dhe mundësitë që përballen të dy vendet në fushën e sigurisë, politikës ndërkombëtare dhe marrëdhënieve diplomatike. Gjatë takimit, studentët nga ShBA shprehën interes të veçantë për procesin e

shtetndërtimit të Kosovës, rolin e institucioneve të sigurisë, sfidat e politikës së jashtme, si dhe kontributin e Kosovës në paqen dhe stabilitetin rajonal. Nga ana tjetër, studentët e UBT-së ndanë perspektivat e tyre mbi bashkëpunimin ndërkombëtar, sigurinë globale, dhe rolet që vendet e vogla mund të kenë në një botë multipolare.

Profesori amerikan Jeffrey Peake, i cili është i specializuar në politikën e jashtme amerikane dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, theksoi rëndësinë e mësimin përmes përvojave ndërkulturore dhe vlerësoi nivelin e përgatitjes dhe angazhimit të studentëve të UBT-së.

Vizita u konsiderua një mundësi e shkëlqyer për ndërtimin e urave të bashkëpunimit akademik, për të nxitur dialogun ndërkombëtar, si dhe për të thelluar mirëkuptimin mbi çështjet aktuale të sigurisë dhe politikës globale.

Aktorja dhe profesoresha e UBT-së, Fatlume Bunjaku, pjesëmarrëse në edicionin e 78-të të Festivalit të Filmit në Cannes

Në edicionin e 78-të të Festivalit prestigjioz të Filmit në Cannes, këtë vit po merr pjesë edhe aktorja dhe profesoresha, Fatlume Bunjaku, e cila njëkohësisht është edhe profesoreshë në UBT.

Me ftesë të drejtpërdrejtë nga organizatorët e festivalit, profesoresha Bunjaku po qëndron në Cannes në cilësinë e aktorese dhe Casting Director, duke përfaqësuar denjësisht Kosovën dhe rajonin përmes kompanisë Balkan Faces. Ajo po merr pjesë në një sërë punëtorish, ngjarjesh dhe panelesh ndërkombëtare,

me qëllim të promovimit të aktorëve dhe talenteve të reja nga Ballkani në skenën globale të filmit.

Pjesëmarrja e saj në këtë festival të njohur botërisht është një vlerësim i rëndësishëm për kontributin që ajo ka dhënë ndër vite në artin skenik dhe kinematografi, por edhe një krenari për UBT-në, si institucion që fuqishëm mbështet dhe kultivon talentet në fushën e arteve. Përmes angazhimit të saj si pedagoge në UBT, Fatlume Bunjaku ka ndihmuar në formimin profesional të dhjetëra



studentëve të artit dramatik dhe filmit, duke i përgatitur ata për një karrierë të suksesshme në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Pjesëmarrja e saj në Cannes është një tjetër dëshmi e cilësisë së stafit akademik të UBT-së dhe ndikimit që ky institucion ka në ngritjen e kulturës dhe artit në vend

Studentët e Fakultetit MBE morën pjesë në “Kosova Finance Forum 2025”

Një grup studentësh nga Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, të shoqëruar nga Prof. Shpresim Vranovci, morën pjesë në “Kosova Finance Forum 2025”, i cili u mbajt në ambientet e Beethoven Hall në Prishtinë. Ky forum është një prej ngjarjeve më të rëndësishme në kalendarin financiar të Kosovës dhe një platformë strategjike për dialog profesional dhe politikëbërje financiare në nivel kombëtar e rajonal. Forumi mbledhi në një vend emrat më të spikatur të fushës së financave, përfaqësues nga Banka Qendrore e Kosovës, banka komerciale, institucione mikrofinanciare dhe fintech, fonda investive, kompani sigurimesh, si dhe ekspertë të fushës së financave dhe transformimit digjital nga vendi dhe rajoni, përfshirë edhe përfaqësues

nga organizata ndërkombëtare dhe institucione akademike.

Për studentët e UBT-së, pjesëmarrja në këtë forum përbën një mundësi të jashtëzakonshme për të ndjekur nga afër zhvillimet më të fundit në sektorin financiar, duke dëgjuar diskutime të thelluara mbi: Stabilitetin financiar dhe bashkëpunimin rajonal; Open Banking dhe teknologjitë financiare (fintech); Financimin e tranzicionit energjetik dhe të qëndrueshëm; Inovacionet digjitale në shërbimet financiare; Sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave financiare.

Përmes këtyre sesioneve, studentët pasuruan njohuritë e tyre praktike, u ekspozuan ndaj modeleve të suksesshme të menaxhimit financiar dhe zhvillimeve teknologjike në këtë fushë,



si dhe patën mundësi të ndërveprojnë me profesionistë dhe vendimmarrës të rëndësishëm të industrisë.

UBT, si institucion lider në arsimin e lartë në Kosovë, vazhdon të krijojë urë lidhëse mes teorisë dhe praktikës, duke u ofruar studentëve përvoja konkrete dhe pjesëmarrje në ngjarje me ndikim në formësimin e të ardhmes ekonomike dhe financiare të vendit.

Ambasadori i ri i Italisë në Kosovë, Maurizio Antonini, viziton Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së



Ambasadori i ri i Italisë në Kosovë, Maurizio Antonini, realizoi një vizitë të veçantë në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së, ku u prit nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe stafi akademik e profesional i institucionit.

Gjatë vizitës, Ambasadori Antonini pati mundësinë të njihet nga afër me kapacitetet teknologjike, labororët e avancuar, projektet inovative dhe bashkëpunimet ndërkombëtare që zhvillohen në këtë qendër unike në rajon. Ai vlerësoi lart përkushtimin e UBT-së në avancimin e arsimit, kërkimit shkencor dhe nxitjen e inovacionit,

duke theksuar potencialin për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe kompanive italiane dhe UBT-së.

Rektori Hajrizi shprehu mirënjohjen për këtë vizitë dhe theksoi rëndësinë e thellimit të marrëdhënieve me Kosovën dhe Italisë në fushën e arsimit të lartë, teknologjisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Vizita u përmbyll me një prezantim të projekteve të suksesshme të studentëve dhe një bashkëbisedim për mundësitë konkrete të bashkëpunimit të ardhshëm në kuadër të agjendave të përbashkëta për zhvillim.

Vizitë studimore në ARKEP me studentët e vitit të katërt të Juridikut në UBT

UBT vazhdon të jetë një institucion lider në ofrimin e përvojave praktike për studentët, përmes bashkëpunimeve me institucionet më të rëndësishme në vend. Në këtë kuadër, është realizuar me sukses një vizitë studimore në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), me pjesëmarrjen e studentëve të vitit të katërt të Fakultetit Juridik.

Kjo vizitë përbën një aktivitet të rëndësishëm edukativ, që synon të forcojë lidhjen mes teorisë dhe praktikës, duke i mundësuar studentëve të njihen nga afër me funksionimin real të një institucioni shtetëror me rol të rëndësishëm



në garantimin e rregullsisë dhe transparencës në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare në Kosovë.

Gjatë vizitës, studentët patën mundësi të bashkëbisedojnë me ekspertë të ARKEP-it, të cilët ofruan një pasqyrë të qartë mbi kompetencat ligjore të këtij autoriteti, sfidat me të cilat përballen në rregullimin e tregut, si dhe rëndësinë që ka ky institucion në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe promovimin e konkurrencës së ndershme.

Ky aktivitet është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të UBT-së për të promovuar programin Juridik si një program cilësor, i cili përgatit juristë të aftë për të kontribuar në sistemin ligjor dhe institucional të vendit. Studentët e këtij programi nuk marrin vetëm dije teorike, por pajisen edhe me shkathtësi praktike përmes vizitave, punëtorive dhe praktikave profesionale, duke u bërë kështu më të përgatitur për tregun e punës dhe sfidat profesionale që i presin.

Studentët e Medias dhe Komunikimit vizitojnë mediat kryesore në Shqipëri

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim realizuan një vizitë studimore në disa prej televizioneve dhe mediave më të njohura në Shqipëri, përfshirë Top Channel, Televizionin Klan, Vizion Plus dhe RTSH. Kjo vizitë ishte pjesë e aktiviteteve praktike dhe ndërdisiplinore që kanë për qëllim afrimin e studentëve me tregun real të punës dhe përgatitjen e tyre profesionale për sfidat që i presin në të ardhmen.

Të shoqëruar nga dekani i fakultetit, Prof. Dr. Ferid Selimi, profesorët Musa Sabedini, Votim Hanoli, Safet Zejnulahu si dhe mentorja e vizitave studimore Albina Zeneli dhe koordinatoresha e programit Jehonë Kapllani-Ilazi, studentët patën mundësinë të vizitojnë ambientet profesionale të redaksive, studiot e lajmeve dhe emisioneve, si dhe departamentet teknike të televizioneve, duke vëzhguar nga afër proceset e përditshme të prodhimit mediatic.

Gjatë kësaj vizite, studentët u pritën nga përfaqësues dhe gazetarë të njohur të secilës media, të cilët ndanë përvojat e tyre dhe shpjeguan mënyrën se si funk-



sionon një redaksi, si merren vendimet editoriale dhe çfarë sfidash përballet gazetaria moderne në një treg të lirë mediatic.

Vizita në këto media u përqendrua kryesisht në politikën editoriale të kanalit dhe mënyrën e përgatitjes së edicioneve informative dhe programeve analitike. Në Televizionin Klan, studentët patën rastin të ndjekin nga afër transmetimin live dhe të njihen me sistemin e automatizuar të transmetimit dhe arkivimit. Ndërkohë, në Vizion Plus u diskutua mbi zhvillimin e mediave digjitale dhe integrimin e platformave online në punëditore të gazetarit. RTSH, si media publike, ofroi një perspektivë të veçantë mbi

misionin e informimit të paanshëm dhe shërbimin ndaj publikut.

Kjo eksperiencë përbën një hap të rëndësishëm për formimin profesional të studentëve, duke i ndihmuar ata të lidhen drejtpërdrejt me realitetin e tregut mediatic në Shqipëri, të kuptojnë rëndësinë e etikës profesionale, objektivitetit dhe pavarësisë në raportimin e lajmeve.

UBT, përmes këtyre aktiviteteve, vazhdon të ofrojë një model bashkëkohor të arsimit të lartë, duke kombinuar teorinë me praktikën dhe duke krijuar ura lidhëse mes studentëve dhe industrisë së medias në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Studentët e Psikologjisë në vizitë studimore në SHFMU “Qamil Batalli” në Prishtinë



Studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Psikologjisë në UBT, nën udhëheqjen e profesoreshës Diana Sejdiu Shala, realizuan një vizitë studimore në kuadër të lëndës “Psikologji e Edukimit”. Vizita u zhvillua në ambientet e Shkollës Filllore dhe të Mesme të Ulët “Qamil Batalli” në Prishtinë, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, Liridon Maliqi.

Qëllimi i kësaj vizite ishte të ofrojë për studentët një përvojë praktike në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e psikologut shkollor. Gjatë vizitës, ata patën rastin të ndjekin një ligjëratë mbi funksionimin e grupit të ndërmjetësimit brenda shkollës

– një iniciativë që synon ndërtimin e një rrjeti ndërmjetësuesish për të përmirësuar ambientin shkollor, për të adresuar konfliktet në mënyrë konstruktive, dhe për të nxitur një kulturë bashkëpunimi mes nxënësve.

Po ashtu, pjesë e diskutimit ishte edhe struktura pedagogjike e shkollës, duke përfshirë qasjen e personalizuar ndaj nxënësve nga grupet parafillore deri te klasat më të larta. U theksua rëndësia e zhvillimit të aftësive bazë dhe socializimit në moshat e hershme, ndërsa në klasat më të avancuara fokusi zhvendoset te

ndërtimi i mendimit kritik dhe thellimi i njohurive.

Studentët u informuan gjithashtu për organizimin e qëndrimit gjithëditor në shkollë, që përfshin mësimin aktiv, pushimet, dhe mbështetjen psikologjike, duke kontribuar në krijimin e një ambienti të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës për zhvillimin e nxënësve.

Në këtë kontekst, u vlerësua edhe roli i bibliotekës së shkollës, e cila funksionon si një qendër burimesh edukative për nxënësit dhe mësimdhënësit. Ajo ndihmon në promovimin e leximit, hulumtimit të pavarur dhe zhvillimit akademik e personal të nxënësve gjatë gjithë vitit shkollor.

Kjo vizitë u konsiderua si një mundësi e vlefshme për studentët që të pasurojnë njohuritë teorike me përvojë praktike dhe të njihen nga afër me mjedisin shkollor dhe sfidat e profesionit të psikologut në arsim.

Ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, viziton Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së

Ambasadori i Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, realizoi një vizitë zyrtare në UBT dhe në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së, në Lipjan. Gjatë vizitës, Ambasadori Nissinen u prit nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Rektori Hajrizi, e falënderoi ambasadorin Nissinen për angazhimin e tij të palodhur dhe përkushtimin ndaj arsimit dhe zhvillimit të rinisë kosovare. Ai theksoi se Ambasada e Finlandës ka qenë një mbështetje e fuqishme për UBT-në dhe për studentët.

Rektori Hajrizi dhe Ambasadori Nissinen gjithashtu diskutuan mundësitë e bashkëpunimit në nivelin akademik dhe profesional, duke theksuar rëndësinë e shkëmbimit të studentëve dhe zhvillimitin e projekteve ndërkombëtare që mund të përfshijnë studentët e UBT-së.

Vizitë studimore e studentëve të Dizajnit të Integruar në Shtypshkronjën “Dukagjini” dhe Galerinë e Arteve në Pejë

Studentët e vitit të dytë të programit Dizajn i Integruar në UBT, nën udhëheqjen e profesorëve Ardita Rizvanolli, Rajan Arapi dhe Arbresha Hoxha, realizuan një vizitë studimore në qytetin e Pejës, në kuadër të zhvillimit praktik të njohurive të fituara gjatë studimeve.

Pjesa e parë e vizitës u zhvillua në Shtypshkronjën “Dukagjini”, një prej emrave më të njohur në industrinë e shtypshkrimit në vend. Studentët patën mundësi të ndjekin nga afër të gjitha etapat e prodhimit grafik – nga konceptimi dhe dizajnimi i produktit, përgatitja për shtyp, procesi i printimit, prerja, deri te lidhja përfundimtare. Kjo përvojë praktike u vlerësua si shumë e rëndësishme për të kuptuar ndërthurjen mes dizajnit, teknologjisë dhe realizimit përfundim-



tar të një produkti të printuar. Përfaqësuesit e shtypshkronjës u treguan të hapur dhe bashkëpunues, duke ofruar sqarime të detajuara dhe duke iu përgjigjur me përkushtim pyetjeve të studentëve.

Gjatë qëndrimit në Pejë, studentët vizituan gjithashtu Galerinë e Arteve, ku ishte e hapur ekspozita e artistit Orof Fetah Krypa. Ekspozita përmbante punime grafike të cilat pasuruan ndjeshëm

përvojën kulturore dhe artistike të studentëve, duke ndihmuar në zgjerimin e perceptimit vizual dhe estetik që është thelbësor për një dizajner të integruar. Kjo vizitë u konceptua si pjesë e angazhimit të programit të Dizajnit të Integruar për të kombinuar teorinë me praktikën, duke iu ofruar studentëve mundësi konkrete për të ndërtuar përvojë reale dhe kontakte profesionale në fushën e dizajnit, prodhimit dhe artit.

Dr. Elmi Berisha ligjeron në UBT për rolin e lobit shqiptaro-amerikan dhe aleancën strategjike Kosovë–ShBA



Në kuadër të bashkëpunimeve akademike dhe angazhimit për ofrimin e njohurive me rëndësi globale, në UBT u mbajt një ligjëratë tematike me Dr. Elmi Berishën, Presidenti i Federatës Panshqiptare VATRA në ShBA dhe një figurë e njohur në fushën e politikës dhe sig-

urisë ndërkombëtare.

Ligjëratë ishte e dedikuar për studentët e programit Studime të Sigurisë në UBT dhe u fokusua në sfidat aktuale të sigurisë globale, me theks të veçantë në rolin e politikës amerikane në adresimin e tyre. Dr. Berisha ndau një analizë

të thelluar mbi zhvillimet në skenën ndërkombëtare, përfshirë rivalitetin mes fuqive të mëdha, kërcënimet bërthamore, sigurinë kibernetike dhe transformimin e arkitekturës globale të sigurisë.

Pjesë e rëndësishme e diskutimit ishte ndikimi i lobit shqiptaro-amerikan në avancimin e kauzës shqiptare, si dhe rëndësia e aleancës së palëkundur mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Studentët patën mundësi të shtrojnë pyetje dhe të zhvillojnë një dialog të drejtpërdrejtë me Dr. Berishën, duke marrë përgjigje të argumentuara dhe perspektiva të vlefshme mbi çështje kyçe të sigurisë dhe politikës ndërkombëtare.

Filmi i shkurtër i profesorit të UBT-së, Alban Muja, nominohet për Çmimet Evropiane të Filmit

Një tjetër sukses i rëndësishëm për kinematografinë kosovare në arenën ndërkombëtare. Filmi i shkurtër “I Believe the Portrait Saved Me” me regji të profesorit të UBT-së, Alban Muja, është nominuar për Çmimet Evropiane të Filmit (European Film Awards) nga juria e Festivalit të Filmit të Shkurtër në Hamburg.

Filmi, i cili pati premierën botërore në Berlinale, trajton në mënyrë të ndërë dhe artistike fuqinë e kujtesës, identitetit dhe simbolikës së portretit si një formë shpëtimi në situata ekstreme. Ai është prodhuar nga 038STUDIO në bashkëpunim me AsphaltFilms dhe

është mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës.

Nominimi për EFA konsiderohet një ndër vlerësimet më të larta në fushën e filmit evropian, dhe përbën një njohje të drejtpërdrejtë të cilësisë dhe origjinalitetit që sjell ky projekt filmik.

Alban Muja, përveçse regjisor i filmit, është edhe artist i njohur ndërkombëtarisht dhe ligjërues në Fakultetin e Artit dhe Dizajnit në UBT. Në karrierën e tij shumëvjeçare, ai ka prezantuar veprat e tij në bienalet dhe ekspozitat më të njohura të artit bashkëkohor, ndërsa kjo veprë e fundit shënon edhe një përkushtim



të tij në format filmike të rrëfimit.

“I Believe the Portrait Saved Me” vjen si një dëshmi e fuqisë së tregimeve personale që tejkalojnë kufijtë gjeografikë dhe kulturorë, duke e pozicionuar edhe një herë Kosovën në hartën e krijimtarisë filmike evropiane.

UBT rilicencohet nga MASHTI për ofrimin e arsimit profesional në katër drejtime të rëndësishme shëndetësore



Me një vendim zyrtar të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), UBT është rilicencuar për të ofruar arsimin profesional në katër programe kryesore në fushën e shëndetësisë, duke forcuar edhe

më tej pozitën e tij si një nga institucionet udhëheqëse në arsim profesional në Kosovë.

UBT është rilicencuar për ofrimin e këtyre katër programeve: Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, Niveli III dhe IV (180 kredi AAP), Asistent Dentar, Niveli III dhe IV (180 kredi AAP), Teknik i Farmacisë, Niveli III dhe IV (180 kredi AAP), Teknik i Laboratorit Mjekësor, Niveli III dhe IV (180 kredi AAP)

UBT, si institucion lider në arsim, ofron infrastrukturë moderne dhe kushte të standardeve ndërkombëtare, të cilat i

mundësojnë studentëve një përvojë të plotë praktike dhe teorike. Laboratorët e pajisur me teknologji të avancuar, hapësirat multifunktionale për trajnim dhe praktikat e integruara në mjedise reale të punës janë vetëm disa nga asetet që garantojnë një arsimim të cilësisë së lartë. Përmes këtyre programeve dhe kushteve të avancuara, nxënësit do të kenë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u përgatitur për të qenë konkurrues si në tregun vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

UBT sjell në Tiranë trashëgiminë evropiane të Karl Gegës në bashkëpunim me partnerë prestigjiozë

UBT, në bashkëpunim me Fondacionin Musei Civici di Venezia dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ka organizuar një ngjarje të veçantë që përmbledh historinë dhe ndikimin e madh të Inxhinierit vizionar, Karl Gega. Konferenca Shkencore dhe Ekspozita, e titulluar "Një hekurudhë për të ndryshuar historinë", u dedikuan Inxhinierit vizionar që ndikoi thellësisht në Evropën e shekullit XIX.

Konferenca është mbajtur në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe ka bërë bashkë personalitete të shquara nga fusha e shkencës, arsimit dhe kulturës. Pjesëmarrësit përfshinë figura të njohura si Rektori dhe Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Kryetarin e Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. asoc. Gëzim Hoxha, si dhe përfaqësuesen e Fondacionit Musei Civici di Venezia, Monica Viero. Gjithashtu, ngjarja ka pasur një prani të spikatur nga institucione të tjera, si dhe nga pjesëmarrës nga

Kosova, Shqipëria dhe Italia, duke theksuar rëndësinë ndërkombëtare të kësaj ngjarje. Në fokus të diskutimeve kanë qenë tema të ndryshme të lidhura me trashëgiminë e familjes së Karl Gegës, një figurë kyçe në zhvillimin e infrastrukturës dhe të historisë inxhinierike të Evropës, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme që lidhen me ndikimin e tij në zhvillimet teknologjike të kohës. Diskutimet kanë përfshirë gjithashtu aspekte të kulturës, teknologjisë dhe ndikimit të zgjerimit të hekurudhës në lidhjen e kulturave dhe vendeve të ndryshme të Europës. Në fjalën e tij, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe të lidhjes mes institucioneve shkencore dhe kulturore për zhvillimin e mëtejshëm të dijes. Ai nënvizoi se, ngjarje të tilla nuk janë vetëm mundësi për të nxjerrë në pah trashëgiminë e vizionarëve të shquar si Karl Gegë, por gjithashtu ofrojnë mundësi për të reflektuar mbi ndikimin që kanë pasur dhe vazhdojnë



të kenë përparimet teknologjike dhe inxhinierike në shoqërinë moderne.

Pjesëmarrësit janë angazhuar gjithashtu në një diskutim të thellë rreth trashëgimisë kulturore dhe historike të Karl Gegës dhe ndikimit të tij në ndërtimin e infrastrukturave hekurudhore që kanë lidhur qytete dhe shtete të ndryshme në Europë.

Nga 12 qershori, do të jetë e hapur gjithashtu ekspozita për Karl Gegën, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, dhe organizohet nga UBT dhe Fondacioni Musei Civici di Venezia. E njëjta ekspozitë do të vjen edhe në Kosovë, në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në korrik.

UBT – Institucioni privat me më së shumti programe të akredituara nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës

UBT vazhdon të jetë institucioni privat me më së shumti programe të akredituara në Kosovë, sipas vendimeve të fundit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Me gjithsej 17 programe të akredituara, prej të cilave 9 riakreditime dhe 8 programe të reja, UBT dëshmon përkushtimin e vazhdueshëm ndaj cilësisë në arsim dhe zhvillimit akademik.

Nga programet e riakredituara, shumica kanë marrë vlerësimin maksimal për një periudhë pesëvjeçare, që tregon standardet e larta akademike dhe profesionalizmin e stafit akademik të UBT-së. Në listën e programeve të akredituara përfshihen fusha të rëndësishme të

inxhinierisë, shëndetësisë, shkencave të natyrës, teknologjisë, menaxhimit dhe dizajnit, duke u ofruar studentëve mundësi të shumta për zhvillim profesional dhe kërkim shkencor.

Programet që janë pjesë e këtij procesi janë: Inxhinieri e Mekatronikës – BSc, Inxhinieri e Mekatronikës – MSc, Inxhinieri e Agrikulturës dhe Mjedisit – BSc, Shkencat dhe Teknologjia e Ushqimit – MSc, Shëndet Publik dhe Shkenca Mjekësore – BSc, Shkenca Paramjekësore – MSc, Biokimi Mjekësore – BSc, Kimi Aplikative – BSc, Stomatologji - Dr. Dent, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi – BSc, UBT Ferizaj,

Dizajn – BP, UBT Prizren, Shëndeti dhe Aktiviteti Fizik – MSc, Shkencat e Sportit dhe Lëvizjes – BSc

Psikologji – MSc, Teknik i Radiologjisë – BSc, Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës – BA, E Drejta Komeriale - LLM. Kjo arritje thekson angazhimin e UBT-së për t'u ofruar studentëve arsimin më të mirë dhe programet akademike që i përmbushin standardet më të larta ndërkombëtare. Me këtë, UBT vazhdon të jetë një nga institucionet kryesore të arsimit të lartë në Kosovë dhe rajon, duke kontribuar fuqishëm në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe inovacionit shkencor.

UBT pjesë e ekspozitës “Përpyjekja e Artë – Rrugëtimi i Xhudos në Lartësimin e Kosovës” në Pejë

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Sportit dhe Lëvizjes, Prof. Agron Thaqi, morën pjesë në hapjen solemne të ekspozitës madhështore “Përpyjekja e Artë – Rrugëtimi i Xhudos në Lartësimin e Kosovës”, e organizuar në Galerinë e Arteve në Pejë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Federatën e Xhudos së Kosovës. Ekspozita sjell një përjetim unik të historisë së lavdishme të xhudos kosovare – nga hapat e parë në qytetin e Pejës, deri te triumfet historike në skenën olimprike. Ajo nderon figurat e jashtëzakonshme të sportit tonë kombëtar, si

Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, të cilat me përkushtim, sakrificë dhe pasion kanë ngritur lart emrin e Kosovës. Ato tani janë pjesë e UBT-së, duke qenë figura kyçe në zhvillimin e institucionit dhe në formimin e gjeneratave të reja përmes kontributit të tyre profesional dhe akademik në fushën e sportit dhe edukimit fizik. Gjatë kësaj ngjarjeje inspiruese, përfaqësuesit e UBT-së zhvilluan edhe një takim të rëndësishëm me mysafirë specialë nga Gjermania, përfshirë Kryetarin e qytetit të Potsdam-it, z. Mike Schubert, dhe përfaqësues të Shkollës Sportive Olimprike të Potsdam-it. Takimi



shënoi fillimin e një bashkëpunimi të ri ndërkombëtar në fushën e sportit dhe edukimit fizik, duke hapur perspektiva të reja për studentët dhe profesionistët e rinj të kësaj fushe.

UBT vazhdon të jetë një faktor kyç në promovimin e sportit, kulturës dhe suksesit kombëtar, duke përkrahur nismat që e afirmojnë Kosovën në nivel global.

Rektori i UBT-së mori pjesë në Tech Fest

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi mori pjesë në Tech Fest 2025, një ngjarje e madhe e organizuar nga London School në bashkëpunim me DKA dhe DKRS në Universitetin e Mitrovicës.

Në këtë ngjarje u diskutuan temat më të fundit mbi programimin, robotikën dhe inteligjencën artificiale.

Gjatë pjesëmarrjes së tij, Prof. Dr. Edmond Hajrizi foli për mundësitë e shumta që ofron tregu i punës në Kosovë dhe më gjerë, veçanërisht në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit digjital.

Ai theksoi angazhimin e UBT-së për t'i përgatitur studentët dhe të rinjtë me aftësitë dhe njohuritë më të avancuara, duke i pajisur ata me kapacitete të nevojshme për t'u integruar me sukses në



tregun e punës dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të rajonit.

Tech Fest 2025 mbledhi një grup të madh folësish të nivelit të lartë – nga drejtues institucionesh, CEO dhe inxhinierë, deri te ekspertë të edukimit dhe zhvillimit teknologjik. Ata ndanë përvojat dhe njohuritë e tyre, duke frymëzuar brezin e ri të profesionistëve në Kosovë.

Rektori Hajrizi zhvillon takim miqësor në Panama me diplomatin Pablo Garrido

Gjatë qëndrimit të tij në Panama, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, është takuar me ish-ambasadorin e Panamës në Portugali dhe Greqi, njëherit Drejtor i Akademisë Diplomatike, Pablo Garrido.

Në këtë takim miqësor, Rektori Hajrizi dhe Diplomati Garrido, ndanë pikëpamjet e tyre për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Panamës, me theks të veçantë në fushat e arsimit, inovacionit, teknologjisë dhe diplomacisë ndërkombëtare.

UBT merr pjesë në konferencën e organizuar nga Binance

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte pjesë e panelit të rëndësishëm “Kosovo – The Heart of Crypto Communities in the Balkans”, në kuadër të konferencës së organizuar nga Binance, platforma më e madhe qendrore për shkëmbim të kriptomonedhave në botë, me mbi 275 milionë përdorues aktivë globalisht.

Konferenca mbledhi liderë të industrisë, përfaqësues të institucioneve dhe anëtarë të komunitetit krypto nga Kosova dhe rajoni i Ballkanit, për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjive blockchain, mundësitë që ofron Binance për përdoruesit dhe të ardhmen e ekosistemit krypto në Evropën Juglindore.

Në panelin ku mori pjesë Rektori Hajrizi, së bashku me Shkëlqim Dushi (Shine), Memli Krasniqi dhe Sandro Slukan, u diskutua gjerësisht për pozicionin gjithnjë e më të rëndësishëm që po merr Kosova



në skenën ndërkombëtare të kriptomonedhave, si dhe për ndikimin që komunitetet lokale kanë në nxitjen e inovacionit digjital dhe zhvillimit ekonomik. Në fjalën e tij, Prof. Dr. Edmond Hajrizi theksoi rolin e edukimit dhe institucioneve akademike në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme digjitale. Ai vuri në pah përkushtimin e UBT-së për të përfshirë teknologjitë më të avancuara, përfshirë blockchain dhe kriptovalutat,

në proceset mësimore dhe kërkimore, me qëllim fuqizimin e brezit të ri në epokën digjitale.

Tematika e përgjithshme e konferencës u përqendrua rreth veçorive inovative të Binance dhe rritjes së komunitetit të kriptovalutave në Kosovë dhe Ballkan, duke e shndërruar këtë event në një pikë takimi të rëndësishme për ide, vizione dhe bashkëpunime të reja në sektorin e teknologjisë financiare.

Rektori Hajrizi mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Digjitalizim “Smart City Prishtina 2025”

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë në Konferencën e Parë Ndërkombëtare për Digjitalizim “Smart City Prishtina 2025”, një ngjarje e rëndësishme që synon të promovojë zhvillimin e qyteteve të mençura dhe të digjitalizuara në Kosovë dhe më gjerë.

Në kuadër të kësaj ngjarje, UBT prezantoi disa nga zgjidhjet e tij inovative për ndihmën e zhvillimit të qyteteve të mençura, duke u përqendruar veçanërisht në aspektet e edukimit.

UBT, si institucion kryesor arsimor në Kosovë, po zhvillon dhe implementon



projekte të avancuara që lidhen ngushtë me digjitalizimin e arsimit, si pjesë e iniciativës për të ndihmuar në ndërtimin e një “Smart City” që është i përqendruar në teknologjinë dhe inovacionin.

Rektori Hajrizi viziton UniMarconi në Romë

Gjatë vizitës zyrtare në Itali, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, zhvilloi një vizitë në Universitetin UniMarconi, i pari institucion digjital i akredituar në Itali. Me këtë rast, Rektori Hajrizi u takua me Rektorin e UniMarconi-t, Prof. Marco Abate, me Prof. Ulrike Haider-Quercia, udhëheqëse e Shkollës së Doktoratës, si dhe me Prof. Francesco Gaspari, përgjegjës për bashkëpunimin ndërkombëtar.

Të dy rektorët shkëmbyen përvoja rreth zhvillimit të universiteteve moderne, bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe mundësive për forcimin e partneritetit ndërmjet dy institucioneve në fusha të ndryshme, si mobiliteti akademik, studimet e përbashkëta, projektet kërkimore dhe inovacioni.


Profesorët e Fakultetit të Arkitekturës pjesë e një projekti ndërkombëtar për strategjinë e rindërtimit të Ukrainës

Profesorët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Prof. Lulzim Beqiri dhe Prof. Bekim Ceko, po marrin pjesë në një projekt ndërkombëtar të rëndësishëm që synon hartimin e strategjisë për zhvillimin dhe rindërtimin e Ukrainës pas luftës.

Takimi i parë i këtij projekti u mbajt në formë online dhe u organizua nga Instituti për Studime të Avancuara në kuadër të Universitetit Çek të Teknologjisë (CVUT). Projekti përfshin përfaqësues nga disa vende evropiane si Çekia, Ukraina, Polonia, Sllovakia, Gjermania

dhe Kosova. Profesorët nga Kosova janë të ftuar të kontribuojnë në këtë projekt falë përvojës së tyre shumëvjeçare në proceset e rindërtimit pas luftës në Kosovë, si dhe angazhimit të tyre në projektet e Kombeve të Bashkuara për të drejtat pronësore (UN-Habitat) në Kosovë.

Në kuadër të këtij projekti, takimi i radhës do të jetë një punëtori fizike që do të mbahet në Pragë, nga data 15 deri më 18 tetor 2025, ku pritet të marrin pjesë sërish Prof. Beqiri dhe Prof. Ceko, duke përfaqësuar Kosovën në këtë



nismë të rëndësishme akademike dhe zhvillimore.

Ky bashkëpunim përbën një mundësi të madhe për Kosovën që të kontribuojë në proceset ndërkombëtare të rindërtimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, duke afirmuar njëkohësisht kapacitetet akademike dhe institucionale të vendit në arenën ndërkombëtare.

Studentët e UBT-së përfaqësojnë Fakultetin e Stomatologjisë në konferencën ndërkombëtare në Austri



Studentët dhe ish-studentët e Fakultetit të Stomatologjisë në UBT kanë përfaqësuar me sukses institucionin në konferencën ndërkombëtare të mbajtur në Medical University of Graz në Austri, ku kanë prezantuar punime shkencore me rëndësi të veçantë për fushën e stomatologjisë.

Nart Ajeti, ish-student i Fakultetit të Stomatologjisë, prezantoi temën e diplomës së tij me titull: “The role of platelet-rich plasma (PRP) in accelerating soft tissue healing and bone regeneration in oral surgery”, nën mentorimin e Prof. Dr. Vjosa Hamiti.

Dea Zejnullahu, studente e Fakultetit

të Stomatologjisë, prezantoi punimin “Bridging Academia, Health Policy, and Clinical Practice”, me mbështetjen e mentorëve Dr. Mr. Sci. Nora Kursani Demjaha dhe Prof. Dr. Genc Demjaha.

Ndërkohë, studentët Lis Ibërdemaj dhe Nina Jevriq, të udhëhequr nga Prof. Dr. Genc Demjaha, Prof. Dr. Dugagjin Sokoli dhe Prof. Dr. Burim Kiseri, prezantuan temën: “Prosthetic Rehabilitation in Maxillofacial Trauma and Cancer Surgery”. Kjo pjesëmarrje dëshmon jo vetëm përkushtimin akademik dhe cilësinë e punës kërkimore-shkencore të studentëve tanë, por edhe nivelin e lartë të përgatitjes së tyre profesionale. UBT vazhdon të jetë një platformë e fuqishme për zhvillim akademik dhe promovim të liderimit ndërkombëtar në fushën e stomatologjisë.

Trashëgimia evropiane në zemrën e Kosovës – UBT nderon Karl Gegën me ekspozitën më të madhe ndërkombëtare

Në një ceremoni solemne, në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan, u zhvillua hapja e ekspozitës ndërkombëtare kushtuar gjenit të inxhinierisë hekurudhore, Karl Gega, si dhe ceremonia qendrore e Global UBT Fest 2025. Kjo ekspozitë ndërdisiplinare, e sjellë për herë të parë në Kosovë, përfaqëson një bashkëpunim unik midis UBT-së dhe partnerëve ndërkombëtarë nga Italia dhe rajoni.

Ngjarja mbloodhi një mori personalitetesh të rëndësishme nga fusha e politikës, arsimit, diplomacisë, biznesit dhe arkitekturës. Të pranishëm ishin: Rektori dhe Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, Deputetë të Kuvendit të Kosovës, Përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, Arkitektë nga Italia, profesorë dhe studentë të shumtë. Në hapje të ceremonisë, Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë strategjike të kësaj ekspozite për vendin tonë:

“Me këtë ekspozitë, jo vetëm që e nderojmë figurën e Karl Gegës, një prej inxhinierëve më të shquar të historisë evropiane, por njëkohësisht i japim një mesazh

të qartë brezave të rinj: se vizioni, dijet dhe përkushtimi nuk njohin kufij. Qyteti i Mençur i UBT-së është hapësira ku historia takohet me inovacionin, dhe ku trashëgimia kulturore ndërlihdet me teknologjinë dhe të ardhmen”.

Prof. Lucia Nadin vlerësoi UBT-në si një partner të denjë evropian dhe përgëzoi të gjithë për punën e arritur deri më tani. “Qëllimi i kësaj ngjarjeje është të bëjë të njohur figurën e Karl Gega-s, gjenialitetin e tij, sfidën e tij ndaj të pamundurës, këmbënguljen e tij për të mbrojtur idetë dhe projektet e veta – veçanërisht për të rinjtë: që ata të mësojnë, përmes njohjes së veprës së kësaj personaliteti të madh, se gjithçka mund të arrihet nëse, përveç ëndrrave dhe vizioneve, janë të vetëdijshëm për thellësinë e dijeve që duhet të zotërojnë – dhe që shpesh kërkojnë përpjekje për t'u fituar”, tha Nadin.

Sipërmarrësi shqiptar në Itali, Genc Podgorica, një nga kontribuuesit kyç për realizimin e kësaj ekspozite, u shpreh:

“Ky bashkëpunim është dëshmi se sa shumë mund të arrijmë kur lidhim rrënjët tona kulturore me përvojën dhe dijen ndërkombëtare. Karl Gega ishte vizionar – dhe të rinjtë e Kosovës meritojnë të in-



spirohen nga të tillë shembuj. UBT është duke krijuar një platformë të jashtëzakonshme që i bën të mundshme këto ura bashkëpunimi”.

Në përmbyllje të ngjarjes, UBT ndau certifikata mirënjohjeje për të gjithë ata që kontribuuan në realizimin e ekspozitës ndërkombëtare për Karl Gega. Rektori Hajrizi theksoi se këto certifikata nuk janë thjesht dokumente simbolike, por shprehje e një vlerësimi të thellë për punën dhe përkushtimin ndaj dijes dhe kulturës.

Ekspozita është organizuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Fondacionin Musei Civici di Venezia, duke sjellë në vëmendje trashëgiminë evropiane të kësaj figure kyçe të shekullit XIX.

Ceremonia shënoi një moment të veçantë me këngët e kënduara nga studentët e Fakultetit Muzika Moderne, Prodhimi Digjital dhe Menaxhmenti.

UBT pret në vizitë zyrtare Kryetarin e FFK-së, Agim Ademi – fokus te edukimi dhe inovacioni në sport

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka zhvilluar sot një vizitë zyrtare në UBT, ku është mirëpritur nga Presidenti dhe Themeluesi, Rektori, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në ambientet e Parkut Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan.

Gjatë kësaj vizite, Ademi pati mundësinë të njihet nga afër me kapacitetet infrastrukturore, laboratorët e avancuar, si dhe projektet ndërdisiplinore që po zhvillohen në UBT.

Rektori Hajrizi dhe Kryetari Ademi diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet UBT-së dhe FFK-së, me qëllim të ndërlihdjes së teknologjisë, inovacionit dhe sportit në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të rinjve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Gjatë vizitës së tij në UBT, Kryetari Ademi, vlerësoi rolin udhëheqës të këtij institucioni në fushën e arsimit, teknologjisë dhe inovacionit. Ai u shpreh i impresionuar nga projektet dhe potenciali që UBT ofron për zhvillimin e të rinjve dhe për krijimin e bashkëpunimeve konkrete ndërmjet sportit dhe edukimit. “Sot pata kënaqësinë të vizitës UBT-në në Prishtinë, një qendër jo vetëm e dijes dhe

inovacionit, por që me të drejtë mund të quhet edhe një ‘smart city’ brenda kryeqytetit tonë. Ishte impresionuese të shihja nga afër një institucion që jo vetëm e ndjek hapin e zhvillimit teknologjik, por edhe kontribuon në të, me një program të sofistikuar që përfshin gjithçka – nga bazat deri te formimi i shkencëtarëve në profile të ndryshme”, u shpreh Ademi.

Rektori Hajrizi theksoi se përmes programeve bashkëkohore dhe investimeve në infrastrukturë, UBT jo vetëm që udhëheq në fushën akademike, por gjithashtu kontribuon drejtpërdrejt në përgatitjen e sportistëve dhe trajnerëve të rinj, duke i dhënë vendit një bazë të fortë për afirmim në arenën ndërkombëtare. “UBT është shndërruar në një qendër unike arsimore e inovative, ku talentet e reja jo vetëm edukohen, por edhe fuqizohen për të qenë kampionë në sport, shkencë dhe jetë. Kemi krijuar një ekosistem që i tejkalon kufijtë e edukimit tradicional – duke integruar teknologjinë, leadershipin dhe përgatitjen praktike me standarde ndërkombëtare, për të formuar gjenerata të gatshme të konkurronjë në çdo arenë”, theksoi Rektori Hajrizi. Vizita e Kryetarit të FFK-së në UBT hap



perspektiva të reja për bashkëpunim në fusha të ndryshme si teknologjia sportive, edukimi i trajnerëve përmes platformave digjitale, organizimi i ngjarjeve të përbashkëta dhe mbështetja e inovacionit në sport. UBT, si institucion lider në arsimin e lartë në rajon, vazhdon të dëshmojë se është një partner i besueshëm për bashkëpunime strategjike me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, UBT veçon edhe Fakultetin e Shkencave të Sportit dhe të Lëvizjes, përmes të cilit synon të kontribuojë në zhvillimin e sportit në vend duke nxjerrë kuadro të rinj profesionalë dhe talente të reja, të cilat do të mund të afirmohen në skenën ndërkombëtare përmes përgatitjes me standarde të larta dhe inspirimit nga kampionët botërorë.

UBT zhvillon qendrën e saj të sigurisë kibernetike në një rën nga qendrat më të avancuara në rajon

UBT ka transformuar qendrën e saj të sigurisë kibernetike në një rën nga qendrat më të avancuara në rajon, duke forcuar rolin si një ndër institucionet më të rëndësishme në rajon për kërkimin, inovacionin dhe reagimin ndaj kërcënimeve kibernetike.

Në qendër të kësaj qëndron UBT CERT, i cili ofron zgjidhjet më të fundit për detektim dhe reagim ndaj incidenteve dhe sulmeve kibernetike, me teknikat më moderne dhe bashkëkohore për të

siguruar asetet dhe infrastrukturën.

Përveç të tjerash, UBT posedon njërin nga laboratorët më të mëdhenj të sigurisë kibernetike në rajon, laborator i cili simulon skenare reale në fushën e sigurisë kibernetike për të përgatitur studentët dhe personel për tregun e punës. Këto skenare përfshijnë qindra laboratore virtuale në fusha të specializuara të sigurisë kibernetike si: offensive cybersecurity, defensive cybersecurity, dhe incident response.



Me transformimin e kësaj qendre, UBT pozicionohet si një aktor kyç në nivelin kombëtarë dhe atë ndërkombëtarë për siguri kibernetike, duke ofruar ekspertizë, infrastrukturë dhe inovacion.

Inovacion, qëndrueshmëri dhe ndikim social: Fjalimi i Rektorit Hajrizi në samitin e të rinjve



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mori pjesë në Balkan International Youth Summit for Peace 2025, një ngjarje e rëndësishme që mbledhi mbi 120 të rinj nga më shumë se 40 shtete të botës, së bashku me personalitete akademike, politikanë dhe përfaqësues

të shoqërisë civile. Në kuadër të samitit, Rektori Hajrizi mbajti një fjalim rreth temës: “Leading beyond boundaries: Innovation, Sustainability and Social Impact at UBT”, ku theksoi rëndësinë e inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në arsim, si dhe rolin e UBT-së në

fuqizimin e të rinjve si liderë të së ardhmes.

Ai theksoi se përmes edukimit dhe projekteve ndërkombëtare, studentët e UBT-së mësojnë të krijojnë ndikim social pozitiv, të ndërtojnë ura bashkëpunimi dhe të përfshihen aktivisht në shoqëri. Samiti, i organizuar nga Youth and Students for Peace Balkan (YSP Balkan) në bashkëpunim me komunat e Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut dhe Leposaviqit, zhvilloi tre ditë të plota dialogu, aktivitete inovative dhe programe kulturore që nxisin shkëmbimin ndërkulturor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis të rinjve.

UBT prezanton modelin e parë Digital Twin të Kampusit Smart City në aktivitetin përmblyës të projektit Evropian IoT-ECO në Sofia

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, së bashku me Prof. Dr. Besnik Qehaja, dekan i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, dhe ekipin e UBT-së, po marrin pjesë në aktivitetin përmblyës të projektit IoT-ECO, pjesë e programit Erasmus-LS, ERASMUS-EDU-2022-CBHE, i cili po mbahet në Technical University of Sofia, në Bullgari.

Ky projekt ndërkombëtar synon zhvillimin e modeleve inovative për Internet of Things (IoT) në fushën e ekonomisë së gjelbër, duke bashkuar ekspertë dhe akademikë nga universitete të ndryshme të rajonit dhe Evropës.

Në këtë aktivitet u prezantua modeli i parë real i Digital Twin Smart City Kampus në UBT, një inovacion unik i zhvilluar mbi infrastrukturën Smart City dhe teknologjitë e avancuara nga ekipi i UBT-së. Ky model digjital funksionon si një pasqyrim virtual i kampusit dhe qytetit, duke mundësuar ndërveprim në kohë reale. Kjo



teknologji rrit ndërveprimin dhe aftësinë për të reaguar shpejt ndaj situatave, si dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës, efikasitetit dhe sigurisë.

Rektori Hajrizi prezantoi gjithashtu UBT Hub, duke theksuar kontributin dhe avancimet e universitetit në integrimin e IoT në mjedisin akademik dhe industrial. Ai diskutoi rëndësinë e zhvillimit të infrastrukturës digjitale dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare për fuqizimin e inovacionit dhe edukimit teknologjik në Kosovë, me theks të

veçantë të modeleve inovative që janë zhvilluar dhe implementuar në fushat e IoT, inteligjencës artificiale, smart cities, smart education, mjekësisë, etj. Programi i ngjarjes përfshin prezantime mbi modelet virtuale të IoT, integrimin me cloud, aplikimet praktike në industri, si dhe sfidat e sigurisë kibernetike në rrjetet moderne inteligjente. Përveç pjesës akademike, aktiviteti ofron edhe vizita kulturore dhe ture në Sofia, duke krijuar hapësirë për shkëmbim përvojash dhe rrjetëzim ndërkombëtar.

Presidenti i UBT-së folës në Forumin Global të ACEEU në Pragë

Presidenti dhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte folës në Forumin Global të ACEEU (The Accreditation Council for Entrepreneurial & Engaged Universities), i cili po mbahet në Pragë.

Në këtë forum ndërkombëtar, që mbledh qindra përfaqësues nga universitetet më të mëdha dhe inovative në botë, Rektori Hajrizi prezantoi mbi temën: "Leading Beyond Boundaries: Innovation, Sustainability, and Social Impact at UBT", duke paraqitur modelin unik të ekosistemit UBT Smart City si një shembull frymëzues për transformimin e arsimit të lartë në shekullin XXI.

Në fjalën e tij, ai theksoi rëndësinë e ndërthurjes së arsimit, teknologjisë, sipërmarrjes, përgjegjësisë sociale dhe

inovacionit, duke prezantuar rezultate konkrete dhe modele të reja, ndër të cilat edhe ai i fundit që konfirmon UBT-në si "The leading fully AI-powered ecosystem in Europe" – një ekosistem i ndërtuar mbi inteligjencën artificiale, i cili po shërben si model për universitetet evropiane dhe globale.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen nga afër me mënyrën se si UBT ka arritur të krijojë një platformë gjithëpërfshirëse, ku studentët, profesorët, industria dhe institucionet vendore e globale bashkëpunojnë për të gjeneruar dije të reja dhe për të ndërtuar zgjidhje inovative. Ky ekosistem po kontribuon në adresimin e sfidave të ndryshme që lidhen me urbanizimin, shëndetin, rritjen ekonomike, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.



Kjo konferencë vlerësohet si një ndër më të rëndësishmet në fushën e arsimit të lartë, sipërmarrjes dhe inovacionit, duke theksuar nevojën që universitetet të jenë të adaptueshme, të orientuara drejt impaktit dhe të angazhuara ngushtë me shoqërinë.

UBT shënon Tetorin Rozë me aktivitet edukativ dhe debat mbi kancerin e gjirit

Në kuadër të Tetorit Rozë, Fakulteti i Psikologjisë në UBT, në bashkëpunim me UBT International Smart Schools, United Hospital dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, organizoi një aktivitet të veçantë informues, edukativ dhe diskutues, i cili ofroi mundësi të gjera për studentët, stafin akademik dhe komunitetin për të njohur rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe parandalimit të kancerit të gjirit. Ngjarja shërbeu si një platformë e hapur për informim, debat dhe diskutim interaktiv, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të ndërvepronin direkt me ekspertë të fushës së shëndetit publik, kirurgjisë dhe radiologjisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë të shëndetësisë nga fusha të ndryshme: Dr. Shkendije Nuza – Drejtore e Radiologjisë, ShSUK; Dr. Saud Maliqi – Kirurg Torakal;



Dr. Mejreme Bajqinovci – Specialiste e Shëndetësisë Publike, IKSHPK; Dr. Elfije Krasniqi – Specialiste e Shëndetësisë Publike, QRSHP-Prishtinë, Koordinatore për Edukim dhe Promovim Shëndetësor. Ligjërues të veçantë ishin: Dr. Saud Maliqi, nga United Hospital, i cili ndau njohuri mbi diagnostikimin dhe trajtimin kirurgjikal të kancerit të gjirit, duke theksuar sfidat dhe benefitet e ndërhyrjeve të hershme.

Dr. Valbona Maloku, Koordinatore për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në QRSHP-Prishtinë, e cila trajtoi strategjitë e ndërgjegjësit të publikut, rëndësinë e kontroleve periodike dhe promovimin e shëndetit të grave. Pjesëmarrësit u angazhuan në pyetje, diskutime dhe de-



bate të drejtpërdrejta me ekspertët, duke përfituar njohuri të thella mbi parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e hershëm të sëmundjes, si dhe mbi rolin e edukimit shëndetësor në komunitet.

Ky aktivitet i UBT-së është një dëshmi e përkushtimit të institucionit për shëndetin dhe edukimin shëndetësor të komunitetit, duke mbështetur iniciativat kombëtare dhe ndërkombëtare për vetëdijësimin mbi kancerin e gjirit dhe fuqizimin e grave. Përmes këtij bashkëpunimi ndërinstucional, UBT vazhdon të krijojë ura mes arsimit, shëndetit dhe komunitetit, duke u bërë një model për edukim dhe promovim shëndetësor në rajon.

UBT bëhet anëtar i ACEEU

UBT ka fituar statusin e anëtarit të ACEEU (The Accreditation Council for Entrepreneurial & Engaged Universities), duke hyrë kështu në një rrjet global të universiteteve më të mira për ndërmarrësi dhe impakt shoqëror.

Ky anëtarësim shënon një hap të rëndësishëm historik për UBT-në dhe për Kosovën, duke e pozicionuar këtë institucion në mesin e universiteteve që udhëheqin transformimin global në arsim, sipërmarrje dhe inovacion. Përmes anëtarësimit, UBT fiton

mundësi të shumta për bashkëpunim ndërkombëtar, përfshirë zhvillimin e projekteve të përbashkëta, shkëmbimin e praktikave më të mira akademike dhe qasjen në një rrjet global ekspertësh dhe institucionet të përkushtuara ndaj arsimit të orientuar nga impakti shoqëror. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u shpreh se ky është një konfirmim i rrugëtimit të jashtëzakonshëm të UBT-së:

"Anëtarësimi në ACEEU është dëshmi se vizioni ynë për një universitet ndër-

marrës, inovativ dhe të orientuar drejt shoqërisë është duke u realizuar. Kjo është një arritje jo vetëm për UBT-në, por për gjithë Kosovën, duke e vendosur vendin tonë në hartën e arsimit të lartë ndërkombëtar".

Ky zhvillim forcon pozitën e UBT-së si lider në Ballkanin Perëndimor dhe si një institucion që ofron standarde të reja në arsim dhe teknologji, duke i dhënë Kosovës një zë të fuqishëm në platformat globale akademike.

Rektori Hajrizi i ftuar të flasë në Konferencën Rajonale Vjetore të RCF-së në Budva

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, me ftesë nga Regional Challenge Fund po merr pjesë në Konferencën Rajonale Vjetore të RCF-së 2025, e cila këtë vit po zhvillohet në Budva dhe ka mbledhur personalitete të njohura nga fusha e arsimit, biznesit dhe politikëbërjes në Ballkanin Perëndimor.

Ky aktivitet rajonal trajton çështje kyçe që lidhen me zhvillimin ekonomik, qeverisjen e mirë, qëndrueshmërinë dhe ndërtimin e kapaciteteve konkurruese në epokën e inteligjencës artificiale dhe automatizimit.

Në këtë ngjarje përveç Rektorit Hajrizi, po merr pjesë edhe Drejtori i Departamentit për Edukim dhe Zhvillim Profesional në UBT, Prof. Dr. Besnik Skenderi.

Në panelin me temë "AI, Automation & Skills: Is the Western Balkans Ready?", Rektori Hajrizi prezantoi vizionin e tij dhe të UBT-së mbi mënyrat se si rajoni



mund të përfitojë nga integrimi i inteligjencës artificiale në sistemin arsimor dhe në sektorin e biznesit.

Ai theksoi se përgatitja e kuadrove profesionale për epokën digjitale kërkon një bashkëpunim më të ngushtë mes universiteteve, institucioneve publike dhe sektorit privat, duke krijuar ura që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm dhe punësim cilësor për të rinjtë.

Sipas tij, inteligjenca artificiale duhet

të shihet si një mjet që fuqizon njeriun dhe shoqërinë, duke mundësuar vendimmarrje më të mençur, procese më efikase dhe rritje të përgjegjshme ekonomike.

Konferenca RCF 2025 sjell së bashku akademikë, liderë të biznesit dhe vendimmarrës politik, duke krijuar një platformë gjithëpërfshirëse për shkëmbim idesh, zhvillim strategjish dhe ndërtim partneritetesh.

Rektori Hajrizi flet për suksesin e UBT-së në Polytechnic Institute of Beja në Portugali



Rektori Hajrizi flet për suksesin e UBT-së në Polytechnic Institute of Beja gjatë Edicionit të 8-të të Javës Erasmus ku po marrin pjesë 72 pjesëmarrës nga 37 institucione të arsimit të lartë, të ftuar nga 20 vende të ndryshme.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ndau përvojën dhe sukseset e UBT-së si një universitet modern me rang ndërkombëtar në konferencën e Polytechnic Institute of Beja. Ai theksoi se UBT përfaqëson anën më të ndritur të rritjes në shkencë dhe teknologji në shtetin e ri të Kosovës, duke sjellë në qendër inovacion dhe duke dëshmuar përkushtim për arsimim të cilësisë së lartë. Me një qasje proaktive dhe një ekosistem inovativ, UBT po ndihmon në formimin e liderëve të së ardhmes.

Kjo ngjarje ka si qëllim forcimin e lidhjeve të bashkëpunimit akademik, shpërndarjen e praktikave të mira dhe thellimin e shkëmbimit kulturor mes universiteteve nga vende të ndryshme.

UBT nënshkruan Deklaratën "Brighton Plus Helsinki" për fuqizimin e rolit të gruas në sport



Me qëllim të promovimit dhe fuqizimit të rolit të gruas brenda dhe jashtë fushës sportive, UBT ka nënshkruar Deklaratën ndërkombëtare "Brighton Plus Helsinki", një dokument i rëndësishëm që synon të avancojë barazinë gjinore në sport dhe të sigurojë përfshirjen e plotë të grave dhe vajzave në të gjitha nivelet e veprimtarisë sportive.

Kjo deklaratë, e iniciuar nga IWG Women and Sport, ka për qëllim krijimin e një kulture të qëndrueshme sportive që vlerëson, fuqizon dhe inkurajon kontributin e grave dhe vajzave në të gjitha aspektet e sportit dhe aktivitetit fizik.

Nënshkrimi i kësaj deklaratë nga UBT shënon një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të politikave gjithëpërfshirëse dhe krijimit të mundësive të barabarta për vajzat dhe gratë, si në pjesëmarrje, ashtu edhe në ndërtimin e karrierës profesionale. Me këtë veprim, UBT riafirmton përkushtimin për një sistem edukativ dhe sportiv të drejtë,

të barabartë dhe motivues, ku talenti dhe pasioni i çdo të reje vlerësohen pa dallim gjinie.

Në këtë ngjarje, Annamarie Phelps, kryetare e Sekretariatit të Mbretërisë së Bashkuar dhe bashkëkryesuese e Komitetit Ekzekutiv Global të "IWG Women and Sport", vlerësoi rolin e grave të suksesshme në sportin kosovar dhe theksoi se është koha që institucionet të garantojnë hapësirën e merituar për to. Ajo tha se për shumë kohë sporti ka qenë "një derë e mbyllur" për gratë, por sot po fillon një epokë e re e barazisë dhe përfshirjes, ku gratë janë pjesë thelbësore e zhvillimit sportiv global.

UBT, si institucion lider në arsim, inovacion dhe zhvillim shoqëror, mbetet i përkushtuar në mbështetjen e iniciativave që promovojnë zhvillimin e sportit, barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si faktorë aktivë të ndryshimit pozitiv në shoqëri.

Kjo ceremoni e nënshkrimit u organizua nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

UBT feston me ceremoni solemne gradimin e Gjeneratës së 22-të të studentëve



Në një atmosferë solemne dhe plot emocion, UBT ka shënuar ceremoninë e gradimit të Gjeneratës së 22-të të studentëve, duke i dhuruar Kosovës dhe rajonit një brez të ri profesionistësh, inovatorësh dhe liderësh të ardhshëm. Ceremonia u zhvillua në Sallën "1 Tetori" në Prishtinë, në dy sesione, për të mirëpritur me nderim e krenari qindra të diplomuar të programeve Bachelor dhe Master në fusha të ndryshme.

Studentët, të entuziazmuar për këtë arritje të madhe akademike, përmbyllën një kapitull të rëndësishëm të jetës së tyre, për të nisur tashmë një rrugëtim të ri profesional e shoqëror.

Në këtë ngjarje, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, shprehu krenarinë dhe gëzimin e tij për suksesin e studentëve, duke i përgëzuar për punën e palodhur dhe përkushtimin e treguar gjatë viteve të studimeve.

"Ky është një moment krenarie, reflektimi dhe gëzimi. Ju tashmë keni treguar se me disiplinë, vullnet dhe dije mund të arrini gjithçka. Si gjenerata e 22-të e UBT-së, ju do të mbani mbi supë përgjegjësinë për të qenë ambasadorë të dijes, inovacionit dhe vlerave që përfaqëson ky institucion", tha Rektori Hajrizi.

Në mesin e të pranishmëve ishin edhe përfaqësues të trupit diplomatik. Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guérot, uroi studentët për suksesin e tyre, ndërsa e pranishme ishte edhe përfaqësuesja e Ambasadës së Italisë në Kosovë, Refaela Rittuci.

Ceremonia u pasurua me fjalimet e ish-studentëve të UBT-së që ndanë përvojat e tyre të suksesshme.

Fortesa Kllokoqi, alumni e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, ndau rrugëtimin e saj nga studimet në Infermieri dhe Shkencat Paramjekësore në UBT, deri te puna e saj aktuale në Spitalin United.

"Rruga ime nuk ka qenë gjithmonë e lehtë, por ka qenë gjithmonë e vlefshme. UBT më mësoi se me punë, pasion dhe mbështetje, çdo ëndërr mund të bëhet

realitet. Sot jam krenare që si ish-studente e këtij institucioni po kontribuoj drejtpërdrejt në kujdesin shëndetësor".

Nga ana tjetër, arkitekti i njohur dhe themeluesi i Maden Group, Ideal Vejsa, foli për rrugëtimin e tij profesional



pas përfundimit të studimeve Master në UBT. Ai theksoi se sfidat janë pjesë e natyrshme e profesionit, por janë ato që e bëjnë punën më kreative. "Çdo projekt është një mundësi për të testuar ide të reja dhe për të lënë gjurmë. Kjo është diçka që e mësova në UBT dhe që më ka shoqëruar në çdo hap të karrierës sime", tha Vejsa.

Fjalë mirënjohjeje dhanë edhe disa nga studentët e diplomuar.

Marigona Doberlluka, nga Fakulteti i Psikologjisë, tha se UBT nuk është vetëm vend studimi, por edhe një hapësirë e shëndetshme dhe frymëzuese për zhvillim personal e profesional.

"Këtu mësuam se sfidat nuk janë pengesa, por mundësi për të zbuluar potencialin tonë të vërtetë. UBT është vendi ku ëndrrat marrin formë", theksoi ajo.

Ndërsa Beatrisë Shabanaj, nga Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, e cila së shpejti do të vazhdojë studimet Master në Frankfurt me bursën prestigjioze Deutschlandstipendium, u shpreh:

"Ky institucion më ka dhënë dije, vlera dhe guxim për të synuar më lart. Sot e

ndaj këtë sukses me profesorët, prindërit dhe kolegët e mi, duke besuar se secili prej nesh do të vazhdojë të bëjë ndryshim në shoqëri".

Një moment i veçantë i ceremonisë ishte betimi solemn i studentëve, i udhëhequr nga Rinor Rexhaj dhe Fjona Sylejmani, si dhe betimi i Hipokratit i udhëhequr nga Mjellma Çollaku, duke simbolizuar përkushtimin e të diplomuarve për t'i shërbyer dijes, shëndetit dhe vendit me ndershmëri e përgjegjësi.

Atmosfera u gjallërua edhe nga interpretimet muzikore të studentëve të Fakultetit të Muzikës Moderne, Prodhimit Digjital dhe Menaxhimit: Eda Lecaj me "I will survive", Leona Ferati me "Firework" dhe Genta Selmani me "We are the Champions".

Ceremonia kulmoi me hedhjen e kapelave në ajër, një moment i shumëpritur dhe simbol i përfundimit të një periudhe të mbushur me punë, përkushtim dhe sakrificë. Me këtë gjest, Gjenerata e 22-të e UBT-së nisi zyrtarisht kapitullin e ri të jetës së saj.

UBT, me dy dekada përvojë dhe arritje, po dëshmon edhe një herë se mbetet lider kryesor i arsimit, inovacionit dhe zhvillimit në Kosovë dhe rajon.



Rektori Hajrizi, pritet zyrtarisht nga Kryetari i Komunës së Braga-s në Portugali

Profesor Edmond Hajrizi, në Portugali, u prit zyrtarisht nga Kryetari i Komunës së Braga, zt. Ricardo Rio. Kjo vizitë shënon një hap të rëndësishëm në përpjekjet e UBT-së për ndërkombëtarizim dhe inkurajimin e bashkëpunimeve në nivele evropiane.

Braga, si një nga qytetet më të rëndësishme dhe më të vjetra në Portugali, ofron një potencial të madh për zhvillim, ku UBT mund të angazhohet drejtpërdrejt në projekte inovative për mobi-

litetin e së ardhmes.

Gjatë qëndrimit në Braga, Rektori Hajrizi pritet të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Rajonal Minho, me theks të veçantë në akreditimet e përbashkëta në fushën e mjeksisë. Gjithashtu, programi i vizitës do të përfshijë takime në Politeknikun Braga, InvestBraga, si dhe me drejtuesit e Asociacionit të Ndërmarrësisë Minho, duke forcuar kështu lidhjet dhe mundësitë e bashkëpunimit në të gjitha nivelet.



Rektori Hajrizi në takim me drejtuesit e Shkollës së Aviacionit, SevenAir



Në një takim të rëndësishëm, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe z. Alexandre Alves, Administrator i Shkollës së Aviacionit SevenAir, diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit mes dy institucioneve.

Fokus i veçantë ishte instalimi i avionëve simulues në Kosovë, si dhe certifikimi dhe trajnimet profesionale për mirëmbajtjen e avionëve.

Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e zhvillimit të këtij programi të përbashkët,

i cili do të ndihmojë në përgatitjen e pilotëve të rinj në përputhje me kërkesat e mëdha të tregut të punës në këtë profesion të fisnik.

Ndërkohë, z. Alves shprehu interesin e tij dhe të kompanisë SevenAir për të krijuar një marrëdhënie specifike me UBT në fushën e aviacionit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve aeronautike, duke shprehur besimin se ky bashkëpunim do të sjellë rezultate të jashtëzakonshme!

Lajm historik për futbollin e Kosovës

Me sloganin “Making Kosovo Heroes”, një nga akademitë më të njohura të futbollit në botë, S.L. Benfica, hap shkollën e saj të futbollit në Prishtinë. Me shumë emocion ju njoftojmë për një arritje dhe një lajm të mrekullueshëm për botën e sportit në Kosovë! Në mars të vitit 2026 do të inaugurohet Shkolla e Futbollit S.L. Benfica, një nga akademitë më prestigjioze të futbollit në botë, duke shënuar kështu një moment të rëndësishëm për futbollin në vendin tonë. Kjo do të jetë shkolla e parë nga disa që do të hapen në rajon, përfshirë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si pjesë të këtij projekti.

Shkolla e Futbollit Benfica do të zhvillohet në partneritet me UBT-në, respektivisht në Prishtinë, një nga kryeqytetet më dinamike dhe më të gjalla në rajon.

Kjo akademi jo vetëm që do të sjellë njohuri dhe ekselencë në fushën e futbollit, por do të krijojë gjithashtu mundësi të reja për të rinjtë e Kosovës, duke u ofruar atyre një platformë për të zhvilluar talentin dhe për të ndjekur ëndrrat e tyre sportive. Marrëveshja u formalizua në frymën e entuziazmit dhe miqësisë ndërmjet dy institucioneve, përmes një ceremonie të organizuar në Klubin Benfica në Lisbonë. Ajo u nënshkrua nga Drejtori i Zgjerimit Ndërkombëtar të Benfica-s, z. Bernardo Faria de Carvalho, dhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi. Kjo akademi do t'u ofrojë të rin-

jve mundësinë për të mësuar nga trajnerë të njohur dhe të përkushtuar, me qëllim arritjen e standardeve që kërkon niveli i futbollit evropian për grupmoshat 4-16 vjeçare.

Për të siguruar mbikëqyrjen e projektit, klubi do të dërgojë një ekip koordinatorësh dhe trajnerësh që do të qëndrojnë në Prishtinë, për të monitoruar nga afër dhe për të zbatuar programin në përputhje me standardet më të larta.

Ky është një lajm i madh për të gjithë ne — për të gjithë ata që e duan sportin, dhe veçanërisht për fëmijët e talentuar. Ky projekt do të kontribuojë në zhvillimin e futbollit vendor dhe do të forcojë imazhin dhe pozitën e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Shkolla e Futbollit Benfica në Kosovë synon të bëhet një qendër ekselence për zhvillimin e atletëve të rinj, duke ofruar kushte sportive të cilësisë së lartë që do t'u mundësojnë atyre të përparojnë sipas strategjisë dhe metodologjisë së zhvillimit të Benfica-s.

Me një fokus të veçantë në zhvillimin e futbollit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në prag të Kupës së Botës 2030, S.L. Benfica po forcon strategjinë e saj për të rritur praninë në Kosovë dhe për të mbajtur lidhje me një brez të ri talentesh. Ky zgjerim gjithashtu synon forcimin e marrëdhënieve të klubit me tifozët rajonalë dhe thellimin e ndikimit të futbollit në vend në prag të këtij eventi madhor.



Benfica Campus në Kosovë, përveç angazhimit të saj të drejtpërdrejtë në Prishtinë për zbulimin e talenteve të rinj, do të ofrojë një gamë programesh të dizajnuara për të integruar dhe zhvilluar të gjitha aftësitë dhe njohuritë që kërkon futbollin modern, duke i kombinuar ato me: Kampet e trajnimit të ekipeve – Prishtinë, Kampet në Benfica – Lisbonë & Lisbonë, Turne ndërkombëtare të futbollit për të rinjtë – Evropë dhe SHBA Edukim dhe certifikim të trajnerëve.

Ftojme të gjithë dashamirët e futbollit që të bashkohen me ne në këtë rrugëtim të bukur, sepse futbollin në Kosovë po hyn në një dimension të ri! Ky është vetëm fillimi, dhe jemi të bindur se shumë talente do të lindin nga Shkolla e Futbollit Benfica në Prishtinë, e cila padyshim do të jetë një histori suksesi që do ta bëjë Kosovën krenare.

UBT organizoi me sukses Konferencën e parë Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive



Në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan, u mbajt me sukses Konferenca e parë Ndërkombëtare e Mjekësisë Sportive (IC-SM 2025) – një ngjarje e nivelit të lartë që shënoi një moment historik për zhvillimin e kësaj fushe në Kosovë dhe rajon.

Në këtë konferencë morën pjesë figura të njohura ndërkombëtare të mjekësisë sportive, përfshirë Presidentin e Federatës Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive (FIMS), Prof. Dr. Fabio Pigozzi nga Italia, Prof. Dr. Norbert Bachl nga Austria, Annika Hangleiter, M.Sc. nga Universiteti Teknik i Mynihut (Gjermani), dhe Prof. Dr. Gobert von Skrbensky nga Austria, së bashku me shumë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në hapje të konferencës, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi se që nga themelimi, UBT ka qenë e përkushtuar ndaj dijes, inovacionit dhe krijimit të një shoqërie të zgjuar, ku shkencë, teknologjia dhe praktika bashkohen për të krijuar ndikim të qëndrueshëm në shoqëri.

“Mjekësia sportive është një nga fushat që mishëron më së miri këtë filozofi – duke bashkuar shëndetin, edukimin, performancën dhe inovacionin teknologjik”, u shpreh Rektori Hajrizi, duke theksuar se përmes Themelimit të Qendrës për Mjekësi Sportive në UBT, është hapur një kapitull i ri për zhvillimin e kësaj fushe në Kosovë.

Ai gjithashtu përmendi se falë kësaj nisme, Kosova është bërë për herë të parë anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Mjekësisë Sportive (FIMS), përmes Shoqatës së Mjekësisë Sportive dhe Ushtrimeve të Kosovës (KASEM) — një arritje që e rendit vendin përkrah mbi 117 shteteve anëtare të kësaj organi-

zate prestigjioze.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Prof. Dr. Fabio Pigozzi, President i FIMS-it, vlerësoi kontributin e UBT-së në zhvillimin e mjekësisë sportive dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për avancimin e kërkimit dhe praktikave klinike në këtë fushë.

Në hapje të konferencës morën fjalën edhe: Fitim Arifi, përfaqësues i Komitetit Olimpik të Kosovës; Agim Krasniqi, Kryetar i KASEM; Iber Alaj, Drejtor i Departamentit të Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pjesa kryesore e konferencës përfshiu sesionet shkencore me ligjërata nga:

Prof. Dr. Fabio Pigozzi (Itali) – “Sudden Cardiac Death in Sports and Exercise”
 Prof. Dr. Norbert Bachl (Austri) – “Sports Medicine as a Specialty in Europe: Shaping Precise Prevention”
 Prof. Dr. Edmond Hajrizi (Kosovë) – “UBT Smart City – An Integrated Platform of Emerging Technologies and Smart Support for Sports Medicine Education, Research, Innovation, and Clinical Services”
 Annika Hangleiter, M.Sc. (Gjermani) – “Wearable Technologies in Personalized Prevention: The Future is Already Present”
 Prof. Dr. Gobert von Skrbensky (Austri)

– “Concepts in Sports Surgery Following Knee Trauma: The Role of Activity Level and Biological Age”

Prezantimet shkencore dhe punimet kërkimore

Në sesionin e dytë të konferencës, të udhëhequr nga Dr. Milaim Berisha dhe Dr. Agron Thaqi, u prezantuan punime shkencore të recenzuara, ndër të cilat:

“The New Era FitScore Test: A Comprehensive General Fitness Assessment” – Era Deva, Milaim Berisha;

“The Success Ratio of Non-Surgical Management of Proximal Hamstring Injury in Judo: The Case of Olympic Gold Medalist” – Nora Gjakova, Milaim Berisha; “Beyond Consensus, Into Action: Kosovo’s Response to Elite Athlete Mental Health Challenges” – L.J., Zhu, J., Hell & V. Klissouras; “Comparative Analysis of Body Composition in Elderly Residents of Nursing Homes in Kosovo” – Agron Thaqi.

Konferenca IC-SM 2025 shërbeu si një platformë e rëndësishme ndërkombëtare për bashkëpunim, shkëmbim përvojash profesionale dhe prezantim të trendeve më të fundit në mjekësinë sportive. Ngjarja synon të nxisë kërkimin shkencor, inovacionin në rehabilitim, edukimin profesional dhe ndërtimin e rrjeteve ndërkombëtare në fushën e sportit dhe shëndetit.

Konferenca u organizua nga UBT, në bashkëpunim dhe mbështetje të:

Kosovo Association of Sports and Exercise Medicine (KASEM), International Federation of Sports Medicine (FIMS), Komitetit Olimpik të Kosovës, dhe Sport, Health and the People – A Western Balkan University Network (SHAPE Project).

IC-SM 2025 u vlerësua si një ngjarje që shënon fillimin e një tradite të re shkencore në Kosovë, duke e pozicionuar vendin në hartën ndërkombëtare të kërkimit në mjekësinë sportive dhe shëndetin publik.



UBT hap “Nukleus Lab” – Qendrën për Inovacion Gjuhësor dhe Zhvillim Akademik

Fakulteti i Gjuhës Angleze në UBT ka nisur zyrtarisht implementimin e “Nukleus Lab: Qendra për Inovacion Gjuhësor dhe Zhvillim Akademik”, në hapësirat e Parkut Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së.

Kjo qendër e re synon të shndërrohet në një bërthamë akademike dhe kërkimore që përqendrohet në zhvillimin e kompetencave gjuhësore përmes metodave moderne dhe teknologjisë së avancuar në edukim. “Nukleus Lab” do të shërbejë si një hapësirë për trajnime, punëtori, kërkime dhe mbështetje profesionale për studentët dhe stafin akademik.

Në kuadër të hapjes së qendrës, u mbajt edhe punëtori e parë me temë: "Digital Literacy + Good Moodle Design", e cila u udhëhoq nga eksperti ndërkombëtar Christopher Allen nga Suedia.



Punëtorja u zhvillua në gjuhën angleze dhe mblodhi pjesëmarrës nga radhët e studentëve, ligjëruesve dhe stafit akademik të UBT-së.

Qendra “Nukleus Lab” është konceptuar si një urë ndërlidhëse mes hulumti-

mit shkencor, praktikës gjuhësore dhe inovacionit pedagogjik, duke forcur kështu rolin e Fakultetit të Gjuhës Angleze në zhvillimin akademik dhe ndërkombëtarizimin e arsimit në Kosovë.

UBT organizon Panairin e Biznesit dhe Karrierës 2025



Në ambientet e UBT-së po mbahet Panairin e Biznesit dhe Karrierës 2025, një ngjarje e rëndësishme që synon të lidhë studentët, bizneset dhe profesionistët nga fusha të ndryshme të inovacionit, teknologjisë dhe zhvillimit profesional. Në këtë panair morën

pjesë mbi 30 kompani vendore dhe ndërkombëtare, të cilat po prezantojnë produktet, shërbimet dhe mundësitë e tyre të bashkëpunimit me studentët dhe profesionistët të rinj.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e këtij akti-

viteti si një hap konkret drejt lidhjes së edukimit me tregun e punës:

“Ky panair është dëshmi e qasjes sonë praktike ndaj arsimit dhe inovacionit. Ne duam që studentët tanë të jenë të përgatitur për tregun e punës, të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me kompanitë dhe të krijojnë bashkëpunime që nxisin zhvillimin profesional dhe ekonomik”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Ai shtoi se UBT vazhdimisht po investon në krijimin e platformave ku studentët mund të shfaqin talentin, idetë dhe projektet e tyre përpara bizneseve dhe institucioneve partnere. Ky aktivitet është një mundësi për rrjetëzimin profesional, bashkëpunime të reja dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë mes bizneseve, studentëve dhe profesionistëve të fushave të ndryshme.

Ekipi përfaqësues i Kosovës nis për në Panama për garën ndërkombëtare të robotikës



Ekipi përfaqësues i Kosovës, First Kosovo është nisur drejt Panamasë, ku do të marrë pjesë në garën ndërkombëtare të robotikës First Global Challenge 2025.

Pas muajsh përgatitjesh në laboratorët e UBT-së, këta të rinj të talentuar janë gati të përfaqësojnë me krenari Kosovën në mesin e mbi 180 shteteve

nga e gjithë bota.

Tema e First Global Challenge 2025 do të fokusohet në ruajtjen e biodiversitetit dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike, duke inkurajuar të rinjtë të zhvillojnë zgjidhje teknologjike që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit.

UBT, si institucioni që ka mbështetur këtë iniciativë që nga fillimi, është vlerësuar më herët me medalje të artë për kontributin e tij në promovimin e edukimit STEM dhe për angazhimin e vazhdueshëm në garat ndërkombëtare të robotikës.

UBT përmbyll suksesshëm edicionin e 14-të të Konferencës Ndërkombëtare – mbi 3,000 pjesëmarrës nga dhjetëra vende të botës

UBT ka përmbyllur me sukses edicionin e 14-të të Konferencës Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion, një nga ngjarjet akademike më të mëdha në rajon, e cila këtë vit mbledhi rreth 3 mijë pjesëmarrës – akademikë, studiues, ekspertë dhe studentë nga dhjetëra vende të botës.

Konferenca, e cila u zhvillua në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së, në Lipjan, përfshiu mbi 24 konferenca të specializuara ndërdisiplinare, duke trajtuar tema të rëndësishme nga inovacioni teknologjik, inteligjenca artificiale, mjekësia, arkitektura, ekonomia, psikologjia, edukimi, shkencat juridike e inxhinierike, deri tek komunikimi, media dhe shëndeti publik.

Në mbyllje të konferencës, Rektori Hajrizi falënderoi të gjithë kontribuesit dhe partnerët ndërkombëtarë, duke konfirmuar se UBT do të vazhdojë ta forcojë këtë traditë shkencore.

“Ky edicion ka treguar se UBT është një motor i zhvillimit të dijes dhe inovacionit në rajon. Ne do të vazhdojmë ta bëjmë Kosovën një qendër të rëndësishme akademike në Ballkan dhe më gjerë”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Gjatë ditëve të punimeve, studiues dhe profesionistë nga Evropa, ShBA, Azia dhe rajoni i Ballkanit prezantuan punime dhe analiza kërkimore që trajtonin sfidat dhe zgjidhjet bashkëkohore në fusha të ndryshme. Konferenca shër-



beu si një platformë për shkëmbimin e ideve, përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe për krijimin e rrjeteve të reja bashkëpunimi akademik dhe profesional.

Ky edicion përfshiu një gamë të gjerë temash përmes konferencave të veçanta si: Konferenca Ndërkombëtare për Inxhinieri Ndërtimore; Konferenca për Shkencën Mjekësore; Infermieri dhe Psikologji; Konferenca për Ekonomi dhe Menaxhment; Konferenca për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor; Konferenca për Edukim, Komunikim dhe Media; Konferenca për Mjedis,

Energjistikë dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, ndër të tjera.

Pjesëmarrësit theksuan se UBT po shndërrohet në një qendër të rëndësishme kërkimore që lidh shkencën me industrinë dhe tregun e punës, duke nxitur inovacionin përmes bashkëpunimit ndërdisiplinar.

Konferenca u mbyll me ceremoninë e ndarjes së certifikatave, ndërsa u paralajmërua se edicionet e ardhshme do të sjellin bashkëpunime të reja ndërkombëtare dhe programe kërkimore me ndikim global.

Flamuri i Kosovës valon në mesin e mbi 190 shteteve në ceremoninë e hapjes së First Global Challenge 2025 në Panama



Në një atmosferë madhështore, mes flamujve të mbi 190 shteteve dhe duartrokitjeve të mijëra pjesëmarrësve nga e gjithë bota, flamuri i Kosovës u valëvit me krenari në ceremoninë e hapjes së First Global Challenge 2025 në Panama. Ky është momenti kur rinia e Kosovës, përmes ekipit First Kosovo,

hyn në arenën botërore të inovacionit, teknologjisë dhe kreativitetit.

Në këtë ngjarje madhështore, ekipi përfaqësues i Kosovës – First Kosovo, i përbërë nga të rinj të talentuar që janë përgatitur me muaj në laboratorët e UBT-së, do të garojë për të treguar kreativitetin, dijen dhe shpirtin ino-

vativ të rinisë kosovare. Ata do të përfaqësojnë Kosovën në një nga garat më të rëndësishme botërore në fushën e robotikës dhe teknologjisë.

Tema e sivjetshme e garës, “Biodiversiteti dhe ndryshimet klimatike”, synon të nxisë të rinjtë të krijojnë zgjidhje teknologjike që ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e jetës në planetin tonë.

UBT, si partneri institucional që ka mbështetur këtë iniciativë që nga fillimi, është vlerësuar më herët me medalje të artë ndërkombëtare për kontributin e jashtëzakonshëm në promovimin e edukimit STEM dhe pjesëmarrjen e suksesshme të ekipeve kosovare në garat globale të robotikës. Në këtë garë të dijes dhe inovacionit, të rinjtë e Kosovës po e bëjnë vendin tonë të njihet si një forcë e re kreative në hartën teknologjike botërore.

Profesorët e UBT-së përfaqësojnë institucionin në konferencën ndërkombëtare të projektit COWEB në Sarajevë



Profesorët Dr. Engelbert Zefaj dhe Dr. Mentor Shaqiri përfaqësuan UBT-në në konferencën punuese ndërkombëtare të projektit COWEB, e cila u mbajt në Sarajevë, në ambientet e International Burch University.

Gjatë konferencës, përfaqësues nga universitete partnere të rajonit prezantuan punimet dhe rezultatet e tyre kërkimore, duke ndarë përvoja mbi zhvillimin e praktikave të reja në mësimin virtual bashkëpunues.

Në këtë kuadër, profesori i UBT-së Dr. Engelbert Zefaj mbajti një prezantim me temën: “Kultura dhe Ndërkulturaliteti në Mësimin Virtual Bashkëpunues (VCL): Ndikimet Pedagogjike dhe Vlerësimi i Studentëve”, ku theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkul-

turor dhe ndikimin pozitiv të tij në përmirësimin e përvojës së të nxëniet.

Projekti COWEB ka për qëllim ndërtime të kapaciteteve në institucionet e arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor për bashkëpunim ndërkombëtar virtual, duke promovuar pedagogji inovative dhe bashkëkrijimin e përmbajtjeve digjitale që forcojnë aftësitë dhe kompetencat e shekullit XXI.

Nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në këtë projekt, UBT vazhdon të dëshmojë rolin e tij si një ndër institucionet lidere në avancimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe në nxitjen e bashkëpunimit akademik ndërkombëtar në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ish-deputetët austriakë vizitojnë UBT-në

Një grup i ish-deputetëve të Parlamentit Federal të Austrisë, bashkë me politikanë dhe ekspertë të angazhuar në fushën e arsimit dhe çështjeve sociale, vizituan Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, e mirëpriti delegacionin dhe theksoi rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit me universitetet austriake, duke u angazhuar për të forcuar edhe më tej lidhjet akademike dhe shkencore. Ai gjithashtu falënderoi për ndihmën dhe mbështetjen që Austria ka ofruar për zhvillimin e arsimit dhe kërkimit në Kosovë.

Delegacioni austriak ishte i udhëhequr nga prof. Josef Höchtl dhe përfshinte personalitete të rëndësishme si dr. Ernst Wurz, Stefan Zobl, dhe Franz Fuchs, ndërsa takimi u zhvillua në praninë e drejtuesve të UBT-së, si dhe të stafit akademik dhe administrativ të universitetit.

Delegacioni u informua për sukseset dhe arritjet e UBT-së, si institucioni më inovativ në Kosovë, që ka një pozicion të fortë si lider në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, si dhe për angazhimin e tij në zhvillimin e teknologjisë dhe bizneseve inovative.

UBT sjell programin e mençur për sigurinë kibernetike në Konferencën më të madhe të IEEE-së për Teknologji dhe Siguri - “Smart Security for Smart Cities”

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, prezantoi në Romë rezultatet e punës shkencore dhe inovative të ekipit të UBT-së dhe Universitetit të Sofjes për zhvillimin e programit të mençur për sigurinë kibernetike, i cili po implementohet tashmë në qytetin e mençur të UBT-së. Ky prezantim rriti interesimin e pjesëmarrësve, të cilët shtruan pyetje dhe shprehën kërkesën për implementimin e këtij modeli edhe në vende dhe sisteme të tjera në botë.

Gjatë Konferencës më të madhe të IEEE-së për Teknologji dhe Siguri, Rektori Hajrizi prezantoi temën “Advanced Techniques for Reconnaissance and Enumeration in Internal Network Security Assessments”, duke përfshirë rezultatet e punimeve shkencore të realizuara nga ai dhe kolegët nga UBT dhe Universiteti i Sofjes për Teknologji, në kuadër të programit për avancime shkencore.

Në kuadër të konferencës dhe panairit

të teknologjisë, Rektori pati mundësinë të takojë përfaqësues dhe ekspertë nga ushtritë pjesë e Aleancës së NATO-s, ushtria italiane dhe amerikane, universitete të ndryshme nga e gjithë bota, si dhe përfaqësues të kompanive kryesore të sektorit teknologjik. Ai gjithashtu takoi Prof. DePonte, udhëheqësin e konferencës, me të cilin ranë dakord për nismat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në fusha specifike.

Rektori Hajrizi prezantoi punën e bërë në UBT në fushat e shkencës dhe teknologjisë që lidhen me sektorin e mbrojtjes, sigurisë dhe menaxhimit të infrastrukturës kritike dhe të qëndrueshme, duke vënë theks të veçantë në sigurinë kibernetike, robotikë, teknologjinë e droneve, 5G, Internet of Things, Digital Twins dhe Inteligjencën Artificiale. Ai prezantoi gjithashtu një sërë projektesh të financuara nga UBT dhe Bashkimi Evropian, të cilat kanë rezultuar me produkte dhe



aplikacione inovative. IEEE është një nga organizatat më prestigjioze në botë, dhe punimet e saj vlerësohen jashtëzakonisht shumë ndërkombëtarisht. Prof. Dr. Edmond Hajrizi është anëtar i rregullt i IEEE-së dhe kontribuon prej vitesh me punime dhe organizimin e eventeve të saj. UBT ka një kontribut të spikatur në kuadër të konferencave të IEEE-së.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, nderohet me titullin e lartë “Doctor Honoris Causa” në Tiranë



Në një ceremoni solemne të mbajtur në Tiranë, Rektorit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, iu akordua titulli i lartë “Doctor Honoris Causa”, një vlerësim i rëndësishëm që nderon kontributin e tij shkencor, profesional dhe shoqëror brenda dhe jashtë vendit. Titulli u miratua dhe u akordua nga Uni-

versiteti Kombëtar Kapodistrian, një nga institucionet më të vjetra të arsimit të lartë në Evropën Juglindore, në bashkëpunim me Misionin Diplomatik për Siguri, Paqe dhe Filantropi (U.D.M.P) me seli në Bruksel.

Gjatë fjalës së tij, Rektori Hajrizi shprehu mirënjohje të veçantë për këtë vlerësim,

duke e cilësuar atë si një motiv shtesë për të vazhduar misionin akademik dhe human.

“Është një nder i veçantë për mua që ky titull i lartë më jepet, dhe e marr këtë vlerësim si një përgjegjësi të madhe për të vazhduar me përkushtim punën për arsimin, inovacionin dhe shërbimin ndaj shoqërisë. Ky çmim merr edhe më shumë kuptim duke ardhur në muajin e festave të nëntorit, muaj që lidhet me krenarinë dhe identitetin tonë kombëtar. Me këtë motivim, do të vazhdoj të promovoj prosperitet, zhvillim të qëndrueshëm dhe vlera ndërkombëtare që na lidhin me botën demokratike”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Në motivacionin zyrtar të çmimit theksohet se titulli i jepet: “Për kontributin juridik, ekonomik dhe në të drejtat e njeriut në shërbim të njerëzve në nevojë dhe të gjithë njerëzimit në mbarë botën”.

Ky vlerësim prestigjioz vjen si njohje për angazhimin e vazhdueshëm të Prof. Dr. Hajrizi në fushat e arsimit, inovacionit, sigurisë, zhvillimit ekonomik dhe fuqizimit të komuniteteve.

Rektori Hajrizi po merr pjesë në panairin më të madh të teknologjisë mjekësore dhe do të flasë në konferencën e mjekësisë sportive në Dyseldorf

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, po merr pjesë në panairin më të madh botëror të teknologjisë mjekësore – MEDICA – si dhe është ftuar të flasë në MEDICA Medicine + Sports Conference 2025, që po zhvillohet në Dyseldorf të Gjermanisë. Ky event mbledh mijëra prodhues, shkencëtarë dhe ekspertë nga mbarë bota për të prezantuar risitë më të fundit në teknologjinë mjekësore dhe mjekësinë sportive. Në këtë konferencë, Rektori Hajrizi së bashku me Prof. Norbert Bachl do të flasin për temën:

“Precise prevention in a university campus ecosystem”.

Gjatë vizitës dyditore, Rektori Hajrizi po zhvillon takime me kompani prodhuese dhe partnerë ndërkombëtarë, ndërsa po prezanton zhvillimet e fundit të UBT-së në fushat e mjekësisë sportive, teknologjisë së avancuar dhe integritet të inteligjencës artificiale në shëndetësi. Panairi dhe konferenca përfshin tema bashkëkohore si jetëgjatësia, parandalimi përmes aktivitetit fizik, biohacking, inovacionet digjitale dhe terapitë



moderne në sport, duke e kthyer MEDICA-n në një platformën globale.

Vlerësohet lartë modeli UBT 5S në Kongresin e 61-të Botëror të Planifikimit Urban të organizuar nga ISOCARP

Në kuadër të Kongresit të 61-të Botëror të Planifikimit Urban (ISOCARP 2025), Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka prezantuar online modelin inovativ të qytetit të mençur UBT 5S. Në këtë prezantim autor ishte edhe Drejtori i Institutit për Studime Urbane, Shqiprim Ahmeti. Ky model inovativ vendos Kosovën në qendër të modeleve ndërkombëtare për planifikimin urban dhe integrimin e teknologjisë në qytet e së ardhmes.

Këtë vit, kongresi po mbahet në Riad të Arabisë Saudite, nën temën qendrore: “Qytetet dhe Rajonet në Vepër: Rrugët e Planifikimit drejt Qëndrueshmërisë dhe Cilësisë së Jetës”. Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e qasjeve sistematike, përdorimit të teknologjive digjitale dhe prototipeve të vogla, për të krijuar një model të integruar që përfshin të gjitha grupmoshat dhe sektorët e një qyteti. Aktualisht, ekosistemi përfshin rreth 17,000 per-

sona dhe kombinon zona komunitare, arsimin, infrastrukturën, shërbimet shëndetësore dhe aktivitetet bujqësore, duke u mbështetur në teknologji si 5G për monitorim dhe analizë në kohë reale.

Pjesëmarrësit në kongres vlerësuan modelin e UBT-së si një shembull model të qytetit të mençur dhe rezilient, duke nënvizuar rolin kyç të universiteteve në udhëheqjen e inovacionit dhe planifikimit urban të qëndrueshëm.

Në UBT nisi punimet Kongresi i VII-të Ndërkombëtar TURKIC COSE 2025

Në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan, u hap zyrtarisht Kongresi i VII-të Ndërkombëtar TURKIC COSE 2025 (Turkic World Congress on Science and Engineering), një nga ngjarjet më të rëndësishme shkencore në rajon që ka bashkuar dhjetëra rektorë universitetesh, profesorë, studiues dhe përfaqësues institucionalë nga shumë vende të botës. Ky kongres prestigjioz po zhvillohet nga 13–15 nëntor 2025, nën organizimin e përbashkët të UBT-së, Niğde Ömer Halisdemir University (NOHU) nga Turqia, Azerbaijan Technical University (AzTU) nga Azerbajxhani, Kirgiz-Turkish Manas University nga Kirgistani dhe Ahmet Yesevi University (AYU) nga Kazakistani.

Në ceremoninë solemne të hapjes morën pjesë personalitete të larta akademike dhe institucionale, përfshirë Rektori e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Prof. Dr. Hasan Uslu, Rektor i Universitetit Niğde Ömer Halisdemir (Turqi), Prof. Dr. Alpaslan Ceylan, Rektor i Universitetit Kirgiz-Turk Manas, Prof. Dr. Vilayt Mammad oğlu Vliyev, Rektor i Universitetit Teknik të Azerbajxhanit, Prof. Dr. Naci Genc, Zv/rektor i Universitetit Ahmed Yesevi (Kazakistan); si dhe përfaqësues nga Universiteti Teknik i Kievit dhe institucione të tjera ndërkombëtare nga Evropa, Azia dhe Afrika.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u shpreh se kongresi përfaqëson një platformë të rëndësishme për bashkëpunim akademik dhe shkëmbim shkencor ndërmjet vendeve të botës turke dhe rajonit të Ballkanit.

“Është kënaqësi dhe nder i veçantë që mirëpresim sot në UBT një ngjarje të tillë ndërkombëtare si TÜRK-COSE 2025. Ky kongres bashkon mendjet më të ndritura në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe inovacion, dhe synon të



ndërtojë ura të reja bashkëpunimi ndërkombëtar. UBT është i përkushtuar të mbetet qendër ekselence ku teoria dhe praktika, arsimi dhe industria, si dhe vizioni akademik e zhvillimi shoqëror, takohen për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë”, theksoi ai.

Pas rektorit Hajrizi, fjalën e mori Prof. Dr. Hasan Uslu, Rektor i Universitetit Niğde Ömer Halisdemir (NOHU), i cili theksoi rolin e këtij kongresi në forcimin e bashkëpunimit shkencor ndërmjet vendeve të botës turke:

“Sot, shumë shkencëtarë të shquar nga bota turke, si dhe nga Azia, Afrika dhe Evropa, janë mbledhur këtu në Prishtinë për të ndarë dijen dhe për të promovuar bashkëpunim akademik. TURK-COSE 2025 fokusohet në tema strategjike si inteligjenca artificiale, Interneti i Gjërave, nanoteknologjia, qytetet e mençura dhe energjia e rinovueshme. Kjo ngjarje është dëshmi e unitetit akademik dhe shkencor mes kombeve tona”, u shpreh ai.

Ndërsa Prof. Dr. Alpaslan Ceylan, Rektor i Universitetit Kirgiz-Turk Manas, në fjalimin e tij vuri theksin te roli transformues i shkencës dhe teknologjisë në epokën e inteligjencës artificiale: “Jetojmë në një kohë kur shkencat nuk mjaftohet më me vëzhgimin e natyrës,

por krijon sisteme që mësojnë dhe mëndojnë. Inteligjenca artificiale është bërë gjuha e përbashkët e gjithë shkencave. Kongrese si ky janë laboratorë idesh, ku lindin zbulimet e së ardhmes dhe ku ndërtohen ura bashkëpunimi midis brezave të shkencëtarëve”, theksoi ai.

Në vijim, Prof. Dr. Naci Genc, zv/rektor i Universitetit Ahmed Yesevi, vlerësoi rëndësinë e konferencës për nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar:

“Ngjarje si TÜRK-COSE jo vetëm që nxisin ndarjen e dijes akademike, por edhe forcojnë miqësinë dhe partneritetin mes kombeve tona. Jam i bindur se idetë, prezantimet dhe bashkëpunimet që do të lindin këtu do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin shkencor dhe teknologjik të rajonit”, deklaroi ai.

Organizatori kryesor i kongresit, Prof. Dr. Murat Barut nga Universiteti Niğde Ömer Halisdemir, theksoi se edicioni i sivjetëm përfshin një program të pasur me mbi 14 sesione tematike që mbulojnë fusha të gjera si: inxhinieria dhe teknologjia, arkitektura dhe mjedisi i qëndrueshëm, mjekësia dhe bioteknologjia, inteligjenca artificiale dhe transformimi digjital, shkencat natyrore dhe energjia e rinovueshme.

Në kuadër të kongresit do të prezantohen mbi 150 punime shkencore, me pjesëmarrje fizike dhe virtuale të studiuesve nga Turqia, Kosova, Azerbajxhani, Kirgizia, Kazakistani, Ukraina dhe vende të tjera të rajonit euroaziatik. Me organizimin e këtij kongresi, UBT dëshmon edhe njëherë rolin e tij si një qendër ndërkombëtare e ekselencës akademike dhe inovacionit, duke forcuar pozicionin e Kosovës si një nyje e rëndësishme në rrjetin global të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik.



Rektori Hajrizi folës kryesor në Kongresin e VII-të Ndërkombëtar TURKIC COSE 2025

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte folësi kryesor në Kongresin e VII-të Ndërkombëtar “TURKIC COSE 2025 – Turkic World Congress on Science and Engineering”, i cili po mbahet në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së.

Rektori Hajrizi prezantoi punimin me titull: “A Small-Scale, Smart Self-Sustaining Entrepreneurial Innovation-Based Ecosystem Model: Case Studies Related with Smart City, Digital Twins and Sustainable Developments”, një koncept inovativ që përfaqëson filozofinë dhe qasjen unike të UBT-së ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, inovacionit, sipërmarrjes dhe transformimit të qyteteve në ekosisteme të mençura. Në prezantimin e tij, Rektori Hajrizi theksoi se UBT 5S Model (Small-Scale, Smart, Self-Sustaining, Entrepreneurial Innovation-Based Ecosystem) është rezultat i më shumë se 30 viteve përvojë akademike, kërkimore dhe zhvillimore, dhe përfaqëson një qas-



je sistematike që lidh arsimin, kërkimin shkencor, biznesin dhe komunitetin në një mjedis të integruar të inovacionit. Ky model, që tashmë është zbatuar në UBT Smart City dhe UBT Future Campus, funksionon si një ekosistem i qëndrueshëm dhe vetëmbajtës, ku studentët, profesorët, studiuesit dhe partnerët ndërkombëtarë ndërveprojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për të krijuar

zgjidhje të reja për qytetet inteligjente, digjitalizimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik. Ky model u cilësua si një ndër qasjet më të avancuara në Evropën Juglindore për zhvillimin e ekosistemeve të qëndrueshme të inovacionit dhe për ndërtimin e qyteteve të mençura përmes arsimit dhe kërkimit shkencor.

Ramadan Nishori ndan rrëfimin e tij para studentëve të UBT-së në një takim të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar



Në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) në bashkëpunim me UBT, organizoi një takim të veçantë me studentë, i cili u fokusua në prezantimin e librit me rëndësi të mad-

he dokumentuese “Zëra të Padegjura – rrëfimet e burrave mbi tejkalimin e dhunës seksuale në luftë”.

Gjatë këtij aktiviteti, studentët u njohën nga afër me rrëfimin e Ramadan Nishorit, i cili njihet si i mbijetuari i parë burrë që ka folur publikisht për

përvojën e tij dhe që ka ndarë historinë personale në librin “Përtej Dhimbjes, Drejt Guximit”. Ai tregoi rrugëtimin e tij nga plagët e së kaluarës drejt forcës, shërimit dhe shpresës, duke sjellë një perspektivë të rëndësishme mbi stigmat që shpesh e shoqërojnë këtë temë. Diskutimi u përqendroi në rëndësinë e dokumentimit të përvojave të të mbijetuarve, si një mënyrë e domosdoshme për të ruajtur kujtesën historike, për të ndriçuar të vërtetën dhe për t’i dhënë zë atyre që për dekada janë mbajtur në heshtje. Studentët patën mundësinë të kuptojnë më thellë dimensionet emocionale, sociale dhe njerëzore të këtyre rrëfimeve. Aktiviteti u mbështet nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, duke dëshmuar rëndësinë ndërkombëtare të përpjekjeve për adresimin e traumave të luftës dhe mbështetjen e të mbijetuarve.

UBT organizoi tryezën e rrumbullakët “Trashëgimia kulturore evropiane” në kuadër të projektit Jean Monnet AKIL-EU

Në kuadër të projektit Jean Monnet AKIL-EU Jean Monnet, në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së u zhvillua tryeza e rrumbullakët me temë: “Trashëgimia kulturore evropiane”. Në këtë aktivitet morën pjesë studentë dhe profesorë të UBT-

së, të cilët kontribuan me diskutime të vlefshme rreth rolit dhe rëndësisë së trashëgimisë kulturore evropiane.

Tryeza u drejtua nga Prof. Asoc. Dr. Manjola Zaçellari, koordinatore e projektit AKIL-EU, e cila udhëhoqi diskutimin, duke theksuar rëndësinë e

përfshirjes akademike në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore evropiane.

Gjatë aktivitetit u shkëmbyen ide dhe përvoja, duke nënvizuar rolin e trashëgimisë kulturore si element thelbësor i identitetit dhe zhvillimit evropian.

Rektori Hajrizi në IFM: Bashkëpunimi në të gjitha nivelet është çelësi për të përballuar kërcënimet digjitale

Në kuadër të Annual Conference and Internet Freedom Meet (IFM) 2025, i cili po mbahet në Prishtinë, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ishte i ftuar në diskutimin rajonal mbi keqpërdorimin e inteligjencës artificiale (AI) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: nga imitimi deri te dhuna digjitale.

Gjatë panelit u diskutua mbi mënyrat se si inteligjenca artificiale përdoret për mashtrime, imitime dhe dhunë seksuale të lehtësuara nga teknologjia, si dhe masat që duhet të ndërmerren për të mbrojtur privatësinë dhe sigurinë e përdoruesve në një kontekst global të rrezikut dhe keqpërdorimeve digjitale.

Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në të gjitha nivelet – lokal, organizativ, nacional, rajonal dhe global – për të krijuar sisteme të zgjuara dhe të decentralizuara, që mund të bashkëveprojnë në mënyrë efikase dhe të sigurojnë mbrojtje nga kërcënimet digjitale: “Ne duhet të punojmë së bashku në të gjitha nivelet dhe të krijojmë një aleancë globale për t’u përballur me kërcënimet e inteligjencës artificiale. Institucionet duhet të kenë kapacitete dhe sisteme të decentralizuara, të ndërveprojnë pa vonesa dhe të ndërtojnë besim, për të menaxhuar këto zhvillime teknologjike në mënyrë efikase”, theksoi Rektori Hajrizi.



Ai gjithashtu nënvizoi sfidat dhe mundësitë që paraqet AI për Kosovën:

“Ne po ecim shpejt drejt identifikimit të përmbajtjes së gjeneruar nga AI dhe jemi duke punuar për të rritur transparencën e këtyre zgjidhjeve, duke studiuar dhe analizuar procesin nga pikëpamja kërkimore”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Paneli, i moderuar nga Aida Mahmutović, Menaxhere e Projektit për të Drejtat Digjitale në BIRN Kosovo, solli ekspertë dhe aktivistë nga rajoni dhe jashtë tij, duke përfshirë: Snežana

Nikčević, Civic Tech Advocate, NGO 35mm, Mali i Zi; Alba Brojka, Eksperte e Teknologjisë dhe Politikave Digjitale, Shqipëri; Feđa Kulenović, Universiteti i Sarajevës (pjesëmarrje online).

Ky panel u zhvillua në kuadër të konferencës vjetore të IFM 2025, ku morën pjesë gjithashtu Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, zyrtarë të BE-së dhe liderë lokalë, duke ofruar një platformë të rëndësishme për dialog mbi të drejtat digjitale, sigurinë online dhe përgjegjësitë e institucioneve në epokën e transformimit digjital.

Vesa Shatri zgjidhet Kryetare e re e Këshillit Studentor të UBT-së



Këshilli Studentor i UBT-së ka zhvilluar procesin zgjedhor për përzgjedhjen e përfaqësuesve të rinj të studentëve, në një proces të drejtë, transparent dhe të monitoruar nga autoritetet akademike të institucionit. Me shumicë votash, Vesa Shatri është zgjedhur Kryetare e Këshillit Studentor të UBT-së, duke marrë besimin e studentëve për të udhëhequr strukturën përfaqësuese të tyre.

Në përbërjen e re të kryesisë, janë zgjedhur këta përfaqësues:

Kryetare: Vesa Shatri

Nënkryetare: Eliona Kastrati

Sekretar: Mal Shehu

Këshilli Akademik: Ema Spahija

Komisioni për Ankesa: Elena Jashanica

Komisioni i Cilësisë: Odesa Mala

Komisioni Disiplinor: Rizgjim Sejdiu

Komisioni i Etikës: Arianit Hasani

Procesi zgjedhor u mbikëqyr nga për-

faqësues të lartë të UBT-së, përfshirë Prorektorin e UBT-së, Prof. Dr. Binak Beqaj, sekretarin e institucionit, Prof. Dr. Artan Tahiri, këshilltarin në Zyrën e Rektorit, Prof. Dr. Elmi Kelmendi, koordinatoren për Çështje Akademike në UBT, Mirlinda Jashanica, si dhe Ismije Pllana, nga zyra e sekretarit.

Zgjedhja e kryesisë së re vjen me synimin që përfaqësimi i studentëve të jetë sa më efektiv, gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të jetës akademike e studentore në UBT. Përfaqësuesit e rinj do të angazhohen për të qenë zëri i studentëve, për të adresuar kërkesat e tyre dhe për të bashkëpunuar ngushtë me menaxhmentin e institucionit.

Në fjalën e saj, Kryetarja e re, Vesa Shatri, falënderoi studentët për besimin dhe theksoi angazhimin e saj për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të ndërtuar ura komunikimi të qëndrueshme mes studentëve dhe strukturave drejtuese të UBT-së.

UBT merr pjesë në seminarin prestigjioz Central European Joint Infodays 2025 në Çeki

UBT po merr pjesë në Central European Joint Infodays 2025, ngjarjen më të madhe rajonale të dedikuar programeve ndërkombëtare të arsimit të lartë, e cila këtë vit mbahet në qytetin e Brnos, në Çeki. Ky seminar përbën një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e eksperiencave dhe krijimin e lidhjeve strategjike mes institucioneve të arsimit të lartë nga Europa dhe më gjerë.

UBT është institucioni i vetëm privat nga Ballkani Perëndimor i ftuar në këtë ngjarje prestigjioze, duke dëshmuar kështu pozitën e saj të veçantë dhe reputacionin e konsoliduar në arenën

akademike evropiane. Në këtë samit, UBT u përfaqësua nga Prof. Dr. Bekim Marmullaku, Drejtor për Bashkëpunim Ndërkombëtar, i cili zhvilloi një numër të madh takimesh bilaterale dhe diskutimesh në grup me përfaqësues të universiteteve nga Evropa, Azia dhe Amerika Latine. Këto takime u konkretizuan në arritjen e një serie marrëveshjesh të reja bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta akademike dhe hulumtuese.

Pjesëmarrja në këtë ngjarje nënvizon angazhimin e UBT-së për t'u pozicionuar si një partner serioz ndërkombëtar, duke ofruar mundësi të reja për studentët dhe stafin akademik për t'u angazhuar në programet më inovative dhe globale të arsimit të lartë.



bëtar, duke ofruar mundësi të reja për studentët dhe stafin akademik për t'u angazhuar në programet më inovative dhe globale të arsimit të lartë.

Java e Kuzhinës Italiane në UBT – bashkëpunim, kulturë dhe inovacion

Parku Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik i UBT-së u shndërrua sot në qendrën kryesore të një aktiviteti ndërkombëtar me rëndësi të veçantë kulturore dhe shkencore, në kuadër të edicionit të 10-të të “Week of Italian Cuisine in the World”, një nga iniciativat më të njohura globale të Italisë. Ngjarja, e organizuar me mbështetjen zyrtare të Ambasadës së Italisë në Kosovë, solli në UBT profesorin italian Tommaso Centrella, nga Instituti “Vergani Navarra” i Provincës së Ferraras, i cili mbajti një ligjëratë të thelluar mbi konceptin inovativ “Culinary Medicine” — një fushë që ndërthur artin kulinar, shkencën mjekësore dhe nutricionin për të promovuar shëndetin përmes ushqimit.

Në hapje të aktivitetit, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Italinë dhe rolin e UBT-së si institucion udhëheqës në edukim, inovacion dhe partneritete ndërkombëtare.

“UBT është shtëpia e projekteve ndërdisiplinore që sjellin vlerë për studentët dhe shoqërinë. Culinary Medicine lidhet drejtpërdrejt me vizionin tonë për të krijuar sisteme të zgjuara, qasje të reja dhe zgjidhje inovative që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien. Sot, Kosova dhe Italia po ndërtojnë ura të reja bashkëpunimi, dhe UBT mbetet pikë takimi e këtij partneriteti kulturor, akademik dhe shkencor”, u shpreh Hajrizi.

Ambasadori i Italisë në Kosovë, Maurizio Antonini, përgëzoi UBT-në për organizimin dhe theksoi se ky aktivitet përputhet plotësisht me vlerat dhe traditën italiane mbi ushqimin e shëndetshëm.



“Culinary Medicine është një fushë që bashkon shkencën mjekësore, nutricionin dhe artin kulinar me qëllimin për të përmirësuar shëndetin përmes asaj që hamë. Italia ka një trashëgimi të jashtëzakonshme gastronomike, të lidhur thellë me shëndetin — mjafton të kujtojmë dietën mesdhetare, të njohur nga UNESCO. UBT është vendi më i përshtatshëm për këtë konferencë, sepse është një institucion që e kupton rëndësinë e inovacionit dhe kulturës së qëndrueshme ushqimore”, theksoi Antonini. Profesor Centrella prezantoi për studentët dhe të ftuarit konceptin modern të “Culinary Medicine”, duke theksuar rëndësinë e ushqimit të ndërgjegjshëm, përdorimit të produkteve natyrale dhe shmangies së ushqimeve të tepërta të industrializuara.

“Ushqimi i shëndetshëm fillon nga zgjedhja e produkteve natyrale, të stinës dhe të trajtuara me kujdes. Çdo përbërës që na jep natyra duhet respektuar. Kjo është thelbi i ushqimit të ndërgjegjshëm”, tha Profesor Centrella. Profesori foli për rëndësinë e hidrati-



mit, të yndyrave të mira, të antioksidantëve, dhe dha shembuj konkretë nga kuzhina mesdhetare: “Vaji i ullirit ekstra i virgjër, farat, perimet me gjethe jeshile, drithërat dhe frutat e stinës janë aleatët tanë më të mëdhenj. Kombinimi i duhur i ushqimeve forcon mirëqenien tonë”.

Pas ligjëratës, ai demonstroi përgatitjen e një risoto me kungull të verës, duke i shpjeguar studentëve teknikat profesionale të përzgjedhjes së orizit, përgatitjes së lëngut të perimeve dhe karamelizimit përmes “reaksionit Maillard”.

Ngjarja i shtoi një kapitull të ri bashkëpunimit akademik dhe kulturor midis UBT-së dhe institucioneve italiane. Ajo u ndoq nga profesorë, studentë, ekspertë të gastronomisë dhe të fushës së shëndetit, të cilët patën mundësinë të ndërveprojnë drejtpërdrejt me ambasadorin Antonini dhe profesorin Centrella.

UBT feston 28 Nëntorin me një koncert madhështor artistik



Në kuadër të festimeve të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit dhe të Pavarësisë, Fakulteti i Arteve në kuadër të UBT-së, programi Muzikë Moderne, Prodhim Digjital dhe Menaxhim, organizoi një koncert festiv që i dha skenës ngjyrat e artit, emocionit dhe krenarisë kombëtare.

Programi u hap me një performancë solemne të Korit të UBT-së, nën drejtimin e Prof. Lindita Isufit. Kori interpretoi me dinjitet Hymnin Kombëtar si dhe Suitën Korale të kompozitorit të madh Rauf Dhomi, duke krijuar një hyrje madhështore dhe atmosferë të denjë për këtë ditë të shënuar.

Më pas, pianisti Ledian Shala mbushi sallën me emocion përmes interpretimit të ndër të veprës “Për Ty Atdhe”, një performancë që u prit me qetësi të thellë dhe duartrokitje mirënjohëse.

Koncerti vazhdoi me klarinetistin Rinor Hasimi, i cili interpretoi me virtuozeitet veprën e njohur “Czardas” nga V. Monti. Atij iu bashkuan në skenë Prof. Du-

kagjin Muhaxheri në piano dhe studenti Shend Xhini në bateri – një trio dinamike që solli energji dhe ritëm, duke marrë vlerësime të shumta nga publiku.

Një nga momentet më prekëse të mbrëmjes ishte interpretimi i Erza Ahmetit, e cila solli një kombinim të veçantë të oboes dhe vokalit me veprën “Trim Mbi Trima”, e shoqëruar në piano

nga Prof. Muhaxheri. Interpretimi i saj i brishtë dhe emocional la gjurmë të thella te të pranishmit.

Publiku u entuziazhua edhe nga klarinetisti Sunaj Qerimi, i cili ndezi skenën me veprën “Baresha”, të interpretuar me shumë finesë dhe ritëm, i shoqëruar nga studentët Ledian Shala në piano dhe Shend Xhini në bateri. Një performancë që u shpërblye me duartrokitje të zjarrta.

Në mbyllje, të gjithë studentët, së bashku me Prof. Dukagjin Muhaxherin, u bashkuan në një interpretim të fuqishëm dhe emocional të veprës “Këngë Moj”, duke e finalizuar koncertin me një atmosferë festive dhe të ngrohtë.

Ky koncert dëshmoi edhe një herë talentin e jashtëzakonshëm të studentëve dhe përkushtimin e pedagogëve që i udhëheqin. Një mbrëmje arti e cila nderoi kulturën kombëtare, muzikën dhe festën e 28 Nëntorit me dinjitet dhe profesionalizëm.



Rektori Hajrizi pjesëmarrës në ceremoninë e ndezjes së dritave në Crown të Texas-it

Më 2 dhjetor, në mbrëmje, në qytetin Crown të Teksasit u zhvillua ceremonia tradicionale e ndezjes së dritave festive, e organizuar nga Kryetari dhe Zv. Kryetari i qytetit. Në këtë aktivitet të veçantë ishte i ftuar Rektori Hajrizi, i cili mori pjesë në darkën zyrtare së bashku me përfaqësues të institucioneve lokale, komunitetit shqiptar, universiteteve shqiptare dhe Sam Houston State University, duke thelluar bashkëpunimin akademik dhe lidhjet komunitare.

Për këtë ngjarje festive, si përfaqësues dhe figurë e dalluar e komunitetit shqiptaro-amerikan, u zgjodh z. Joe Haliti, i shpallur këtë vit “Personaliteti i Vitit” në rajon. Kontributi i tij i vazhdueshëm në jetën e komunitetit dhe roli i tij në pro-



movimim e vlerave shqiptare janë vlerësuar gjerësisht nga autoritetet lokale dhe bashkëkombësit.

Gjatë ceremonisë, Rektori Hajrizi mbajti një fjalim ku theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes komunitetit dhe institucioneve arsimore, si dhe rolin e personaliteteve si Joe Haliti në forcimin e marrëdhënieve kulturore dhe akade-

mike ndërmjet Shteteve të Bashkuara, Kosovës dhe Shqipërisë.

Ky aktivitet shënoi një moment të rëndësishëm për komunitetin shqiptaro-amerikan në Texas, duke nderuar punën dhe përkushtimin e Joe Halitit, ndërkohë që thelloi edhe më tej lidhjet mes komunitetit dhe institucioneve arsimore ndërkombëtare.

UBT nderon xhudisten Laura Fazliu për medaljen historike të argjendtë në Lojërat Universitare Botërore “FISU 2025”

Në një ceremoni solemne të mbajtur në Kampusin Inovativ të UBT-së në Lipjan, u nderua xhudistja dhe studentja e UBT-së, Laura Fazliu, për suksesin historik në Lojërat Universitare Botërore “FISU 2025”, të mbajtura në Rhine-Ruhr të Gjermanisë, ku ajo fitoi medaljen e argjendtë të parën në histori për Kosovën në këtë kompeticion prestigjioz ndërkombëtar. Në shenjë vlerësimi për suksesin e saj të jashtëzakonshëm, UBT i ndau Laurës një bursë të veçantë meritore, si dëshmi e përkushtimit të institucionit për të mbështetur talentet që dallohen në fusha të ndryshme sportive, akademike dhe shkencore.

Rektori i UBT-së, Prof.Dr Edmond Hajrizi theksoi rëndësinë e këtij sukcesi dhe rolin që luan institucioni në mbështetjen e studentëve.

“Ky është një moment krenarie për të gjithë ne. Sukcesi i Laurës është dëshmi e potencialit të jashtëzakonshëm që kanë studentët tanë. Përkrahja e talenteve si Laura është misioni i përhershëm i UBT-së”, tha rektori Hajrizi.

Gjatë fjalimit të saj, Laura shprehu emocionet dhe krenarinë për këtë arritje të madhe, duke theksuar rëndësinë që ka kjo medalje për vendin dhe për të gjithë të rinjtë që synojnë suksesin:

“Kjo medalje nuk është vetëm për mua



është për Kosovën, për të rinjtë që ëndërojnë dhe për çdo vajzë që beson se mund të arrijë majat. Jam krenare që përfaqësoj vendin tim dhe UBT-në në arenën botërore”, theksoi Laura.

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Sportit dhe të Lëvizjes, Agron Thaçi, gjatë fjalës së tij, potencoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë mes fushës akademike dhe asaj sportive. Ai vuri në pah se sukcesi i Laurës tregon se kur shkencat dhe sporti bashkëpunojnë, arrihen rezultate të jashtëzakonshme. Dekani gjithashtu nënvizoi nevojën për të krijuar lidhje më të forta mes institucioneve arsimore dhe sportit elitare për të mundë-

suar zhvillimin e sportistëve të talentuar në nivel të lartë.

Në ceremoni, trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, theksoi se sukcesi i Laurës është rezultat i punës së palodhshme, disiplinës së saj dhe mbështetjes së duhur, duke vlerësuar gjithashtu bashkëpunimin efikas me UBT-në si një faktor kyç në arritjen e këtij rezultati.

Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, e përshkroi medaljen e argjendtë si një pikë kthese për sportin universitar në Kosovë, duke theksuar rolin e Laurës si një ambasadore e vlerave të sportit dhe arsimit që frymëzojnë brezat e rinj.

Udhëheqësi i Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës, Musa Selimi, theksoi se sukcesi i Laurës është dëshmi që institucionet arsimore si UBT mund të jenë një faktor thelbësor në zhvillimin e sportit kombëtar dhe një shembull i mirë që duhet ndjekur dhe përsëritur.

Përmes kësaj ngjarjeje, UBT rikonfirmon misionin e saj për të fuqizuar të rinjtë, për të krijuar një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e talenteve dhe për të ndërtuar ura mes akademisë dhe sportit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.



Schneider Electric trajnon studentët e Masterit në UBT me softuerët më të avancuar energjetikë

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me kompaninë ndërkombëtare Schneider Electric, Fakulteti i Inxhinierisë së Energjisë organizoi më 06-07 dhjetor 2025 një trajnim intensiv për profesorët dhe studentët e programeve master, në ambientet e UBT-së. Schneider Electric i ka dhuruar fakultetit licenca profesionale për dy softuerët e avancuar EcoStruxure Power Design dhe EcoStruxure Power Build, të cilët

janë ndër mjetet më bashkëkohore në fushën e projektimit elektroenergjetik. Për përdorimin e tyre, u zhvillua një trajnim dyditor i dedikuar, duke ofruar njohuri praktike dhe të thelluara.

Qëllimi i trajnimit ishte aftësimi i studentëve të studimeve master për projektimin dhe përgatitjen e projekteve për linjat e tensionit të ulët dhe të mesëm, përmes aplikimit të komponentëve të ndryshëm elektroenergjetikë si trans-

formatorë, gjeneratorë, motorë, linja, zbarra, stabilimente shpërndarëse, ndërprerës, siguresa dhe lloje të tjera të ngarkesave elektrike.

Po ashtu, trajnimi u mundësoi edhe profesorëve që në të ardhmen të zhvillojnë ushtrimet praktike të lëndëve të tyre duke përdorur këto softuerë modernë, duke rritur cilësinë dhe nivelin e përgatitjes profesionale të studentëve.

Rektori i UBT-së zhvilloi vizitë zyrtare në Texas me ftesë të Sam Houston State University



Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, realizoi një vizitë zyrtare në Texas me ftesë të Sam Houston State University (SHSU), në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe angazhimit të përbashkët për avancimin e bashkëpunimit akademik dhe kërkimor.

Gjatë vizitës, Rektori Hajrizi zhvilloi një sërë takimesh me drejtues akademikë, institucione kërkimore dhe personalitete të komunitetit shqiptar në SHBA, ku u diskutuan mundësitë për zgjerimin e shkëmbimeve studimore, projekteve të përbashkëta dhe iniciativave strategjike në fusha me interes të përbashkët.

Në delegacion morën pjesë edhe përfaqësues nga universitetet partnere të rajonit: Rektori, Prof. Dr. Jusuf Zejneli, dhe Kryetari i Senatit të UT, Prof. Dr. Kenan Ferati, si dhe përfaqësues të Universitetit të Tiranës. Pjesëmarrja e tyre shtoi edhe më shumë peshën e dimensionit ndër-universitar rajonal, duke e bërë vizitën një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të urave të reja të bashkëpunimit.

Vizitat në infrastrukturën e Universitetit ishin një tjetër pjesë e rëndësishme e programit, ku Rektori Hajrizi vizitoi Fakultetin e Biznesit, të Infermierisë, të Mjekësisë dhe një numër njësisish të tjera akademike të SHSU-së. Këto vizita shërbyen për të parë nga afër standardet e larta akademike dhe laboratorike të institucionit, duke identifikuar mundësi konkrete për bashkëpunim dhe shkëmbime profesionale. Gjatë qëndrimit, Rektori Hajrizi zhvilloi një takim të rëndësishëm me Major Gjeneral David P. Glaser, të cilin UBT e

ka nderuar me çmimin më të lartë institucional. Në këtë takim u diskutua për mundësitë e bashkëpunimeve të mëtejshme në fushat e sigurisë, lidershitit dhe edukimit profesional, si dhe përfshirja e ekspertëve nga të dy institucionet në projekte të përbashkëta trajnimit dhe hulumtimi.

Po ashtu, u mbajt takimi me Dekanën e Fakultetit të Administrimit të Biznesit, Dr. Sharmistha (Shar) Self, e cila ishte organizatorja kryesore e vizitës, së bashku me Alban Fetahun – ish-student i SHSU-së dhe nismëtar i këtij partneriteti të rëndësishëm.

Rektori u prit gjithashtu nga dekanët e fakulteteve të Kriminologjisë, Shkencave, Teknologjisë Inxhinierike, Shkencave të Shëndetit dhe Shkencave Humane, me të cilët u shkëmbyen ide mbi programet akademike dhe mundësitë për projekte të përbashkëta kërkimore.

Një moment i veçantë i vizitës ishte takimi me Presidenten e SHSU-së, Dr. Alisa White, dhe Provost-in, Dr. Sumanth Yenduri, ku u diskutua thellimi i bashkëpunimit institucional, zhvillimi i programeve të përbashkëta studimore dhe krijimi i mundësive konkrete për studentët e UBT-së. Në të gjitha takimet, Rektori Hajrizi prezantoi programet akademike të UBT-së dhe potencialin për zgjerim të bashkëpunimit në fusha të ndryshme, duke u dakorduar që së shpejti të nisin projekte të përbashkëta konkrete.

Në të dy rastet, Rektori Hajrizi prezantoi iniciativën për krijimin e qendrës për studime amerikane në UBT dhe të studimeve shqiptare në Texas, e cila u prit shumë mirë nga të gjithë.

Programi përfshiu edhe vizita në institucione të rëndësishme edukative dhe shkolla të zonës së Houston-it, si dhe një vizitë në NASA Headquarters dhe muzeun e tyre, ku u diskutua për mundësinë e përfshirjes së studentëve të UBT-së në aktivitete dhe programe edukative ndërkombëtare.

Një nga aktivitetet më të rëndësishme të vizitës ishte pjesëmarrja në eventin akademik dhe kulturor të SHSU-së, “Bridge-Building Event: Strengthening Partnerships with the Albanian Community”, ku u diskutua për perspektivat e reja të bashkëpunimit afatgjatë dhe për angazhimin e mëtejshëm me komunitetin shqiptar në SHBA.

Në këtë event morën pjesë përfaqësues të komunitetit shqiptaro-amerikan nga



Houston dhe Dallas, si dhe Ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, z. Ilir Dugolli, të cilët e mirëpritën me shumë entuziazëm iniciativën e bashkëpunimit dhe shprehën gatishmërinë për të mbështetur studentët shqiptarë me bursa dhe mundësi të tjera akademike.

Falë kësaj qasje bashkëpunuese, studentët e UBT-së potencialisht do të kenë mundësinë të përfitojnë bursa në studime në Sam Houston State University, si dhe të marrin pjesë në programe të përbashkëta studimore dhe kërkimore.

Më 2 dhjetor në mbrëmje, Rektori Hajrizi ishte i ftuar të marrë pjesë në ceremoninë e ndezjes së dritave të qytetit Crown në Texas, të organizuar nga Kryetari dhe Zv. Kryetari i qytetit. Për këtë ngjarje, u zgjodh z. Joe Haliti, anëtar i komunitetit shqiptaro-amerikan dhe kontribues i jashtëzakonshëm në jetën e komunitetit, i cili këtë vit u shpall “Personaliteti i Vitit” në rajon. Në këtë ceremoni, Rektori Hajrizi mbajti një fjalim gjatë darkës, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve të rrethit, komunitetit shqiptar, përfaqësues të universiteteve shqiptare dhe të Sam Houston State University, duke forcuar edhe më shumë lidhjet midis komunitetit dhe institucioneve akademike.

Kjo vizitë nënvizon përkushtimin e UBT-së për të forcuar rrjetin e partneriteteve ndërkombëtare dhe për të krijuar mundësi të reja për zhvillimin akademik, shkencor dhe profesional të studentëve dhe stafit të universitetit.

Në kuadër të Global UBT Fest UBT mirëpret Ambasadorin Dr. Christian Steiner

Në kuadër të Global UBT Fest, në Akademinë e Medias, Shkencave Politike dhe Juridikut, u mbajt një ligjëratë e veçantë nga Dr. Christian Steiner, Ambasador i Austrisë në Mal të Zi. Në hapje të aktivitetit, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i uroi mirëseardhje ambasadorit dhe e vlerësoi praninë e tij si një mundësi të rëndësishme për studentët dhe të pranishmit që të përfitojnë nga përvojat ndërkombëtare.

Gjatë ligjëratës, Dr. Steiner ndau me të pranishmit përvojën e tij shumëvjeçare në diplomaci dhe angazhimin në çështje ndërkombëtare, duke folur për sfidat dhe përgjegjësitë që lidhen me rolin e një diplomati, si dhe për rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme ndërkombëtare.

Ai solli momente kyçe nga karriera e tij dhe u shpreh i impresionuar nga arrit-



jet dhe niveli profesional i UBT-së, duke theksuar rëndësinë e institucioneve të tilla në edukimin e gjeneratave të reja.

Ky aktivitet ishte pjesë e një sërë ngjarjesh të organizuara në kuadër të

Akademisë, e cila synon të fuqizojë njohuritë, aftësitë dhe përvojat e studentëve përmes bashkëpunimeve me diplomatë, ekspertë dhe profesionistë të njohur ndërkombëtarisht.

Vizitë zyrtare dhe ligjëratat akademike nga profesorët e University of Sannio në UBT

Në kuadër të bashkëpunimit akademik ndërkombëtar, një delegacion nga University of Sannio në Itali ka realizuar një vizitë zyrtare në UBT, në kuadër të Akademisë Verore të Shkencave Kompiuterike dhe Inxhinierisë dhe projektit IOT-Eco.

Delegacioni përbëhej nga profesorë dhe ekspertë të njohur ndërkombëtarisht, si: Prof. Pasquale Daponte, Prof. Stefano Acierno, Giuseppe Nappi, Prof. SSA Marina Paolucci, Prof. Francesco Pepe, Prof. Giovanni Vito Persiano dhe Prof. Francesco Vespasiano.

Gjatë qëndrimit në UBT, anëtarët e delegacionit mbajtën ligjëratat të special-



izuara për studentët dhe stafin akademik, duke ndarë njohuri, përvoja dhe zhvillime të fundit në fushën e inteligjencës artificiale, IoT-së dhe teknologjive të avancuara.

Në kuadër të vizitës, ata u pritën nga Rektori dhe Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, si dhe nga stafi

akademik. Delegacioni vizitoi gjithashtu Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan, ku patën mundësi të njihen nga afër me kapacitetet infrastrukturorë, laboratorët, projektet kërkimore dhe modelet e inovacionit të zbatuara në këtë hapësirë unike në rajon.

Në Balkan International Youth Summit 2025

Nxënësit e UBT International Smart Schools fitues të çmimit “Best Youth-Led Initiative”



Nxënësit e UBT International Smart Schools u nderuan me çmimin “Best Youth-Led Initiative” gjatë Balkan International Youth Summit for Peace 2025, për projektet e tyre inovative të

prezantuara në kuadër të S!NERGY Youth Innovation Forum.

Marta Çerkini dhe Endrit Krasniqi garuan me projektet e tyre në këtë forum, ku projekti i nxënëses Marta Çer-

kini u shpall fituese si një nga projektet më të mira. Ky çmim vlerëson fuqinë e udhëheqjes së të rinjve, iniciativën dhe kreativitetin e tyre, duke nënvizuar rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në ndërtimin e shoqërive gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Programi përfshiu trajnimin Peace Designer Training, i cili përgatiti nxënësit për të zhvilluar projekte inovative me ndikim social dhe për të kontribuar në promovimin e paqes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

UBT dhe Binance bashkë në një ngjarje unike për Blockchain dhe sigurinë në krypto

Në kuadër të Akademisë Verore të Fakultetit Shkencë Komputerike dhe Inxhinieri, pjesë e Global UBT Fest 2025, në hapësirat e Parkut Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së u organizua një aktivitet i veçantë me Binance, që mbledhi së bashku studentë, profesorë, profesionistë të fushës dhe të interesuar të tjerë për të diskutuar dhe mësuar më shumë rreth temave aktuale në teknologjinë Blockchain dhe kriptovaluta.

Hapjen solemne të ngjarjes e bëri Presidenti dhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili theksoi rëndësinë e integritetit të teknologjive të reja si Blockchain në arsim, ekonomi dhe sektorë të tjerë strategjikë të zhvillimit.

Në vijim, eksperti Sandro Slukan mbajti një prezantim tematik rreth "Themeleve të Kriptovalutave, sigurisë në krypto dhe mënyrave për mbrojtjen e vetes në botën digjitale", duke ofruar njohuri të rëndësishme praktike për të rinjtë që duan të angazhohen në këtë fushë.

Pjesë e programit ishte edhe paneli di-



skutues me temën "Integrimi i Blockchain në institucione", i udhëhequr nga Rektori Hajrizi, ku morën pjesë Sandro Slukan dhe Polina Brottier, përfaqësuesë nga kompania globale Binance. Paneli solli perspektiva konkrete për aplikimin institucional të teknologjisë Blockchain në administratë, arsim dhe biznese.

Ngjarja vazhdoi me një prezantim të veçantë nga Polina Brottier, me temën "Karriera dhe vullnetarizmi në Binance: Qasjet më të mira", ku ajo ndau me studentët përvojat dhe mundësitë që ofron

Binance për të rinjtë e pasionuar pas teknologjisë dhe inovacionit.

Gjithashtu u prezantua edhe Angels Program Binance, ku Betim Cakiqi nga Kosova tregoi përvojën e tij si vullnetar në këtë platformë ndërkombëtare, duke dëshmuar se të rinjtë tanë mund të bëhen pjesë aktive e skenës globale të inovacionit.

Ky aktivitet ishte një mundësi unike për pjesëmarrësit që të kuptojnë më thellë potencialin transformues të Blockchain-it dhe të krijojnë lidhje të drejtpërdrejta me ekspertë të industrisë.

Nxënësit e UBT International Smart Schools dhe studentët e psikologjisë organizojnë aktivitete edukative dhe kreative për fëmijët e kopshtit "Borëbardha"

Sot, në kopshtin "Borëbardha" u zhvillua një aktivitet i veçantë, i cili solli një bashkëpunim të shkëlqyer ndërmjet brezave dhe institucioneve edukative. Aktiviteti u organizua nga nxënësit e UBT International Smart Schools dhe studentet e psikologjisë, Kosovare Hamiti dhe Shqipe Shala, si dhe studenti i aktrimit, Denis Arifi. Ky bashkëpunim kishte për qëllim të ofronte një përvojë edukative dhe argëtuese për fëmijët e vegjël të kopshtit "Borëbardha", ndërsa shërbente edhe si mundësi për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale për të rinjtë pjesëmarrës.

Gjatë aktivitetit, nxënësit dhe studentët udhëhoqën një sërë lojërash grupore, aktivitete artistike dhe ngjyrosje, që ndihmuan fëmijët në zhvillimin e aftësive të motorikës së hollë dhe të trashë. Ata u mësuan fëmijëve disa aktivitete të thjeshta që stimulonin kreativitetin dhe aftësinë për të punuar me materialet e



ndryshme, duke kontribuar në zhvillimin e koordinimit dhe përqendrimit të fëmijëve. Për nxënësit e gjimnazit dhe studentët, ky aktivitet ofroi mundësinë për të zhvilluar aftësi udhëheqëse dhe për të mësuar si të punojnë në grupe me individë të moshave të ndryshme. Ata patën mundësinë të rrisin empatinë dhe të kuptojnë më mirë nevojat dhe emocionet e fëmijëve, duke krijuar një lidhje më të thellë me ata.

Nga ana tjetër, fëmijët e kopshtit shijuan një atmosferë të ngrohtë dhe energjike, ku ata mund të shpreheshin lirshëm dhe të krijonin lidhje të reja me të rinjtë që ishin pjesë e aktivitetit. Aktivitetet kreative dhe lojërat grupore i ofruan atyre mundësinë për të mësuar në një mjedis argëtues dhe të sigurt. Ky përvojë ishte e rëndësishme për zhvillimin e aftësive sociale dhe ndërveprimeve pozitive mes fëmijëve, të cilët u ndihmuan të rrisin besimin në vetvetë dhe të zhvillo-

jnë një sens të bashkëpunimit. Ky aktivitet i sotëm theksoi rëndësinë e ndërveprimeve ndërmjet brezave të ndryshëm, duke ndihmuar në ndërtimin e një mjedisi të përbashkët mësimi dhe rritje. Aktivitetet e organizuara kontribuan në forcimin e lidhjeve ndërmjet fëmijëve dhe të rinjve, duke nxitur aftësitë sociale dhe emocionale dhe duke krijuar mundësi për rritjen dhe zhvillimin e të gjithëve. Ky bashkëpunim i shkëlqyer është një hap i rëndësishëm drejt forcimit të marrëdhënieve ndërmjet institucioneve edukative dhe ndihmës për të rinjtë dhe fëmijët në zhvillimin e aftësive të tyre.

Ky aktivitet ka dhënë një shembull të shkëlqyer për forcimin e lidhjeve ndërmjet brezave dhe ka treguar rëndësinë e krijimit të një shoqërie më të bashkuar dhe të kujdesshme për nevojat e të gjithëve.

Global UBT Fest 2025: Mijëra të rinj nga e gjithë bota bashkohen për dijen dhe shkencën



Festivali tradicional më i madh i dijes dhe shkencës në Kosovë dhe Evropë, Global UBT Fest 2025, ka përmbyllur me sukses edicionin e tij të 14-të, duke ofruar një përvojë të pasur edukative dhe profesionale për të gjithë pjesëmarrësit.

Gjatë 30 ditëve të festivalit, 35 shkolla verore bënë bashkë mijëra studentë, profesorë, ekspertë dhe profesionistë nga Kosova, rajoni dhe e gjithë bota.

Programi përfshiu ligjërata tematike, debate, punëtori kreative dhe sesione të shumta për shkëmbimin e njohurive dhe përvojave, duke u fokusuar në zhvillimin profesional dhe njohuritë praktike të të rinjve.


Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi se: “Global UBT Fest 2025 është një platformë unike për të nxitur dijen, inovacionin dhe kreativitetin ndër brezat e rinj. Pjesëmarrja ak-

tive e studentëve dhe profesionalizmi i prezantuesve ka kontribuar në krijimin e një eksperience të jashtëzakonshme edukative për të gjithë”.

Koordinatorja e festivalit, Mirlinda Jashanica Gashi, shtoi: “Ky edicion i Global UBT Fest ka tërhequr mijëra të rinj nga e gjithë bota, të cilët morën pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet dhe u angazhuan në shkëmbimin e ideve, njohurive dhe eksperiencave. Kjo tregon qartë interesin dhe energjinë e të rinjve për dijen dhe shkencën”.

Festivali u karakterizua nga një gamë e gjerë aktivitetesh, duke përfshirë prezantime të akademikëve të shquar, punëtori praktike dhe takime për bashkëpunim ndërkombëtar. Shkollat verore mbuluan tema dhe disiplina të ndryshme shkencore, duke i mundur ar pjesëmarrësve të përzgjedhin fushat që i interesonin më shumë.

Ky festival konfirmoi rolin e tij si një nga evenimentet më të rëndësishme në fushën e dijes dhe shkencës në Kosovë dhe Evropë, duke ofruar një mundësi unike për të zgjeruar horizontet, për të mësuar dhe për të krijuar rrjete profesionale ndërkombëtare.



UBT International Smart Schools shënon 28 Nëntorin me një aktivitet të pasur kulturor-artistik

Në kuadër të festimeve të 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit dhe të Pavarësisë, njëjës prej datave më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar, UBT International Smart Schools organizuan një aktivitet festiv të mbushur me emocion, solemnitet dhe krenari kombëtare. Ngjarja mbledhi së bashku nxënës, prindër, pedagogë dhe të ftuar të shumtë, të cilët krijuan një atmosferë të veçantë dhe shumë domethënëse.

Gjatë aktivitetit, nxënësit e UBT International Smart Schools sollën para publikut një program të larmishëm kulturor-artistik, me poezi, këngë, valle, aktrim dhe performanca të tjera që ngjallën emocione të forta dhe u shoqëruan me duartrokitje të vazhdueshme. Çdo pjesë artistike shfaqti talentin, kreativitetin dhe përkushtimin e të rinjve, duke reflektuar njëherazi dashurinë dhe respektin e tyre për kulturën dhe historinë shqiptare.

Në fjalën e saj përshëndetëse, drejtoresha Hajrie Devetaku – Gojani vlerësoi angazhimin e nxënësve dhe rëndësinë që mbart kjo ditë në formësimin e identitetit kombëtar.

“28 Nëntori është dita që na kujton rrugën e gjatë të sakrificave dhe aritjeve tona si komb. Jam krenare për nxënësit tanë që sot, me talentin dhe energjinë e tyre, e sollën këtë histori para nesh me kaq pasion e dinjitet. Rinia jonë është garancia më e madhe se vlerat tona kombëtare do të mbeten të gjalla dhe do të përcillen me krenari brez pas brezi”, u shpreh Devetaku – Gojani.



Në mesin e të pranishmëve, aktivitetin e përshëndeti edhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili vlerësoi këtë manifestim si një dëshmi të fuqishme të harmonisë, edukimit dhe vizionit të UBT-së për formimin e brezave të rinj.

“Është frymëzuese të shohim se si nxënësit tanë e përqafojnë me kaq dashuri e krenari historinë dhe identitetin shqiptar. 28 Nëntori nuk është vetëm një datë, por një mesazh i fortë për unitetin, zhvillimin dhe aspiratat tona. UBT do të mbetet gjithmonë një hapësirë ku edukimi bashkohet me kulturën, dhe ku të rinjtë rriten duke e dashur vendin dhe duke kontribuar për të”, tha Rektori Hajrizi.

Ky aktivitet jo vetëm që i dha më shumë ngjyrë festimeve të 28 Nëntorit, por edhe dëshmoi përkushtimin e UBT International Smart Schools në kultivimin e vlerave kombëtare, zhvillimin e talentit dhe nxitjen e kreativitetit tek gjeneratat e reja. Falë energjisë së nxënësve dhe mbështetjes së vazhdueshme të mësimitdhënësve dhe prindërve, ngjarja u shndërrua në një festë të vërtetë të kulturës dhe identitetit shqiptar.



UBT Start-up School nis trajnimet në Prizren, një mundësi e re për sipërmarrësit dhe inovatorët e rinj

Prizreni po shndërrohet në një qendër të re të inovacionit dhe ndërmarrësisë, pasi që, në një ceremoni të veçantë, nisi punën UBT Start-up School, një platformë e veçantë që synon të mbështesë sipërmarrësit, pronarët e bizneseve dhe profesionistët e rinj në ndërtimin dhe zhvillimin e ideve të tyre të biznesit.

Në ceremoninë e hapjes, e cila u mbajt në ambientet e UBT-së në Prizren, morën pjesë Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Drejtori i Departamentit për Edukim dhe Zhvillim Profesional në UBT, Besnik Skenderi, si dhe një numër i madh studentësh, sipërmarrësish të rinj, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe mentorë nga fusha e ndërmarrësisë dhe teknologjisë.

Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e edukimit dhe inovacionit në zhvillimin e bizneseve të reja dhe mbështetjen që UBT ofron për studentët dhe të rinjtë e apasionuar pas ndërmarrësisë.

“UBT Start-up School është një platformë gjithëpërfshirëse që do të ndihmojë sipërmarrësit e rinj të zhvillojnë idetë e tyre, të ndërtojnë rrjete të rëndësishme dhe të kenë qasje në mentorët më të mirë nga Kosova dhe jashtë saj. Ne po krijojmë një mjedis ku talenti, kreativiteti dhe inovacioni bashkohen për të prodhuar sukses”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Nga ana tjetër, Besnik Skenderi, duke folur për përmbajtjen dhe objektivat e programit, nënvizoi rëndësinë e ndërlihdjes së edukimit me industrinë,



duke mundësuar një qasje të re për zhvillimin e aftësive të sipërmarrësve të rinj.

Ky program inovativ ka për qëllim të krijojë një mjedis të favorshëm për edukimin dhe zhvillimin e aftësive në ndërmarrësi, duke i ndihmuar pjesëmarrësit të përgatisin dhe zgjerojnë bizneset e tyre përmes qasjes së drejtpërdrejtë me ekspertë nga Kosova, Gjermania dhe ShBA-ja.

Quality Kosova me mbështetjen e ITP-së përmes German Government (implemented by GIZ) dhe German Cooperation ka themeluar UBT Start-UP School, një iniciativë e cila ka për qëllim rritjen e aftësive dhe talentit të të rinjve në fush-

ën e biznesit dhe inovacionit në Kosovë. Në një ekonomi globale gjithnjë e më konkurruese, UBT Start-up School sjell një metodologji të re të të mësuarit, duke e kombinuar teorinë me praktikën dhe mentorimin nga ekspertë të njohur të fushës. Trajnimet përfshijnë aspekte kyçe të sipërmarrjes, si zhvillimi i ideve të biznesit, strategjitë e marketingut, menaxhimi i financave, transformimi digjital dhe globalizimi i kompanive të reja.

Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të fitojnë njohuri të avancuara përmes punëtorive, diskutimeve interaktive dhe sesioneve të mentorimit, duke u përgatitur për sfidat e tregut modern.

Nxënësit e UBT International Smart Schools shpërblehen për angazhimin e tyre kundër dhunës me bazë gjinore

Nxënësit e UBT International Smart Schools në Prishtinë janë vlerësuar me çmim të veçantë nga Fondacioni Jahjaga dhe UN Women, për pjesëmarrjen e tyre të jashtëzakonshme dhe përkushtimin gjatë fushatës 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore.

Ky vlerësim është një dëshmi e angazhimit të nxënësve në sensibilizimin dhe promovimin e barazisë gjinore, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë. Përmes diskutimeve kuptimplota dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese, ata dëshmuar fuqinë e rinisë për të sjellë ndryshime pozitive.

Ky çmim është një motivim i mëtejshëm për të rinjtë që të vazhdojnë të jenë zë për ndryshim, duke ndërtuar një të ardhme më të sigurt dhe më të drejtë për të gjithë!



Në UBT Smart City u mbajt Ceremonia e Diplomimit të Gjeneratës së Dytë të Maturantëve të UBT International Smart Schools



Në një atmosferë festive dhe emocionuese, në kampusin inovativ të UBT Smart City u mbajt Ceremonia e Diplomimit për gjeneratën e dytë të maturantëve të UBT International Smart Schools. Kjo ngjarje shënoi një moment të veçantë për 87 maturantë të cilët përfunduan me sukses një kapitull të rëndësishëm në rrugëtimin e tyre arsimor dhe profesional.

Ceremonia u zhvillua në prani të figurave të larta të arsimit, institucioneve publike dhe komunitetit, përfshirë Presidentin dhe Rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Drejtoreshën e UBT International Smart Schools, Hajrije Devetaku – Gojani, anëtarë të bordit të shkollës, si dhe mysafirë të nderuar si Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, Drejtori i Policisë së Republikës së Kosovës, Gazmend Hoxha dhe Drejtori i Arsimit në Komunën e Prishtinës, Samir Shihini.

Në fjalën e tij, Prof. Dr. Edmond Hajrizi theksoi rëndësinë e një arsimit të bazuar në inovacion dhe teknologji, duke vënë në dukje se UBT International Smart Schools përfaqësojnë një mod-

el të avancuar të shkollimit modern që përgatit gjenerata të gatshme për sfidat globale. Ai falënderoi prindërit dhe mësimmshënësit për përkushtimin e tyre të vazhdueshëm në mbështetje të nxënësve.

“Ju jeni gjenerata që jeni rritur me standardet më të larta arsimore, të lidhura drejtpërdrejt me nevojat reale të tregut të punës dhe me trendet globale në edukim, teknologji dhe biznes. Ju jeni pasqyra më e mirë e misionit tonë – për të zhvilluar liderët e së ardhmes dhe profesionistë të aftë, me dije të thellë, shkathtësi konkrete dhe me vetëbesimin për të ndikuar pozitivisht në shoqëri”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Drejtoresha e UBT International Smart Schools, Hajrije Devetaku – Gojani, u shpreh krenare për arritjet e maturantëve dhe vuri në dukje se përkushtimi i tyre dhe metodologjia unike e mësimmshënies që ofron shkolla, ka ndikuar në formimin e një baze të fortë për të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale.

Një ndër folësit kryesorë të kësaj ceremonie ishte Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, i cili në fjalën

e tij drejtuar maturantëve theksoi rëndësinë e arsimit cilësor si bazë për ndërtimin e një shoqërie të avancuar dhe të drejtë. Ai përgëzoi të diplomuarit për arritjet e tyre dhe i inkurajoi që të vazhdojnë të kultivojnë njohuritë, kreativitetin dhe përgjegjësinë qytetare, duke theksuar se të rinjtë janë forca më e madhe për ndryshim dhe zhvillim në Kosovë.

Maturantët u përshëndetën gjithashtu edhe nga përfaqësues të institucioneve publike të cilët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sektorit të arsimit dhe institucioneve shtetërore për të ndërtuar një të ardhme të qëndrueshme për të rinjtë e Kosovës.

Ceremonia u përmbyll me ndarjen e diplomave dhe çmimeve për nxënësit më të dalluar, ndërkohë që emocionet dhe krenaria nuk munguan as nga prindërit dhe familjarët të cilët ndoqën me entuziazëm çdo moment të kësaj dite të veçantë.

UBT International Smart Schools vazhdojnë të jenë një shembull i edukimit cilësor, duke përgatitur të rinjtë për të qenë qytetarë të denjë dhe kontribuues aktivë në shoqërinë moderne.





UBT, themel i ëndrrës profesionale të studentit Guri Berishës

Rrugëtimi profesional i Guri Berishës është një shembull frymëzues i suksesit që ndërtohet mbi baza të forta akademike, përkushtim dhe pasion për arkitekturën. Ai e ka nisur këtë rrugëtim në UBT, ku ka përfunduar me sukses studimet në nivelin Bachelor dhe Master në programin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor.

Gjatë kësaj periudhe, Guri ka qenë pjesë e dy mobiliteteve akademike në Gjermani, duke përfutur nga mundësitë që ofron UBT për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim përvojash. Ai ka studiuar në Dessau Institute of Architecture (DIA), pranë Anhalt University në kampusin historik të Bauhaus-it, si dhe në Technical University of Applied Sciences Lübeck, ku ka pasuruar njohuritë dhe përvojën e tij profesionale në ambient ndërkombëtar.

Përveç angazhimit akademik, Guri ka marrë pjesë në punëtori vendore dhe ndërkombëtare që ndërthurin artin me arkitekturën, duke e zhvilluar më tej qasjen e tij kreative dhe profesionale në këtë fushë.

Tash e tri vite, ai është pjesë e stafit akademik në UBT si asistent në lëndën “Fizika e Ndërtesave dhe Banimi”, duke kontribuar drejtpërdrejt në përgatitjen e gjeneratave të reja të arkitektëve dhe



duke ndarë përvojën e tij me studentët. Së fundmi, Guri ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm në karrierën e tij duke themeluar studion e tij arkitektonike ruur architecture, një projekt që pasqyron vizionin dhe përkushtimin e tij ndaj arkitekturës bashkëkohore.

Ai e konsideron UBT-në si themelin e zhvillimit të tij profesional dhe trampolinën që i ka hapur dyert drejt mundësive ndërkombëtare – një rrugëtim që vazhdon me pasion dhe përkushtim të pandalshëm.

Guri Berisha është dëshmi konkrete se me vizion të qartë, punë të palodhshme dhe mbështetje institucionale, ëndrrat arkitektonike mund të bëhen realitet.

UBT përgatit profesionistë të shëndetit – Studentja Shendrita Popaj histori suksesi



Shendrita Popaj, ish-studente e programit master Shkencat Paramjekësore në UBT, është punësuar si Infermiere në repartin e Emergjencës, një nga sektorët më sfidues dhe me përgjegjësi të lartë në sistemin shëndetësor.

Ajo thekson se përvoja e fituar në UBT, nga laboratorët modernë, praktikat profesionale dhe mentorimi nga profesorë ekspertë, ka qenë thelbësore për përgatitjen e saj si profesioniste. “UBT më ka dhënë njohuri, aftësi dhe besim për të përballuar sfidat në terren. Sot ndihem e gatshme të kontribuoj në kujdesin dhe shpëtimin e jetëve në repartin e Emergjencës”, shprehet Popaj. Ky sukses është edhe një dëshmi e faktit që mbi 98% e studentëve të UBT-së në fushën e Shkencave Mjekësore gjejnë punësim gjatë ose menjëherë pas përfundimit të studimeve, duke u bërë pjesë aktive e sistemit shëndetësor në Kosovë dhe jashtë saj.

Punimi shkencor i studentit Arbias Shahini publikohet në konferencën ndërkombëtare IACyC2025

Arbias Shahini, student i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në UBT, ka arritur një sukses në fushën e sigurisë kibernetike. Artikulli i tij shkencor, i titulluar “The Use of AI for Detecting Cyber Attacks in Web Applications”, është pranuar për botim në konferencën ndërkombëtare International Applied Cybersecurity Conference (IACyC2025), që do të mbahet në Stamboll, Turqi.

Ky punim, i mentoruar nga Prof. Dr. sc. Elissa Mollakuqe, adreson një nga sfidat më të mëdha të epokës digjitale: sulmet ndaj aplikacioneve web. Shahini ka propozuar një qasje inovative përmes përdorimit të Inteligjencës Artificiale – duke aplikuar teknika të mësimit makinerik (ML) dhe mësim-it të thellë (DL) – për të zbuluar dhe parandaluar sulme të tilla si SQL injection, XSS dhe kërcënimet e avancuara të vazhdueshme (APT).

Studenti Arbias Shahini paraqet një model që monitoron trafikun e aplikacioneve në kohë reale dhe përdor algoritme të avancuara si Random Forest, SVM, CNN dhe RNN për të analizuar të dhënat dhe për të identifikuar sjellje të dyshimta që mund të tregojnë një sulm kibernetik. Për më tepër, ai ka theksuar rëndësinë e përmirësimit të performancës së modeleve përmes teknikave si normalizimi, përzgjedhja e veçorive dhe trajtimi i të dhënave të paekuilibruara, duke e bërë sistemin më të saktë dhe efikas.

Konferenca IACyC2025, që është pjesë e programit Erasmus+ Mundus Joint Master Degree: Applied Cybersecurity (CyberMACS), është një ngjarje prestigjioze që mbledh studiues dhe ekspertë nga e gjithë bota për të diskutuar përparimet më të fundit në fushën e sigurisë kibernetike.

Ky kontribut shkencor nënvizon po-



tencialin e Inteligjencës Artificiale në përmirësimin e sigurisë kibernetike dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin e zgjidhjeve inteligjente për mbrojtjen e aplikacioneve web.

Përkushtimi dhe mbështetja e UBT-së: Historia e suksesit të Kosovare Hamiti në psikologji

Kosovare Hamiti është një shembull i shkëlqyer i një studenteje që ka ndjekur pasionin e saj dhe ka realizuar ëndrrat në fushën e psikologjisë, duke zgjedhur UBT-në si institucionin ku të gjitha mundësitë për zhvillim të mëtejshëm ishin të hapura për të. Ajo ka gjetur në UBT një platformë që i ka mundësuar të shndërrojë dijen në mundësi të prekshme dhe t'i dedikohet një fushe që e frymëzon dhe e motivon çdo ditë. "Zgjedha UBT sepse është më shumë se një universitet – është një mundësi për të transformuar pasionin tim për psikologjinë në aftësi të vlefshme dhe të dobishme për shoqërinë. Me profesorë të përkushtuar dhe një qasje inovative, UBT është vendi ku kam zhvilluar jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësitë praktike që më ndihmojnë të kuptoj më mirë njerëzit dhe shoqërinë", u shpreh Hamiti.

Programi i Psikologjisë në UBT i ka ofruar Kosovares mundësi të shumta për të zhvilluar aftësitë e saj, duke përfshirë një kombinim të teorisë dhe praktikës, që ka qenë një faktor kyç në formimin e saj si profesioniste. Ajo është angazhuar në aktivitete dhe projekte që i kanë mundësuar të aplikohet në jetën reale, duke trajtuar probleme psikologjike dhe duke ndihmuar individët të zhvillojnë aftësitë emocionale dhe sociale.

"Në UBT, çdo ligjëratë, çdo aktivitet, çdo projekt më ka ndihmuar të kuptoj më shumë jo vetëm teorinë, por edhe sesi mund të bëj një ndikim të drejt-

përdrejtë në jetën e individëve. Çdo ditë është një mundësi për t'u rritur dhe për t'u përgatitur për sfidat që do të vijnë në profesionin e psikologut".

Kosovarja e di mirë se programi i Psikologjisë në UBT ka hapur dyer për mundësi të shumta profesionale dhe zhvillim personal. "UBT më ka ofruar një ambient mbështetës dhe inovativ, ku pasioni im për psikologjinë është fuqizuar dhe ku kam mësuar si të përballoj sfidat e jetës profesionale." Ajo është thellësisht mirënjohëse për mundësinë që ka pasur për të mësuar nga ekspertët e fushës dhe për të aplikuar njohuritë e fituara për të ndihmuar të tjerët.

Duke u angazhuar në projektet praktike dhe duke marrë pjesë në aktivitete vullnetarizmi, Kosovarja ka kontribuar në ndihmën për ata që kanë nevojë për mbështetje psikologjike, duke përdorur njohuritë e saj për të sjellë një ndryshim pozitiv në shoqëri.

"Gjatë viteve të studimit në UBT, kam pasur mundësinë të kontribuoj në komunitetin tim dhe të ndihmoj individë që janë në nevojë për mbështetje psikologjike. Ky angazhim ka qenë një pjesë e rëndësishme e rrugëtimit tim dhe më ka dhënë ndjesinë e plotësimit dhe përmbushjes."

Kosovarja është shembull i asaj se si një program studimi i mirëmenyuar dhe mbështetje e vazhdueshme mund të transformojnë një student në një profesionist të suksesshëm dhe të angazhuar. Programi i Psikologjisë në



UBT e ka përgatitur atë për t'u bërë një lider në fushën e saj dhe për të bërë ndryshime të prekshme në jetët e njerëzve.

"UBT më ka mundësuar të ndërtoj një të ardhme të ndritur si psikologe. Këtu, pasioni im është shndërruar në mundësi konkrete për t'i dhënë shoqërisë atë që ka më shumë nevojë – mbështetje, mirëkuptim dhe ndryshim pozitiv."

Kosovare Hamiti është një histori suksesi që tregon se me mund, pasion dhe mbështetje të duhur, gjithçka është e mundur. UBT, me programin e saj të Psikologjisë, është një mundësi që shndërron ëndrrat në realitet dhe hap dyer të reja për të ardhmen.

Nga UBT në Pragë: Historia e suksesit të studentes së UBT-së, Genita Tahiri tani e punësuar në një nga kompaninë evropiane Gen Digital



Genita Tahiri është një nga shembujt më të mirë se si arsimit cilësor në UBT dhe përkushtimi personal mund të çojnë në sukses ndërkombëtar. Ajo është ish-studente e programit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, ndërsa sot është e punësuar si Software Engineer në një nga kompanitë më të njohura të teknologjisë në Evropë – Gen Digital në Pragë, Çeki.

Gjatë studimeve në UBT, Genita përfitoi nga një mjedis dinamik dhe praktik, ku njohuritë teorike shoqëroheshin gjithmonë me projekte konkrete dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Ishin pikërisht këto përvoja që e ndihmuar atë të zhvillojë aftësitë e nevojshme teknike, të ndërtojë vetëbesim profesional dhe të jetë gati për tregun global të punës. "UBT më ka ndihmuar të kuptoj jo

vetëm bazat e forta të programimit dhe sistemeve, por edhe të zhvilloj mendim kritik, punë ekipore dhe leadership – që janë thelbësore në çdo kompani teknologjike", thekson Genita.

Puna e saj në Gen Digital konsiston në zhvillimin dhe përmirësimin e produkteve softuerike të cilat përdoren nga miliona njerëz në mbarë botën. Ajo është pjesë e një ekipi ndërkombëtar, ku vlerësohet për përgatitjen e saj profesionale dhe kreativitetin që sjell në zgjidhjen e problemeve.

Rruga e Genitës është një dëshmi se studimet në UBT në fushën e Shkenca Kompjuterike hapin dyer të reja për studentët – që nga punësimi i menjëhershëm në Kosovë, e deri tek sukseset profesionale në vendet më të zhvilluara të botës.

Nga UBT në skenën globale: “Sentinel Cyber Defense” – Historia e suksesit të Driton Shalës në ShBA

Driton Shala, një ndër studentët e parë të diplomuar në UBT, është sot një nga emrat më të shquar në fushën e teknologjisë dhe menaxhimit të sigurisë kibernetike në nivel global.

I njohur për përkushtimin e tij ndaj inovacionit, etikës profesionale dhe zhvillimit të vazhdueshëm, ai ka ndërtuar një karrierë brilante që kulmon me themelimin dhe drejtimin e kompanisë së suksesshme amerikane Sentinel Cyber Defense.

“Sentinel Cyber Defense” – Revolucion në sigurinë kibernetike

Driton Shala është CEO i Sentinel Cyber Defense, kompani e specializuar në mbrojtjen kibernetike proaktive, e cila ka përmbysur mënyrën tradicionale të reagimit ndaj sulmeve kibernetike. Produkti inovativ i kompanisë – “Bulletproof Cyber Security Vest” – përfaqëson një ndryshim rrënjësor në qasjen ndaj sigurisë digjitale: nga mbrojtja reaktive, në parandalim të plotë të kërcënimeve.

Ky “jelek antibalistik” virtual është krijuar për të funksionuar si një mburojë e padukshme, që mbron organizatat nga sulmet para se ato të ndodhin. I zhvilluar në laboratorin e specializuar të kompanisë, ky produkt përfshin teknologjitë më të fundit dhe është tashmë një standard i ri në industrinë globale të sigurisë digjitale.

Një ekip elitare dhe mbi 1000 raste të zgjidhura Sentinel Cyber Defense për-



bëhet nga një ekip me mbi 150 vite përvojë të kombinuara nga profesionistë të drejtësisë dhe ekspertë të forenzikës digjitale. Me mbi 500 klientë dhe më shumë se 1000 raste të suksesshme të zgjidhura, kompania e Driton Shalës është shndërruar në një pikë referimi për sigurinë në botën moderne të teknologjisë.

Suksesi i kurorëzuar me çmime ndërkombëtare Në vitin 2025, Sentinel Cyber Defense u vlerësua si “Zgjidhja më e mirë për Siguri Kibernetike në Shtetet e Bashkuara” nga Best of Best Review, një nga vlerësimet më prestigjioze në industrinë e teknologjisë. Ky çmim i dhënë për produktin “Bulletproof Cyber Security Vest” dëshmon vlerën e veçantë që sjell kjo kompani në një botë gjithnjë e më të rrezikuar nga krimi digjital.

Nga UBT në Columbia University e deri në lidhshmëri globale

Paralelisht me suksesin e kompanisë, Driton Shala mban edhe pozitën e Menaxherit të Prokurimit në Teachers College, Columbia University – institucioni më prestigjioz i edukimit pasuniversitar në ShBA. Aty, ai ka udhëhequr transformime të rëndësishme teknologjike dhe strategjike në sistemin e prokurimit. Ai është gjithashtu President i Kapitullit për Amerikën e Veriut (që përfshin ShBA, Kanadanë, Brazil, Meksikë) të CIPS dhe anëtar i PMI, duke kontribuar në përparimin e fushës së prokurimit dhe menaxhimit të projekteve në shkallë ndërkombëtare.

Një ambasador i vlerave të UBT-së në botë

Përvojat e shumta, sukcesi ndërkombëtar dhe përkushtimi i tij për të sjellë risi në fushat më kritike të teknologjisë e bëjnë Driton Shalën një prej figurave më të dalluara të diasporës shqiptare në ShBA. Ai është mishërimi i vizionit të UBT-së: arsim cilësor, lidhshmëri globale dhe ndikim pozitiv në shoqëri.

Sot, historia e Driton Shalës është një frymëzim për brezat e rinj që ëndërrojnë të arrijnë sukses në skenën botërore duke filluar nga Kosova. Ai është shembulli konkret se si një ide, një vizion dhe një diplomë nga UBT mund të çojnë në ndërtimin e një kompanie që ndryshon botën.

Nga UBT në Departamentin Amerikan të Shtetit, ish-studentja Teuta Agushi bëhet pjesë e ekipit diplomatik në Ambasadën e Kosovës në ShBA



Rrugëtimi profesional i Teuta Agushit, ish-studente e Shkencave Politike në UBT, është shembull frymëzimi për të gjithë të rinjtë që ëndërrojnë të kenë një karrierë në botën e diplomacisë dhe sigurisë ndërkombëtare. Me përgatitje aka-

demike cilësore dhe përkushtim, ajo ariti të jetë pjesë e prezencës diplomatike të Kosovës në Washington, D.C., duke kontribuar në një fushë tejet të ndjeshme dhe moderne – diplomacia digjitale dhe siguria kibernetike. Pasi përfundoi stu-

dimet në UBT, Teuta vazhdoi rrugëtimin e saj profesional në një nga qendrat më të rëndësishme të diplomacisë botërore – në Washington, D.C., ku ishte pjesë e prezencës diplomatike të Kosovës. Ajo përmbylli me sukses një angazhim njëvjeçar si Zyrtare Ndërlidhëse në Byronë për Politika Kibernetike dhe Digjitale, në kuadër të Departamentit Amerikan të Shtetit. Kontributi i saj në fushën gjithnjë në zhvillim të diplomacisë digjitale dhe sigurisë kibernetike është vlerësuar zyrtarisht nga ky institucion amerikan, duke dëshmuar profesionalizmin dhe përgatitjen që ajo mori që nga ditët e para në UBT.

Sot, Teuta është pjesë e ekipit diplomatik të Ambasadës së Kosovës në ShBA, ku do të vazhdojë misionin e saj diplomatik për të përfaqësuar vendin me dinjitet, vizion dhe përkushtim.

Studentët e UBT-së, pjesë e rinisë në jurinë e Festivalit të Filmit në Venecia

Studentët tanë të talentuar të Arteve Dramatike – Aktrim në UBT, Çlirimtare Llumica dhe Kevin Kqira janë përzgjedhur për të qenë pjesë e jurisë studentore në edicionin e 9-të të Çmimit UNIMED, i cili zhvillohet në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Venecia 2025. Festivali i Filmit në Venecia është një nga festivalet më të vjetra dhe më prestigjioze të filmit në botë, pjesë e “Big Three” së bashku me Cannes dhe Berlinale. Ai mbahet çdo vit në qytetin magjepsës të Venecias, duke tërhequr aktorë, regjisorë dhe producentë nga e gjithë bota. Këtë vit, edicioni i 82-të do të mbahet nga 27 gusht deri më 6 shtator 2025, dhe do të shfaqë premierat e filmave më të rëndësishëm ndërkombëtarë.

Pjesëmarrja e Çlirimtares dhe Kevinit është një arritje e madhe jo vetëm për ta personalisht, por edhe një dëshmi e nivelit profesional dhe ndërkombëtar



të programit Arte Dramatike – Aktrim në UBT, i cili përgatit artistë të rinj për skenën kombëtare dhe ndërkombëtare. Çmimi UNIMED u jepet filmave që trajtojnë tema të dialogut ndërkulturor, tolerancës, diversitetit dhe integritetit vlera që ne i promovojmë fuqishëm edhe në edukimin artistik të studentëve tanë. Juria, e përbërë nga studentë të univer-

siteteve anëtare të UNIMED, ka privilegjin dhe përgjegjësinë të shikojë filmat në garë dhe të vendosë fituesin e këtij çmimi të rëndësishëm.

Nëse dëshiron të studiosh aktrim në një ambient ku arti, pasioni dhe mundësitë ndërkombëtare bashkohen – aplikimet për vitin e ri akademik janë të hapura!

Studentja e Farmacisë, Vlera Lipa - Një histori suksesi që nis në UBT dhe vazhdon me shërbim cilësor shëndetësor



Vlera Lipa, ish-studente e Fakultetit të Farmacisë në UBT, ka hapur barnatoren “Lipa Pharm”. Rruga e saj nga studimet e deri te shërbimi shëndetësor është

dëshmi praktike e vizionit të UBT-së: formimi i kuadrove profesionale që jo vetëm punësohen, por edhe krijojnë vende të reja pune dhe përmirësojnë kujdesin shëndetësor për komunitetin. Aftësitë e fituara në lëndët e farmacisë klinike, teknologjisë farmaceutike, legjislacionit dhe menaxhimit të barnave i dhanë asaj bazën e nevojshme për të kuptuar të gjitha hallkat e zinxhirit të furnizimit dhe shërbimit farmaceutik. Praktikën profesionale, punët në laborator dhe angazhimet me partnerë të industrisë e ndihmuan që të transformonte njohuritë teorike në kompetenca të aplikuara. Përveç shërbimeve të përditshme, “Lipa Pharm” ka vendosur standarde në zbatimin e procedurave

të sigurisë, ruajtjes së medikamenteve dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë — elemente që pasqyrojnë qasjen profesionale që Vlera mori gjatë studimeve në UBT.

Historia e suksesit të Vlera Lipës dëshmon me fakte se modeli i UBT-së — i mbështetur te mësimdhënia praktike, bashkëpunimet me industrinë dhe fokusimi në zhvillimin e aftësive të duhura profesionale — prodhon jo vetëm farmacistë të kualifikuar, por edhe liderë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shëndetësor të komunitetit. Suksesi i Vlerës tregon se programet universitare mund të jenë katalizator për sipërmarrje, punësim dhe shërbim cilësor ndaj pacientit.

Legjendare Rizanaj, ish-studente e Shkencave Paramjekësore në UBT, tashmë pjesë e Spitalit Rajonal të Prizrenit

Legjendare Rizanaj, ish-studente e programit master Shkencat Paramjekësore në UBT, ka arritur të ndërtojë një karrierë të suksesshme në fushën e mjekësisë. Aktualisht, ajo është pjesë e stafit të Spitalit Rajonal të Prizrenit, në repartin e Kirurgjisë Maksilofaciale, ku ushtron profesionin në një nga sektorët më delikatë dhe më kërkuar të shëndetësisë. Ky sektor kërkon nivel të lartë profesionalizmi, përqendrim, shkathtësi dhe përgjegjësi të jashtëzakonshme, cilësi që Legjendare i ka dëshmuar në mënyrë

të shkëlqyer gjatë punës së saj. Përvoja praktike në sallën e operimit, e kombinuar me formimin akademik në UBT, i ka dhënë asaj bazën e fortë për të kontribuar në trajtimin dhe shpëtimin e jetëve. Ajo thekson se studimet në UBT, me laboratorë modernë, praktika klinike dhe mentorim nga profesorë ekspertë, kanë qenë vendimtare për zhvillimin e saj profesional. Sot, Legjendarja është një shembull frymëzues i mënyrës se si arsimit cilësor hap dyert drejt karrierës së sigurt dhe të suksesshme.



Studentët e Arkitekturës së UBT-së realizuan praktikë profesionale në Kampin Bondsteel

Studentët e vitit të tretë në programin Bachelor në Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, dega Ferizaj, në UBT, Lorik Selimi dhe Altin Callaku, përfunduan me sukses një praktikë profesionale tremujore Kampin Bondsteel, një prej bazave më të mëdha të Ushtrisë Amerikane në rajon.

Praktika u realizua në bashkëpunim me kompaninë ndërkombëtare Kellogg Brown and Root (KBR), e cila është e specializuar në menaxhimin e projekteve inxhinierike dhe infrastrukturore në nivel global.

Përvojë unike me standarde ndërkombëtare

Gjatë kësaj praktike, studentët patën mundësinë të aplikojnë në mënyrë praktike njohuritë e fituara gjatë studimeve në Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, duke u përfshirë drejtpërdrejt në proceset e mirëmbajtjes, menaxhimit dhe operimit të infrastrukturës në një ambient ndërkombëtar dhe kompleks si Bondsteel.

Ata morën pjesë në: Inspektimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të infrastrukturës dhe objekteve; Ndihmën në riparime teknike dhe ndërhyrje emergjente; Bashkëpunimin me ekipet teknike



dhe respektimin rigoroz të protokolleve të sigurisë në punë; Përdorimin e pajisjeve moderne dhe mjeteve të mirëmbajtjes sipas standardeve KBR.

Kjo eksperiencë u mundësoi studentëve të përfitojnë njohuri të reja në lidhje me menaxhimin teknik-operativ të infrastrukturës, si dhe të kuptojnë nga afër funksionimin e një kampi ndërkombëtar me standarde të larta.

Fakulteti i Arkitekturës në UBT – ura drejt tregut të punës

Ky bashkëpunim është një dëshmi e qartë e qasjes praktike dhe profesionale që UBT i ofron studentëve të saj, duke i përgatitur jo vetëm teorikisht, por edhe

praktikisht për tregun e punës. Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT është i njohur për orientimin e tij drejt praktikës, inovacionit dhe mundësive ndërkombëtare, duke i pajisur studentët me aftësi që janë të kërkuara në sektorin privat dhe publik, brenda dhe jashtë Kosovës.

Në përfundim të praktikës, studentët Lorik Selimi dhe Altin Callaku falënderuan kompaninë KBR për mikpritjen dhe përvojën e vlefshme, si dhe UBT-në që iu mundësoi këtë rrugë drejt një eksperiencë unike me standarde ndërkombëtare.

Dy çmime për studentët e UBT-së në Konventën e Industrisë së Drurit



Studentët e UBT-së kanë shënuar një sukses të jashtëzakonshëm në garën studentore të dizajnit, të zhvilluar në kuadër të Konventës së 8-të të Industrisë së Drurit, një prej ngjarjeve më të rëndësishme për sektorin e përpunimit të drurit në Kosovë. Konventa, e organizuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës, mbledhi profesionistë, ekspertë dhe studentë nga e gjithë vendi, duke krijuar një platformë të rëndësishme për prezantimin e ideve dhe inovacioneve në industrinë e drurit.

Në këtë aktivitet, të dy çmimet kryesore u fituan nga studentët e UBT-së: vendi i dytë u fitua nga Berna Salihu dhe vendi i tretë nga Diona Ukaj. Të dy projektet u vlerësuan për kreativitetin, funksionalitetin dhe elegancën e dizajnit, duke reflektuar përgatitjen profesionale dhe qasjen moderne të studentëve në këtë fushë.

Në këtë konferencë mori pjesë edhe Dekania e Fakultetit të Artit dhe Dizajnit në UBT, Ariana Gjoni, e cila përfaqësoi institucionin në emër të Rektorit të UBT-së. Ajo theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet industrisë dhe institucioneve akademike, si dy shtylla kyçe për zhvillimin e sektorit të drurit dhe të dizajnit në Kosovë.

UBT ka ndërtuar ndër vite një model unik bashkëpunimi me industrinë e drurit, prodhimit dhe dizajnit. Institucioni beson se universiteti duhet të jetë i lidhur ngushtë me ekonominë reale, të prodhojë dije praktike dhe të kontribuojë në modernizimin e industrisë. Si rezultat, çdo vit më shumë se 90% e studentëve të UBT-së punësohen në këtë sektor, shpesh para diplomimit.

Suksesi i Bernës dhe Diona Ukajt përbën një dëshmi të talentit, përkushtimit dhe nivelit të lartë të përgatitjes së studentëve të UBT-së. Institucioni shpreh krenarinë për këtë arritje dhe riafirmton angazhimin për t'i mbështetur studentët në rrugëtimin e tyre akademik dhe profesional.

Nga UBT në Itali: Një rrugëtim sukcesi akademik i studentes së Arkitekturës, Sümeyye Toska

Sümeyye Toska, ish-studente e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, sot po ndjek studimet Master of Science in Architecture – Built Environment and Heritage në Politecnico di Milano, një nga universitetet më prestigjioze në Evropë.

Gjatë procesit të aplikimit për master, Sümeyye është pranuar në disa universitete të njohura evropiane, përfshirë Universitetin e Firences (Università degli Studi di Firenze) — një dëshmi e qartë e cilësisë së përgatitjes që ajo mori në UBT.

“Kjo për mua ishte një dëshmi e fortë e bazës akademike që ndërtova në UBT – një përgatitje që më ka bërë konkurrese në çdo nivel ndërkombëtar. Sot, në Politecnico di Milano, e ndjej plotësisht vlerën e formimit që më ka dhënë UBT, që më bën të përballoj me sukses çdo sfidë akademike”, shprehet Sümeyye Toska.

Ajo thekson se sukcesi i saj është fryt i përkushtimit dhe profesionalizmit të profesorëve të UBT-së, të cilët krijojnë



një ambient të dijes që përgatit studentët jo vetëm për tregun vendor, por edhe për atë ndërkombëtar.

Sot, në kuadër të Built Heritage Design Studio në Politecnico di Milano, Sümeyye vazhdon të zhvillojë punë praktike e kërkimore, duke përfaqësuar me krenari UBT-në në arenën akademike evropiane.

“Jam me të vërtetë krenare që përfaqësoj UBT-në në një universitet si Politecnico di Milano, duke treguar se cilësia që kultivohet në UBT është në nivelin më të lartë evropian”.

Studentët e UBT-së përfundojnë praktikën profesionale në Coca-Cola HBC Kosova

Studentët e UBT-së kanë përfunduar me sukses praktikën profesionale në kompaninë prestigjioze Coca-Cola HBC Kosova.

Gjatë kësaj periudhe, studentët kanë pasur mundësinë të punojnë në një ambient profesional, duke përfituar njohuri praktike, përvojë reale në industri dhe aftësi që i përgatisin drejtpërdrejt për tregun e punës. Kjo eksperiencë ka qenë një kombinim i mësimin inovativ të fituar në UBT dhe praktikës dinamike në një kompani lidere globale.

Ky sukses është rezultat i bashkëpunimit strategjik dhe të qëndrueshëm mes UBT-së dhe Coca-Cola HBC Kosova, që synon të forcojë lidhjen mes edukimit dhe tregut të punës. Falë këtij partneriteti, studentët e UBT-së përfitojnë qasje në praktika cilësore, mentorim profesional dhe mundësi punësimi të garantuar.

Studentët e UBT-së sjellin ide për projekte të reja në sektorin e agroturizmit



Studentët e programit master “Planifikim Urban dhe Zhvillim i Qëndrueshëm” në UBT realizuan një vizitë të veçantë studimore në kompleksin Lura Agroturizëm në Novobërd, duke eksploruar rolin dhe potencialin e agroturizmit në zhvillimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë rurale.

Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të lëndës “Periferia Urbane dhe Zonat Rurale si Ekosisteme Ekonomike”, një platformë që i frymëzon studentët të lidhin teorinë me praktikën përmes shembujve konkretë.

Të mirëpritur nga pronari, Gani Buca,

dhe drejtori, Genc Buca – një ish-student i UBT-së, studentët u njohën me historinë, aktivitetet dhe filozofinë e këtij kompleksi agroturistik. Me pasion dhe profesionalizëm, ata ndanë përvojën e tyre mbi menaxhimin e një biznesi të tillë inovativ dhe ndikimin e tij në komunitetin lokal.

Gjatë vizitës, studentët patën mundësinë të shohin nga afër proceset e prodhimit dhe përpunimit të lëndëve të para ushqimore, përgatitjen e ushqimeve tradicionale, si dhe të eksplorojnë galerinë e kompleksit, shtëpitë për mysafirë dhe terrenet sportive.

Ky kompleks ilustron në mënyrë të përkryer se si një biznes rural mund të ndërthurë traditën dhe inovacionin për të krijuar një ekosistem ekonomik të qëndrueshëm.

Një moment i veçantë ishte theksimi i përfshirjes së prodhuesve lokalë në këtë iniciativë, duke u treguar studentëve se si agroturizmi mund të jetë një motor zhvillimi për komunitetin përreth. Për më tepër, studentët realizuan një shëtitje studimore në zonë për të identifikuar mundësi të reja për zhvillimin e agroturizmit dhe për të dhënë rekomandime konkrete për projekte të ardhshme.

Përmes këtyre përvojave, studentët jo vetëm që fitojnë kompetenca dhe aftësi të avancuara, por gjithashtu bëhen pjesë aktive e ndryshimeve pozitive në komunitet. Agroturizmi, si një sektor që mbart potencial të madh për zhvillimin ekonomik të Kosovës, paraqet një fushë të rëndësishme ku studentët e UBT-së do të kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhme më të gjelbër, më të qëndrueshme dhe më të prosperuar për vendin.

Studenti Ledian Shala fiton Çmimin e Tretë në “Singapore International Music Competition”

Studenti i Fakultetit të Arteve në UBT, Ledian Shala, ka shënuar një arritje të madhe ndërkombëtare duke fituar Çmimin e Tretë në “4th Singapore International Music Competition” Kategoria F.

Ky vlerësim prestigjioz dëshmon për talentin, përkushtimin dhe profesionalizmin e tij të jashtëzakonshëm në fushën e muzikës. Arritjet e shumta të kësaj vere e bëjnë Ledionin një shembull

frymëzues të studentëve që përfaqësojnë me dinjitet UBT-në në arenën ndërkombëtare.

Një rol të rëndësishëm në këtë sukses ka dhënë edhe prof. Klevis Gjergji, përmes mbështetjes së vazhdueshme dhe punës së tij të përkushtuar në formimin artistik të studentëve dhe në përfaqësimin dinjitoz të UBT-së në arenën botërore të muzikës. Ky sukses tregon nivelin e lartë të përgatitjes artistike që ofron



Fakulteti i Arteve në UBT dhe përkushtimin për të zhvilluar gjenerata të reja krijuesish dhe interpretuesish që spikasin në skenat ndërkombëtare.

Rruga drejt suksesit profesional – Studentja e Fakultetit të Psikologjisë, Zhaneta Shatri bëhet pjesë e klinikës “Reze Dielli”



Zhaneta Shatri, studente e psikologjisë në UBT, po dëshmon se pasioni dhe përkushtimi ndaj profesionit shpërblehet. Ajo tashmë është angazhuar në Klinikën “Reze Dielli”, ku punon me fëmijët me çrregullime neurozhvillimore, duke treguar profesionalizëm, empati dhe përkushtim në punën terapeutike.

Përmes këtij angazhimi, Zhaneta po dëshmon se si një studente e motivuar

mund të shndërrohet shpejt në një profesioniste të rëndësishme në fushën e psikologjisë.

Suksesi i Zhanetës është një shembull i qartë i ndikimit që UBT ka në formimin e profesionistëve të rinj. Në këtë rrugëtim, rol të veçantë ka Qendra e Karrierës në UBT, e cila vazhdimisht kujdeset që studentët të jenë të përgatitur dhe konkurrues në tregun e punës.

Nga UBT në Itali – Rrugëtimi frymëzues i studentes së Shkencave të Ushqimit në UBT, Anisa Krasniqi



Ish-studentja e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, Anisa Krasniqi ka realizuar një rrugëtim të veçantë në fushën e hulumtimeve shkencore. Pas përfundimit të studimeve bachelor në UBT, ajo ka vazhduar studimet master në Universitetin e Firences, ku është angazhuar në studimin “Chronotype-adapted Diet and Weight Loss” në Spitalin Poliklinik Italian më të madhin në Firenze, Azienda Ospedaliero-Universitaria Careggi, në bashkëpunim me Universitetin e Firences. Në këtë studim, Anisa ka pasur një rol kyç si nutricioniste dhe hulumtuuese,

duke mbikëqyrur dhe ndihmuar në studimin e 142 pacientëve me mbipeshë dhe obezitet, duke përdorur një dietë të personalizuar bazuar në kronotipin e tyre.

“Fushat e shkencës dhe kërkimit janë një udhëtim i pafund, dhe unë jam e vendosur të kontribuoj me dijen dhe pasionin tim për të krijuar ndryshime pozitive. Studimet dhe përpjekjet e mia janë ndihmuar nga mundësitë që UBT më ka ofruar dhe nga përkushtimi ndaj zhvillimit të vazhdueshëm”, ka thënë Krasniqi.

Aktualisht, ajo është duke shkruar temën e diplomës, e cila është po ashtu e lidhur me këtë studim, duke u fokusuar në ndryshimet e mikrobiotës në varësi të kronotipit dhe rolin e mikrobiotës së shëndetshme në humbjen e peshës.

Me angazhimin dhe pasionin e saj për kërkimin shkencor, Anisa është një shembull i shkëlqyer i suksesit dhe i mundësive që ofron UBT për studentët e saj, duke i forcuar ata për një karrierë të suksesshme në fushën e shkencave dhe teknologjisë.

Florian Mehmeti, shembull i suksesit nga UBT drejt industrisë globale



Florian Mehmeti, student i Inxhinierisë Mekatronike në UBT, po dëshmon se angazhimi dhe vullneti për t'u zhvilluar profesionalisht hapin dyer të rëndësishme. Ai është i angazhuar në kompaninë Proton Group, ku kontribuon në projekte të fushës së IT-së, mirëmbajtjen e sistemeve dhe realizimin e proceseve teknologjike. Përveç angazhimit profesional, Floriani po merr pjesë edhe në konferenca ndërkombëtare, ku po pasuron njohuritë e tij, po njihet me praktikat më të mira globale dhe po ndërton lidhje me profesionistë nga fusha të ndryshme. Kjo dëshmon nivelin e lartë të përgatitjes dhe vlerave që ofron UBT. Qendra e Karrierës në UBT vazhdon t'i mbështesë studentët me mundësi punësimiti, praktika profesionale dhe pjesëmarrje në aktivitete të rëndësishme, brenda dhe jashtë vendit.

Florinda Kelmendi, ish-studente e UBT-së, shpërblehet për storie inovative në Mobile Journalism



Florinda Kelmendi, ish-studente e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në UBT, ka fituar vendin e dytë në një konkurrencë të nivelit të lartë për storie në mobile journalism, një format i ri dhe shumë i kërkuar i gazetarisë në Kosovë. Në këtë garë, që përfshinte gjithsej 67 storie të konkurrentëve të ndryshëm, historia e Florindës u shpërblye për cilësinë dhe kreativitetin e saj në përdorimin e teknologjisë për të krijuar lajme dhe histori të prekshme dhe të rëndësishme për audiencën.

Ky sukses tregon jo vetëm aftësitë e saj të shkëlqyera në fushën e gazetarisë, por edhe angazhimin e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit për të ofruar një edukim të nivelit të lartë, që për-

gatit studentët për sfidat e gazetarisë moderne dhe të teknologjisë. Mobile journalism është një fushë që ka fituar terren të gjerë, duke u mundësuar gazetarëve të krijojnë dhe shpërndajnë lajme me anë të telefonave celularë, duke e bërë gazetarinë më të shpejtë dhe më të aksesueshme për audiencat më të gjera.

Për Florindën, ky është një hap i rëndësishëm në karrierën e saj profesionale, duke e vendosur atë në qendër të zhvillimeve më të reja të gazetarisë digjitale. Ajo ka dëshmuar se ka aftësi për të kombinuar informacionin me teknologjinë, për të krijuar storie që jo vetëm informojnë, por edhe angazhojnë dhe prekin audiencën.

Nga UBT në Presidencën e Kosovës – Ish-studentja e Fakultetit Juridik, Lyra Begolli, punësohet në zyrën ligjore të Presidencës së Republikës së Kosovës



Lyra Begolli, ish-studente e Fakultetit Juridik në UBT, është punësuar në Zyrën Ligjore të Presidencës së Republikës së Kosovës. Ky sukses pasqyron përkushtimin e saj dhe bazën profesionale që ajo ndërtoi gjatë studimeve në UBT.

UBT vazhdon të jetë vendi ku studentët marrin dije praktike, mbështetje dhe mundësi të vërteta zhvillimi. Lyra është shembull i kësaj. Qendra e Karrierës në UBT vazhdon të luajë një rol kyç në lidhjen e studentëve me institucionet dhe organizatat, duke i mbështetur ata në zhvillimin e aftësive dhe ndërtimin e karrierës së tyre.

Nga UBT në Suedi – Erza Kaja dhe rrugëtimi i saj drejt dijes globale



Erza Kaja, studente e Gjuhës Angleze në UBT, ka përjetuar një eksperiencë të paharrueshme si exchange student në Linnaeus University në Suedi, e cila jo vetëm që e ka pasuruar akademikisht, por edhe i ka zgjeruar horizontet personale dhe kulturore.

Përmes kësaj eksperience, Erza pati mundësinë të takonte studentë nga e gjithë bota, duke mësuar rreth kulturave, traditave, muzikës dhe kuzhinës së vendeve të ndryshme. Ajo gjithashtu u bë pjesë e një organizate studentore që organizonte aktivitete të ndryshme sociale, si board game nights, climbing, kuize dhe movie nights, duke krijuar kështu miqësi të reja dhe kujtime të paharrueshme.

Përveç angazhimit akademik, Erza shfrytëzoi mundësinë për të eksploruar disa nga qytetet më të bukura të Evropës, si Oslo, Hamburg, Helsinki,

Copenhagen dhe rajonin magjik të Laplandit. Këto udhëtime e ndihmuan atë të zhvillojë një perspektivë ndërkom-bëtare dhe të njohë vende dhe kultura të reja nga afër.

Përveç dijes akademike dhe përvojës kulturore, Erza thotë se kjo përvojë e ndihmoi të njohë më shumë veten dhe të ndërtojë aftësi të rëndësishme personale. Ajo shpreh mirënjohje të veçantë për UBT-në, e cila i mundësoi këtë eksperiencë përmes bursës dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Eksperiencia të tilla janë dëshmi e përkushtimit të UBT-së për të përgatitur studentët e saj për një treg global, duke u mundësuar atyre të eksplorojnë botën, të mësojnë nga eksperiencat ndërkom-bëtare dhe të rriten profesionalisht e personalisht!

Studentja e UBT-së, Sumea Zogaj, në shkëmbim studentor në Technical University of Sofia përmes Erasmus +

Sumea Zogaj, studente e UBT-së, po përjeton një eksperiencë të jashtëzakonshme akademike dhe kulturore në kuadër të programit Erasmus+, duke ndjekur studimet e saj në Technical University of Sofia, Bullgari. Ky program i ka hapur dyer drejt një mjedisi ndërkombëtar, ku po zhvillon njohuritë dhe aftësitë e saj profesionale, duke u njohur nga afër me metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe teknologjitë më të avancuara në fushën e saj të studimit. Përmes këtij shkëmbimi,

Sumea ka mundësinë të bashkëpunojë me studentë dhe profesorë nga vende të ndryshme të Evropës, duke ndërtuar një rrjet të gjerë akademik dhe profesional. Eksperienca në Technical University of Sofia po i ofron asaj një perspektivë të re mbi studimet, duke e ndihmuar të thellojë njohuritë e saj dhe të përfitojë nga praktikat më të mira në një nga universitetet më prestigjioze në rajon.

Erasmus+ është një përvojë jetësore që ndihmon studentët të zhvillojnë



aftësitë ndërkulturore, të fitojnë paravarsi akademike dhe të eksplorojnë një mënyrë të re të menduarit. UBT vazhdon të ofrojë mundësi të shumta mobiliteti për studentët e saj, duke i përgatitur për një treg global pune dhe një karrierë të suksesshme ndërkombëtare.

Studentja e Shkencave Kompjuterike në UBT, Erijona Muji, ka nisur një eksperiencë profesionale në Fraunhofer Institute for Integrated Circuits



Studentja e Shkencave Kompjuterike në UBT, Erijona Muji, ka nisur një eksperiencë profesionale në Fraunhofer Institute for Integrated Circuits (IIS) në Erlangen, Gjermani.

Erijona është angazhuar në HF and Communication Systems Department, duke punuar në ekipin e GUI për sistemet e integruara dhe kontribuon në zhvillimin e ndërfaqes grafike të përdoruesit për një projekt kërkimor mbi komunikimin

dhe teknologjitë e frekuencave të larta. Roli i saj përfshin zhvillimin e komponentëve front-end dhe përmirësimin e përdorshmërisë së aplikacionit, në bashkëpunim të ngushtë me inxhinierë ndërkombëtar për një ndërfaqe funksionale dhe efikase. Përkushtimi dhe profesionalizmi i Erijonës dëshmojnë aftësitë e saj dhe cilësinë e arsimit në UBT në nivel ndërkombëtar.

Nga UBT drejt industrisë së IT-së: Anita Maloku nis karrierën si Front-End Developer

Studentja e Shkencave Kompjuterike në UBT, Anita Maloku, ka hapur një kapitull të ri në karrierën e saj profesionale duke u bërë pjesë e ekipit të Link Plus IT si Front-End Developer. Ky sukses vjen si rezultat i përkushtimit të saj të palodhur, motivimit dhe njohurive të fituara gjatë studimeve në UBT, të cilat e kanë përgatitur për sfidat e tregut modern të teknologjisë.

Qendra e Karrierës në UBT ka luajtur një rol kyç në këtë rrugëtim, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për Anita

dhe studentë të tjerë, përfshirë këshillime profesionale, ndihmë në përgatitjen e CV-së dhe përgatitje për intervistat e punës.

Përmes këtij shembulli, UBT demonstroi se programet e saj të Shkencave Kompjuterike dhe inxhinierisë jo vetëm që ofrojnë dije teorike, por edhe aftësi praktike që e vendosin studentin direkt në rrugën e karrierës në industri konkurruese si IT.

Ky rast është një shembull i qartë i rolit të UBT-së në lidhjen e arsimit me tre-



gun e punës, duke siguruar që studentët e saj të jenë të përgatitur, të aftë dhe të kërkuar nga kompanitë lider në vend dhe në rajon.

Studenti i Shkencave Politike në UBT, Adnan Seferi angazhohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës

Adnan Seferi, student i Shkencave Politike në UBT, po dëshmon se përkushtimi akademik hap rrugë të rëndësishme profesionale. Ai tashmë është angazhuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, në Departamentin për Çështje Konsullore, ku kontribuon në proceset diplomatike, komunikimin institucional dhe bashkëpunimin me misionet diplomatike.



Përmes këtij angazhimi, Adnani po fiton përvojë të vlefshme në diplomaci dhe po shndërrohet në një profil premtues të administratës shtetërore. Qendra e Karrierës në UBT u ofron studentëve mbështetje profesionale, mundësi praktike dhe kontakt direkt me institucione, duke i ndihmuar të zhvillohen dhe të jenë të përgatitur për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit.

UBT forcon partneritetet globale përmes bashkëpunimit me Universitetin Muş Alparslan nga Turqia

UBT ka mirëpritur delegacionin nga Universiteti Muş Alparslan i Turqisë, të udhëhequr nga Rektori Prof. Dr. Mustafa Aliçan, në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik në Lipjan, në kuadër të një vizite zyrtare që shënoi një hap të rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit akademik ndërkombëtar.

Gjatë takimit, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, duke hapur rrugë për projekte të përbashkëta shkencore, shkëmbim të stafit akademik dhe administrativ, mobilitet të studentëve, organizim të konferencave dhe simpoziumeve, si dhe iniciativa të për-



bashkëta në fushën e inovacionit dhe teknologjisë.

Në këtë takim morën pjesë figura kyçe nga të dy universitetet. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, delegacioni turk

vizitoi ambientet e Parkut Shkencor, duke u njohur nga afër me laboratorët, hapësirat e inovacionit dhe kapacitetet teknologjike që UBT ofron për studentët dhe studiuesit e tij.

UBT dhe OIRK forcojnë bashkëpunimin në fushën e inxhinierisë ndërtimore



Në një hap të rëndësishëm drejt avancimit të bashkëpunimit ndërmjet akademisë dhe profesionit, Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës në UBT dhe Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit në fushën e inxhinierisë ndërtimore dhe zhvillimit profesional të studentëve dhe inxhinierëve të rinj.

Marrëveshja u firmos nga Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës në UBT, Prof. Dr.

Visar Krelani dhe Kryetari i OIRK-së, Ing. Dpl. Arsim Rapuca, në praninë e Drejtorit Ekzekutiv të OIRK-së, përfaqësuesve të stafit akademik të UBT-së si dhe përfaqësuesve institucionalë. Pikat kyçe të bashkëpunimit përfshijnë: Ofrimin e praktikave profesionale dhe mentorimit për studentët e sapodiplomuar të INI – UBT; Organizimin e trajnimeve, seminareve dhe ligjëratave të përbashkëta, me qëllim të rritjes së kapaciteteve profesionale; Edukimin e vazhdueshëm profesional, si për inxhinierët aktualë, ashtu edhe për gjeneratat e reja që synojnë të ndjekin

këtë profesion; Pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin në projekte kërkimore dhe zhvillimore që ndërlidhen me fushën e inxhinierisë ndërtimore; Kontribut të përbashkët në përmirësimin e kurrikulave akademike dhe politikave profesionale, me qëllim që ato të reflektojnë nevojat reale të tregut të punës.

Ky partneritet strategjik vjen si rezultat i përkushtimit të UBT-së për të ndërtuar ura bashkëpunimi me institucionet profesionale të vendit, duke e vënë studentin dhe përgatitjen e tij praktike në qendër të misionit akademik.

Me këtë marrëveshje, Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës në UBT konfirmon edhe një herë rolin e tij lider në përgatitjen e inxhinierëve të aftë për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës dhe ndërtimtarisë në Kosovë dhe më gjerë.

Bashkëpunimi mes OIRK-së dhe UBT-së është dëshmi e përkushtimit të përbashkët për cilësi, profesionalizëm dhe inovacion në sektorin e inxhinierisë.

UBT zgjeron rrjetin ndërkombëtar: Partneritet i ri me Fakultetin e Arteve Grafike të Universitetit të Zagrebit

UBT ka bërë një tjetër hap të rëndësishëm në drejtim të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë, duke formalizuar një marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Arteve Grafike të Universitetit të Zagrebit, një nga institucionet më të njohura akademike në Kroaci në fushën e artit dhe dizajnit.

Kjo marrëveshje hap horizonte të reja për bashkëpunim ndërinstitucional në fusha kyçe si shkëmbimi i studentëve dhe stafit akademik e administrativ, zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore dhe inovative, si dhe organizimi i ngjarjeve të përbashkëta shkencore, artistike

dhe kulturore. Ky bashkëpunim vjen si pjesë e vizionit të UBT-së për të ndërtuar ura të qëndrueshme me institucionet më të mira arsimore në Evropë, duke krijuar një platformë të përbashkët për avancimin e dijes, inovacionit dhe krijimtarisë.

UBT zgjeron bashkëpunimin ndërkombëtar me Universitetin Ondokuz Mayıs në Turqi

Gjatë kësaj jave, një delegacion nga UBT po qëndron në Universitetin Ondokuz Mayıs në Samsun të Turqisë, në kuadër të programit Erasmus+ Mobility.

Delegacioni i UBT-së përbëhet nga: Prof. Dr. Agron Thaqi – Dekan i Fakultetit të Shkencave të Sportit; Prof. Dr. Cengiz Çesko – Drejtor i Institutit të Forenzikës; Skender Ramadani – Përfaqësues i Zyrës së Studentëve; Bahti Sadiku – Menaxher.

Gjatë kësaj vizite, janë zhvilluar një sërë takimesh dhe aktiviteteve akademike e institucionale të rëndësishme, të cilat kanë rezultuar me nënshkrimin e marrëveshjeve bashkëpunimi në disa fusha: Në fushën e Shkencave të Sportit – Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet dekanit të Fakultetit të Shkencave të Sportit në UBT, Prof. Dr. Agron Thaqi dhe homologut të tij nga Universiteti Ondokuz Mayıs, Prof. Dr. Murat Eliöz. Në fushën e Forenzikës – Prof. Dr. Cengiz Çesko realizoi një takim zyrtar me Prof. Dr. Yildiray Topçu dhe Prof. Dr.



İslam Saruhan nga Departamenti i Forenzikës në Ondokuz Mayıs, me qëllim zhvillimin e projekteve të përbashkëta akademike dhe shkencore mes dy institucioneve.

Gjithashtu, Skender Ramadani dhe Bahti Sadiku zhvilluan takime të frytshme me përfaqësues të administratës së universitetit nikoqir për bashkëpunime të ardhshme ndërinstitucionale. Në përfundim të vizitës,

delegacioni i UBT-së u prit në një takim protokollar nga Pro-Rektorja e Universitetit Ondokuz Mayıs, Prof. Dr. Ayşe Pınar Sümer, e cila shprehu përkrahjen për thellimin e marrëdhënieve mes dy universiteteve.

UBT vazhdon të forcojë pozicionin e vet si lider në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë, duke ndërtuar ura të qëndrueshme bashkëpunimi akademik në skenën ndërkombëtare.

Nga Kosova në Valencia: Ekspertiza e UBT-së në fokusin e Evropës shkencore



Profesorët e UBT-së, Prof. Dr. Visar Hoxha dhe Prof. Dr. Fisnik Laha, realizuan një vizitë zyrtare në kuadër të programit Erasmus+ në Universitetin Politeknik të Valencias (UPV) dhe në Instituto Universitario de Investigación – ICITECH.

Prof. Dr. Visar Hoxha zhvilloi sesione strategjike me studiues të UPV-së për thellimin e bashkëpunimit në kërkime eksperimentale mbi përdorimin e mbetjeve organike me aciditet të lartë, me qëllim rritjen e efikasitetit energjetik të tullave dhe materialeve ndërtimore, duke përdorur modelimin parashikues me inteligjencë artificiale.

Prof. Dr. Fisnik Laha zhvilloi diskutime shkencore mbi mbrojtjen kundër korrozionit të materialeve ndërtimore nga kloruret, një fushë kritike për ndërtimet në mjedise me përmbajtje të lartë kripërash dhe në zona

bregdetare. Gjatë vizitës, u realizuan gjithashtu takime me doktorantë nga Universiteti i Pekinit, i renditur i 14-ti në botë sipas renditjes prestigjioze QS World University Rankings, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor.

Një nder dhe kënaqësi e veçantë për profesorët e UBT-së ishte të dëgjonin nga stafi akademik i Universitetit Politeknik të Valencias vlerësimet maksimale për dy studentët e UBT-së, Diellza Vishi dhe Leart Shabani, të cilët kanë shënuar rezultate të shkëlqyera gjatë mobilitetit të tyre.

UBT po thellon partneritetet akademike dhe kërkimore me universitetet më të njohura në botë, në funksion të zhvillimit shkencor dhe inovacionit në Kosovë dhe më gjerë.

UBT forcon bashkëpunimin ndërkombëtar me një nga universitetet më prestigjioze në Greqi – University of Thessaly

Në kuadër të angazhimeve të vazhdueshme për të ndërtuar ura bashkëpunimi me institucione të rëndësishme akademike në Evropë, UBT ka nënshkruar një marrëveshje me University of Thessaly në Greqi, një universitet me reputacion të lartë ndërkombëtar në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Kjo marrëveshje vendos bazat për një partneritet të thellë akademik dhe shkencor, duke përfshirë: shkëmbimin e studentëve, mobilitetin e stafit akademik, zhvillimin e përbashkët të projekteve kërkimore, mentorimin e përbashkët të disertacioneve doktorale, si dhe organizimin e praktikave profesionale dhe trajnimeve për studentët afër përfundimit të studimeve. Një nga pikat më të rëndësishme të këtij bashkëpunimi është mundësia për zhvillimin e programeve të përbashkëta ndërkombëtare të studimit, duke i ofruar studentëve një avantazh të qartë në skenën globale të arsimit dhe punësimit.

Me këtë marrëveshje, UBT thellon angazhimin e tij për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe afirmon pozicionin e tij si një aktor aktiv në rrjetet evropiane të bashkëpunimit akademik dhe shkencor.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me North South University të Bangladeshit, për thellimin e shkëmbimit akademik dhe kërkimit shkencor ndërkombëtar

Në një hap tjetër drejt zgjerimit të ndikimit të tij global, UBT ka lidhur një partneritet strategjik me North South University (NSU) – universitetin më prestigjioz në Bangladesh, duke krijuar kështu një urë të re bashkëpunimi akademik midis Kosovës dhe Azisë Jugore. Kjo marrëveshje bashkëpunimi vendos bazat për një partneritet të qëndrueshëm në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, duke synuar të forcojë lidhjet akademike mes dy universiteteve dhe të krijojë mundësi konkrete për zhvillim të përbashkët.

Marrëveshja përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh bashkëpunimi, si:

- Zhvillimi i hulumtimeve të përbashkëta shkencore në fusha me interes të ndërsjellë;
- Shkëmbimi i stafit akademik, studuesve dhe studentëve në nivelin universitar dhe pasuniversitar;
- Pjesëmarrje e përbashkët në konferenca, seminare dhe simpoziume ndërkombëtare;
- Mentorimi i përbashkët i studentëve të doktoratës dhe projekteve kërkimi



more të avancuara;

- Publikime të përbashkëta akademike dhe shkencore;
- Shkëmbim të materialeve mësimore dhe informacionit shkencor, si dhe
- Mundësinë për zhvillim të programeve të përbashkëta studimore ndërkombëtare në të ardhmen.

Përmes kësaj marrëveshjeje, të dy institucionet zotohen të bashkëpunojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e vendeve përkatëse, duke ndërtuar një model bashkëpunimi të bazuar në reciprocitet dhe barazi.

Ky partneritet vjen si pjesë e një strate-

gjie më të gjerë të UBT-së për zgjerimin e bashkëpunimeve me universitete të njohura ndërkombëtare, duke ndjekur suksese të mëparshme si marrëveshja e nënshkruar me University of Thessaly në Greqi. Këto iniciativa i ofrojnë studentëve dhe stafit akademik të UBT-së qasje në rrjete globale, rritje të kapaciteteve kërkimore dhe mundësi të reja për zhvillim profesional dhe akademik. Përmes këtyre marrëveshjeve, UBT afirmon rolin e tij si lider në arsimin e lartë në rajon dhe një partner serioz në bashkëpunimet akademike ndërkombëtare.

Prof. Sokol Loci përfaqëson UBT-në në “International Staff Week” në Bukuresht

Prof. Sokol Loci, pjesë e Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare në UBT, mori pjesë në aktivitetin “International Staff Week”, të organizuar nga Romanian-American University në Bukuresht, Rumani, në kuadër të programit Erasmus+.

Gjatë kësaj vizite, Prof. Loci mbajti një ligjëratë me temën “Preparing Students for an Intercultural Environment”, ku trajtoi çështje të rëndësishme si stereotipet dhe paragjykimet ndërkulturore. Ai zhvilloi gjithashtu takime me përfaqësues të universiteteve nga Evropa, SHBA-ja, Azia dhe Afrika, me të cilët u dakordua për iniciimin e bashkëpunimeve të reja akademike. Kjo pjesëmarrje forcon më tej angazhimin e UBT-së për ndërkombëtarizim dhe krijimin e mundësive të reja për studentët dhe stafin akademik, në një kontekst global dhe bashkëpunues.

UBT nënshkruan një marrëveshje të rëndësishme me Nova University



Edhe një lajm i shkëlqyer nga Lisbona. UBT ka nënshkruar një marrëveshje të rëndësishme me Nova University, respektivisht kampusin më të madh të teknologjisë në Portugali!

Marrëveshja u nënshkrua në hapësirat e UNINOVA e para në renditjen e menaxhimit të fondeve për projektet H2025 të Kërkimit dhe Zhvillimit.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Dekani i NOVA School of Science and Technology, Prof. Dr. Jose Julio Alferes dhe në prani të Drejtorit të Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë, Prof. Dr. Ricardo Jardim-Gonçalves, firmosën marrëveshjen e bashkëpun-

imit që përqendrohet në fusha të rëndësishme si kërkimi shkencor, zhvillimi teknik, trajnimi i avancuar dhe partneritetit për qasje në fondet e BE-së për arsimin e lartë, me theks projektet Smart4Health dhe Digital Health.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të hapë mundësi të reja për studentët tanë dhe do të forcojë edhe më tutje lidhjet tona ndërkombëtare.

Jemi të emocionuar për këtë hap përpara në rrugën drejt ekselencës dhe inovacionit. Rektori Hajrizi uron të gjithë stafin akademik dhe studentët e UBT për këtë arritje.

UBT dhe CCHBC Kosova një model bashkëpunimi për zhvillimin e talentëve të rinj

Për vitin e dytë radhazi, UBT vazhdon partneritetin e suksesshëm me CCHBC Kosova, duke mundësuar realizimin e programit Summership, një mundësi e artë për studentët tanë që synojnë të fitojnë përvojë praktike në një mjedis profesional dhe dinamik.

Këtë vit, rreth 10 studentë nga UBT do të ndjekin një program të strukturuar praktik në departamentet e shitjes dhe marketingut, si dhe do të marrin pjesë në sesione edukative në fushat e logjistikës, CAS-it dhe People & Culture.

Gjatë ditës së parë, praktikantët u pritën nga Capability Lead në CCHBC Kosova dhe u njohën më afër me portofolin e produkteve dhe vlerat që përfaqëson kompania.

Në ditët në vijim, ata do të kalojnë kohën në terren duke u përfshirë në procese të ndryshme, si dhe duke eksploruar thellësisht funksionimin e kompanisë.

Ky bashkëpunim është një tjetër dëshmi e përkushtimit të UBT-së për të sjellë përvojë konkrete dhe të vlefshme



për studentët tanë, duke i përgatitur ata për tregun e punës në mënyrën më profesionale.

UBT sjell modelin e suksesshëm austriak të arsimit në turizëm: Dy diploma për studentët e Kosovës dhe rajonit



Turizmi është një sektor kyç për zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm të Kosovës, që kërkon profesionistë të përgatitur sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Për ta bërë këtë të mundur, UBT ka nënshkruar një marrëveshje për Diplomë të Dyfishtë (Double Degree) me IMC Krems – University of Applied Sciences në Austri, një nga modelet më të suksesshme evropiane në arsimin për turizëm. Në bazë të kësaj

marrëveshjeje, studentët e Turizmit në UBT do të studiojnë dy vite në Kosovë dhe vitin e fundit në Austri, duke u pajisur me dy diploma universitare – një nga UBT dhe një nga IMC Krems.

Marrëveshja u nënshkrua nga Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në Austri, ku ai u prit nga themeluesi dhe kryetari i bordit mbikëqyrës të IMC Krems, Heinz Boyer, drejtori ekzekutiv Udo Brändle, si dhe nga Iris Waringer,

drejtuese e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, dhe Chen Yang, përgjegjës për projektet ndërkombëtare.

“Ky bashkëpunim është dëshmi e orientimit ndërkombëtar të UBT-së dhe përkushtimit tonë për t’u ofruar studentëve mundësi unike që e rrisin cilësinë e studimeve dhe hapin dyert e karrierës ndërkombëtare”, tha Rektori Hajrizi.

Ky program Double Degree do të shndërrohet në një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të turizmit në Kosovë, duke përgatitur gjenerata të reja profesionistësh që do të kontribuojnë në promovimin e vendit si destinacion turistik dhe në rritjen e standardeve të industrisë së mikpritjes.

Austria konsiderohet si një ndër modele më të suksesshme në fushën e arsimit profesional për turizëm dhe hotelieri, duke ofruar një sistem shkolli të avancuar dhe të orientuar drejt praktikës.

UBT dhe Policia e Kosovës nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për forcimin e kapaciteteve në teknologji dhe siguri publike

Në një hap të rëndësishëm për avancimin e fushës së teknologjisë informative dhe komunikimit, UBT dhe Policia e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Ky partneritet ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe ofrimin e mundësive të reja për zhvillimin e burimeve njerëzore, arsimimin dhe trajnimin e specialistëve të Policisë në fushën e sigurisë publike dhe teknologjisë.

Marrëveshja u nënshkrua nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Kolonel Gazmend Hoxha, me

qëllim forcimin e bashkëpunimit akademik dhe praktik mes dy institucioneve.

Marrëveshja e arritur do të mundësojë zhvillimin e formave të reja të bashkëpunimit në fushat e arsimit, trajnimit profesional dhe përdorimit të teknologjive inovative, që janë thelbësore për të përmbushur kërkesat e sigurisë publike në një botë gjithnjë e më e digjitalizuar. Pjesë e këtij bashkëpunimi është gjithashtu ndihma për forcimin e kapaciteteve të Policisë për t’u përballur me sfidat e reja që paraqiten në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

UBT mbetet i angazhuar në zhvillimin



e vazhdueshëm të programeve akademike dhe përgatitjes së ekspertëve të nivelit të lartë, të gatshëm për t’u integruar në sektorët më të rëndësishëm të shoqërisë.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Euroaditiv për zhvillimin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës



Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT ka nënshkruar një marrëveshje të re bash-

këpunimi me kompaninë italiane Euroaditiv, e cila është përfaqësuese e aditivëve dhe shtesave mineralogjike në industrinë e ndërtimit.

Marrëveshja u nënshkrua nga Dekani i Fakultetit të Ndërtimitarisë, Prof. Visar Krelani, dhe Z. Elhami Rexhi, udhëheqës i kompanisë Euroaditiv, në praninë e koordinatorës së fakultetit, Blertë Retkoceri.

Ky bashkëpunim ka për qëllim forcimin e lidhjes mes akademisë dhe industrisë, duke krijuar mundësi të reja për studentët dhe stafin akademik

të fakultetit, si dhe duke ofruar qasje në pajisje të avancuara për testimin e materialeve të ndërtimit.

Po ashtu, kjo marrëveshje synon të ndihmojë studentët të fitojnë njohuri praktike në fushën e prodhimit të betonit dhe përbërësve të tij. UBT, si institucion lider në edukimin inxhinierik dhe inovacionin në ndërtimtarë, vazhdon të krijojë ura bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë, duke sjellë standarde të reja në industrinë e ndërtimit dhe infrastrukturës në Kosovë.


Profesori i UBT-së, Llokman Murtezani, publikon librin “Education as a Public Good, the Case of Kosovo and Education in North Macedonia as a Candidate for Membership of the EU”

Profesori i UBT-së, Dr. Llokman Murtezani, ka publikuar librin e tij më të ri me titull “Education as a Public Good, the Case of Kosovo and Education in North Macedonia as a Candidate for Membership of the EU”. Ky botim trajton çështjen e arsimit si një e mirë publike, duke analizuar rastin e Kosovës dhe sistemin arsimor në Maqedoninë e Veriut në kontekstin e integritit evropian.

Libri ofron një analizë të thellë mbi sfidat dhe mundësitë që paraqet arsi-

mi në këto dy vende, duke vënë theksin në reformat, politikat arsimore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin shoqëror e ekonomik. Ai është një kontribut i rëndësishëm për studiuesit, politikëbërësit dhe të gjithë ata që janë të interesuar në fushën e arsimit dhe integritit evropian.

Ky botim pasuron literaturën akademike dhe dëshmon përkushtimin e Dr. Murtezanit dhe UBT-së në promovimin e dijes dhe kërkimit shkencor.



UBT mirëpret profesorët nga Letonia

Dy profesorë nga Vidzeme University of Applied Sciences në Letoni, Prof. Dr. Ilgvars Abols dhe Prof. Dr. Iveta Druva-Druvaskalne, vizituan UBT-në në kuadër të programit Erasmus+, për të konkretizuar marrëveshjen mes dy institucioneve tona dhe për të eksploruar mundësi të reja bashkëpunimi, duke përfshirë edhe mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik.

Gjatë vizitës, ata zhvilluan takime me zyrtarët e Zyrës Ndërkombëtare të UBT-së, ku shfrytëzuan rastin për të diskutuar lidhur me bashkëpunimin akademik, projektet e mundshme të përbashkëta (capacity building) dhe aplikimet për fonde të reja në kuadër të Erasmus+/KA171. Gjithashtu, profesorët morën pjesë në një sesion informues për studentët e UBT-së mbi mundësitë e tyre për studime në Letoni, duke shfrytëzuar pikërisht marrëveshjen mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve. Profesorët vazhduan vizitën e tyre në UBT Dukagjini Center dhe u njohën nga afër me Qyte-



tin e Mençur të UBT-së në Lipjan, infrastrukturën moderne dhe mbështetjen që UBT u ofron të diplomuarve.

Një nga aktivitetet kryesore ishte tryeza e rrumbullakët me studentët dhe stafin akademik të programit të Turizmit, ku u diskutuan praktikat më të mira në turizëm dhe teknologjitë inovative në këtë fushë. Gjatë qëndrimit të tyre, profesorët eksploruan gjithashtu qytetin e Pejës, ku, në shoqërimin e Prof. Kushtrim Dreshaj, vizituan Muzeun e Qytetit, Rugovën dhe atraksionet e turizmit malor, si dhe zhvilluan takime

me partnerët e UBT-së në këtë sektor. Një nga takimet më domethënëse në Pejë ishte ai me kryetarin e komunës, z. Gazmend Muhaxheri, ku diskutuan mbi mundësitë e bashkëpunimit në çështjet që lidhen me zhvillimin e turizmit në qytetin e Pejës. Vizita përfundoi me një eksplorim të kryeqytetit, Prishtinës, duke shënuar kështu një tjetër hap të rëndësishëm në zgjerimin e partneriteteve të UBT-së me institucionet e arsimit të lartë nga arena ndërkombëtare dhe krijimin e mundësive të reja për studentët dhe stafin akademik.

Dr. Pashko Camaj dhuron librat e tij për bibliotekën e UBT-së

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, mirëpriti në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan sekretarin e Federatës Panshqiptare “Vatra”, Dr. Pashko Camaj, një figurë e shquar e diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjatë këtij takimi, Dr. Camaj dhuroi për bibliotekën e UBT-së disa kopje të librave të tij, “Porosia e kullës” dhe “Dreaming from the Trunk of an American Car”, të cilat sjellin një rrëfim të thellë mbi identitetin, rrugëtimin e di-

asporës dhe sfidat e integritimit në mjediset e reja.

Rektori Hajrizi shprehu mirënjohjen për këtë kontribut të vlefshëm dhe vlerësoi punën e palodhur të Dr. Camaj në ruajtjen e kulturës dhe identitetit shqiptar përmes angazhimit të tij akademik dhe intelektual. Ai theksoi se ky bashkëpunim është një shembull i shkëlqyer i lidhjeve të forta ndërmjet UBT-së dhe diasporës shqiptare, duke thelluar bashkëpunimin në fusha të ndryshme të dijes dhe kulturës.



Studentët e MBE-së në UBT me ligjëratë tematike për strategjitë praktike të “NeuroMarketingut”

Në kuadër të Modullit “Sjellja Konsumatore e Avancuar” të Prof. Rajan Arapi, studentët e nivelit master në programin Marketing dhe Shitje në UBT patën mundësinë të marrin pjesë në një ligjëratë tematike mbi temën “Psikologjia e Konsumatorit – NeuroMarketingu”. Në këtë ligjëratë, si guest speaker mori pjesë Fisnik Behxheti, ndërmarrës dhe themelues i disa prej bizneseve më të suksesshme në Kosovë. Ai ndau me studentët njohuri të thelluara mbi rëndësinë e analizës së sjelljes konsumatore dhe ndikimin e proceseve neuroshkencore në vendimmarrjen e konsumatorëve.

Behxheti theksoi se kuptimi i mekanizmave psikologjik dhe neuroshkencorë që ndodhin pas çdo vendimi të

konsumatorit është kyç për zhvillimin e fushatave të marketingut efektive dhe për krijimin e lidhjeve të qëndrueshme me konsumatorët.

Ky sesion i veçantë, që ndërthuri teorinë dhe praktikën, ofroi një mundësi të shkëlqyer për studentët për të mësuar dhe përvetësuar teknikat e avancuara të NeuroMarketingut, të cilat janë gjithnjë e më të rëndësishme në një treg konkurrues. Studentët morën perspektiva të reja mbi faktorët psikologjikë që formësojnë sjelljen e konsumatorëve dhe mësuan se si këto njohuri mund të përdoren për të optimizuar strategjitë e marketingut dhe rritur suksesin në biznes.

Pjesëmarrësit në këtë ligjëratë të veçantë, studentët e Fakultetit të Me-



naxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë, përfituan njohuri praktike të vlefshme nga eksperiencia e jashtëzakonshme e folësit dhe mund të aplikojnë këto njohuri në projektet e tyre të ardhshme profesionale.

Përgatitja profesionale e studentëve të kontabilitetit përmes aktiviteteve praktike në UBT

Në kuadër të ligjëratës në lëndën “Hyrje në Kontabilitet Financiar”, në kuadër të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, e udhëhequr nga ligjëruesja e lëndës Prof. Fidane Spahija Gjikolli, u zhvillua një aktivitet i veçantë që ofroi studentëve një mundësi të shkëlqyer për të lidhur teorinë me praktikën. Aktiviteti kishte si qëllim t’i ofronte studentëve një përvojë të thelluar dhe ndërvepruese, duke iu mundësuar atyre të kuptojnë më mirë proceset reale të kontabilitetit dhe të përgatiten për kërkesat e tregut të punës.

I ftuar në këtë aktivitet ishte Ismail Qemali, kontabilist i njohur i firmës “Kamila” në Prizren, i cili ndau me studentët përvojën e tij të pasur profesionale. Ai pati mundësinë të demonstrojë përdorimin e softuerit të

kontabilitetit Logo, një mjet i përdorur gjerësisht në industrinë e kontabilitetit, i cili mundëson një përpunim të shpejtë dhe efikas të të dhënave financiare. Softueri u shpjegua në detaje, duke i ndihmuar studentët të kuptojnë aplikimin praktik të njohurive teorike që ata kishin mësuar deri në atë pikë. Gjatë aktivitetit, u trajtuan disa tema kyçe për përgatitjen profesionale të studentëve, duke u ofruar shembuj praktikë të regjistrimeve kontabël, që ilustronin proceset reale të punës në një firmë. U theksua rëndësia e përgatitjes së pasqyrave financiare kryesore, ku proceset dhe teknikat e përdorura në hartimin e këtyre dokumenteve u shpjeguan në detaje, duke përfshirë analizën dhe interpretimin e të dhënave financiare.

Një tjetër element i rëndësishëm i

kësaj ligjërate ishte ndihma që u ofrua për studentët në lidhje me rëndësinë e ndërthurjes së teorisë me praktikën. Ky aktivitet ka për qëllim t’u ofrojë studentëve njohuri të vlefshme për kërkesat aktuale të tregut të punës, duke i aftësuar ata për t’u përballur me sfidat që mund të hasin gjatë angazhimeve të tyre profesionale në të ardhmen.

Ky aktivitet përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin profesional të studentëve të UBT-së dhe kontribuon në forcimin e lidhjeve mes njohurive teorike dhe aplikimit të tyre në botën reale të punës. Ndërthurja e këtyre dy elementeve është çelësi për të krijuar profesionistë të aftë dhe të gatshëm për të përballuar sfidat e sektorit të kontabilitetit.

30 vajza nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian fitojnë aftësi profesionale në teknologji nga UBT



Departamenti për Edukim dhe Zhvillim Profesional i UBT-së, në një ceremoni të organizuar me rastin e ndarjes së certifikatave për 30 vajza nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian, shënoi një moment të rëndësishëm për integrimin dhe avancimin e këtij grupi në fushën e teknologjisë dhe zhvillimit profesional. Ky trajnim nga UBT kishte për qëllim zhvillimin e aftësive të vajzave në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), duke ofruar njohuri të avancuara për përdorimin e mjeteve dhe aplikacioneve të rëndësishme si Microsoft Word, Excel, PowerPoint, si dhe teknika të tjera të nevojshme për punësim.

Në fjalën e tij, Rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë e këtij trajnimit për vajzat e komunitetit dhe i inkurajoi ato të vazhdojnë përpjekjet për t'u zhvilluar profesionalisht. Ai e shprehu gëzimin për mundësitë që ofrohen sot dhe i nxitë ato të shfrytëzojnë mundësitë e shumta që janë në dispozicion, duke u ndalur gjithashtu në rolin e rëndësishëm që edukimi ka për prosperitetin dhe zhvillimin e shoqërisë.

“Edukimi është parakusht për stabilitet dhe prosperitet, dhe këto mundësi janë aty, duhet vetëm të keni guximin dhe dëshirën për t'i shfrytëzuar”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Rektori Hajrizi gjithashtu theksoi se në UBT do të kontribuohet më shumë në zhvillimin e grupeve dhe grave në përgjithësi, duke ofruar mundësi për edukim dhe trajnim të mëtejshëm. Ai theksoi gjithashtu faktin se 50% e studentëve në UBT janë vajza, të cilat tashmë janë pjesë e programeve akademike dhe profesionale të universitetit. Ky fakt tregon

një ecure pozitive për gratë në arsim, duke pasqyruar përparimin e rëndësishëm që ka bërë UBT në përfshirjen e grave në fushat akademike.

“Mesazhi im, si dhe i UBT-së është që ta shfrytëzoni këtë mundësi dhe të angazhoheni në punë, pasi tani ka shumë mundësi financimi dhe grante për zhvillim në fushën e teknologjisë, një mundësi që duhet të përvetësohet dhe shfrytëzohet. Si UBT, ne mund të japim një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin tuaj profesional. Misioni ynë është të kontribuojmë për shoqërinë, dhe ndihma që ofrojmë për grupet që dëshirojnë të rriten dhe të avancojnë në profesionin e tyre është një kënaqësi e madhe për ne. UBT ka potencialin për të lidhur interesat e ndryshme, duke ofruar mundësi në edukim, arsimim, trajnime dhe bashkëpunime që mund të sjellin rezultate të shkëlqyera për të gjithë”, përfundoi rektori Hajrizi.

Profesor Besnik Skenderi, i cili ishte drejtues i projektit, foli për procesin e trajnimit, duke përmendur se ky ishte një hap i rëndësishëm për të gjithë pjesëmarrësit, duke përfshirë dhe mundësinë që pesë vajza nga komuniteti do të përfitojnë shkollim falas në një program të kualifikimit.

“Pesë vajza nga komuniteti do të përfitojnë shkollim falas në një program të kualifikimit të zhvilluesve të aplikacioneve, vlera e të cilit është 3000 euro për person dhe ofron mundësi të shkëlqyera për avancimin në karrierë. Po ashtu, një tjetër program trajnimit për shkencën e të dhënave do të ofrohet falas për vajza të tjera, si një mundësi për të zhvilluar aftësitë profesionale në një fushë të kërkuar”, u shpreh profesori Skenderi.

Fatlume Rexhepi, një nga vajzat që mori pjesë në këtë trajnim, e cila shprehu mirënjohjen për mundësinë që iu dha, tha se kjo ishte një mundësi e jashtëzakonshme për komunitetin e tyre, veçanërisht për ato që përballen me sfida të shumta. Ajo theksoi se trajnimet ishin shumë të dobishme dhe ndihmuan në zhvillimin e aftësive të nevojshme për tregun e punës, siç janë përgatitja e projekteve dhe prezantimeve, dhe se ky trajnim e ka lehtësuar punën për shumë vajza që tashmë punojnë në administratë dhe fusha të tjera.

Amanda Toska, Zyrtare e Lartë për Programin e Punësimit në VORAE, foli për rëndësinë e bashkëpunimit me UBT-në dhe për të ardhmen e këtij partneriteti. Ajo shprehu kënaqësinë e saj për këtë bashkëpunim të frytshëm dhe e vlerësoi si një mundësi të shkëlqyer për vajzat e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas për të avancuar në fushat e punës dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale. Toska përmendi se shumë nga vajzat tashmë po shfrytëzojnë aftësitë e fituara për të përpiluar projekte dhe prezantime në universitete dhe mjedise të tjera profesionale, një dëshmi e suksesit të këtij trajnimit.

Ky program i suksesshëm është një shembull i bashkëpunimit të frytshëm ndërmjet UBT-së dhe organizatave të tjera, që synon zhvillimin e aftësive profesionale të grupeve të marginalizuara dhe ofron mundësi reale për një të ardhme më të mirë për vajzat dhe gratë nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT zhvillojnë pjesën praktike të lëndës “Materialet në Arkitekturë”

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT kanë realizuar pjesën praktike të lëndës “Materialet në Arkitekturë”. Nën udhëheqjen e profesorëve Muhamet Ahmeti, Visar Krelani dhe Driton Kryeziu, si dhe me asistencën e teknikut Hajriz Mazreku, studentët patën mundësinë të zbatojnë në praktikë njohuritë teorike të përfituara gjatë leksioneve.

Kjo qasje praktike synon të rrisë aftësitë profesionale të studentëve duke u ofruar atyre përvoja të drejtpërdrejta me materialet dhe teknikat që përdoren në ndërtim dhe arkitekturë,



duke forcuar përgatitjen e tyre për tregun e punës.

UBT vazhdon të ofrojë një kombinim të shkëlqyer mes teorisë dhe praktikës

përmes stafit të kualifikuar dhe teknologjisë moderne, duke kontribuar në formimin e inxhinierëve të së ardhmes.

UBT merr pjesë në Kick-Off Meeting të projektit CORE-ED ACADEMY



Dekania e Fakultetit të Psikologjisë, Prof. Deniz Çelçima dhe Prodekania e Fakultetit të Juridikut, Prof. Egzona

Osmanaj, po përfaqësojnë UBT-në në ngjarjen e rëndësishme “Kick-Off Meeting” të projektit CORE-ED ACADEMY. Takimi po mbahet në Universitetin Luaras, në Tiranë.

Gjatë këtij takimi dyditor, partnerët e projektit po trajtojnë tema kyçe si prezantimi i qëllimeve dhe planit të punës së projektit.

Profesoresha Osmanaj dhe Çelçima, me përvojën e tyre të pasur akademike dhe përkushtimin profesional, do të kontribuojnë në diskutimet dhe planet

strategjike të projektit, duke prezantuar rolin dhe ekspertizën e UBT-së në zhvillimin e arsimit të lartë dhe inovacionit. Ky projekt synon të krijojë një akademi CORE-ED që përmirëson kompetencat dhe ndikimin në sektorin e drejtësisë për të rinjtë, duke u fokusuar në qasjet ndërdisiplinare dhe inovative.

Pjesëmarrja e UBT-së në këtë projekt dëshmon edhe njëherë angazhimin e tij për të qenë lider në arsimin e lartë dhe në avancimin e kërkimit shkencor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

UBT hap Festivalin e Fotografisë Digjitale: “Beyond the Lens: Stories Untold”



Në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së, u organizua për herë të parë Festivali i Fotografisë Digjitale me titullin “Beyond the Lens: Stories Untold”. Ky event, i organizuar nga Fakulteti i Arteve dhe Mediave Digjitale në UBT, solli në qendër të vëmendjes fuqinë e fotografisë si medium për tregimin e historive të pathëna dhe eksplorimin e temave bashkëkohore.

Festivali mbledhi 50 studentë që prezantuan punimet e tyre kreative, duke eksperimentuar me narrativat që

trajtonin çështje si identiteti, kujtesa, sfidat mjedisore dhe zërat e marginalizuar. Të pajisur me teknologjitë më të avancuara në laboratorët e UBT-së, studentët shpalosën talentin dhe vizionin e tyre artistik përmes fotografive të fuqishme dhe inspiruese.

Ky aktivitet theksoi rëndësinë e kamerës si një dëshmitare e kohës sonë, duke kontribuar në zhvillimin e industrive kreative dhe ndarjen e historive që pasqyrojnë realitetet e ndryshme të shoqërisë sonë.

Biblioteka e UBT-së: Hapësira ideale për studim dhe kërkime

Për të gjithë dashamirët e librit, dijes dhe shkencës, UBT ka krijuar një hapësirë të veçantë ku tradita e librit ndërthuret me teknologjinë moderne. Biblioteka e UBT-së është vendi ideal për të lexuar, studiuar dhe eksploruar botën e pafundme të dijes. Me më shumë se 250 mijë libra fizikë dhe 52 mijë tituj elektronikë, biblioteka e UBT-së ofron një koleksion të pasur në fusha të ndryshme si shkenca, teknologjia, arti, arkitektura, ekonomia dhe shumë të tjera. Titujt janë të disponueshëm në gjuhën shqipe, angleze, gjermane dhe serbe, duke i bërë burimet e saj të qasshme për një audiencë të gjerë lexuesish. Lexim në çdo formë: Biblioteka ka hapësira të rehatshme për lexim dhe studim, ndërsa falë digitalizimit, ajo ofron akses në platforma prestigjioze si EBSCO, SAGE Journals dhe J-Store. Kjo i mundëson studentëve dhe studiuesve të kenë burime cilësore vetëm me një klikim.

Profesori i UBT-së, Dr. Xhavit Bytyçi, publikon librin “Lëndët e Para me Origjinë Shtazore”

Profesori i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, Dr. Xhavit Bytyçi, ka publikuar librin akademik me titull “Lëndët e Para me Origjinë Shtazore”. Ky libër, i dedikuar studentëve të programit Shkencat e Ushqimit, synon të plotësojë nevojën për literaturë të strukturuar në gjuhën shqipe, duke ofruar një burim gjithëpërfshirës dhe të domosdoshëm në këtë fushë.

Libri trajton rëndësinë e produkteve me origjinë shtazore në industrinë ushqimore përmes një përmbajtjeje të ndarë në 12 kapituj, ku ndër të tjera diskutohen:


- Rëndësia e blegtorisë dhe kafshëve bujqësore si gjedhet, delet dhe dhitë.
- Përbërja dhe vetitë e qumështit si një ndër lëndët më të rëndësishme ushqimore.
- Mishi dhe ndikimi i faktorëve higjienikë dhe teknologjikë në cilësinë e tij.
- Shpendaria, akuakultura dhe apikultura, që kontribuojnë në prodhimin e

produkteve me prejardhje shtazore. Libri është rezultat i përkushtimit të Dr. Bytyçit për t’u ofruar studentëve njohuri të thelluara dhe praktike, duke mbuluar tema të rëndësishme si seleksionimi i kafshëve, mirëqenia e tyre, dhe ndikimi i faktorëve teknologjikë dhe biologjikë në cilësinë e produkteve.

Përveç studentëve të Shkencave të Ushqimit, ky libër është një burim i vlefshëm edhe për ekspertët e bioteknologjisë, veterinarët, politikëbërësit dhe hulumtuesit e fushave bujqësore.

Recensentët e këtij libri, Prof. Ass. Dr. Medin Zeqiri dhe Prof. Ass. Dr. Januz Veziri, kanë vlerësuar lart cilësinë dhe rëndësinë e tij për zhvillimin e sektorit ushqimor në Kosovë.

Dr. Xhavit Bytyçi, i cili ka një karrierë të gjatë dhe të suksesshme si profesor dhe ekspert në fushën e veterinarisë dhe bioteknologjisë, shprehet se ky libër është konceptuar për të ndihmuar studentët të kuptojnë dhe të vlerëso-



jnë rëndësinë e produkteve me origjinë shtazore në industrinë ushqimore. Ai gjithashtu falënderon bashkëshorten dhe familjen e tij për mbështetjen e pandërprerë gjatë procesit të punës në këtë libër.

Ky publikim është një tjetër dëshmi e përkushtimit të UBT-së dhe stafit të tij për të kontribuar në zhvillimin e arsimit dhe shkencës në Kosovë.

UBT përfaqësohet në Universitetin EMUNI për projektin inovativ COWEB

Në kuadër të projektit COWEB (Virtual Collaborative Learning in WB HEIs), stafi i Fakultetit të Menaxhimit, Biznesit dhe Ekonomisë (MBE) në përbërje të Muhamet Gërvalla, Gonxhe Beqiri, Engelbert Zefaj dhe Kestrim Avdimetaj përfaqësuan UBT-në në Universitetin EMUNI, në Piran, Slloveni. Ata morën pjesë dhe kontribuan aktivisht në aktivitetet e radhës së projektit.

Gjatë sesioneve të organizuara, u prezantuan arritjet e deritanishme të projektit, duke përfshirë implementimin e VCL (Virtual Collaborative Learning) në nivel rajonal, ku janë angazhuar disa nga profesorët, e-tutorët dhe studentët e UBT-së. Diskutimet u fokusuan gjithashtu në planifikimin e VCL-së ndërkombëtare dhe aktivitetet e tjera të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të projektit. Në këtë kuadër, u trajtuan edhe mundësitë për bashkëpunime të reja me partnerët ndërkombëtarë dhe angazhimet e stafit për



publikimin e një libri që trajton temën e VCL-së.

Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe synon të promovojë aplikimin e teknikave të Bashkëpunimit Virtual në Mësimdhënie (VCL) si një qasje inovative pedagogjike, me fokus në bashkë-krijimin e hapësirave virtuale dhe të përziera të të mësuarit, si dhe përmbajtjen e kurseve që nxisin aftësitë

dhe kompetencat e shekullit të 21-të për studentët. Po ashtu, projekti synon të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet IAL-ve dhe studentëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Projekti bashkon 3 IAL nga BE-ja dhe 7 IAL nga Ballkani Perëndimor, duke krijuar një platformë për të ardhmen e inovacionit në arsimin e lartë.

Studentët e Aktrimit në UBT zhvilluan një shfaqje të hapur për publikun

Në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së, studentët e Fakultetit të Aktrimit organizuan një shfaqje të hapur, duke ofruar një spektakël për të pranishmit.

Shfaqja u realizua nën drejtimin e profesorëve Ilir Prapashtica dhe Fiona Gllavica, ku studentët paraqitën forma

të ndryshme aktrimit, duke përfshirë teknika dhe ushtrime që shërbejnë për zhvillimin e aftësive të tyre në skenë. Fakulteti i Aktrimit në UBT është i strukturuar për të ofruar një qasje të gjithanshme në fushën e aktrimit. Programi i studimit përfshin një kombinim të thellë të aftësive prak-

tike, si njohuri në teatrin dhe filmin, aftësi për të interpretuar karaktere të ndryshme dhe një kuptim të thellë të mekanizmave të teatrit dhe filmit, elemente të cilat janë thelbësore për suksesin e studentëve në këtë fushë.

Studentët e masterit në Media dhe Komunikim në UBT prezantojnë punimet për komunikimin ndërkulturor

Në kuadër të lëndës “Komunikimi Ndërkulturor”, studentët e nivelit master në programin Media dhe Komunikim në UBT prezantuan punimet dhe të gjeturat e tyre mbi tematika të rëndësishme që pasqyrojnë trashëgiminë dhe fenomenet kulturore shqiptare. Punimet e studentëve trajtuan një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë traditat e dasmave shqiptare në rajone të ndryshme, fenomenin e gjakmarrjes dhe ndikimin e tij në shoqërinë shqiptare, Kanunin e Lekë Dukagjinit, origjinën dhe rëndësinë e çiftelisë, si dhe

tema të tjera që lidhen me identitetin dhe kulturën.

Nën udhëheqjen e profesorit, Dr. Votim Hanoli, studentët jo vetëm që eksplorojnë këto tema, por thelluan diskutimet për të nxjerrë në pah detajet e komunikimit ndërkulturor dhe rolin e tyre në mirëkuptimin dhe ndërlidhjen midis kulturave.

Ky angazhim akademik u dha mundësinë studentëve të kombinojnë njohuritë teorike me analizën praktike, duke kontribuar në thellimin e kuptimit të fenomeneve kulturore shqiptare



dhe mënyrës se si ato ndikojnë komunikimin në kontekste të ndryshme.

UBT vazhdon të jetë kryeqendër për promovimin e edukimit cilësor dhe studimeve që pasqyrojnë vlerat kulturore dhe ndërkulturore.

Studentët e UBT dhe TH Lubeck prezantojnë projektet për integrimin e lumenjve të Prishtinës



Në kuadër të bashkëpunimit mes UBT-së dhe Universitetit TH Lubeck nga Gjermania, është mbajtur prezantimi final i modulit të përbashkët “Revival of the River”.

Ky modul synon integrimin e lumenjve të Prishtinës në hapësirat publike, dhe ka përfshirë një prezantim online të punimeve të studentëve të të dyja in-

stitucioneve. Në këtë modul, nga UBT kanë marrë pjesë 5 profesorë bashkë me studentët: Arbër Azemi, Laura Hakaj, Donart Zairi, Arneida Muçiçi, Qëndresa Hoxha, Nita Arifi, Arnisa Hyseni dhe Bardha Ukzeka, ndërsa nga TH Lubeck janë angazhuar 4 profesorë dhe 22 studentë. Pjesëmarrësit kanë paraqitur propozime inovative për revitalizimin

dhe integrimin e lumenjve të kryeqytetit në jetën urbane, me qëllim krijimin e hapësirave të përdorshme dhe të qëndrueshme për qytetarët.

Punimet e këtij moduli do të prezantohen në një ekspozitë të organizuar në ditët në vijim, e cila do të paraqesë idetë dhe projektet e studentëve për Komunën e Prishtinës, si një mundësi për të kontribuar në zhvillimin urban të qytetit.

Ky është edicioni i dytë i këtij moduli të përbashkët, pas organizimit të tij në vitet 2023 dhe 2024. Ndërkohë, në vitin 2025, moduli do të zgjerohet, duke përfshirë UBT-në, TH Lubeck dhe Universitetin Politeknik të Tiranës, për të sjellë një perspektivë më të gjerë dhe një bashkëpunim ndërkombëtar më të thellë në fushën e studimeve urbane dhe inxhinierisë.

Studentët e UBT-së në ligjëratën e KFOR-it amerikan mbi punën ekipore dhe sigurinë ndërkombëtare

Tradita e bashkëpunimit mes Përfaqësuesve të Ushtrisë Amerikane dhe Programit të Studimeve të Sigurisë në UBT vazhdon të forcohet dhe të ofrojë mundësi të shumta për studentët e këtij programi. Në kuadër të ligjëratave të organizuara nga Prof. Arian Kadriu, studentët e Studimeve të Sigurisë patën mundësinë të mirëprisnin një ligjëratë tematike të zhvilluar nga CPT. Eckstein dhe Sgt. Robinson, të cilët janë pjesë e KFOR-it amerikan.

Kjo ligjëratë ishte një mundësi e shkëlqyer për të thelluar njohuritë e studentëve në fusha të ndryshme të sigurisë ndërkombëtare dhe të përfshinte ekspertizën e Ushtrisë Amerikane në këto çështje.

Gjatë ligjëratës, CPT. Eckstein trajtoi aspektin juridik të sigurisë ndërkombëtare nga prizmi i Ushtrisë Amerikane, duke ndarë me studentët mendimet dhe



përvoja të tij mbi rregullat dhe ligjet që rregullojnë operacionet ushtarake ndërkombëtare. Ndërsa, Sgt. Robinson u përqëndrua në aspektet e vlerave që Ushtria Amerikane mbron dhe promovon, duke u ndalur në rëndësinë e integritetit, altruizmit dhe punës ekipore.

Ai theksoi se këto vlera janë të domosdoshme për suksesin gjatë ekspeditave ushtarake dhe se janë gjithashtu thelbësore për formimin e ekipeve efektive dhe arritjen e objektivave të përbashkë-

ta. Ligjëratat u shërbeu si një shembull i shkëlqyer për studentët, duke u mundësuar atyre të kuptojnë se sa të rëndësishme janë këto aspekte për punën në ekip, si në fushën ushtarake ashtu edhe në atë akademike dhe profesionale. Ligjëratat ishin një mundësi për studentët që të mësojnë nga praktika dhe përvoja të drejtpërdrejta, duke i përgatitur ata për sfidat e mundshme që mund të hasin në karrierën e tyre të ardhshme.

Studentët e Juridikut në UBT – Prizren realizojnë gjykim të simuluar në kuadër të “Klinikës Ligjore”

Në kuadër të lëndës “Klinika Ligjore”, studentët e Fakultetit Juridik në UBT, kampusi në Prizren, nën udhëheqjen e Prof. Ass. Dr. Merita Muharremit, realizuan me sukses një gjykim të simuluar me fokus në procedurat civile. Ky aktivitet kishte për qëllim të lidhte njohuritë teorike me praktikën, duke krijuar një përvojë unike për studentët.

Gjatë simulimit, studentët trajtuan një kontest martese mbi zgjidhjen e saj, duke punuar në grupe në Gjykatoren e UBT-së në Prizren. Në këtë proces, ata interpretuan rolet e gjyqtarëve, avokatëve dhe palëve të tjera të përfshira në një gjykim civil. Aktiviteti përfshiu të gjitha fazat e procesit gjyqësor, nga paraqitja e kërkesave deri te vendimi përfundimtar, duke demonstruar profesionalizëm dhe aftësi të shkëlqyera.

Kjo iniciativë e Fakultetit Juridik të UBT-së dëshmon përkushtimin ndaj integ-



rimin të metodave inovative të mësimdhënies, duke ndërtuar ura të fuqishme midis teorisë dhe praktikës. Përmes aktiviteteve të tilla, studentët pajisen me kompetencat dhe përgatitjen e duhur për sfidat që i presin në karrierën e tyre si profesionistë të drejtësisë.

UBT mbetet një lider në promovimin e arsimit cilësor dhe ofrimin e mundësive praktike për studentët, duke i përgatitur ata për tregun e punës dhe për të qenë liderë të suksesshëm në fushën e drejtësisë.

UBT në vizitë zyrtare në Universitetin Politeknik të Valencias në Spanjë

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i shoqëruar nga Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Prof. Binak Beqaj, dhe Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, Prof. Visar Krelani, po zhvillon një vizitë zyrtare në Universitetin Politeknik të Valencias në Spanjë.

Në kuadër të kësaj vizite, u zhvillua një prezantim nga Rektori Hajrizi rreth ekosistemit inovativ të UBT-së, i cili ndërthur arsimin, kërkimin shkencor dhe teknologjinë për të krijuar një mjedis inovativ akademik dhe profesional. Gjatë këtij prezantimi u shpalosën qasjet novatore të institucionit në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe UBT International Smart Schools, shkollat e para në Kosovë dhe rajon që ofrojnë edukim cilësor, me kurrikula ndër-kombëtare dhe edukim 4.0, duke kombinuar teknologjinë dhe kreativitetin për të përgatitur liderët e së ardhmes.

Po ashtu, një ligjëratë për studentët e Ndërtimitarisë ka mbajtur edhe Prof. Visar Krelani, ku janë paraqitur aspektet e jetëgjatësisë së strukturave dhe punët kërkimore në UBT.

Dekani i Arkitekturës, Prof. Binak Beqaj, paraqiti rëndësinë e ndërdisiplinaritetit që ndërlidh drejtimitet e ndryshme dhe po ashtu si ai aplikohet shumë mirë në UBT.

Në këtë vit akademik, përmes programit Erasmus, edhe dy studentë të nivelit master në Fakultetin e Inxhinierisë së



Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, Diellza Vishi dhe Leart Shabani, po i ndjekin studimet në këtë universitet, të cilët po ashtu po zhvillojnë hulumtime të ndara nën udhëheqjen e njërit ndër profesorët më të njohur të Spanjës dhe Europës, Prof. Pedro Serna, i cili është gjithashtu mbështetësi më i madh i kësaj marrëveshjeje.

Delegacioni i UBT-së ka pasur shumë takime me rëndësi, në të cilat u shkëmbyen përvoja dhe u shpreh gatishmëria për bashkëpunim edhe më të thellë në fushën e mësimdhënies, shkencore, konferencave etj.

Delegacioni i takua me pro-rektorin e Universitetit Politeknik, me Prof. Pedro Serna, i cili ishte organizatori kryesor, me sekretarin e Institutit të Hulumti-

meve në UPV, ku studentët e UBT-së po realizojnë hulumtime të rëndësishme, si dhe u takuan me përfaqësues të Zyrës Ndërkombëtare në këtë Universitet.

Gjatë kësaj vizite, delegacioni i UBT-së po realizon takime me përfaqësues të lartë akademikë dhe drejtues të fakulteteve përkatëse, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndëruniversitar dhe shkëmbimin e përvojave akademike dhe profesionale.

Diskutimet u përqendruan në partneritete në fusha të ndryshme, siç janë arkitektura, planifikimi hapësinor, inxhinieria ndërtimore, si dhe në bashkëpunime për projekte kërkimore dhe mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik.

Në UBT u mbajt promovimi i librit të ri “Etika, mburojë e gazetarisë profesionale” të autorit, gazetarit, publicistit dhe profesorit Musa Sabedini



Në hapësirat e UBT-së u mbajt promovimi i librit të ri “Etika, mburojë e gazetarisë profesionale” të autorit, gazetarit, publicistit dhe profesorit në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, Musa Sabedini. Ky libër i radhës i profesorit Sabedini, përfaqëson një shtyllë të rëndësishme për studentët e gazetarisë, studiuesit e medias, gazetarët hulumtues dhe redaktorët e përkushtuar ndaj profesionalizmit.

Në këtë ngjarje të veçantë, e cila mbledhi shumë mysafirë, ishin të pranishëm personalitete të shquara nga fusha akademike dhe mediatike, përfshirë Rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, profesorin dhe recensentin e librit, Dr. Safet Zejnullahu, si dhe vetë autorin Musa Sabedini. Gjithashtu, në këtë promovim morën pjesë një numër i madh studentësh, ekspertësh dhe dashamirës të librit, të cilët e vlerësuan këtë punim si një kontribut të jashtëzakonshëm për fushën e gazetarisë në Kosovë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e këtij libri si një udhëzues për standardet etike në gazetari. Ai vlerësoi përkushtimin dhe përvojën e gjatë të profesor Sabedinit, duke e cilësuar këtë vepër si një bazë të fuqishme për formimin e gazetarëve të rinj dhe avancimin e gazetarisë profesionale në Kosovë.

“Ende ka shumë për të bërë, pasi ka mungesë të literaturës dhe tematikave që duhet të mbulohen në aspektin profesional. Ky libër është një lajm pozitiv dhe i rëndësishëm, duke pasur parasysh se deri në vitin 2025 nuk kemi pasur një botim të tillë mbi etikën gazetareske. Si UBT, kemi kënaqësinë që ta sjellim këtë vepër për studentët dhe për audiencën në përgjithësi”, tha Rektori Hajrizi.

Përmbytja dhe mesazhi i librit

Libri “Etika, mburojë e gazetarisë profesionale” sjell një analizë të thelluar mbi rëndësinë e etikës në gazetari dhe mediat bashkëkohore. Në parathënien e tij, autori thekson se vepra vjen si rezultat i një pune të gjatë hulumtuese dhe përvojë mbi 33-vjeçare në gazetarinë informative dhe hulumtuese, si dhe mbi 13 vite si themelues i një portali me ndikim dhe anëtar i Bordit të KMSHK-së.

“Libri, gjithashtu, erdhi si rezultat i punës sime të palodhshme disavjeçare, gjatë së cilës jam përpjekur ta avancoj etikën, në të gjitha dimensionet. Përvoja ime mbi 33-vjeçare në gazetarinë informative dhe atë hulumtuese, përvoja tjetër mbi 13-vjeçare si themelues i një portali me ndikim dhe po kaq vite si pjesë e Bordit të KMSHK-së, më mundësuan të mësoj shumë për gabimet e përditshme që bëjnë portalet dhe të metat e shumta, që shfaqen gjatë të bërit gazetari online”, shkruan autori Sabedini.

Autori ka trajtuar në detaje konceptet dhe parimet kryesore të etikës, duke ndriçuar rolin e saj thelbësor në mbrojtjen e profesionalizmit gazetaresk. Me shembuj konkretë nga mediat vendore dhe ndërkombëtare, Sabedini ofron udhëzime praktike për shmangien e shkeljeve etike dhe avancimin e standardeve profesionale.

Në fjalën e tij gjatë promovimit, Sabedini deklaroi se “Etika është shpirti i gazetarisë profesionale. Pa të, çdo shkrim, kronikë apo analizë humbet vlerën dhe kredibilitetin. Ky libër nuk është thjesht një udhëzues për gazetarët, por një apel për gjithë shoqërinë që të respektojë dhe avancojë etikën si një element kyç për emancipimin kolektiv”.

“Etika është thelbi i gazetarisë profesionale, sepse nëse gazetari nuk ka etikë personale, ai do ta ketë të vështirë ta zbatojë etikën kolektive ose të respektuarit të

etikës në jetën publike. Jo rastësisht është thënë se pa etikë nuk ka gazetari. Etika është shpirti dhe detaji që e forcon çdo shkrim, kronikë, analizë apo tekst gazetaresk. Nëse e kemi respektuar etikën, ne automatikisht jemi bërë përgjegjës ndaj vetes dhe ndaj lexuesve tanë. Etika e mirë, etika me autoritet në gazetari dhe media, është ilaç për një shoqëri të emancipuar. Kuptohet etikën nuk duhet ta ruajmë apo ta avancojmë vetëm mediat e gazetarët, sepse ajo duhet të respektohet edhe nga lexuesit, dhe ata që i kemi sy e vesh, për punën tonë të përditshme”, ka shkruar profesori Sabedini.

Strukturimi i librit

Libri është i ndarë në tre kapituj kryesorë, ku çdo kapitull trajton tema të ndryshme që lidhen me etikën në gazetari:

- Teoria dhe konceptet bazë të etikës – përfshirë definicionet, rëndësinë e saj në gazetari, sfidat dhe ndikimin e gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe shpifjet.
- Kredibiliteti dhe përgjegjësia e gazetarëve – duke ofruar shembuj konkretë të shkeljeve etike dhe rekomandime për përmirësimin e standardeve.
- Dilemat etike në mediat bashkëkohore – me fokus në sfidat e mediave digjitale, rrjetet sociale dhe rastet studimore mbi ndikimin e etikës në raportimin gazetaresk.

Recensenti i librit, Dr. Safet Zejnullahu, e cilësoi veprën si një udhërrëfyes të domosdoshëm për gazetarët dhe mediat shqiptare. Ai vlerësoi qasjen hulumtuese dhe kompetente të autorit, duke theksuar se libri ofron një alternativë të plotë për të kuptuar dhe zbatuar etikën në praktikën e përditshme gazetareske.

Në kapitullin e parë libri trajton ballafaqimin e teorisë mbi etikën, sferën e etikës, kodet dhe parimet e saj, përkufizimet e etikës, rëndësinë që ka ajo në gazetari, thelbi i etikës, rëndësia e saj, sfidat që bartë me vete, gjithashtu autori ka shkruar gjerë e gjatë mbi gjuhën e urrejtjes, dezinformimit, privatësinë, shpifjen, lajmet e rreme, për vlerat etike të lajmit, për parimet etike, për raportimin jo etik në mediet e Kosovës, për dëmet ligjore që shkakton etika, për shkeljet etike, për sfidat e gazetarisë etike.

Kurse, në kapitullin e dytë shkruhet mbi kredibilitetin e gazetarit, për etikën në gazetari e media, për plagjiaturën dhe copy-paste lajmet, kam ofruar shumë shembuj praktikë të portaleve që kanë bërë shkelje të kodeve të etikës, janë ofruar udhëzime e qëndrime të KMSHK-së, KPM-së, si dy mekanizma që merren me vetërregullimin e mediave online dhe

atyre televizive, për etikën në foto, video dhe videografi, për sharjet e dhunën banale në televizionet tona, për vdekjet e personaliteteve nga bota, tek të cilët është shkelur etika dhe raste studimore të vdekjeve, edhe të njerëzve të famshëm në Kosovë, që ishin atakuar me shkelje të etikës nga mediat, për ndershmërinë e gazetarit dhe problemet që medie digjitale ka në zbatim të etikës, për avantazhet dhe disavantazhet e kodeve të etikës.

Edhe kapitulli i tretë përbëhet nga materiale interesante, ku kam trajtuar dilemat e etikës, për dëmet që sjell TikTok, për rrjetet sociale e mediat sociale, që përshkruhen me shkelje ekstreme të etikës, për etikën në Blllog dhe bllogerët, për abuzimin gjatë aksidenteve, vrasjeve, vetëvrasjeve, dhunës në familje, për vetërregulimin dhe standardet e medias online, për parimet më të pranuar etike, për konfliktin e interesit dhe kualitetin e portaleve në fushën e etikës etj.

“Por, tema që trajton e bën atë të veçantë dhe të ndryshëm. Sepse trajton një temë e cila, si kudo në botë, i ndihmon gazetarët të mos gabojnë ose të gabojnë minimalisht, pasi edhe gabimet njerëzore janë, i ndihmon mediat të bëhen më të mira dhe më profesionale, sepse këtë e kanë obligim parësor, pa çka se nganjëherë e

harrojnë, me ose pa qëllim”, ka nënvizuar profesor Zejnullahu.

Sipas tij libri vjen si sublimim i një përvoje të gjatë mbi tridhjetëvjeçare të autorit në të bërit gazetari aktive të terrenit, të të qenit pjesë e trupave rregulluese të gazetarisë në Kosovë, si dhe i profesorit të gazetarisë, që e bën atë të trajtojë temat e shtruar për diskutim nga të tri rrafshet, të veçanta secila: duke praktikuar gazetarinë profesionale e pa shkelje, duke monitoruar shkeljet e të tjerëve, si dhe duke parë në praktikë cilat cilësi e parime u duhen sot më së shumti gazetarëve të rinj.

Profesor Zejnullahu ka thënë se “Teknologjia dhe rrjetet sociale e mundësojnë këtë, por gazetarët profesionistë dhe trupat rregulluese e vetërregulluese janë ato që duhet të ndihmojnë në këtë periudhë transitore shumë të rëndësishme të medias në Kosovë, duke minimizuar “gazetarinë amatore” dhe duke qëndruar fuqishëm në parimin e gazetarisë profesioniste, të cilën e krijojnë, e zhvillojnë dhe e mbrojnë vetëm profesionistët”.

“Duke u nisur nga përmbajtja, literatura e bollshme dhe referente e shtjelluar nga autori, shembujt meritore dhe porosia se vetëm profesionalizmi e mbron gazetarinë, besoj se libri “Etika, mburojë e gazetarisë profesionale” do të jetë një mjet i

fortë në duart e atyre që bëjnë gazetari, për të bërë gazetari të mirë e profesionale dhe për të eliminuar lëshimet që, edhe i bëjnë keq gazetarisë, edhe e ngufatin mendimin e lirë në një vend në tranzicion e në zhvillim, siç është Kosova.

Gazetaria e Kosovës është shumë e mirë, krahasuar me rrethanat në të cilat zhvillohet. Huluntimet dhe librat si ky i kolegut Musa Sabedini ndihmojnë shumë që ajo të bëhet edhe më e mirë, edhe më profesionale” ka përfunduar Zejnullahu.

Ndryshe libri ka 520 faqe ndërsa botues është UBT.

Përfundimi dhe rëndësia për të ardhmen

Promovimi i librit “Etika, mburojë e gazetarisë profesionale” u përmbyll me diskutime të frytshme mbi nevojën për avancimin e etikës në gazetari. Studentët dhe pjesëmarrësit patën mundësinë të shkëmbejnë mendime dhe të parashtrijonë pyetje për autorin dhe panelistët.

Kjo vepër pritet të ketë një ndikim të madh jo vetëm në rrafshin akademik, por edhe në praktikën e përditshme gazetareske, duke shërbyer si një udhëzues për brezat e rinj të gazetarëve dhe për të gjithë ata që janë të angazhuar në mbrojtjen e profesionalizmit dhe integritetit mediatic.

Doli nga shtypi monografia “Ujëmbledhësi i Lumit Blinajë”, e profesorit të UBT-së, Hazir Çadraku

Me një punë kërkimore të gjatë dhe të thelluar, Profesori Hazir Çadraku ka botuar librin “Ujëmbledhësi i Lumit Blinajë”, një monografi e cila përmban një hulumtim të hollësishëm dhe shënon një arritje të rëndësishme në fushën e inxhinierisë së ujërave dhe studimeve hidrografike. Ky libër synon të avancojë njohuritë për një nga elementët më të rëndësishëm të burimeve natyrore të rajonit, duke ofruar informacion dhe analizë të detajuar për ujëmbledhësin e Lumit Blinajë. Monografia trajton aspekte të shumta të rëndësishme të ujëmbledhësit të Lumit Blinajë, duke përfshirë pozicionin gjeografik, kushtet klimatike, ndërtimin gjeologjik, karakteristikat hidrogeologjike dhe cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ajo gjithashtu përshkruan tipet hidrokimike të ujërave nëntokësore dhe elementët e tjerë të burimeve hidrike, të cilat janë jetike për banorët që jetojnë brenda këtij ujëmbledhësi. Një nga qëllimet kryesore të këtij libri është plotësimi i boshllëqeve në të dhënat dhe informacionet për këtë ujëmbledhës, duke ofruar një burim të vlefshëm për të gjithë ata që kërkojnë njohuri mbi burimet ujore të këtij rajoni. Sipas au-

torit, këto burime janë pasuri e vetme për banorët e kësaj zone, dhe menaxhimi i duhur i tyre është jetik për zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj hapësire. Përmes këtij studimi, autori ka përdorur mbi dhjetë vjet punë kërkimore për të grumbulluar, përpunuar, analizuar dhe sistemuar të dhënat dhe informacionet që paraqiten në këtë libër. Rezultatet janë të bazuara në kërkime autentike dhe përfaqësojnë një përpjekje të thelluar shkencore për të kuptuar më mirë burimet hidrike të ujëmbledhësit të Lumit Blinajë.

Në kuadër të trajtimit të burimeve ujore, ky libër përputhet me konceptin e integruar të menaxhimit të burimeve ujore, që përshkruhet në Direktivën Kornizë për Ujëra të Këshillit të Evropës, e cila thekson rëndësinë e menaxhimit të ujërave në kuadër të një ujëmbledhësi lumor. Ky është një hap i rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të kërkimeve shkencore në këtë fushë, dhe libri ka si objektiv të paraqesë gjithë hulumtimin në një formë të organizuar dhe të plotë, për t'i mundësuar të gjithë atyre që janë të interesuar për këtë temë të kenë një burim të besueshëm dhe gjithëpërfshirës.



Ky është libri i parë që trajton në këtë mënyrë dhe në këtë format ujëmbledhësin e Lumit Blinajë, dhe autorët e tij janë të hapur për plotësime, komente dhe sugjerime, për ta bërë atë më të dobishëm dhe të saktë për lexuesin dhe studiuesin e kësaj fushe. Me botimin e këtij libri, është e qartë se kërkimet dhe studimet për këtë ujëmbledhës do të vazhdojnë të zhvillohen dhe të ofrojnë informacion të rëndësishëm për menaxhimin e burimeve ujore në të ardhmen.

UBT ndërlihd bashkëpunimin me Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane

UBT ndërlihd bashkëpunimin me Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, duke forcuar lidhjen mes arsimit dhe sektorit të biznesit, si dhe duke krijuar mundësi të reja për zhvillim profesional, akademik dhe ekonomik.

Marrëveshja u nënshkrua nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Kryetari i Degës së Unionit në Kosovë, Shkelzen Jusaj.

Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e

bashkëpunimit mes arsimit dhe sektorit të biznesit, duke nënvizuar se UBT vazhdon të jetë një mbështetës i fuqishëm i bizneseve, ndërmarrësve dhe iniciativave të diasporës.

“UBT ka qenë dhe mbetet një nga mbështetësit kryesorë të bizneseve, ndërmarrësve dhe iniciativave të diasporës, duke u angazhuar vazhdimisht në fuqizimin e ekosistemit të inovacionit dhe zhvillimit ekonomik”, u



Nga materialet e ricikluara te veprat e artit – Punëtori kreative me studentët e Artit dhe Medias Digjitale në UBT



Në UBT u organizua një punëtori frymëzuese me temën “Riciklimi në praktikën e artit bashkëkohor”, në kuadër të Fakultetit Art dhe Media Digjitale, ku studentët dhe arti u bashkuan për të eksploruar një qasje të re krijuese.

I ftuari special i kësaj punëtorie ishte artisti i njohur nga Kosova, Driton Selmani, i cili është i njohur për eksperimentimin e tij me materialet e ricikluara dhe krijimin e veprave me një qasje të thellë konceptuale. Gjatë këtij sesi, studentët e AMD-së patën privilegjin të bashkëbisedojnë me të, duke eksploruar

mënyrat se si riciklimi nuk është vetëm një akt ekologjik, por edhe një proces artistik që mund të transformojë plotësisht narrativën e një vepre arti.

Në qendër të diskutimit ishin praktikat e reja krijuese që sfidojnë perceptimet tradicionale mbi materialin dhe funksionin e tij në artin bashkëkohor. Selmani ndau me studentët përvojën e tij mbi mënyrën se si objektet e përdorura, të refuzuara apo të vjetra mund të fitojnë një jetë të re përmes artit, duke u shndërruar në medime shprehëse me histori dhe mesazhe të fuqishme.

Punëtorja nuk u kufizua vetëm në teori – ajo u zhvillua në një atmosferë interaktive, ku studentët kishin mundësinë të ndryshme të ricikluara, duke parë nga afër sesi një objekt i zakonshëm mund të transformohet në një formë të re estetike dhe konceptuale. Po ashtu, u theksua rëndësia e hulumtimit në hapësirë si pjesë e domosdoshme e procesit krijues, duke nxitur një qasje më të thellë ndaj elementeve të mjedisit përreth.

Ky aktivitet pasuron përvojën akademike të studentëve të AMD-së, duke i motivuar ata të eksperimentojnë me forma të reja të shprehjes artistike dhe të eksplorojnë ndërthurjen mes artit, ekologjisë dhe teknologjisë. Përmes takimeve të tilla, UBT vazhdon të mbështesë dhe të promovojë krijimtarinë inovative dhe ndërveprimin mes studentëve dhe artistëve bashkëkohorë, duke e shndërruar ambientin akademik në një laborator idesh dhe eksperimentimesh artistike.

UBT vendos Kosovën pjesë të certifikimeve për gjuhën italiane

UBT ka arritur një tjetër sukses të rëndësishëm duke u autorizuar për certifikimet ndërkombëtare CELI (Certificati di Conoscenza della Lingua Italiana) për gjuhën italiane. UBT është institucioni i parë dhe i vetmi në vend që tani do të ofrojë këtë mundësi për studentët, profesionistët dhe të gjithë ata që dëshirojnë të certifikojnë aftësitë e tyre në gjuhën italiane.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, tha se ky hap ndihmon shumë studentët dhe profesionistët e tjerë që dëshirojnë të mësojnë gjuhën italiane dhe të certifikojnë kompetencat e tyre gjuhësore, të cilat mund t'i përdorin për studime apo për të qenë më konkurrues në tregun ndërkombëtar të punës.

“Jemi krenarë që UBT po sjell një mundësi të re dhe shumë të rëndë-

sishme për të gjithë ata që dëshirojnë të dëshmojnë njohuritë e tyre në gjuhën italiane me një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht. Ky hap jo vetëm që forcon rolin e UBT-së si një institucion lider në arsim dhe certifikime profesionale, por gjithashtu ndihmon studentët tanë dhe profesionistët të jenë më konkurrues në tregun ndërkombëtar të punës”, tha Rektori Hajrizi.

Krahas certifikimeve të shumta si TOEFL, PSI CELT, Prometrics, GRE dhe tani CELI, UBT po bëhet një qendër e suksesshme për certifikimet e gjuhëve. Me këtë mundësi të re, studentët dhe të interesuarit në Kosovë nuk kanë më nevojë të udhëtojnë jashtë vendit për të marrë një certifikim të njohur ndërkombëtarisht në gjuhën italiane – tashmë ata mund ta arrijnë këtë sukses

në UBT.

CELI është një certifikatë e njohur ndërkombëtarisht, e lëshuar nga Universiteti për të Huajt në Perugia, që vërteton njohuritë gjuhësore sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane për Gjuhët (CEFR). Kjo certifikatë vlerësohet lart nga institucionet arsimore dhe tregu i punës në Itali dhe më gjerë, duke i dhënë kandidatëve një avantazh të madh në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

Ky sukses është arritur falë edhe kontributit të Ambasadorit të Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, profesoreshës së gjuhës italiane, Dr. Raffaella Ritucci, si dhe Universitetit italian “Università per Stranieri di Perugia”.

Profesorët e UBT-së në programin ERASMUS+ në Romanian American University



Profesorët e UBT-së, Dr. Sc. Elmi Kelmendi dhe Dr. Sc. Kujtim Zylfijaj, po marrin pjesë në një program prestigjioz mobiliteti, të mbështetur nga ERASMUS+, në Romanian American University në Bukuresht të Rumanisë. Kjo vizitë akademike u realizua në kuadër

të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe ishte pjesë e Javës Ndërkombëtare të Mësimdhënies, e organizuar nga Universiteti Amerikan në Bukuresht.

Gjatë qëndrimit të tyre, profesorët patën mundësinë të angazhohen në shkëmbimin e praktikave më të mira pedagogjike me shumë pjesëmarrës nga tetë universitete evropiane. Përmes sesioneve interaktive dhe diskutimeve akademike, ata ndanë përvoja të vlefshme mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe qasjet inovative në fushat e tyre të ekspertizës.

Në mënyrë specifike, profesor Elmi Kelmendi mbajti ligjërata mbi ndikimin e Kriminologjisë në organizimin e Kriminologjisë në vendet ne

tranzicion me fokus në ekonomi, dhe domosdoshmërinë e reformës në drejtësinë penale (tema nga Kriminologjia, Krimi i organizuar dhe E drejta penale), duke trajtuar çështje kyçe të jurisprudencës bashkëkohore penale, ndërsa profesori Kujtim Zylfijaj mbajti ligjërata mbi lidhjet dhe sjelljen organizative, duke analizuar faktorët që ndikojnë në efektivitetin e udhëheqjes dhe dinamikën e organizatave moderne. Ky angazhim i profesorëve të UBT-së jo vetëm që forcon lidhjet akademike ndërkombëtare, por gjithashtu pasuron përvojën e tyre profesionale dhe kontribuon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në universitet.


Dolën nga shtypi librat: “Kontabiliteti Menaxherial dhe Kostot (KMK)” dhe “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” të profesorit, Burhan R. Rexhepi

Profesori i Fakultetit të Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT, Burhan R. Rexhepi, ka botuar dy libra të rëndësishëm universitarë: “Kontabiliteti Menaxherial dhe Kostot (KMK)” dhe “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”. Të dy këta libra janë të dedikuara studentëve të programit Master në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi (MBE) në UBT dhe ofrojnë njohuri të avancuara dhe praktika të dobishme në menaxhimin e kostove, raportimin financiar dhe aplikimin e standardeve ndërkombëtare.

Libri “Kontabiliteti Menaxherial dhe Kostot (KMK)” i ofron studentëve një pasqyrë të thelluar mbi menaxhimin e kostove dhe vendimmarrjen financiare, duke i pajisur ata me njohuri

praktike për të kuptuar dhe zbatuar teknikat e menaxhimit të kostove. Autori, në parathënien e librit, ka thënë: “Ky libër është hartuar me qëllim që të shërbejë si një udhëzues i thelluar për studentët e programit MBE, duke i ofruar njohuri të nevojshme për të kuptuar dhe zbatuar teknikat e menaxhimit të kostove dhe për të marrë vendime të informuara financiare.”

Në anën tjetër, libri “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar” ofron një kuptim të thelluar të standardeve ndërkombëtare për raportimin financiar, duke i ndihmuar studentët të kuptojnë rregullat dhe parimet që drejtojnë përgatitjen e pasqyrave financiare në nivel global. Këta botime janë një kontribut i çmuar për zhvillimin e njo-



hurive dhe aftësive të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e mundshme në karrierën e tyre profesionale në fushën e menaxhimit financiar dhe kontabilitetit.

Studentët e UBT-së ndjekin ligjëratën e Prof. Dr. Oliver Jens Schmitt mbi historinë shqiptare

Studentët e UBT-së, posaçërisht ata të Shkencave Politike, patën mundësinë të ndjekin një ligjëratë tematike nga historiani i njohur botëror, Prof. Dr. Oliver Jens Schmitt, rreth temës “Pse merremi me historinë shqiptare?”.

Kjo ligjëratë e organizuar nga Instituti i Ballkanologjisë i UBT-së ofroi mundësinë për studentët që të fitojnë njohuri të thelluara mbi historinë shqiptare dhe të angazhohen në diskutime akademike me një nga historianët më të njohur të Evropës. Prof. Schmitt, përmes analizave të tij të thelluara dhe qasjes metodologjike të re, ofroi

një perspektivë të freskët dhe të pasur mbi zhvillimet historike shqiptare, duke theksuar rëndësinë e studimit të kësaj historie për kuptimin më të thellë të kontekstit ballkanik dhe evropian. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë mbi materialet përgatitore që Prof. Schmitt i kishte dërguar, duke krijuar një mundësi të shkëlqyer për shkëmbim idesh dhe për të reflektuar mbi çështje të rëndësishme historike.

Prof. Dr. Oliver Jens Schmitt është një nga historianët më të shquar të Evropës dhe një ekspert i njohur i historisë shqiptare dhe Ballkanit. Ai ka studiuar

Bizantologji, Neogreqisht dhe Histori të Evropës Lindore, dhe ka një karrierë të pasur akademike si pedagog dhe studiues në disa nga universitetet më prestigjioze të Evropës, duke përfshirë Universitetin e Mynihut, Universitetin e Bernës dhe Universitetin e Vjenës.

Me një eksperiencë të gjerë kërkimore dhe si drejtues i Institutit të Historisë së Evropës Lindore, Prof. Schmitt ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në fushën e studimeve të historisë shqiptare dhe të Ballkanit, duke ofruar një kuptim të thellë dhe të gjerë të proceseve historike.

Nga Amerika në UBT: Prof. Martin L. Camp mbajti ligjëratën mbi rolin e avokatëve në sundimin e ligjit dhe mundësitë për studime në ShBA

UBT pati kënaqësinë të mirëpresë Profesorin Martin L. Camp, profesor i profesionit juridik dhe prodekan i programeve diplomike dhe ndërkombëtare në SMU Dedman School of Law, Universiteti “Southern Methodist University” në Dallas, Texas. Prof. Camp mbajti një ligjëratë të jashtëzakonshme me temën “Detyrimet etike të avokatëve në Shtetet e Bashkuara: Gardianët e sundimit të ligjit”.

Në ligjëratën e tij, Prof. Camp theksoi rëndësinë e avokatëve në mbrojtjen e sundimit të ligjit dhe sigurinë e drejtësisë dhe përgjegjësisë në shoqëri. Ai shpjegoi se sundimi i ligjit është themeli i një shoqërie të drejtë dhe funksionale, ku të gjitha individët dhe institucionet janë të barabartë para ligjit dhe janë të përgjegjshëm ndaj tij. Pa këtë themel, shoqëritë rrezikojnë të bien në arbitraritet dhe padrejtësi.

Në përshëndetjen e tij, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, u shpreh: “Ne jemi të nderuar të kemi në mesin tonë një figurë kaq të respektuar si Profesor Martin L. Camp. Ligjëratat e tij jo vetëm që na ka ofruar një pasqyrë të thellë mbi rolin e avokatëve, por gjithashtu ka shtuar mundësi të shkëlqyera për studentët tanë që mund të aplikojnë për mundësi studimi në ShBA. Ky është një tjetër hap drejt forcimit të lidhjeve tona ndërkombëtare dhe mundësive për zhvillim profesional”.

Në këtë kontekst, Prof. Camp solli shembuj nga organizata ndërkombëtare si Projekti i Drejtësisë Botërore, i cili mat faktorët kryesorë që kontribuojnë në vlerësimin global të sundimit të ligjit, siç janë: Barazia para ligjit; Transparenca dhe përgjegjshmëria ligjore; Drejtësia në zbatimin e ligjit; Pavarësia e pushtetit gjyqësor dhe ndarja e pushtetit.

Roli i avokatëve si mbrojtës të drejtësisë dhe barazisë

Prof. Camp theksoi se avokatët janë



mbrojtësit kryesorë të sundimit të ligjit, duke përbushur role të rëndësishme si: Pjesëmarrës në procese gjyqësore dhe mbrojtës të të drejtave të klientëve; Shërbimi si gjyqtarë, duke siguruar drejtësi dhe paanshmëri; Mbikëqyrja dhe kontrolli i institucioneve shtetërore për të siguruar që ato veprojnë në përputhje me ligjin; Ndhima në hartimin e legjislacionit dhe përmirësimin e reformave ligjore.

Ai gjithashtu theksoi nevojën për trajnim të vazhdueshëm dhe specializim të avokatëve dhe gjyqtarëve për të ruajtur kompetencën dhe praktikën etike të ligjit.

“Avokatët mbajnë çelësin e dyerve të pallatit të drejtësisë—ata janë të ngarkuar me përgjegjësinë për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve, të ruajnë paanshmërinë dhe të formulojnë ligje që sigurojnë një shoqëri të drejtë dhe të barabartë. Rëndësia e këtij misioni është e papërbalueshme, pasi pa një sistem ligjor të fortë dhe të besueshëm, nuk mund të mbijetojë asnjë shoqëri e drejtë.”

Mundësitë e bursave për studime diplomike në ShBA

Pjesë e këtij takimi ishte dhe prezantimi i mundësive të bursave për studime

diplomike në ShBA, veçanërisht në fushën e së drejtës. Prof. Camp diskutoi mundësitë që ofron SMU Dedman School of Law për studentët që duan të zhvillojnë karrierën e tyre në ligj, duke përfshirë mundësi bursash dhe këshilla për aplikimin për LL.M. (Master of Laws) në ShBA.

Në këtë drejtim, Prof. Camp theksoi përfitimet e studimit të një LL.M., të cilat përfshijnë: Përmirësimin e njohurive ligjore të specializuara; Rritjen e mundësive për karrierë dhe konkurrueshmërisë në tregun global; Përsosjen e aftësive në gjuhën angleze për praktikën ligjore; Zgjerimin e rrjetit profesional dhe mundësitë për bashkëpunim me liderët e ardhshëm të së drejtës.

Në fund të ligjëratës, Prof. Camp theksoi se avokatët dhe profesionistët ligjorë mbajnë çelësin e drejtësisë dhe sundimit të ligjit, duke luajtur një rol të pazëvendësueshëm në ruajtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në mbarë botën.

Ky takim ishte një mundësi e mirë për studentët dhe të gjithë të interesuarit për të thelluar njohuritë e tyre në fushën e ligjit dhe për të eksploruar mundësi studimi dhe zhvillimi në ShBA.

Rektori Hajrizi vizitoi Panairin Ndërkombëtar të Farmacisë dhe Kozmetikës “Cosmofarma Exhibition” në Bolonja

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka vizituar panairin ndërkombëtar “Cosmofarma Exhibition” që u mbajt në Bolonja të Italisë – një nga ngjarjet më të rëndësishme në Evropë në fushën e farmacisë, kozmetikës dhe mirëqenies.

Ky panair shërben si platformë për prezantimin e risive dhe praktikave më të avancuara në kujdesin farmaceutik dhe estetik, me fokus në shëndetin holistik të qytetarëve.

Pjesëmarrja e UBT-së në këtë aktivitet prestigjioz është dëshmi e angazhimit të saj për të qëndruar në hap me zhvillimet globale dhe për të promovuar standartet më të larta akademike e shkencore, sidomos në Fakultetin e Farmacisë, por edhe në njësitë tjera brenda ekosistemit inovativ të UBT-së.

Gjatë vizitës, Rektori Hajrizi zhvilloi takime me përfaqësues të kompanive farmaceutike dhe kozmetike, duke

shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në fushat e teknologjisë farmaceutike, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të produkteve të reja.

UBT tashmë ka ndërtuar eksperiencë të konsiderueshme në sektorin e farmacisë dhe shëndetësisë, jo vetëm në arsimim, por edhe përmes prodhimeve të veta, me synimin për të zgjeruar më tej bashkëpunimet ndërkombëtare në këtë fushë me ndikim të madh shoqëror.

UBT organizoi diskutim mbi zhvillimin e sigurisë së Kosovës dhe transformimin e FSK-së, me Gjeneralmajor dhe ZVKOMFSK, Enver Cikaqi



Në UBT, u organizua një diskutim i hapur mbi temën e rëndësishme “Proceset e Sigurisë së Kosovës dhe Zhvillimi i FSK-së”, me pjesëmarrjen e Gjeneralmajorit dhe Zëvendës Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (ZVKOMFSK), Enver Cikaqi, i cili ndau eksperiencat dhe vizionin e tij për sfidat dhe zhvillimet e fundit në sektorin e sigurisë në Kosovë. Aktiviteti ka ofruar një mundësi për studentët e Fakulteteve Shkenca Politike dhe Studime të Sigurisë dhe stafin akademik të UBT-së për të angazhuar një bisedë të drejtpërdrejtë mbi rëndësinë e forcimit të sigurisë në vend dhe rolin që

Forca e Sigurisë së Kosovës luan në garantimin e stabilitetit dhe paqes në rajon. Gjatë diskutimit, janë shqyrtuar zhvillimet më të fundit në fushën e sigurisë dhe janë trajtuar tema të rëndësishme lidhur me përgatitjen dhe avancimin e kapaciteteve të FSK-së. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të dëgjojnë nga afër përkushtimin e FSK-së për të kontribuar në stabilitetin e Kosovës, duke përfshirë sfidat dhe mundësitë për forcimin e mëtejshëm të saj. Gjatë diskutimit, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka theksuar rëndësinë e këtij aktiviteti për studentët

dhe komunitetin akademik të UBT-së.

“Në UBT, ne besojmë se arsimimi dhe njohuritë e thella mbi këto çështje janë të rëndësishme për të forcur ndërgjegjësimin dhe për të kontribuar në një të ardhme më të sigurt dhe më stabile për vendin tonë”, tha Rektori Hajrizi.

Nga ana tjetër, Gjenerali Enver Cikaqi, Zëvendës Komandant i FSK-së, ka ndarë me pjesëmarrësit një mesazh të fuqishëm mbi rëndësinë e forcimit të kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe rolin e saj në garantimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

“FSK-ja ka kaluar një transformim të jashtëzakonshëm në vitet e fundit dhe është një nga faktorët kyç në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë. Siguria është një detyrë që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë”, u shpreh Gjeneralmajor Cikaqi.

Ky aktivitet krijoi mundësi për bashkëbisedim dhe shkëmbim ideje për një temë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhmen e sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Pjesëmarrësit kanë shprehur interes të madh për këto çështje dhe kanë kontribuar me pyetje dhe ide mbi mënyrat për të avancuar më tej sigurinë kombëtare dhe rajonale.

UBT nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Abdullah Gül” nga Turqia

Në një hap të rëndësishëm për zhvillimin e arsimit dhe kërkimit shkencor, UBT ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Abdullah Gül” nga Turqia, e cila hap dyert për mundësi të reja për studentët dhe stafin akademik të dy institucioneve.

Kjo marrëveshje e nënshkruar, e cila thellon lidhjet ndërkombëtare, është një mundësi për të përforcuar nivelin edukativ dhe kërkimor dhe për të sjellë eksperiencat të reja ndërkombëtare për komunitetin akademik të UBT-së.

Marrëveshja përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh bashkëpunuese, përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe burimeve mes dy universiteteve, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe trajnimeve të përbashkëta. Pjesë e këtij bashkëpunimi janë edhe mundësitë për kërkime të avancuara shkencore, që do të mundësojnë forcimin e lidhjeve profesionale dhe do të rrisin njohuritë e studentëve dhe stafit akademik në fusha të ndryshme.

Një nga aspektet më të rëndësishme



të kësaj marrëveshjeje është mundësia për certifikim të dyfishtë, që do t'u ofrojë studentëve të dy universiteteve mundësi për të fituar tituj të cilësuar ndërkombëtarisht, duke i mundësuar atyre të konkurrojnë në tregun global të punës me një kualifikim të njohur dhe të vlerësuar.

Po ashtu, në kuadër të marrëveshjes do të organizohen aktivitete si konferenca,

simpoziume dhe seminare të ndryshme, që do të mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe përvojave mes studiuesve, profesorëve dhe studentëve. Këto aktivitete do të krijojnë një mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe për avancimin e dijes dhe kërkimeve shkencore.

UBT organizoi Panairin e Industrive Kreative në partneritet me UNDP Kosovë

Qyteti i Mençur i UBT-së në Lipjan u bë sot pikëtakimi i industrive kreative. Kjo ngjarje, e organizuar në bashkëpunim me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë, ofroi një platformë dinamike për start-up-et lokale për të prezantuar idetë e tyre, për t'u lidhur me mentorë dhe për të eksploruar mundësi të reja brenda industrive kreative të Kosovës.

Ngjarja filloi me fjalime nga mysafirët, përfshirë Ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, përfaqësuesin e posaçëm të UNDP-së në Kosovë, Nuno Queirós dhe Rektorin e UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Panairi dha mundësinë për të paraqitur disa startupet që morën pjesë në një program të gjerë mentorimi të zhvilluar nga UBT në partneritet me UNDP Kosovë. Gjatë disa muajve, këto startupe morën udhëzime të personalizuara, simulime produktesh dhe vizita ekspertësh për t'i ndihmuar ato të rafinojnë idetë dhe të përgatiten për hyrjen në treg.

Në total, u përzgjedhën 10 startupet për të marrë pjesë në program, secila duke sjellë zgjidhje kreative që adresojnë sfida kyçe të industrisë. Nga dizajni i produkteve të qëndrueshme deri te platformat e fuqizuara nga AI, larmia e projekteve të paraqitura pasqyron mundësinë e paçmueshme të sektorit kreativ të Kosovës.

Disa nga startupet më të spikatura ishin: Zonda Creative L.L.C.: Zhvillimi i zgjidhjeve AR/VR për qëllime edukative.



AA Izolimi: Rirregullimi i mbetjeve të poliuretani në beton të lehtë, duke mbështetur ndërtimin e qëndrueshëm.

The Brain Maze: Një platformë edukative interaktive 3D që ka për qëllim të përmirësojë angazhimin e studentëve.

Bling Marketing: Ofrimi i zgjidhjeve të marketingut digjital të përshtatura për SME-të.

Dare to Create: Një platformë e fuqizuar nga AI për dizajnin e brendshëm dhe profesionalët e produktit.

GoCreative: Një platformë softuerike për dizajn që integron module shumëgjuhëshe për qasje më të gjerë.

F-Innovate SH.P.K.: Zhvillimi i një mjeti analize sentimentit në kohë reale për industrinë e medias dhe reklamave.

Anymate: Një platformë krijuese për zgjidhje mësimore që synon përmirësimin e përvojës së përdoruesit. Galanteria SHPK: Prototipa produktesh të qëndrueshme që minimizojnë mbetjet.

Eleven Eight: Një linjë veshjesh për fëmijë të qëndrueshme me para-porosi nga shitësit.

Programi i mentorimit dhe coaching-ut ishte thelbësor në fuqizimin e këtyre startup-eve me mjetet e nevojshme për të pasur sukses në një treg konkurrues. Çdo startup u bashkua me një ekspert të industrisë që ofroi coaching personal në fusha si strategjia e biznesit, planifikimi financiar dhe zgjerimi operacional.

Programi gjithashtu përfshinte simulime produktesh, ku startupet testuan dhe rafinuan Prototipet e Minimumit të Produktit (MVP) në studio mentorësh të UBT-së. Për më tepër, mbështetjet praktike përmes vizitave të ekspertëve të industrisë mundësoi që startupet të merrnin njohuri të vlefshme mbi nevojat e tregut dhe strategjitë e mundshme për rritje.

Delegacioni i UBT-së zhvillon vizitë zyrtare në Universitetin Trakya në Turqi

Në kuadër të thellimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare akademike dhe shkencore, një delegacion i UBT-së, i përbërë nga Dekani i Fakultetit të Biokimisë Mjekësore dhe Bioteknologjisë, Prof. Dr. Fisnik Laha, dhe Drejtori i Institutit të Shkencave Forenzike, Prof. Dr. Cengiz Çesko, zhvilloi një vizitë zyrtare në Universitetin Trakya në Edirne, Turqi, ku u prit nga Rektorin e këtij universiteti, Prof. Dr. Mustafa Hatipler.

Takimi u fokusua në vlerësimin e bashkëpunimit ekzistues ndërmjet dy institucioneve dhe shprehjen e vullnetit të ndërsjellë për intensifikimin e këtij bashkëpunimi në fusha me interes të përbashkët, siç janë biokimia mjekësore, bioteknologjia dhe shkencat forenzike.

Gjatë diskutimeve u trajtuan mundësitë për zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, lëvizshmërinë e studentëve dhe stafit akademik, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si seminare, punëtori shkencore dhe konferenca ndër-



kombëtare. UBT dhe Universiteti Trakya theksuan rëndësinë e bashkëpunimeve afatgjata që ndikojnë në rritjen e cilësisë së arsimit dhe shkencës, por edhe në zhvillimin institucional dhe rajonal.

Rektori Hatipler vlerësoi lart përkushtimin e UBT-së për inovacion dhe ndërkombëtarizim në arsim, duke theksuar

se bashkëpunimet ndëruniversitare janë thelbësore për përparimin shkencor dhe integrimin global të dijes. Në të njëjtën frymë, përfaqësuesit e UBT-së shprehën mirënjohje për mikpritjen dhe konfirmuan gatishmërinë për të shkëmbyer njohuri, përvoja dhe ekspertizë në nivel institucional.

Italian Design Day në UBT: Dizajni si mjet për të luftuar pabarazitë dhe për të ndërtuar një të ardhme më të mirë

Në kuadër të Italian Design Day, në UBT u organizua një konferencë e veçantë e dedikuar për studentët të Arkitekturës dhe Dizajnit, si dhe profesionistëve të fushës, ku u trajtua tema “Pabarazitë. Dizajni për një jetë më të mirë”. Kjo ngjarje shënoi një moment të rëndësishëm për të reflektuar mbi rolin e dizajnit si një instrument për të adresuar pabarazitë dhe për të krijuar një mjedis më gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë. Konferenca u mbajt në Parkun Shkencor, Inovativ dhe Teknologjik të UBT-së në Lipjan, duke bashkuar studentë, akademikë dhe profesionistë të arkitekturës dhe dizajnit me ekspertë të njohur ndërkombëtarë. Ligjëruesi kryesor i ngjarjes ishte arkitekti dhe dizajneri Alessandro Mason, themelues i Studio GISTO, i cili ndau me të pranishmit përvojat dhe qasjet e tyre inovative në dizajn. Duke u bazuar në hulumtimet dhe praktikat profesionale, ai trajtoi mënyrat se si dizajni mund të shërbejë për të zbutur pabarazitë shoqërore dhe për të ndërtuar hapësira që promovojnë gjithëpërfshirjen, mirëqenien dhe një cilësi më të mirë të jetës për të gjithë. Diskutimet u fokusuan gjithashtu në ndikimin e dizajnit në planifikimin urban, arkitekturën sociale dhe krijimin e qyteteve të qëndrueshme, duke nxitur të pranishmit të mendojnë për një të ardhme ku estetika dhe funksionaliteti ecin krah për krah me barazinë dhe drejtësinë sociale.

Në këtë ngjarje morën pjesë edhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Ambasadori i Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, dhe Ark. Gëzim Kastrati nga Komuna e Prishtinës, të cilët theksuan rëndësinë e kësaj teme dhe rolin e arkitekturës e dizajnit në krijimin e një bote më të barabartë. Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, e cilësoi këtë ngjarje si një mundësi të jashtëzakonshme për studentët që të mësojnë nga ekspertët dhe të frymëzohen për të sjellë ndryshime konkrete në arkitekturë dhe dizajn për një shoqëri më



të barabartë.

“Dizajni nuk është thjesht një art apo profesion, por një përgjegjësi ndaj shoqërisë. Ai ka fuqinë të shërojë pabarazitë, të ndërtojë ura bashkëpunimi dhe të krijojë hapësira që pasqyrojnë vlerat e drejtësisë dhe gjithëpërfshirjes. Studentët tanë sot nuk po mësojnë vetëm si të krijojnë forma, por si të formësojnë një të ardhme më të mirë për të gjithë. Pikërisht për këtë arsye, në UBT kemi krijuar dhe zhvilluar departamente të specializuara në fusha si Arkitektura, Dizajni, Inxhinieria dhe Teknologjia, të cilat po tërheqin gjithnjë e më shumë të rinj që dëshirojnë të ndërtojnë të ardhmen me kreativitet dhe inovacion”, tha Rektori Hajrizi.

Ambasadori italian në Kosovë, Antonello De Riu në fjalën e tij inspiruese, citoi arkitektin e njohur Renzo Piano, duke thënë: “Bukuria është po aq jetike sa buka, dhe si buka, duhet të jetë e qasshme për të gjithë”.

Ai shtoi se dizajni nuk është thjesht një art apo profesion, por një mjet për ndryshim shoqëror, i aftë të ripërcaktojë mënyrën se si njerëzit jetojnë, bashkëveprojnë dhe përjetojnë hapësirat rreth tyre.

“Dizajni nuk është një privilegj, por një e drejtë – e drejta për një jetë të dinjitetshme, për një shoqëri të drejtë dhe për një planet të qëndrueshëm. E ardhmja është në duart tuaja, në skicat dhe pro-

jektet që do të krijoni. Ndërtoni qytete që bashkojnë, shtëpi që mbrojnë dhe hapësira që fuqizojnë. Kur dizajni është i rrënjësor në humanizëm, ai nuk është thjesht një mjet për ta zbukuruar jetën, por për ta transformuar atë në thelb”, u shpreh Ambasadori De Riu.

Ark. Gëzim Kastrati, përfaqësues i Komunës së Prishtinës, foli për rëndësinë e urbanizmit të qëndrueshëm dhe nevojën për dizajn që i përgjigjet kërkesave të të gjithë qytetarëve, pa përjashtime. Ai vlerësoi rolin e UBT-së si një qendër e rëndësishme e inovacionit dhe edukimit në fushën e arkitekturës dhe dizajnit.

Ngjarja përfundoi me një sesion diskutimi interaktiv, ku studentët patën mundësinë të ndajnë idetë dhe pikëpamjet e tyre mbi temën e pabarazive në dizajn. Ata u inkurajuan të shohin arkitekturën jo vetëm si një profesion, por si një mjet për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë dhe të qëndrueshme. Italian Design Day në UBT ishte një dëshmi e fuqisë së dizajnit për të ndikuar pozitivisht në shoqëri dhe për të krijuar hapësira që pasqyrojnë vlera të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe drejtësisë sociale. Kjo ngjarje forcoi edhe më shumë bashkëpunimin akademik dhe profesional mes Kosovës dhe Italisë, duke hapur rrugën për ide të reja dhe projekte që synojnë të ndërtojnë një botë më të mirë për të gjithë.

Stafi i UBT-së përfundon me sukses javën e mobilitetit në Bratislavë

Nëntë përfaqësues nga UBT morën pjesë së fundmi në një javë mobiliteti, organizuar nga Universiteti Teknologjik Sllovak në Bratislavë (STU). Gjatë javës u zhvilluan aktivitete të shumta interesante, që kishin për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit institucional.

Mobiliteti filloi me një takim mirëseardhjeje, duke krijuar një atmosferë bashkëpunuese dhe entuziaste për javën. Stafi i UBT-së pati gjithashtu mundësinë të ta

kohej me ekipin e Green Team, ku u diskutua për Formula student dhe mënyrën e organizimit të ekipit, makinës dhe detaje tjera që mund të shërbejnë si frymëzim për zhvillime të ngjashme në UBT. Për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve akademike, u zhvillua një takim me Prof. Maroš Finka, udhëheqës i Qendrës së Ekselencës Spectra, ku u diskutuan mundësi bashkëpunimi kërkimor dhe shkëmbimi njohurish në fusha që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe planifi-

kimin hapësinor. Për më tepër, përfaqësuesit e UBT-së u takuan me Zyrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare (IRO), ku u trajtuan mundësitë për forcimin e mëtejshëm të shkëmbimeve të studentëve dhe stafit, projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunimit akademik ndërkombëtar. Javë e mobilitetit u përmbyll me sukses, duke shënuar një tjetër arritje të rëndësishme në angazhimin e UBT-së për ndërkombëtarizim dhe përsosmëri akademike.

UBT promovon dy botime të rëndësishme shkencore në fushën e mekanikës dhe inxhinierisë së ndërtimit të autorit, Prof. Dr. Naser Morina

Në UBT u mbajt promovimi për dy botime të rëndësishme shkencore në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe infrastrukturës: “MEKANIKA – 1 (Statika)” dhe “MEKANIKA – 2 (Kinematika dhe Dinamika)”, autor i të cilave është Prof. Dr. Naser Morina, profesor i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës.

Këto dy vepra përfaqësojnë një kontribut të vyer akademik dhe praktik në fushën e mekanikës, të ndërtuara mbi një përvojë shumëvjeçare shkencore dhe pedagogjike, duke u shndërruar në literaturë të domosdoshme për studentët universitarë e pasuniversitarë, si dhe për profesionistët e fushës.

Në këtë aktivitet, morën pjesë personalitete të rëndësishme nga bota akademike dhe profesionale, ndër ta edhe Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili vlerësoi lart angazhimin e profesor Morinës, duke theksuar se ky promovim është një tjetër dëshmi e përkushtimit të stafit akademik të UBT-së për avancimin e shkencës dhe dijes në Kosovë dhe më gjerë.

“Ky është një moment i rëndësishëm për institucionin tonë, për studentët dhe për gjithë komunitetin akademik që kërkon dije cilësore. Vepra të tilla i japin hov zhvillimit profesional dhe krijojnë një bazë të fortë për ndërtimin e kompetencave të inxhinierëve të rinj”, u shpreh Rektori Hajrizi.

Në fjalën e tij, autori i librave, Prof. Dr. Naser Morina, ndau me të pranishmit rrugëtimin e tij akademik në ndërtimin



e këtyre dy veprave, të cilat, sipas tij, kanë për qëllim të përmbushin boshllëkun që ekzistonte në literaturën teknike në gjuhën shqipe, duke ofruar një qasje të qartë dhe të strukturuar mbi temat më sfiduese të mekanikës.

Në diskutim mori pjesë edhe Prof. Dr. Visar Krelani, Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, i cili theksoi rëndësinë e pasurimit të burimeve didaktike në gjuhën shqipe dhe rolin që ka kjo literaturë në përgatitjen e inxhinierëve të aftë për sfidat e tregut të punës.

Gjatë promovimit, studentë, profesorë dhe ekspertë të fushës diskutuan mbi përmbajtjen e librave, rëndësinë e tyre për kurset universitare dhe ndikimin që

kanë në avancimin e metodologjisë së mësimdhënies në inxhinieri.

“MEKANIKA – 1 (Statika)” trajton parimet bazë të trupave në ekuilibër, analizën e forcave konkurrenente, strukturat statikisht të përcaktuara dhe analiza të trarëve.

“MEKANIKA – 2 (Kinematika dhe Dinamika)” përfshin konceptet e lëvizjes së pikave materiale dhe trupave të ngurtë, duke ofruar analiza dinamike dhe zgjidhje përmes ekuacioneve diferenciale. Me metodologji bashkëkohore dhe ilustrime të shumta praktike, këto tekste janë projektuar për të lehtësuar procesin mësimor dhe për të forcuar aftësitë analitike dhe teknike të studentëve.

Delegacioni i UBT-së realizon vizitë në TÜBAT, në kuadër të Kongresit të 15-të Kombëtar të Studentëve të Mjekësisë

Në kuadër të Kongresit të 15-të Kombëtar të Studentëve të Mjekësisë, i mbajtur nga data 12-14 prill 2025 në Universitetin Trakya, një delegacion i UBT-së zhvilloi një vizitë zyrtare në Shoqatën e Kërkimeve Shkencore të Universitetit Trakya (TÜBAT).

Gjatë takimit u diskutuan mundësitë për thellimin e bashkëpunimeve akademike dhe shkencore mes dy institucioneve, me fokus në projekte të përbashkëta, shkëmbime studentore dhe zhvillim profesional.

Delegacioni i UBT-së u përfaqësua nga Prof. Dr. Fisnik Laha, Dekan i Fakultetit të Biokimisë Mjekësore dhe Bioteknologjisë, dhe Prof. Dr. Cengiz Çesko. Takimi u përmyll me shkëmbimin e dhuratave simbolike dhe me një ndjenjë të ndërsjellë respekti dhe bashkëpun-



imi.

UBT shpreh mirënjohjen për mikpritjen e ngrohtë dhe organizimin e shkëlqyer të kongresit, duke falënderuar në

veçanti Kryetarin e TÜBAT-it, Ömer Bolat, si dhe të gjithë ekipin organizator për angazhimin dhe profesionalizmin.

UBT shënon Ditën Ndërkombëtare të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT organizoi një ngjarje të rëndësishme në kuadër të Ditës Botërore të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, duke sjellë në vëmendje çështjet thelbësore që lidhen me sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien në vendin e punës.

Në këtë panel diskutimi morën pjesë personalitete të rëndësishme të institucionit: Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, Prof. Visar Krelani, si dhe Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë, Armend Ymeri.

Në fjalën e tij hyrëse, Rektori Hajrizi theksoi rëndësinë e menaxhimit të organizatës si bazë për ndërtimin e një kulture të qëndrueshme të sigurisë. Ai foli për tre standardet kryesore që, sipas tij, janë jetike për funksionimin e çdo organizate moderne.

“Do të doja të nisja duke thënë se është shumë e rëndësishme që organizatat të fokusohen në menaxhimin dhe organizimin e brendshëm. Standardi i parë është menaxhimi i organizatës, i cili ka ndikim në çdo gjë që bëjmë më mirë në jetë. I dyti është sistemi i menaxhimit të integruar, që përfshin sigurinë, shëndetin, mirëqenien. Dhe i treti lidhet me menaxhimin e përgjithshëm që ndikon në çdo proces pune. Sepse në fund të fundit, qëllimi është të kemi njerëz të shëndetshëm, të motivuar, pozitivë – pra një mirëqenie të plotë në vendin e punës”, tha ndër të tjera Rektori Hajrizi. Gjatë panelit, Dekani Visar Krelani vuri theksin te rëndësia e zbatimit praktik



të njohurive të sigurisë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, duke përmendur se studentët e këtij fakulteti përgatiten jo vetëm për të ndërtuar objekte, por edhe për të ndërtuar mjedise të sigurta pune, ku respektohen standardet ndërkombëtare dhe ruhet jeta e çdo punonjësi.

Ndërkaq, Dekani i Inxhinierisë së Energjisë, Armend Ymeri, theksoi sfidat dhe mundësitë që sjellin teknologjitë e reja në aspektin e sigurisë teknike dhe industriale, duke shtuar se një sistem energjetik i mirëmenaxhuar nuk ka vetëm qëllime funksionale, por edhe mbrojtjet dhe shëndetin e njerëzve që punojnë me të.

Në këtë kuadër, prezantoi edhe profesori Hazir Cadraku, ekspert në fushën e sigurisë dhe menaxhimit të rrezikut në punë, i cili solli një perspektivë të gjerë

dhe praktike mbi sfidat dhe zgjidhjet që lidhen me sigurinë në ambientet e punës. Ai theksoi se edukimi i brezave të rinj me qasje të reja dhe standarde ndërkombëtare është kyç për ndërtimin e një kulture të qëndrueshme të sigurisë.

Kjo ngjarje shërbeu jo vetëm si platformë për reflektim dhe ndarje përvojash ndërdisiplinore, por edhe si thirrje për angazhim më të madh të institucioneve, studentëve dhe profesionistëve për të forcuar kulturën e sigurisë në çdo hap të procesit të punës.

UBT konfirmon rolin e tij si promotor i arsimit cilësor, inovacionit dhe përgjegjësisë shoqërore, duke i paraprirë trendeve globale dhe duke vendosur në qendër të vëmendjes njeriun dhe mirëqenien e tij në çdo fushë të jetës profesionale.

UBT organizon aktivitet për Inovacionin dhe Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale

Në një ngjarje të rëndësishme të organizuar nga UBT në bashkëpunim me Agjencinë për Pronësi Industriale dhe Doganën e Kosovës, u trajtua një temë mjaft e rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë dhe industrisë: Mbrojtja e pronësisë intelektuale dhe inovacionit. Ky aktivitet pati si qëllim rritjen e ndërgjegjësimin për rolin e inovacioneve, patentave, dizajneve dhe markave, si dhe nevojën për mbrojtjen ligjore të këtyre të drejtave.

Në këtë eveniment, i cili bashkoi ekspertë dhe profesionistë nga fusha e pronësisë intelektuale, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe studentë, u diskutua rëndësia e sigurisë ligjore për krijimet intelektuale dhe mënyrat e mbrojtjes së tyre për të stimuluar rritjen



e ekonomisë dhe zhvillimin e sektorëve të teknologjisë, inxhinierisë dhe biznesit.

Në këtë kontekst, rektori i UBT-së, prof. Dr. Edmond Hajrizi, dhe përfaqësues

të tjerë, theksuan domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për të mbrojtur pronësinë intelektuale dhe promovuar inovacionin si një faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm.

UBT organizon panel diskutimi në Edicionin e Tretë të Konferencës për Leadership – “Sfida dhe mundësi në qeverisje”



Në kuadër të edicionit të tretë të Konferencës për Leadership, e organizuar nga Qendra për Leadership në UBT, një nga momentet më të rëndësishme ishte paneli i diskutimit mbi temën “Sfida dhe mundësi në qeverisje”.

Ky panel i veçantë mbledhi ekspertë të shquar nga fusha të ndryshme, të cilët ndanë me audiencën mendimet dhe përvojat e tyre për përmirësimin e proceseve të qeverisjes dhe sfidat me të cilat përballen shtetet në zhvillim në implementimin e politikave efektive.

Paneli u moderua nga Prof. Assoc. Dr. Nexhat Kryeziu, anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Ai theksoi rëndësinë e një qeverisjeje të efektshme për zhvillimin e qëndrueshëm të shteteve dhe mundësitë që ofron një qeverisje e tillë për rritjen e transparencës, ndershmërisë dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Në këtë panel, morën pjesë edhe Er. Pooja Agarwal, Pro-Kancelare e Shri Ramswaroop Memorial University në Indi, Rozafa Ukimeraj, eksperte në Politika Publike, dhe Devendra Goyal, sipërmarrës në Teknologji dhe Pasuri të Pa-luajtshme, i diplomuar nga MIT. Secili prej tyre kontribuoi me një perspektivë të pasur dhe të thellë mbi sfidat që hasin vendet në zhvillim në krijimin dhe zbatimin e politikave efektive.

Një nga temat kryesore të diskutuara ishte se si vendet në zhvillim mund të përmirësojnë strukturat e qeverisjes për të përballuar sfidat e korrupsion-

it, mungesës së transparencës dhe pjesëmarrjes të kufizuar të qytetarëve. Er. Pooja Agarwal shprehu besimin e saj se liderët duhet të identifikojnë dhe ndajnë vizionin e tyre me qytetarët për të siguruar që ata të jenë pjesë e procesit të zhvillimit dhe ndryshimeve. Ajo theksoi gjithashtu rëndësinë e edukimit si një mjet kyç për të kapërcyer hendekun e zhvillimit dhe për të krijuar mundësi për brezat e ardhshëm.

Rozafa Ukimeraj, me një përvojë të gjatë në administratën publike, ndau perspektivën e saj për rëndësinë e krijimit të politikave të bazuara në prova që mund të zbatohen një qeverisje efektive. Ajo theksoi se për të përmirësuar qeverisjen, është e domosdoshme që të bëhen reforma në administratën shtetërore dhe të krijohet një kulturë përgjegjshmërie dhe transparence.

Devendra Goyal, një sipërmarrës dhe ekspert i teknologjisë, foli për mundësitë që ofron përdorimi i teknologjisë dhe digjitalizimit në përmirësimin e shërbimeve publike dhe të struktura të qeverisjes. Ai sugjeroi që mund të zhvillohen platforma të reja për përmirësimin e transparencës dhe aksesit të qytetarëve në informacionin publik.

Panelistët ishin njëzëshëm në theksimin e rëndësisë që ka angazhimi i qytetarëve në krijimin e politikave dhe proceseve që i prekin ata direkt. Në këtë kontekst, Devendra Goyal foli për përgjegjësinë që ka çdo qytetar për kontribuar në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të drejtë. Ai thek-

soi se duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë mes qytetarëve dhe liderëve për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Prof. Assoc. Dr. Nexhat Kryeziu, duke moderuar diskutimin, nënvizoi gjithashtu se ndërtimi i një liderशिpi të qëndrueshëm dhe transparent është një proces që kërkon angazhim të përbashkët dhe një planifikim të qartë nga të gjitha nivelet e qeverisjes.

Paneli u mbyll me një mesazh optimist nga të gjithë panelistët, të cilët besuan se, megjithë sfidat që ekzistojnë, ka mundësi të mëdha për zhvillimin e qeverisjes në Kosovë dhe në vendet në zhvillim. Ata theksuan se arritjet e mundshme do të vijnë përmes angazhimit të përbashkët, përdorimit të politikave të bazuara në prova dhe inovacioneve që mund të ofrojnë teknologjitë moderne.

Në përfundim të konferencës, pjesëmarrësit që ndoqën programin morën certifikata të përfundimit, duke vërtetuar përkushtimin e tyre për forcimin e liderशिpit dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, si në nivel lokal, ashtu edhe në atë global.

Konferenca për Leadership, edicioni i tretë, ka qenë një sukses i jashtëzakonshëm, duke bashkuar ekspertë dhe liderë të nivelit të lartë dhe duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e liderशिpit në Kosovë dhe më gjerë.

UBT organizoi suksesshëm Edicionin e Tretë të Konferencës për Leadership – Ekspertët ndajnë vizionet për qeverisjen dhe politikave efektive



Në ambientet e UBT-së, u mbajt me sukses edicioni i tretë i Konferencës për Leadership, një ngjarje prestigjioze që është kthyer në një traditë të rëndësishme në Kosovë. Kjo konferencë u organizua nga Qendra për Leadership e UBT-së dhe mbledhi një audiencë të gjerë, duke përfshirë liderë të industrisë, akademikë, dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Tema e këtij edicioni, “Sundimi Efektiv: Forcimi i Hartimit dhe Zbatimit të Politikave”, i ofroi mundësinë pjesëmarrësve të diskutonin çështje kyçe të qeverisjes, zhvillimit të qëndrueshëm dhe rëndësinë e përmirësimit të proceseve të vendimmarrjes.

Konferenca u hap nga profesori Faton Limani, i cili theksoi rëndësinë e leadershipit në proceset e qeverisjes dhe u shpreh për nevojën urgjente për trajnimin dhe zhvillimin e liderëve të cilët do të përballen me sfidat globale dhe lokale të sotmes. Ai nënvizoi se një leadership i fortë është çelësi i suksesit në zbatimin e politikave efektive dhe menaxhimin e krizave.

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi në fjalën e tij rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe nevojën për zhvillimin e politikave që mbështesin ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme.

Ai shpjegoi se UBT ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të kontribuar në zhvillimin e leadershipit, duke ofruar arsimin cilësor dhe mundësi për zhvillimin profesional të brezave të rinj.

“UBT e ka bërë të qartë angazhimin e tij për të kontribuar në zhvillimin e leadershipit dhe përgatitjen e liderëve të ardhshëm, duke ofruar një arsimin cilësor dhe mundësi për zhvillimin profesional. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të forcuar ndikimin e politikave dhe për të

kontribuar në avancimin e shoqërisë”, tha ai. Ai gjithashtu theksoi se Kosova, si një vend në zhvillim, ka mundësi të jashtëzakonshme për të shfrytëzuar burimet e saj natyrore dhe për të investuar në teknologji dhe inovacion, siç janë digjitalizimi dhe inteligjenca artificiale.

Në lidhje me zhvillimin e leadershipit etiko-ndihmues, Rektori Hajrizi e theksoi nevojën për liderë që udhëheqin me vlera dhe jo vetëm me interesat personale.

“Leadershipi është për të bërë një hap përpara dhe për të marrë përgjegjësi. Na duhen më shumë liderë me kompetenca të duhura, të aftë për të adresuar kompleksitetet e sfidave të sotme”, theksoi ai. Sipas tij, universitetet, përfshirë UBT-në, kanë një rol kyç në krijimin e mundësive për zhvillimin e resurseve njerëzore dhe ndihmimin e zhvillimit të leadershipit të ardhshëm. Në përfundim të fjalës së tij, ai vlerësoi Qendrën e Leadershipit të UBT-së për kontributin e saj të çmuar në trajnimin dhe zhvillimin e liderëve të rinj të Kosovës. Një tjetër fjalim ishte ai i Pankaj Agarwal, Kancelar i Shri Ram Swaroop Memorial University nga India, i cili theksoi rolin e arsimit dhe leadershipit në transformimin e shoqërive. Agarwal ndau eksperiencën e tij si edukator dhe lider transformues, duke theksuar se “Arsimi është ai që mund të sjellë ndryshimin e vërtetë në shoqëri”.

Ai i inkurajoi pjesëmarrësit që të investonin në zhvillimin e potencialit të rinisë për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

“Suksesi është rezultat i përqendrimit në një filozofi udhëheqëse dhe besimit se gjithçka mund të arrihet përmes angazhimit të përbashkët”, shtoi ai.

Agarwal gjithashtu theksoi se arritjet e

tij janë të mundura përmes punës së përbashkët dhe besimit në filozofinë e leadershipit të ndërtuar gjatë viteve.

Fjalimi i Ahmet Ismailit, Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës, shtoi një dimension të rëndësishëm në konferencë, duke folur për rëndësinë e qeverisjes efektive dhe rolin e Bankës Qendrore të Kosovës në forcimin e sektorit bankar të vendit.

Ismaili theksoi se “Qeverisja korporative është një shtyllë kritike për stabilitetin, integritetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit bankar”. Ai foli për praktikën e dobëta të qeverisjes që janë shpesh shkaktarë të dështimeve të mëdha bankare, duke çuar në kriza sistematike dhe humbje të besimit të publikut.

“Duke zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht kornizën tonë rregulatore dhe duke punuar ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, ne sigurojmë që sistemi bankar i Kosovës të qeveriset me përgjegjshmëri dhe qëndrueshmëri”, theksoi ai. Në përfundim, Ismaili nënvizoi se qeverisja nuk është thjesht një kërkesë rregulatore, por është baza mbi të cilën ndërtohen institucione bankare të qëndrueshme, transparente dhe besueshme. Ai shprehu angazhimin e Bankës Qendrore të Kosovës për të vazhduar forcimin e sektorit bankar përmes politikave të qëndrueshme dhe të bazuara në transparencë dhe siguri.

Konferenca për Leadership, edicioni i tretë, është një dëshmi e angazhimit të UBT-së dhe institucioneve të tjera për zhvillimin e leadershipit dhe forcimin e proceseve të qeverisjes në Kosovë. Ngjarja përfundoi me një angazhim të fortë për të vijuar përpjekjet në avancimin e politikave që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimin e mundësive për leadership të përgjegjshëm dhe efektiv.

UBT organizon diskutim të nivelit të lartë mbi sundimin e ligjit dhe reformat në sistemin gjyqësor shqiptar

Në ambientet e UBT-së u mbajt një diskutim akademik me rëndësi të veçantë mbi temën “Sundimi i ligjit dhe reformat në sistemin gjyqësor të Shqipërisë”, një ngjarje që mbërtheu vëmendjen e studentëve, profesorëve dhe ekspertëve të fushës së drejtësisë.

Aktiviteti, përfaqëson një përkushtim të qartë për të sjellë praktikën më të mira ndërkombëtare dhe për të ndihmuar në formimin e një gjenerate të re juristësh të përgatitur, etikë dhe të aftë të kontribuojnë në ndërtimin e shtetit të së drejtës.

Në hapje të aktivitetit, Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, theksoi rëndësinë që ka ky debat për përgatitjen e studentëve të drejtësisë dhe rolin e UBT-së si një institucion lider në ofrimin e arsimit cilësor dhe të orientuar drejt praktikës.

Ai vuri theksin në domosdoshmërinë që universitetet të jenë jo vetëm bartëse të dijes, por edhe nxitëse të ndryshimeve pozitive në shoqëri, përmes edukimit të profesionistëve të aftë të mendojnë në mënyrë kritike dhe të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme.

Mr. Roland Ilia, ish-kryetar i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në Shqipëri dhe profesor i së Drejtës Kushtetuese dhe Administrative, solli një analizë të thelluar mbi sfidat që ka kaluar sistemi gjyqësor



shqiptar në kuadër të reformës në drejtësi. Ai ndau përvojat e tij personale në procesin e vettingut, duke shpjeguar ndikimin e këtij procesi në rikthimin e besimit të publikut në institucionet gjyqësore.

Mr. James Lofton, me përvojë mbi 30-vjeçare në Departamentin Amerikan të Drejtësisë dhe aktualisht ligjërues në SHBA, solli një perspektivë të gjerë mbi konsolidimin e shtetit të së drejtës në vendet në zhvillim dhe rëndësinë që ka mbështetja ndërkombëtare dhe profesionalizmi i brezave të rinj në këto procese. Ai përmendi edhe rolin e studentëve të drejtësisë si “agentë ndryshimi” në vendet e tyre, veçanërisht në kontekste ku sundimi i ligjit është në zhvillim.

Studentët e Juridikut në UBT morën pjesë aktive në debat, duke ngritur pyetje dhe duke shkëmbyer ide për sfidat që për-

ballen në praktikën juridike në Kosovë dhe më gjerë. Përmes kësaj ngjarjeje, ata patën mundësinë të kuptojnë nga afër se si konceptet teorike që mësojnë në auditor marrin jetë në praktikën ligjore ndërkombëtare dhe se sa e rëndësishme është ndërtimi i një karriere që bazohet në integritet dhe përkushtim ndaj drejtësisë. Departamenti i Juridikut në UBT vazhdon të jetë një prej shtyllave më të forta të universitetit, duke ofruar programe moderne studimi, staf të kualifikuar ndërkombëtarisht dhe një qasje të orientuar drejt praktikës, inovacionit dhe etikës profesionale. Përmes aktiviteteve të tilla, ky departament jo vetëm që ndihmon në ngritjen profesionale të studentëve, por kontribuon edhe në zhvillimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe rajon.

Përvoja ndërkombëtare për studentët e Studimeve të Sigurisë në UBT: Ligjëratë ekskluzive me Dr. Tanja Tamminen

Në kuadër të angazhimeve akademike për ofrimin e njohurive bashkëkohore dhe përfshirjes së ekspertëve ndërkombëtarë në procesin mësimor, u realizua me sukses një ligjëratë online me Dr. Tanja Tamminen, eksperte e njohur në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë evropiane.

Ligjëratat u mbajt me ftesë të posaçme për studentët e Studimeve të Sigurisë dhe ishte përqendruar në temën: “Misionet Civile të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bashkimit Evropian (CSDP)”. Ky aktivitet u mundësua falë angazhimit të Profesor Naim Dedushaj, i cili realizoi kontaktin me Dr. Tamminen dhe krijoi hapësirë për bashkëpunime të mundshme në të ardhmen, përfshirë diskutimet për praktika studentore në institucionet e BE-së në Bruksel.

Gjatë ligjëratës, Dr. Tamminen solli një analizë të thelluar mbi rolin dhe funksionin e misioneve civile të Bashkimit Evropian, me fokus të veçantë në menaxhimin e krizave, forcimin e sundimit të ligjit, si dhe mbështetjen institucionale në vendet që përballen me sfida të sigurisë. Ajo ndau përvojat e saj konkrete nga misionet EUAM Ukrainë dhe EULEX



Kosovë, duke ofruar një perspektivë të drejtpërdrejtë për dinamikën dhe sfidat në terren.

Kjo temë u vlerësua si shumë e rëndësishme dhe aktuale për studentët, veçanërisht në një kohë kur roli i Bashkimit Evropian në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit global po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Studentët patën mundësinë të angazhohen në diskutim interaktiv me pyetje dhe komente, duke përfituar nga përvoja dhe ekspertiza e një profesionisteje të kalibrit ndërkombëtar. Kush është Dr. Tanja Tamminen?

Dr. Tanja Tamminen është doktore e shkencave politike nga Sciences Po Paris, dhe aktualisht udhëheq projektin e Bashkimit Evropian EU4Dialogue. Me një për-

vojë të pasur në politikën e jashtme të BE-së, sigurinë evropiane dhe zhvillimet në Ballkan, ajo ka shërbyer në disa prej misioneve më të rëndësishme të BE-së dhe ka kontribuar në hulumtime të nivelit të lartë në institutet më të njohura të Evropës.

Aktualisht, ajo është edhe profesoreshë e jashtme në Universitetin e Turku në Finlandë, dhe vazhdon të jetë një zë i rëndësishëm në fushën e analizës politike dhe ndërtimit të paqes në rajonet e tensionuara.

Ky aktivitet shënon një hap tjetër të rëndësishëm drejt ndërkombëtarizimit të arsimit në fushën e sigurisë dhe është dëshmi e përkushtimit për të ofruar arsim të cilësisë së lartë me standarde evropiane.

UBT në krye të fuqizimit të vajzave në ICT



Në një epokë ku teknologjia po e dikton ritmin e zhvillimit global, mijëra vajza dhe gra në Kosovë dhe më gjerë kanë zgjedhur që rrugëtimin e tyre profesional ta ndërtojnë në UBT – institucionin lider të arsimit në vend, i njohur për standardet e tij të larta akademike dhe inovacionin në fusha kyçe si teknologjia informative, shkencat kompjuterike dhe inxhinieria.

Me një ekosistem arsimor që fillon nga arsimit fillor dhe shtrihet deri në nivelet më të avancuara të studimeve bachelor dhe master, UBT ka krijuar hapësirë të barabartë për të gjithë, duke u bërë kështu një model i fuqizimit të grave dhe vajzave në fushat që tradicionalisht kanë qenë të dominuara nga burrat.

Mbi 2,500 vajza dhe gra kanë zgjedhur UBT-në për studime në ICT, një numër

që sa vjen e rritet, duke reflektuar jo vetëm një ndryshim kulturor, por edhe besimin që UBT i jep potencialit dhe talentit të gjinisë femërore në këtë sektor strategjik.

Në zemër të këtij vizioni qëndron Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili thekson se:

“Çfarë na motivon dhe na bën krenar është rritja e vazhdueshme e numrit të studenteve në sektorin e ICT-së. Ne besojmë se vajzat dhe gratë do të jenë lideret e inovacionit të së ardhmes. UBT u ofron mbështetje të plotë për të qenë jo vetëm të përgatitura për tregun vendor, por edhe për atë ndërkombëtar – për të konkurruar, për të udhëhequr dhe për të frymëzuar”.

Ky angazhim nuk është vetëm teorik: UBT ofron bursa studimi, praktika

profesionale, akses në laboratorë të teknologjisë së avancuar, si dhe mentoring të dedikuar, për t'i mbështetur studentet në çdo hap të rrugëtimit të tyre akademik e profesional.

Përmes Gjinnazit TIK, vajzat kanë mundësi të fillojnë herët me përgatitjen e tyre për një karrierë në teknologji. Më pas, ato mund të vazhdojnë studimet në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë – shkollën më të madhe të teknologjisë në vend – apo në programe si Sistemet e Informacionit dhe Menaxhim i Mekatronikës.

UBT është më shumë se një universitet – është një platformë për fuqizim, inovacion dhe përfaqësim. Në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave në ICT, por edhe çdo ditë të vitit, UBT promovon rolin e grave në teknologji përmes aktiviteteve, kampanjave vetëdijesuese dhe projekteve që synojnë ndryshimin afatgjatë.

Sot, qindra vajza dhe gra të diplomuara nga UBT janë në pozita udhëheqëse në kompani të teknologjisë, kanë nisur biznese të suksesshme, janë pjesë e institucioneve vendore e ndërkombëtare, si dhe kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit përmes njohurive dhe përvojës së tyre.

Kjo nuk është vetëm histori suksesi, por një transformim i vazhdueshëm që UBT po e udhëheq me përkushtim. Me synimin që Kosova të ketë më shumë shkencëtarë, programere, inxhinierë dhe udhëheqëse teknologjike, UBT do të vazhdojë të jetë një dritare mundësisish për vajzat dhe gratë që ëndërrojnë më shumë dhe që synojnë të arrijnë gjithçka.

Ekipi i UBT-së pjesëmarrës në Javën Ndërkombëtare dhe Ditët e UNITA në Braşov të Rumanisë

Ekipi i UBT-së, i përbërë nga Anita Sadi-kaj, Emrush Thaçi, Kreshnike Haliti Bimbashi, Blerim Canaj, Faton Azemi dhe Jehona Kapllani-Ilazi, po merr pjesë në Javën Ndërkombëtare dhe Ditët e UNITA, që po mbahet në Braşov të Rumanisë. Ky aktivitet është pjesë e programit Erasmus+ dhe fokusohet te Diversiteti Kulturor në Arsimin e Lartë. Pjesëmarrja e ekipit ofroi mundësi të shumta për shkëmbim dhe bashkëpunim midis universiteteve nga vende të ndryshme, duke promovuar kuptimin dhe dialogun ndërkulturor në kontekstin e arsimit të lartë.

Kjo mundësi ndihmon në forcimin e lidhjeve midis UBT-së dhe institucioneve të tjera arsimore ndërkombëtare, duke



kontribuar në një perspektivë më të gjerë për praktikatat globale arsimore.

Gjatë diskutimeve dhe punëtorive, ekipi shqyrtoi strategjitë për të integruar dhe shfaqur diversitetin kulturor në mje-

diset akademike, duke krijuar ambiente gjithëpërfshirëse që janë të dobishme për studentët, mësimdhënësit dhe komunitetet në përgjithësi.

Fakulteti i Gjuhës Angleze në UBT, model i edukimit të lidhur me praktikën profesionale

Në ambientet e Fakultetit të Gjuhës Angleze në UBT u zhvillua një ligjëratë tematike me rëndësi të veçantë për studentët e këtij programi, me temën “Rëndësia e përkthimit në tregun e punës”. Kjo ngjarje u organizua në kuadër të lëndës “Praktikat e përkthimit në institucionet private dhe publike”, e ligjëruar nga Prof. Rina Sefiu, dhe kishte për qëllim të ofronte një pasqyrë të qartë mbi rolin profesional të përkthyesit në botën bashkëkohore të punës.

Ligjëratata u realizua në bashkëpunim me kompaninë partnere të UBT-së në fushën e përkthimit “Lingua”, një ndër zyrtar më të njohura të përkthimit në vend, përfaqësuar nga Anyla Zajmi dhe Flamur Latifi. Ata ndanë me studentët përvojat e tyre nga terreni profesional, duke sjellë raste konkrete dhe sfida të përditshme me të cilat përballen përkthyesit në institucione private dhe publike.

Studentët e programit të Gjuhës Angleze u angazhuan aktivisht në diskutime, duke ngritur pyetje të cilat preknin thelbin e profesionit të përkthyesit:

- Si ruhet saktësia dhe kuptimi në variantet e ndryshme gjuhësore?
- Si përkthehen idiomat dhe shprehjet kulturore që nuk kanë ekuivalent të drejtpërdrejtë?
- Si trajtohet fjalori informal apo “slang”-u në përkthimet moderne?

Këto diskutime nxorën në pah jo vetëm aspektin teknik të përkthimit, por edhe rolin e përkthyesit si një ndërmjetësues



kulturor, i cili duhet të kuptojë kontekste të gjera shoqërore dhe kulturore përtej njohurive gjuhësore.

Duke folur për rëndësinë e këtij bashkëpunimi, dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, Prof. Alma Lama, theksoi: “UBT dhe Fakulteti i Gjuhës Angleze po dëshmojnë se arsimit modern nuk ndalet te teoria, por shtrihet në jetën reale përmes bashkëpunimeve me industrinë. Studentët po formohen për të qenë të gatshëm që nesër të përkthejnë botën – fjalë për fjalë”.

Ky aktivitet përbën një shembull konkret të përkushtimit të UBT-së për të

ndërlidhur procesin akademik me praktikën e tregut të punës. Bashkëpunime të tilla i japin studentëve mundësinë që të zhvillojnë kompetenca profesionale, të kuptojnë realitetin e tregut dhe të ndërtojnë ura që i çojnë drejt një karriere të suksesshme.

Programi i Gjuhës Angleze në UBT vazhdon të afirmohet si një platformë e fuqishme akademike që ofron jo vetëm dije, por edhe aftësi praktike për përgatitjen e përkthyesve të ardhshëm, të cilët do të luajnë rol kyç në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur globalisht.

UBT dhe Qendra “Ri-Jeta” diskutojnë mundësitë për aftësim profesional të studentëve të Psikologjisë



Në një atmosferë frymëzuese bashkëpunimi dhe përkushtimi ndaj zhvillimit profesional të të rinjve, përfaqësueset nga Qendra “Ri-Jeta” u mirëpritën nga Departamenti i Psikologjisë në UBT.

Takimi u zhvillua në prani të studentëve të psikologjisë, të cilët shfaqën një interes të lartë për avancimin e tyre profesional, duke dëshmuar përkushtimin dhe motivimin që i karakterizon si psikologë të ardhshëm.

Gjatë këtij takimi, psikologjia dhe trajnerja, Naile Elezi, prezantoi mundësitë që Qendra “Ri-Jeta” ofron për aftësim profesional përmes trajnimeve të avancuara ndërkombëtare, të cilat priten të realizohen në ambientet e qendrës. Këto trajnime synojnë të pajisin studentët me njohuri dhe aftësi bashkëkohore që do t’i ndihmojnë të jenë sa më të përgatitur për sfidat e profesionit.

Studentët e psikologjisë eksplorojnë rolin e psikologut në shkolla

Studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Psikologjisë në UBT, nën udhëheqjen e profesoreshës Diana Sejdiu-Shala, realizuan një vizitë studimore në kuadër të lëndës “Psikologji e Edukimit”.

Vizita u zhvillua në shkollën “Gjumnazi i Specializuar Matematikor” në Prishtinë, në bashkëpunim me drejtoreshën e shkollës, Fahrije Latifi Retkoceri, dhe psikologjen Fitore Azemi. Ato ndanë me studentët historinë, sukseset dhe përditshmërinë e institucionit arsimor.

Qëllimi i kësaj vizite ishte t'i ofronte studentëve një përvojë të drejtpërdrejtë me procesin edukativo-arsimor, si dhe me rolin e psikologut në shkollë – veçanërisht në një mjedis që promovon qasje moderne dhe të integruar në arsim. Kjo përvojë u mundësoi



studentëve të kuptojnë më mirë kontributin e psikologëve në ndërtimin e një ambienti të shëndetshëm dhe

mbështetës për nxënësit, me fokus të veçantë në mirëqenien e tyre emocionale dhe sociale.

Delegacioni i UBT-së realizon vizitë në TÛBAT, në kuadër të Kongresit të 15-të Kombëtar të Studentëve të Mjekësisë



Studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Psikologjisë, në kuadër të aktiviteteve praktike dhe nën mbikëqyrjen

e Prof. Violeta Zefi, realizuan një vizitë studimore në qendrën psikologjike “Radix” dhe Asociacionin Kosovar për

Psikoterapi Trupore, në Prishtinë.

Gjatë kësaj vizite, studentët patën mundësinë që të bashkëbisedojnë nga afër me psikologun klinik, Arber Zeka, i cili gjithashtu është udhëheqes i të dy institucioneve, ndërsa pjesë e bashkëbisedimit ishin dhe psikologët Behare Bojaxhiu, Urtina Hajdini Sopa dhe Vlera Bokshi Ukmata. Bashkëbisedimi u fokusua në psikoterapi trupore, rolin e trupit dhe emocioneve në terapi dhe marrëdhënien e ndërlikuar midis traumës dhe trupit.

Fakulteti i Psikologjisë vazhdon të mbështesë iniciativa të tilla që krijojnë ura mes teorisë dhe praktikës, duke e konsideruar edukimin praktik si një komponent kyç në përgatitjen e psikologëve të ardhshëm.

Studentët e vitit të 5-të të Stomatologjisë vizituan Institutin e Mjekësisë Ligjore

Studentët e vitit të 5 të Fakultetit të Stomatologjisë, së bashku me profesorin Arsim Gerxhaliu, kanë realizuar një vizitë të rëndësishme në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML). Gjatë kësaj vizite, studentët patën mundësinë të njihen nga afër me të gjitha departamentet që përbëjnë IML-në. Ata vizituan klinikat, ku kryhen ekzaminimet e dhunës fizike dhe seksuale, si dhe sallat e autopsisë, ku kryhen procedurat e hetimit të vdekjes.

Kjo vizitë u zhvillua si një mundësi për studentët të kuptojnë dhe të shohin praktikisht proceset e mjekësisë ligjore, të cilat janë të rëndësishme për



profesionin e stomatologjisë dhe të mjekësisë në përgjithësi. Gjatë vizitës, studentët patën mundësinë të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë mbi procedurat e mjekësisë ligjore me profesionistët

e fushës. Ky aktivitet është një mundësi e shkëlqyer për të pasuruar njohuritë praktike dhe për të thelluar kuptimin mbi rolin e stomatologjisë në kontekstin e mjekësisë ligjore.



UBT, #1 për kërkime shkencore sipas **National H-index Ranking** për tremujorin e dytë të vitit 2025

www.ubt-uni.net



UBT RENDITET **#1** NË KOSOVË DHE NDËR UNIVERSITETET MË TË MIRA NË RAJON NGA **THE IMPACT RANKINGS 2025**



UBT VAZHDON TË VENDOSË STANDARDE GLOBALE

*përkrah universiteteve më prestigjioze në botë në rangimin e fundit nga **WURI***



www.ubt-uni.net






#1 RANKED

institucion i arsimit të lartë privat në rajon sipas renditjes së **Webometrics**



www.ubt-uni.net



#1 RANKED
UBT first institution in Kosovo for science by **SCImago**

www.ubt-uni.net



UBT rangohet në mesin e

TOP 200

institucioneve më të mira për krijimin e kampuseve të gjelbra dhe të qëndrueshme, sipas **UI GreenMetric World University Ranking**



www.ubt-uni.net